



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
26,27,28,29 SHKURT DHE 3 MARS 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
26,27,28,29 FEBRUARA I 3. MARTA 2008.GODINE

SHKURT, MARS – FEBRUAR, MART
2008

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përfitim të ish zyrtarëve të lartë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat bujqësore Nr. 2003/9,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligji për procedurën kontestimore,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligji për procedurën përmbarimore,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligji për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligji për procedurën jokontestimore,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligji për parandalimin e pastrimit të parave,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligji për Noterinë ,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës,
19. Shqyrtimi i parë i Projektligji për përkrahjen materiale të familjeve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme,
20. Shqyrtimi i parë i Projektligji për shitjen e banesave,
21. Shqyrtimi i parë i Projektligji për ndihmë shtetërore,
22. Shqyrtimi i parë i Projektligji për ushqimin,
23. Shqyrtimi i parë i Projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës,
24. Shqyrtimi i parë i Projektligji për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
25. Shqyrtimi i parë i Projektligji për eficientësinë e energjisë,
26. Shqyrtimi i parë i Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,
27. Shqyrtimi i parë i Projektligji për tatimin në vlerën e shtuar,
28. Shqyrtimi i parë i Projektligji për modifikimin gjenetik,
29. Shqyrtimi i parë i Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
30. Shqyrtimi i parë i Projektligji për taksën e vendosjes,
31. Shqyrtimi i parë i Projektligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira
32. Shqyrtimi i parë i Projektligji për Inspektoratin e Bujqësisë,
33. Shqyrtimi i parë i Projektligji për mbrojtjen e mjedisit.

Dnevni red:

1. Usvajanje zapisnika sa predhodnih sednica,
2. Vreme za poslanicka pitanja,
3. razmatranje zahteva Parlamentarne Grupe AKR za zamenu clana Komisije za Budet i Financije,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Privremenog krivičnog zakonika Kosova,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Privremenog krivičnog zakonika o krivičnom postupku Kosova,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o beneficijama visokih zvaničnika,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Privremenog Zakona o poljoprivrednim zadrugama Br. 2003/9,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o civilnoj upotrebi eksploziva,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o parničnom postupku,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izvršnom postupku,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona o deklarisanju i poreklu imovine visokih javnih zvaničnika,
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
13. Prvo razmatranje Nacrta zakona o vanparničnom postupku,
14. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sprečavanju pranja novca,
15. Prvo razmatranje Nacrta zakona o beležništvu,
16. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Strateškoj proceni sredine,
17. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o socijalnoj šemi,
18. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Zakona o inspekciji rada,
19. Prvo razmatranje Nacrta zakona o materijalnoj podršci porodica i dece sa trajnim ograničenim sposobnostima,
20. Prvo razmatranje Nacrta zakona o prodaji stanova,
21. Prvo razmatranje Nacrta zakona o državnoj pomoći,
22. Prvo razmatranje Nacrta zakona o hrani,
23. Prvo razmatranje Nacrta zakona o završnom maturskom ispitu,
24. Prvo razmatranje Nacrta zakona o profesionalnoj rehabilitaciji i zapošljavanju lica sa ograničenim sposobnostima,
25. Prvo razmatranje Nacrta zakona o efikasnosti energije,
26. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o podržavanju manjih i srednjih preduzeća,
27. Prvo razmatranje Nacrta zakona o porezu na dodatnu vrednost,
28. Prvo razmatranje Nacrta zakona o genetičkoj modifikaciji,
29. Prvo razmatranje Nacrta zakona o proceni uticaja na sredinu,
30. Prvo razmatranje Nacrta zakona o smeštajnoj taksi,
31. Prvo razmatranje Nacrta zakona o gradjevinskom zemljištu, privatizaciji i davanju pod zakup,
32. Prvo razmatranje Nacrta zakona o poljoprivrednoj inspekciji, i
33. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti sredine.

Agenda:

1. Approval of the minutes from previous sessions,
2. Time for Parliamentary question,
3. Discussion of the request of the Parliamentary Group in replacing the member of the Committee on Budget and Finances,
4. First reading of the Draft Law on Amendment and Supplementation of the Kosovo Provisional Criminal Code,
5. First reading of the Draft Law on Amendment and Supplementation of the Kosovo Provisional Code of Criminal Procedure,
6. First reading of the Draft Law on Benefits to Former High Officials
7. First reading of the Draft Law on Amendment and Supplementation of the Law on Farmer's Cooperatives No. 2003/9,
8. First reading of the Draft Law on Civil Use of Explosives,
9. First reading of the Draft Law on Contested Procedure,
10. First reading of the Draft Law on Executive Procedure,
11. First reading of the Draft Law on Declaration an Origin of the Property of Public Senior Officials,
12. First reading of the Draft Law on Amendment and Supplementation of the Law on Execution of Penal Sanctions,
13. First reading of the Draft Law on Out Contentious Procedure,
14. First reading of the Draft Law on Deterrence of Money Laundering,
15. First reading of the Draft Law on Notary,
16. First reading of the Draft Law on Environmental Strategic Assessment,
17. First reading of the Draft Law on Amendment and Supplementation of the Law on Social Assistance Scheme,
18. First reading of the Draft Law on Amendment and Supplementation of the Law on Labor Inspectorate,
19. First reading of the Draft Law on Material Support for Families of Children with Permanent Disabilities,
20. First reading of the Draft Law on Sale of Apartments,
21. First reading of the Draft Law on State Aid,
22. First reading of the Draft Law on Food,
23. First reading of the Draft Law on Final Exam and Matura,
24. First reading of the Draft Law on Vocational Rehabilitation and Employment of People with Disabilities,
25. First reading of the Draft Law on Energy Efficiency,
26. First reading of the Draft Law on Amendment and Supplementation of the Law on Supporting small and medium enterprises (delivered on 14.02.2008),
27. First reading of the Draft Law on Tax of Added Value,
28. First reading of the Draft Law on Genetic Modification,
29. First reading of the Draft Law on Environmental Impact Assessment,
30. First reading of the Draft Law on Accommodation Tax,
31. First reading of the Draft Law on building lands, privatization and rental of lands
32. First reading of the Draft Law on Farming Inspectorate, and
33. First reading of the Draft Law on Environmental Protection.

Seanca filloi punën në orën 10:00.

Seancën e drejtoi, zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.
Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 94 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 6, pika 2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Para se t'ia fillojmë punës sipas rendit të propozuar të ditës, dua t'ju njoftoj për dy kërkesa.

Njëra është paraqitur nga ministri Mahir Jagcillar dhe tjetra nga ministrja për Energjetikë dhe Miniera, Justina Pula.

Fjalën e ka ministri Mahir Jagcillar.

MAHIR JAGCILLAR: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar deputetë,
Unë kërkoj të bëhet vetëm një ndryshimin pak në renditje, sepse do të kemi në këtë seancë plenare edhe Ligjin për vlerësimin në ndikim në mjedis. Po ashtu, kemi edhe vlerësimin strategjik mjedisor, kështu që mendoj që pika 16 dhe pika 29 të radhiten si pikë e 16 dhe 17, sepse janë dy ligje të ngjashme e të mos e humbim koncentrimin. Pra, janë ligje përafërsisht të njëjta. Shpresoj se do të keni mirëkuptim për këtë kërkesë.
Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, faleminderit zoti ministër! Fjalën e ka ministrja, zonja Justina Pula.

JUSTINA PULA: I nderuari Kryetar i Parlamentit,
Të nderuar deputetë,
Pasi që ky projektligj ishte rikthyer për ripunim në mandatin e kaluar, konsiderojmë se, duke pasur parasysh kohën e shkurtër të Ministrisë për rishqyrtim të këtij projektligji, në marrëveshje me grupet parlamentare dhe të Komisionit përkatës, ne tërheqim nga shqyrtimi në parim, deri në zgjidhjen e projektit të ripunuar të ligjit.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjala është për pikën 25 të rendit të ditës – Projektligji i parë për eficiencën e energjisë.

Dëgjuat këto dy kërkesa, të cilat kanë arritur pasi është propozuar rendi i ditës.

Kush është për miratimin e këtyre dy kërkesave.

Faleminderit!

A ka “kundër”? 1 “kundër”.

A ka abstenime? Faleminderit!

Konstatohet se me shumicë votash u miratua propozimi për dy kërkesat e paraqitura, që do të thotë se pika 29 radhitet si pikë e 17 dhe pika 25 hiqet nga rendi i ditës.

Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt 2008, Kuvendit i propozon që në pjesën e para të ditës të seancës plenare prej orës 10 deri në orën 14, të bëhet vetëm shqyrtimi i projektligjeve, ndërsa në pjesën e pas ditës, prej orës 16 procedohet me votimin e projektligjeve të shqyrtuara në pjesën e seancës së para ditës.

A pajtoheni me këtë agjendë të propozuar nga Kryesia me shefat e grupeve parlamentare.

Për fjalë janë paraqitur Gani Koci dhe Ibrahim Makolli. Fjalën e ka Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Meqë dy ministrat tërheqën projektligjet që i arsyetuan tërheqjet, unë e konsideroj se ne kemi, ose për të mos thënë, pjesa më e madhe e ligjeve – projektligjeve janë të Qeverisë së kaluar dhe shumica prej tyre nga ky Kuvend kanë qenë të rikthyera, dhe tash na janë ofruar po të njëjtat tekste, pa ndryshime. Konsideroj, se ligjet e tilla do të duhej t'u kthehen ministrave përkatëse dhe të ripunohen, të rishqyrtohen dhe të sillen përsëri në Kuvend.

E kam fjalën për dy projektligje: Projektligjin nën pikën 21 për ndihmën shtetërore. Ju e dini shumë mirë, në mandatin e kaluar, ne kemi rikthyer këtë ligj dhe na është ofruar vetëm me ndërrimin e faqes së parë dhe nuk është bërë kurrfarë ndryshimi në të.

Pastaj kemi Ligjin për TVSH-në, që atëherë kemi kërkuar nga Qeveria dhe nga Ministria përkatëse që duhet të kenë në projekt, së paku të politikave fiskale mbi bazë të cilit ne do të punonim këtë projektligj. Unë konsideroj se Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe Qeveria, në përgjithësi, duhet ta tërheqin këtë projektligj bashkë me Ligjin për ndihmën shtetërore, në mënyrë që vërtet të na sillen ligjet çfarë duhen dhe kërkohen për situatën dhe kohën dhe ndryshimin e rrethanave që kemi tash në Republikën e Kosovës.

KRYETARI: Zoti deputet, jemi në legjislaturën e tretë dhe kur të bëhet rendi i ditës, në ndërkohë, kërkesat e kësaj natyre, është mirë të bëhen me kohë që, vërtet, ne të punojmë sipas rendit të ditës, të mos na bie t'i ndryshojmë gjërat pas kohe, sepse mendoj nuk është mirë as për Kuvendin as për Qeverinë. Jo, ju kisha lutur, ju e dini si bëhet rendi i ditës. Çështje e ngutshme s'është, materialin e keni pasur dhe keni pasur mundësi të bëni kërkesën.

Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zotërinj ministra, zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë,

Sa i përket rendit të ditës dhe duke pasur parasysh gjendjen e sigurisë dhe cenimin e tërësisë territoriale të Kosovës, ditëve të fundit, në kohën kur ne në rend dite nuk kemi mund të parashikojmë gjendjen e krijuar më të re në Kosovë, propozoj që në rend të ditës të futet një pikë e veçantë, ose të debatohet për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në Kosovë, sidomos për këto ditë, të cilat po i kalon Kosova.

Besoj se shumica prej nesh tashmë e dinë se çka po zhvillohet për dhe rreth Kosovës, jashtë dhe brenda kufijve të saj. Kemi edhe përplasjet e fundit ndërmjet protestuesve të dhunshëm serbë – njësitë të Serbisë dhe pjesëtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës. Mendoj se ky Kuvend duhet të debatojë për gjendjen e përgjithshme të sigurisë dhe e ka për obligim të debatojë dhe të marrë qëndrim sa i përket gjendjes së përgjithshme. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh tashmë edhe futjen në territorin e Kosovës të politikanëve të lartë serbë, sikur që kemi rastin e djeshëm të ministrit Samarxhiq, i cili pa lejen e institucioneve tashmë të reja të Kosovës, hyn në pjesë të ndryshme të territorit të Kosovës dhe përpiqet që të ndikojë drejtpërdrejt të bashkëkombësit e vet për të dhunuar në një formë ose tjetrën të territorit të Kosovës.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E njëjta gjë vlen edhe për ty, bile për ty vlen edhe më shumë, por unë dua të them se sa i përket sigurisë Kosova që 8 – 9 ditë kurrë s’ka qenë më e sigurt, prandaj e drejta e qytetarëve është të protestojnë dhe, megjithatë, ne duhet ta përcjellim zhvillimin e ngjarjeve dhe, sigurisht, se me këtë do të merret Parlamenti, por mendoj se sot nuk është për ta futur në rend të ditës.

Kërkoj nga Kabineti qeveritar, e dëgjoj fjalën e deputetit Gani Koci, cili është mendimi i përfaqësuesve të Qeverisë për kërkesën e deputetit Gani Koci?

E ka fjalën ministri Ahmet Shala.

AHMET SHALA:

Përshëndetje të nderuar deputetë,
Zoti Kryetar,

Ne, në bisedën që kemi pasur, më vjen keq në qoftë se ka ngecur në procedura faktikisht administrative, se jemi marrë vesh në parim që këto dy ligje në fakt t’i kthehen Qeverisë – Ligji për TVSH-në dhe Ligji për ndihmat shtetërore, në mënyrë që të kemi mundësi që t’i japim. Kërkoj falje në qoftë se diku në procedurë..., por nuk e di ku është ajo, por pajtohem me propozimin e zotit Koci.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Ministër! Kërkesa nuk ka arritur te ne, por megjithatë, po e pranojmë pasi që edhe Qeveria po kërkon që të tërhiqen këto dy ligje.

Kush është për? Faleminderit!

A ka kundër? 2 vota kundër.

A ka abstenime? 1 abstenim.

Konstatoj se me shumicë votash, miratohet kërkesa e deputetit Gani Koci, me kërkesën edhe të ministrit Ahmet Shala.

Unë edhe njëherë, të nderuar deputetë, po e lexoj propozimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe të shefave të grupeve parlamentare.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt 2008 i propozon Kuvendit, që në pjesën e paraditës të seancës plenare, prej orës 10 deri në orën 14,00 të bëhet vetëm shqyrtimi i projektligjeve, ndërsa në pjesën e pasditës, prej orës 16,00 të procedohet me votimin e projektligjeve të shqyrtuara në pjesën e paraditës.

Mendoj se është një kërkesë e Kryesisë... Urdhëroni! E ka fjalën Zef Morina.

ZEF MORINA: Është mirë, ndoshta, të na sqarohet më qartë, a është fjala për votim në parim apo është fjala për votim të ligjeve veç e veç në përfundim, të themi ashtu. Nëse është fjala për votim në parim, është kërkesë e drejtë. Nëse mendohet ndryshe, atëherë duhet të shikojmë pse.

KRYETARI: Është fjala për votim në parim dhe është leximi i parë.

Fjalën e ka deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Konsideroj të nevojshme, zoti Kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra, të sqarohet edhe më shumë kjo gjë. Meqë është praktikë e shumë parlamenteve të botës që para dite të procedohet ose thjeshtë të debatohet për ligjet dhe pas dite – kohë e caktuar, varësisht se kur dhe si caktohet, votohet për to edhe në parim edhe ndryshe edhe Kryesia edhe shefat e grupeve parlamentare janë dakorduar që kjo praktikë të instalohet edhe te ne, në mënyrë që shumësia e njerëzve që do të votojnë mund të jenë më serioz atëherë kur caktohet koha që do të votohet për ligje. Këtu është problemi. Përndryshe, nuk ka ndonjë ndryshim tjetër. Debatohet 4 orë për ato projektligje që mund të debatohet dhe 2 orë pauzojmë për drekë dhe në orën 16,00 vazhdojmë me procedim normal, por natyrisht të asaj sfare që votohen. Faleminderit!

KRYETARI: Për fjalë është paraqitur Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, Kryetar! Nuk kam fjalë për këtë pikë, e kam kërkuar shumë më herët fjalën për pikën që shkoi, për çështjen e tërheqjes së ligjeve. Mendoj se është dashur të debatohet, tani ka kaluar – ashtu-kështu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E dëgjuat edhe sqarimin shtesë që e dha shefi i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike, zoti Ramë Buja.

Kush është që të procedojmë me kërkesën e Kryesisë dhe të shefave të grupeve parlamentare? Faleminderit!

A ka kundër?

A ka abstenime? Nuk ka. Faleminderit!

Me shumicën absolute është miratuar kërkesa e Kryesisë dhe e shefave të grupeve parlamentare. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

- Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme.

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se procesverbalet e seancave plenare të 15 shkurtit – dy seanca të veçanta, të seancave të 17, 19 dhe 20 shkurtit 2008, si dhe transkriptet e këtyre seancave plenare, u janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët se a kanë vërejtje në procesverbalet dhe transkriptet e këtyre seancave plenare?

Nëse nuk ka vërejtje, atëherë konstatoj se miratohen procesverbalet e seancave plenare të 15 shkurtit, të dy seancave të veçanta, si dhe të seancave plenare më 17, 19 dhe 20 shkurt 2008.

Pika e tretë:

- **Koha për pyetje parlamentare.**

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 21.1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta Në afatin e përcaktuar me Rregullore janë parashtruar 4 pyetje parlamentare:

1. Deputeti Nait Hasani – PDK, bën pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi;
Pasi Kryeministri nuk është këtu, i kemi dy zëvendëskryeministrat dhe, ndoshta, këta janë të gatshëm t'i përgjigjen kësaj pyetjeje. Pyes deputetin a dëshiron ta bëjë pyetjen për seancën e ardhshme kur do ta kemi edhe Kryeministrin? Fjalën e ka Nait Hasani.

NAIT HASANI: Të lutem, unë pyetjen e kam bërë më të 7-tin. Sot jemi thuaja me 27-tin. 20 ditë ka që është bërë pyetja. I keni tejkaluar të gjitha seancat, jo këtë seancë, jo seancën tjetër, jo të jashtëzakonshme, jo të pazakonshme, jo të parakohshme e tjera, i kemi parë rrethanat të cilat i kemi kaluar. Unë jam i interesuar që pyetjet t'i prezantoj: janë dy zëvendëskryeministra, janë mjaft të fuqishëm, po thonë se jemi të fuqishëm dhe dëshiroj që edhe këta të përgjigjen dhe të marrin përgjegjësinë. Nëse, vërtet, janë të fuqishëm, duhet të marrin përgjegjësinë, nëse s'janë, vërtet, të mos na vijnë këtu sa për hijeshi.

KRYETARI: Pse është shtyrë, mendoj se dihet. Nuk ka nevojë tash ne të bëjmë fjalë. Nëse dëshiron ta parashtrosh pyetjen, parashtroje! Shfrytëzoje të drejtën!

NAIT HASANI: Çështja është: Qytetarët e Kosovës janë në gjendje të rëndë ekonomike. Papunësia në shkallën ekstreme mbi 70% e qytetarëve janë të papunë. Shtrenjtimi i bukës dhe i prodhimeve bujqësore janë rritur tej mase, ndërsa ne ende thirrmi në bërjen e pavarësisë së Kosovës, tani veç kjo është kryer. Qytetarët e kanë kuptuar drejt çështjen e Kosovës dhe po presin e durojnë shumë për Kosovën. Unë mendoj dhe kërkoj nga Kryeministri, tani edhe zëvendëskryeministrat që shpërblim për mundin dhe sakrificën e bërë për Kosovën të qytetarët të jenë shpërblim – shlyerja e borxheve të energjisë elektrike. Kjo do të ishte fillim i ri në Kosovën e re, në shtetin e Kosovës.

Pyetja: A do të ketë shpërblim për qytetarët e Kosovës për mundin, sakrificën tetëvjeçare të pritjes në buzë ekzistence për jetë. Pra, a do të ketë shlyerje kolektive të borxheve të energjisë elektrike për qytetarët e Kosovës, për familjet e tyre, jo për biznesin.

KRYETARI: Fjalën e ka zëvendëskryeministri, zoti Hajredin Kuçi.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zoti Hasani, ne jemi të fuqishëm, por jo më shumë se Kryeministri. Edhe ne jemi marrë vesh që në pyetjet e vështira të përgjigjet ai, në të lehtat ne.

Ne jemi marrë me këtë çështje shumë intensivisht. Kryeministri është marrë, është marrë edhe Ministria e Energjetikës. Ne kemi menduar për këtë, por janë dy pengesa ligjore.

Pengesa e parë është se është një pjesë e cila është parashkruar, do të thotë parashkrim ligjor që me gjykata nuk mund t'i mbledhim ato dhe e dyta është se si do ta ndienin veten ata të cilët kanë paguar. Është një vendim që nuk merret aty për aty. Ka nevojë një analizë më të gjerë. Unë ju premtoj që Kryeministri në të ardhmen e afërt do të dalë edhe para jush edhe para qytetarëve lidhur me këtë çështje.

KRYETARI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Deputeti a ka pyetje shtesë? Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Ju faleminderit për përgjigjen që i kanë ndarë rolet, por mua më intereson që qytetarët e Kosovës duhet ta kenë shpërblimin dhe ky Kuvend dhe kjo Qeveri kanë mundësi të marrin vendime dhe të nxjerrin ligje dhe ato ligje mund t'i nxjerrin dhe duhet t'i nxjerrin, pikërisht në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Nëse ne miratojmë sot ligje, edhe këtë ligj mund ta miratojmë dhe këtë aneks mund ta miratojmë që qytetarët t'i shpërblejmë për mundin e sakrificën që e kanë bërë për 8 vjet që kanë pritur.

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër Kuçi! A ke përgjigje? Jo. Kalojmë në pyetjen e dytë, përsëri deputeti Nait Hasani ka pyetje për ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Mahir Jagcillarin.

Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: I nderuar Kryetar! Në komunën e Lipjanit i është dhënë leja për punë një firme gurthyesi, e cila thyen gurë mbi Shpellën e Mermerit, në njërën nga vlerat më të çmuara të Kosovës. Kjo firmë i rrezikon këto vlera të shkatërrohen nga minimet për nxjerrjen e gurëve. Pyetja: a do të lejoni që të shkatërrohet kjo vepër arti e natyrës dhe njerëzimit nga kjo firmë përfituese në shkatërrimin e vlerave dhe cilat janë hapat të cilët ju do t'i ndërmerri për ndalimin e kësaj firme?

KRYETARI: Zoti Ministër Jagcillar, e keni fjalën.

MAHIR JAGCILLAR: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar deputet, zoti Hasani. Lidhur me gurthyesin, që thyen gurë mbi Shpellën e Mermerit në Lipjan desha t'ju them se posa kam marrë pyetjen me shkrim menjëherë i kam urdhëruar inspektorët e Mjedisit që të shkojnë në vendin e ngjarjes dhe të vërtetojnë gjendjen faktike. Ata më kanë raportuar me shkrim dhe kanë inspektuar të gjitha kompanitë gurthyesë, ku ishte konstatuar se asnjë kompani nuk kishte zhvilluar aktivitetet operativ. Ministria ka marrë vendim më 12 dhjetor të vitit 2005, me të cilin u është ndaluar të gjithë personave fizikë dhe juridikë në rreth prej 3 kilometrash nga Shpella e Mermerit në Gadime të Ulët si veprimtaria e minimet gurthyes dhe deponimi i materieve eksplozive, si dhe veprimtari të tjera që kanë potencial rreziku, apo që mund të shkaktojnë çrregullimin mjedisor.

Nga e tërë kjo rrjedh konkludimi se mbrojtja e Shpellës së Mermerit në Gadime nga aktivitetet e rrezikshme të minimet është arritur dhe është duke u respektuar vendimi i Ministrisë për operatorët në këtë lokacion.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Zoti deputet, a keni pyetje shtesë? Fjalën e ka Nait Hasani.

NAIT HASANI: Zoti ministër, ne kemi informacione dhe shohim përditë aty firma që nxjerrin gurë dhe kemi informacione dhe ka gjendje faktike të fotografive që aty ka rënë shpella. Unë nuk di me çfarë ligji, me 2005 e 2000 e kur, por unë e di që gjendja e sotme është e tillë dhe cili do të jetë veprimi juaj që do ta ndërmerrni? Tash nëse fillon edhe ndërtimi i autostradës në atë drejtim, aty do të ketë një shkatërrim masiv. A do të lejoni të shkatërrohen monumentet e kulturës të Kosovës – artit të natyrës:?

KRYETARI: Zoti ministër, keni përgjigjen?
Fjalën e ka ministri Jagcillar.

MAHIR JAGCILLAR: Po përgjigja është e njëjtë. Unë e kam shpjeguar se inspektorët kanë analizuar situatën dhe kanë bërë raportin se nuk ekzistojnë aktivitetet operative. Ligji nuk është vendimi nga Ministria prej 12 dhjetor 2005, ekziston vendimi për ndalimin e çdo aktiviteti operativ. Por, në qoftë se ju keni faktet ndryshe, ne jemi të gatshëm të marrim ato të dhëna dhe të vërtetojmë edhe njëherë gjendjen, por me raportin e inspeksionit, gjendja është sipas përgjigjes që e kam dhënë.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Pyetja e tretë. Përsëri deputeti Nait Hasani, kësaj radhe për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Ministrija nuk është këtu. A dëshironi ta bëni pyetjen? Nëse doni ta lexoni pyetjen, mund ta lexoni. Fjalën e ka Nait Hasani.

NAIT HASANI: Çështja: në burgjet e Kosovës gjenden disa grupe të gjykuar - pjesëtarë të UÇK-së, me nga 4 e 5 vjet burg, të cilët qe sa vite janë pa gjykime të plotfuqishme. Ata janë trajtuar në mënyra të ndryshme dhe janë gjykime politike. Unë mendoj se këto raste, si rasti i Kiçinës ose rasti – grupi i Rahovecit, Grupi i Kaçanikut dhe i Shefqet Musliut, duhet të trajtohen me urgjencë dhe të merret vendim për trajtimin e këtyre lëndëve dhe lirin e tyre.

Pyetja: Kur mendoni, zëvendëskryeministër, zonja ministre që këto lëndë të shqyrtohen dhe a ka një afat kohor që mund të shpresojmë se do të vendosim për këto lëndë? Një afat kohor duhet ta kemi, deri kur. Nëse do të ishin këta në burgje qysh do të ishin trajtuar, domethënë edhe këta t'i kishin të njëjtat emocione dhe kërkesa. Prandaj, duhet ta mendoni edhe këtë që t'i dëgjojmë mundësitë si t'ia zvogëlojmë ato mundësi që ata të rrinë më tepër në burg e të mos rrinë atje.

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet. Zëvendësministrat a janë të gatshëm të përgjigjen? Jo! Do të thotë mbetet që pyetja të ketë përgjigje në seancën e ardhshme.

Kalojmë në pyetjen e katërt: Deputeti Riza Smaka – AKR, ka pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Ministri nuk është këtu. Zoti deputet Smaka, a dëshironi të bëni pyetjen apo të pritni seancën ardhshme?
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit! Përndryshe, ministrin e kam informuar edhe gojarisht dhe është i informuar krejtësisht, për atë kam dëshirë që ta shfrytëzoj oportunitetin që shkurtimisht, në të vërtetë, dy pyetje janë.

Ju lutem, pse administrata e Universitetit të Prishtinës teknobyrokratisht me vite e neglizhon kërkesën e bazuar të disa fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, ku ka

nënshkrues edhe ministra të kësaj Qeverie për iniciimin e procedurës për normimin ligjor të moshës 70 vjeçare për pensionimin e profesorit universitar, ashtu sikundër që është në Bashkësinë Evropiane. Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë është : Si mund të tolerohet po ajo administrate që të pranojë me mijëra studentë në kundërshtim me konkursin publik dhe me normativat universitare? Shembull konkret. Fakulteti Ekonomik ka kapacitet për t'i pranuar 400 studentë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Lus regjinë, t'ia vazhdojë kohën.

RIZA SMAKA: Faleminderit! Ju lutem, shembull konkret ilustrues. Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik kanë kapacitet për t'i pranuar, flas sipas standardeve tona, ndryshe edhe më pak, eventualisht 500 studentë. Janë pranuar 1700 – 1800 studentë. Sot e kësaj dite vijnë studentë me indeks në dorë, paraqesin provime, dalin në provime. U mor vesh çfarë rezultati tregojnë. Kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet. Pasi ministri nuk është këtu, e lëmë për seancën tjetër. Shpresojmë se do të kemi përgjigje nga ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Njoftoj deputetët se nëse pyetjet nuk marrin përgjigje brenda dy seancave, ato publikohen në Buletinin e Kuvendit.

Tani në radhë është shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Meqë deputeti Driton Tali është tërhequr nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, Grupi Parlamentar i AKR- së, në pajtim me Rregullën 41 të Rregullores së Punës ka propozuar, që në vend të deputetit Driton Tali, të emërohet deputeti Shkumbin Demalijaj.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 78 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim – miratohet kërkesa e Grupit Parlamentar të AKR-së.

Pika në vazhdim është:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ky projektligj, në mungesë së ministres së Drejtësisë, shtyhet deri sa ajo të vjen, ndërkohë.

E njëjta gjë ndodhë edhe me pikën e 5-të të rendit të ditës. Propozoj që të shtyhet.

Pika e gjashtë:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përfitimin e ish- zyrtarëve të lartë

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin, njërin prej tyre, që në emër të Qeverisë të Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

HAJREDIN KUÇI: I nderuari Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Sot para jush paraqesim Projektligjin për përfitimin të ish- zyrtarëve të lartë, i cili është paraparë edhe në strategjinë legjislative të Qeverisë në vitin 2007 dhe është miratuar nga Qeveria paraprake, më 16 dhjetor të vitit 2007 dhe është rishikuar prapë nga ne dhe është miratuar në shkurt të këtij viti. Projektligji për përfitimet e ish -zyrtarëve të lartë është nënshkruar edhe nga Kryeministri dhe është proceduar në Kuvendin e Kosovës. Qëllimi i këtij projektligji është sigurimi i bazës ligjore për dhënien e përfitimeve ish-zyrtarëve të caktuar të lartë ku përfshihen Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Kryetari i Gjykatës Supreme. Ky projektligj do të zvogëlojë në mënyrë të dukshme numrin e paqartësive sa i përket ofrimit të privilegjeve të ish-zyrtarëve të lartë.

Projektligji në fjalë përcakton ish-zyrtarët e lartë që mund të marrin përfitime të ofruara nga ky projektligj dhe mënyrën e përfitimit të tyre. Domosdoshmëria për këtë projektligj shprehet me faktin se kjo sferë mund të rregullohet dhe të kompletohet me dispozita aktuale dhe adekuate ligjore. Projektligji është i strukturuar në 9 nene në të cilat parashihen: qëllimi i ligjit, përkufizimet, përfitimi monetar, personeli mbështetës, hapësira për zyra, mbrojtja apo sigurimi i ish- zyrtarëve të lartë, pastaj procedura për marrjen e përfitimit, procedura e ankimit, taksimit dhe hyrja në fuqi e këtij ligji. Projektligji për përfitimet e ish- zyrtarëve të lartë është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe që nga fillimi është ndihmuar dhe mbështetur edhe nga ekspertët ndërkombëtarë, të cilët kanë ndihmuar në gjetjen e praktikave më të mira sikur gjendet në vendet më të zhvilluara në rajon dhe më gjerë. Projektligji është hartuar konform standardeve evropiane dhe ka kaluar të gjitha procedurat sipas Rregullores së punës së Qeverisë.

Ju ftoj më në emër të Qeverisë së Kosovës që ta mbështetni këtë Ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër Kuçi!

Sipas radhës, po të kërkonte fjalën, do ta kishte kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, por nuk e ka kërkuar.

Atëherë, fillojmë me grupe. Sipas radhës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar në parim Projektligjin për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë dhe me këtë rast konsideron se Projektligji është proceduar në tri gjuhët konform Rregullës 33.3 a të Rregullores së Punës së Kuvendit. Gjuha juridike është evidente në tërë tekstin në masë të konsiderueshme. Projektligji e ka deklaratën financiare dhe ka implikime të vazhdueshme buxhetore.

Projektligji është i hartuar në përputhje me *acquis communautaire*. Konsiderojmë se në këtë Ligj janë përdorur rregullat e teknikës juridike për hartimin e legjislacionit dhe shprehjet normative në këtë ligj janë përbërë përmes normës dhe paragrafit, që është në rregull.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike gjatë shqyrtimit të parë ka konstatuar se hartuesi i këtij Projektligji me rastin e përpilimit ka bërë disa lëshime të karakterit teknik, siç janë vërejtur në nenin 1.3, 3.7 paragrafi b dhe këto gabime janë të karakterit gjuhësor dhe drejtshkrimor.

Ndërsa, si vërejtje konkrete parimore mund të përmend:

Në preambulën e Projektligjit, baza mbi të cilën është mbështetur hartuesi i këtij Projektligji, është në rregull kur mbështetet me Kornizën Kushtetuese të Kosovës, mirëpo mbështetja në Rregulloren 2001/19 duhet të fshihet sepse nuk i jep të drejtë Qeverisë së Kosovës për miratim të këtij Projektligji.

Neni 3, titulli i këtij neni duhet të modifikohet se është plotësisht i paqartë.

Neni 5.3 dhe 6.2 janë nene me përmbajtje të njëjtë me një dallim krejt në një fjalë “kërkesa” dhe “ankesa”. Prandaj, mund të bashkohen në një nen të vetëm dhe është mirë të specifikohet.

Neni 8.2, të modifikohet konform rrethanave të reja në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë.

Prandaj, meqë këto nene janë të modifikueshme dhe ka mundësi që Komisioni funksional përgjegjës raportues t'i modifikojë në leximin e dytë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e jep pëlqimin që ky Projektligj të aprovohet në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, këtu e kemi emrin e deputetit Ismet Beqiri.

Fjalën e ka shefi i Grupit, Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Më lejoni gjithashtu të përshëndes përfaqësuesit e Qeverisë këtu, zëvendëskryeministrat, ministrat.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim këtë Projektligj për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë dhe i vjen mirë që dalëngadalë po kodifikohen të gjitha këto dukuri dhe kjo është detyra e Parlamentit.

Natyrisht, edhe ne kemi vërejtur se do të duhej që të gjitha këto projektligje që propozohen këtu, të kenë parasysh ngjarjen e 17 shkurtit dhe, në pajtim me këtë, të bëhen modifikimet e nevojshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeziu!
Sipas radhës, Grupi Parlamentar i AKR-së, deputetja Suzana Novobrdaliu.

SUZANA NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Grupi Parlamentar i AKR-së, në parim e mbështet Projektligjin për përfitimin e ish - zyrtarëve të lartë. Konsiderojmë se ky Projektligj pjesërisht i plotëson nevojat, sepse ka edhe kategori të tjera të zyrtarëve të cilët duhet të përfshihen brenda këtij ligji.

Ky Projektligj ka nevojë për plotësime dhe ndryshime në mënyrë që të jetë i aplikueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke pasur parasysh gjithmonë edhe implikimet buxhetore.

Grupi Parlamentar i AKR-së shprehet në favor të miratimit të këtij Ligji pas kalimit të tij nëpër komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, kryetar i Grupit Parlamentar të AAK-së.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Zëvendëskryeministra, ministra,
Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Fjalën e fundit do ta them të parën. Me siguri, edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet këtë Ligj dhe do ta votojë, detyrimisht pas punës nëpër komisionet parlamentare. Unë e përgëzoj ish Qeverinë për këtë Ligj kaq të mirë që e ka bërë dhe Qeverinë aktuale që e ka sjellë pa asnjë ndryshim.

Sidoqoftë, janë disa elemente shumë interesante të cilat duhet të përmenden. Shembull, ta marrim, në raportin për implikimet buxhetore flitet për implikimet buxhetore për vitin 2007. Më lejoni veç t'ju përkujtoj se është fundi i muajit të dytë të vitit 2008 dhe, duke pasur parasysh që Zyra ligjore e Ministrisë së Financave dhe administrata në Ministrinë e Financave i ka pasur diku përafërsisht 2.808 orë pune në dispozicion, ka mundur që, të paktën, t'i ndryshojë këto elemente të cilat flasin për implikimet buxhetore të vitit të kaluar. Ky vlerësim i implikimit buxhetor bazohet në vlerësimin financiar numër 71, datë 17 maj 2007. Ky është projektligji që na ka ardhur tash, ka qenë dashur të ndryshohen, do të thotë. E njëjta gjë vlen edhe për ligjet e tjera.

Ne po flasim për ligjet që kanë ardhur, që duhet të kthehen, që duhet të modifikohen. Ne e dimë se ka pasur shumë punë Qeveria, mirëpo mos harroni se administrata e Kosovës, nëse dikush e llogaritë në orë pune prej momentit kur është votuar Qeveria dhe ka hyrë në zyrë, i ka pasur diku 80 mijë orë pune në dispozicion. Unë nuk besoj që secili zyrtarë i administratës së shtetit është marrë me pavarësinë, andaj ata kanë pasur kohë t'i bëjnë këto ndryshime.

E njëjta gjë vlen edhe për tërheqjen e ligjeve të cilat ndodhën pak më përpara, do të thotë kanë ardhur ligjet pas dy muajsh punë, ligjet të cilat kanë qenë në këtë Kuvend shumë më përpara. Dy muaj askush asnjë gjë nuk e ka bërë përpos që e ka ndërruar faqen e parë të

ligjeve dhe ne tash duhet t'i kthejmë edhe njëherë në Qeveri dhe kush e di se kur na vijnë. Sidoqoftë, do japim kontributin tonë në komisione. Nuk shohim që ka strategji legislative. Kushdo që e kupton fjalën strategji, e kupton që në atë strategji ka vetëm listë të ligjeve, nuk ka strategji. Ku është strategjia aty, pasi që ish ligjet na vijnë me faqe të parë të ndryshuar. Ku është strategjia, cilën strategji e ka adoptuar kjo Qeveri, cilën strategji legislative, nëse është lista e ligjeve që ka ekzistuar nga Qeveria e kaluar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Gjini!

Fjalën, sipas radhës, e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDD-së, zoti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë i jep mbështetje parimore këtij Projektligji. Ndërsa, sa u përket vërejtjeve të cilat i adreson Grupi Parlamentar i LDD-së gjatë procedurës së mendimit, ne do të japim kontributin tonë. Pra, në parim e mbështesim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Sipas radhës, fjalën do të duhej ta kishte SLS-ja, por ata mungojnë.

Tani e ka radhën Grupi Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniçe!

Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržava ovaj zakon i glasaće za njega. U fazi drugog čitanja verovatno ćemo dati primedbe. Jedna koja je evidentna, verovatno je greška u prevodu. Član 3.6, gde se određuju sredstva za bivše zvaničnike, data je u albanskoj verziji 1200 eura, piše godišnje, isto to piše u srpskoj verziji, a engleska verzija piše per monf, što od prilike znači, verovatno je greška, ne znam koja verzija je tačna, verovatno će to u fazi amandamentiranja biti ispravljeno ili utvrdiće se koja je verzija tačna. Inače, u načelu ćemo podržati ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Me radhë kemi pikën e shtatë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve nr. 2003/9

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ftoj ministrin Idriz Vehapi që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin në fjalë.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Shkurtimisht po e bëj prezantimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve.

Qëllimi i këtij projektligji është të rregullojë çështjet të cilat janë të rëndësishme dhe me prioritet për mbrojtjen e bujqve për të siguruar koherencë dhe legjislacion për Ligjin për kooperativat.

Plotësimi dhe ndryshimi duhet të bëhet për shkak të skadimit të afatit prej një viti për regjistrimin e kooperativave ekzistuese. Fjala është për kooperativat të cilat kanë qenë në ish sistemin dhe shumica e të cilave nuk janë regjistruar në afatin kohor të përcaktuar me ligjin që ka qenë në fuqi, Ligjin 2003/21.

Arsyeja e nxjerrjes së këtij Projektligji është vendosja e një kornize themelore legislative e cila specifikon themelimin dhe regjistrimin e kooperativave të bujqve në baza kontraktuese nga persona fizikë dhe juridikë që merren me bujqësi dhe të cilët bashkëpunojnë në kooperativë me qëllim të përsosjes dhe të zgjerimit të veprimtarisë së tyre bujqësore. Veprimtaritë e ushtruara nga fermerët janë në funksion të shtimit të prodhimtarisë dhe të shfrytëzimit të pronave të tyre.

Projektligji përmban 6 nene, duke përfshirë këtu themelimin dhe regjistrimin e kooperativave të bujqve, anëtarët e kooperativës, federatat e kooperativave të bujqve dhe masat ndëshkuese.

Risitë dhe avancimet e Projektligjit me hyrje në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/21 për kooperativat e bujqve kjo fushë do të begatohet dhe do të rregullohet në pajtim me direktivat e BE-së, sipas praktikave më të avancuara për funksionimin e kooperativave të bujqve.

Zbatimi i Ligjit nuk do të ketë implikime buxhetore. Thërras Kuvendin që ta miratojë këtë Projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Lus kryetarët e komisioneve, kryetarët e grupeve parlamentare, ose deputetët që e marrin fjalën në emër të grupeve parlamentare, t'i shtypin sustat që të dalin emrat e tyre në ekran.

Për komision nuk është lajmëruar askush, ndërsa nga Partia Demokratike është lajmëruar deputeti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në arendën e punës ka dalë gabimisht Ligji për kooperativat bujqësore, në fakt duhet të jetë Ligji për kooperativat e bujqve.

Ky Ligj është miratuar në vitin 2003, por deri më tash, si duket, nuk ka gjetur zbatim të duhur, ka pasur mjaft shumë pengesa. Praktika po tregon se bujqit më lehtë organizohen nëpër shoqata profesionale, sesa në kooperativat e tyre që janë një formë e re e organizimit të tyre, por që ende nuk zbatohen.

Duke i parë problemet që janë hasur në zbatimin e këtij Ligji, Ministria ka bërë këto ndryshime dhe plotësime të Ligjit, të cilat ne mendojmë se janë të arsyeshme dhe në emër të grupit kuvendor të Partisë Demokratike i përkrahim për miratim, në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Ligji është mirë, është kooperativat e bujqve, por ne jemi mësuar me kooperativa bujqësore.

Nga LDK-ja, shefi i Grupit, zoti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Me kënaqësi do ta mbështesim këtë ligj për kooperativat e bujqve. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AKR-së fjalën e ka deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, në parim e përkrah Projektligjin për kooperativat e bujqve.

Ky Projektligj ka 8 nene dhe me plotësimin e Ligjit 2003/9 me këto propozime ligji do të jetë më i aplikueshëm dhe i zbatueshëm në praktikë. Edhe ky Projektligj i cili e plotëson Ligjin në fuqi përcillet me mangësi dhe lëshime përmbajtësore, të cilat besojmë se do të merren parasysh nga komisionet në të cilat do të shqyrtohen.

Grupi i AKR-së vërejtjet konkrete do t'ia adresojë komisionit përkatës, andaj në parim e përkrahim që të procedohet më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Sipas radhës, kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Zoti Kryetar, deputeti Ibrahim Selmanaj do të flasë për këtë Ligj.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ibrahim Selmanaj, prandaj unë thashë që të lajmërohen.

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar ligjin dhe vërejtjet të cilat do të pasojnë do t'ia adresojmë komisionit funksional. Kësaj radhe do të ishte shumë me rëndësi për bujqit në Kosovë që Qeveria të mendojë më seriozisht duke pasur parasysh vetë faktin dhe gjendjen që e kemi në bujqësi dhe përpos përkrahjes së ligjit, të ketë mjete buxhetore shtesë të cilat do ta ndihmojnë bujqësinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Sipas radhës, shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, zoti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, mbështet në parim Ligjin për kooperativat e bujqve dhe konsiderojmë se me këto ndryshime të cilat janë bërë, që janë plotësim i ligjit të kaluar, do të arrihet një efikasitet shumë më i madh në implementimin dhe ngritjen e efikasitetit të punës në këtë segment. Prandaj, vërejtjet tona eventuale të cilat mund t'i kemi ne do t'i procedojmë gjatë procedurës së amendimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Sipas radhës, nga SLS-ja nuk janë prezentë.

Grupi “7+”, është lajmëruar kryetari i Grupit, Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti Kryetar i nderuar i Parlamentit të Kosovës,
Zotëri zëvendësministra, ministra,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Në parim, ky është një ligj shumë i shkurtër dhe ne e përkrahim. Mandej, do ta shohim nëpër komisione ku do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pasi nuk janë lajmëruar deputetë të tjerë, shkojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin në fjalë.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Të nderuar deputetë,
Më lejoni që para jush të prezantoj Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve, të iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Me qëllim të ruajtjes së rendit dhe të qetësisë publike dhe duke ditur se substancat eksplozive paraqesin rrezik permanent për jetën dhe shëndetin e njeriut, për pronën dhe mjedisin, si dhe nevojën imediate të dhënies nën kontroll të substancave eksplozive, Ministria e Punëve të Brendshme ka iniciuar Projektligjin për përdorim civil të eksplozivëve. Qëllimi kryesor i këtij Projektligji është vendosja e rregullave ligjore lidhur me përdorimin civil të eksplozivëve.

Projektligji i adreson çështjet që kanë të bëjnë me prodhimin, tregtimin, importimin, eksportin, transitin, transferimin, deponimin, përdorimin dhe asgjësimin e eksplozivëve, si dhe kushtet për mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij.

Nevoja për nxjerrjen e këtij Projektligji ka rëndësi të madhe për faktin se përdorimi i substancave eksplozive nga personat e paautorizuar paraqet rrezik të vazhdueshëm për qytetarët dhe vendin.

Projektligji ka 12 kapituj me gjithsej 54 nene dhe është i bazuar në praktikën e legjislacionit modern si dhe gjatë hartimit është konsultuar direktiva e BE-së që trajton këtë fushë, direktiva numër 93/15, e vitit 93.

Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese dhe krijon stabilitet legjislativ për fushën që e rregullon.

Për zbatimin e këtij Projektligji nevojiten mjete buxhetore, por gjithashtu edhe krijohen të hyra për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Projektligji është i përgatitur në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në bazë të arsyeve të thëna, propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë, në parim, Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve, në mënyrë që i njëjti të procedohet më tutje.

Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Sipas radhës, do të duhej të diskutonte kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme. Fjalën e ka deputeti Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri, pajtim me Rregullën 35.7 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 6 shkurt shqyrtoi, në parim, Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve.

Komisioni vlerëson se Projektligji i sponzoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme është proceduar në Kuvend në pajtim me Rregullën 33.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Në këtë Projektligj përcaktohen kushtet dhe kriteret e prodhimit, të tregtimit, të importit, të eksportit, të transitit, të transferimit, të deponimit, të asgjësimit të eksplozivëve, si dhe kushtet për mbikëqyrjen e ligjit dhe zbatimin e këtij ligji me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njeriut, të pronës dhe mjedisit të tij.

Projektligji ka 12 kapituj me gjithsej 54 nene. Projektligji i përmban: definicionet, dispozitat e përgjithshme, dispozitat ndëshkimore, dispozitat përfundimtare.

Konsiderojmë se në këtë Projektligj janë zbatuar rregullat e teknikës juridike për hartimin e legjislacionit. Shprehja e normave të së drejtës në këtë Projektligj bëhet përmes neneve dhe paragrafëve që përcaktojnë shprehjen formale të strukturës së Ligjit.

Sa i përket aspektit gjuhësor, Projektligji në gjuhën shqipe është formuluar mirë, ku përdoret gjuhë e rrjedhshme juridike. Nevojiten disa korrigjime shumë të vogla. Teksti në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbe duhet të korrigjohet dhe të harmonizohet.

Projektligji përmban edhe lëshime, të cilat do të përmirësohen gjatë shqyrtimit të tij në fazën e mëvonshme. Komisioni i rekomandon Kuvendit miratimin, në parim, të Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve.

Gjithashtu, zoti Kryetar, ne edhe në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike kemi biseduar se në parim mund të shkojë ky Projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Me radhë është kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi i Lidhjes Demokratike të Kosovës konsideron nevojë e ngutshme miratimin e këtij ligji, do të thotë shndërrimin e këtij Projektligji në Ligj dhe, natyrisht, do ta mbështesë parimisht këtë Projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Nga AKR-ja, në emër të Grupit fjalën e ka kërkuar deputeti Shkumbim Demaliaj.

SHKUMBIM DEMALIAJ: Faleminderit zoti Kryetar!

Ne si Grup parlamentar i Aleancës Kosova e Re, e mbështesim Projektligjin, në parim. Me këtë Projektligj, të them kushtimisht, besoj se në të ardhmen mund të kryhen shumë aktivitete në mënyrë të kontrolluar, jo ashtu siç edhe u tha sot nga vetë zoti deputet Nait Hasani sepse po shkatërrohen bukuritë natyrore duke përdorë masë të madhe, një numër të madh të eksplozivëve në mënyrë të pakontrolluar. Edhe deri më tani, 8 vite me radhë janë shkatërruar shumë shtretër të lumenjve duke marrë aty lëndën e parë shumë veprimtari biznese që kryejnë punë të tilla në kuadër të një legjislacioni që garanton formën e organizimit të kësaj veprimtarie dhe që, kushtimisht, besoj se jo rastësisht është vendosur që këtu Qeveria e Kosovës ka marrë të ardhura shumë të mëdha për buxhetin e Kosovës duke i futur në kuadër të minierave dhe mineraleve këto veprimtari.

Mirëpo, tani e tutje besoj se me këtë ligj në mënyrë të kontrolluar mund të kryhen këto aktivitete. Besoj se ne këtë mbështetje po e japim, mirëpo nuk di se Qeveria e Kosovës a ka paraparë për shpenzime, sepse ne nuk kemi program qeveritar, ashtu që mungon edhe strategjia legjislative për 2008. Edhe pse po i mbështesim ne këto projektligje, nuk e di a mund t'i harmonizojmë këto me shpenzimet buxhetore që mund t'i ketë Qeveria mbas aprovimit dhe miratimit të këtyre ligjeve nga Parlamenti i Kosovës. Besoj se është një kundërshtim i madh, mirëpo ne do ta mbështesim këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit! Janë zëvendëskryeministrat dhe anëtarët e tjerë të Qeverisë dhe sigurisht do t'i kenë parasysh vërejtjet që po jepen në këtë drejtim.

Për fjalë është paraqitur në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i AAK-së e ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të konstatoj, si vijon:

Projektligji për përdorimin civil të eksplozivëve fillimisht është hartuar në Ministrinë e Energjisë dhe të Minierave për shkak se është menduar se implementimi i këtij Ligji kryesisht ka të bëjë me minierat dhe aty është dashur të hartohet. Pastaj, ka kaluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe është marrë me këtë Projektligj Departamenti për menaxhim të emergjencave. Këtu shihet se komponenta e sigurisë, që praktikisht bartet dhe fuqizohet në të gjitha nenet që kanë të bëjnë me këtë projektligj, është fuqizuar dhe sipas mendimit tonë nenet që kanë të bëjnë me licencat dhe afatet e atyre licencave, si për prodhim, përdorim, deponim, transportim të eksplozivëve, duhet të rishqyrtohen dhe në mënyrë obligative të konsultohen ekspertët e Kombinatit “Trepça” për shkak se ata janë më të thirrurit që të japin kontributin e tyre gjatë shqyrtimit të këtyre neneve për arsye se mbajtja e këtyre dispozitave ligjore për certifikim, sipas mendimit tonë, do t'u shkaktonte pengesa të mëdha minierave, posaçërisht “Trepçës” në efektshmërinë e këtyre minierave.

Plus asaj, mbajtja e licencave, të këtyre afateve dhe të procedurave për licenca për prodhimin e eksplozivëve, do të ishte si një masë frenuese për ekonominë private ose për të gjithë ata të cilët janë të interesuar ose kanë synim që në Kosovë të instalojnë teknologjinë dhe repartet për prodhimin e këtyre eksplozivëve.

Grupi Parlamentar i AAK-së jep pëlqimin, në parim, për këtë Projektligj, por duke e shfrytëzuar të drejtën e Grupit Parlamentar të kundërshtimit të këtij Projektligji në qoftë se nuk bëhen ndryshime thelbësore në këto nene të cilat sanksionojnë me ligj kushtet për dhënien e licencave në fjalë dhe gjatë shqyrtimit Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri ne i sugjerojmë që të konsultohet me ekspertët e minierës së Trepçës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë është paraqitur për diskutim deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Duke u bazuar në shkresën shpjeguese të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe duke u mbështetur në Vendimin e Qeverisë së kaluar të datës 16.11.2007, me numër 08-280, dhe në Vendimin e Qeverisë së tashme të datës 24.01.2008 mbi aprovimin e Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, mbështet në parim këtë Projektligj dhe e konsideron si të nevojshëm, ndërsa vërejtjet tona eventuale Grupi ynë parlamentar do t'i paraqesë gjatë procedurës së amendimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputetë! Mungon Grupi parlamentar i SLS-së. Radhën e ka Grupi “7+”. Për fjalë është paraqitur kryetari Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar i nderuar!

Qeveri e nderuar,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ne, Grupi Parlamentar “7+” e pranojmë në parim këtë Ligj, mirëpo kisha për t'i shtruar pyetje Qeverisë se a do të ketë buxhet të mjaftueshëm, sepse këtu është një buxhet i parave shumë të mëdha, për çka duhen 800.000 euro për një vit që të harxhohet për këto eksplozive. A do të kemi buxhet, sepse ne e dimë si e kemi buxhetin, sepse duhet të jepet një shumë e madhe. Mirëpo, në parim ne do ta përkrahim. Ju faleminderit !

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Tani është radha e deputetëve të paraqitur për debat. Fjalën e ka deputeti Ethem Çeku, le të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Në parim unë e mbështesë atë që e tha deputeti Naim Maloku. Në fillim, në Ministrinë tonë është hartuar ky Ligj, do të thotë i gjithë koncepti i hartimit të Ligjit ka qenë që të jepen licencat për miniera, duke mos e përjashtuar anën e sigurisë. Unë mendoj që ky ligj, përpos anës së sigurisë, e ka anashkaluar konceptin dhe përdorimin e eksplozivit për miniera, gjë që e bën të pamundur dhe shumë të vështirë funksionimin e minierave.

Prandaj, mendoj që ky ligj duhet të punohet shumë afër me strategjinë e zhvillimit të minierave, me Komisionin e Pavarur të Minierave dhe të Mineraleve, me komisionet e Parlamentit dhe të merret në konsiderim dimensionin ekonomik i këtij ligji.

Nga përvoja e kaluar rezulton se shumë nga vështirësitë e funksionimit të minierave, këtu është edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, që ka qenë i mishëruar me këto probleme, mosfunksionimi i këtyre minierave ka të bëjë me dhënien e licencës për përdorimin e eksplozivit në minierën e Trepçës apo në kompleksin e Trepçës. Prandaj, këtu kur e shoh ligjin, thotë që kemi përvoja të sllovenëve, të kroatëve dhe nga Shqipëria, ndoshta këto përvoja janë të mira për siguri civile dhe për siguri të tjera, por konceptin zhvillimor mbi të cilën bazohet zhvillimi ekonomik i vendit tonë dhe duhet të bazohet zhvillimi ekonomik i vendit tonë në shfrytëzimin e resurseve minerale, nuk është në harmoni me këtë draftligj.

Prandaj, unë si deputet dhe ish ministër, duke i njohur këto probleme, ftoj ministrin që është si bartës i këtij draftligji, të punojë shumë afër me Ministrinë e Energjisë dhe Minierave dhe me komisionet e Parlamentit që ky ta merr dimensionin e vet, dhënien e licencës së shfrytëzimit të eksplozivit në afatet kohore sikur e merr edhe shfrytëzimin e minierave, do të thotë të jetë në harmoni njëri me tjetrin.

Ne do ta japim kontributin po ashtu në komisionin parlamentar për të diskutuar dhe për ta marrë formën që ky ligj ta ketë karakterin, të them edhe njëherë, ekonomik. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet Çeku! Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Me qëllim që të ndihmoj, Ligji kur shqyrtohet në leximin e dytë në Komisionin funksional përgjegjës, po ... disa çështje parimore. Çështja është se në këtë ligj shumë pak është përdorur teknika juridike dhe kjo konstatohet sepse një pjesë e neneve, ku është rregulluar, fillon me numra e më pastaj në nenet tjera përdoren shkronjat, që nuk është unike deri në fund dhe ia humb kuptimin dhe është shumë vështirë për implementuesin në të ardhmen t'i kuptojë shumë drejt dispozitat e caktuara në këtë Projektligj. Po e përmendi nenin 39 të Projektligjit. Ndoshta komisioni funksional gjatë shqyrtimit duhet të ketë parasysh që neni i cili fillon me numra rendor, t'i përfundojë, natyrisht, të gjitha dispozitat me numra rendor.

Çështja tjetër është çështja e nenit 21, 25, 26. Të gjitha këto nene flasin për kërkesa me rastin e përdorimit, me rastin e prodhimit, me rastin e transportimit, të tregtimit, dhe në të gjitha këto nene parashihen dokumentacione të cilat duhet t'i bëjë personi në fjalë apo institucioni. Prandaj, do të ishte mirë që për të mos qenë edhe vëllimor dhe të jetë më i implementueshëm në praktikë, këto nene të bashkohen në një nen të vetëm dhe mandej ky nen t'i ketë dy-tre paragrafë ku do t'i ketë specifikat në rastin e prodhimit, tregtimit, transportimit dhe deponimit të eksplozivit në fjalë.

Dhe, krejt në fund, e kam edhe një vërejtje, që mendoj se duhet të kihet parasysh pse është përdorur fjala licencë në të gjitha këto raste. Edhe kur është fjala për prodhimin e kësaj materie, edhe kur është fjala për depozitim, edhe kur është fjala për tregtimin, transportimin dhe shitjen. Ndoshta është mirë që të shikohet apo të kërkohet edhe nga ekspertët pse është përdorur kjo fjalë licencë ku ka mundur të përdoret edhe ndonjë fjalë tjetër, së paku kur është fjala për shitje apo për depozitim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Për fjalë është lajmëruar deputetja Salë Berisha Shala.

SALË BERISHA SHALA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje të nderuar ministra, zëvendëskryeministra dhe kolegë deputetë,

Projektligji për përdorimin civil të eksplozivëve është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm që i mbulon fushat që u cekën më herët, por konsideroj që e ka një rëndësi të veçantë nga se është një sferë e bartjes së kompetencave, që më herët ka qenë kompetencë e rezervuar, tani bëhet një bartje nga fuqitë e rezervuara tek institucionet tona.

Në parim e mbështes këtë Projektligj në fjalë, kërkoj edhe nga kolegët deputetë ta mbështesin, mirëpo mendoj që këtij Projektligji i mungon një nen apo një aline me të cilën duhet të parashihet bashkëpunimi në mes inspektorëve të minierave, në mes Ministrisë së Energjisë së Minierave dhe Ministrisë e cila e ka hartuar këtë Projektligj. Nuk dua të lëshohem më në detale pse është i rëndësishëm, por e mbështes kolegun tim deputet, zotin Ethem Çeku nga se ky Projektligj para së gjithash është i një rëndësie të veçantë edhe për minierat të cilat përdorin eksplozivin për shfrytëzimin e minierave, siç është Trepça, por edhe guroret, që momentalisht funksionojnë në Kosovë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Pasi që nuk kemi të paraqitur të tjerë për fjalë, kalojmë në pikën e 9-të të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligji për procedurën kontestimore

Nuk e kemi deputeten këtu, andaj kalojmë në pikën 10 të rendit të ditës. Ministria nuk është këtu, kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës.

Edhe pika e 10-të është e njëjtë. Lus Qeverinë që të na njoftojë me kohë për prezencën ose mosprezencën e anëtarëve të Kabinetit qeveritar.

Pika e 11-të, gjithashtu i përket ministres Nekibe Kelmendi.

Kalojmë në pikën e 12-të, gjithashtu, pika e 13-të, gjithashtu. Pika e 14-të.

E lexojmë edhe këtë dhe shkojmë në pauzë. Urdhëro, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, Kryetar!

Kështu qysh kemi filluar dhe të mos të jenë ministrat këtu, ne si duket do t'i kalojmë të gjitha. Do të ishte mirë që ta kemi një pushim të shkurtër, që të ftohen ministrat të jenë të pranishëm në sallë, që ne të procedojmë në mënyrë të rregullt, ndërsa po shihet po ashtu që shumica e këtyre draftligjeve janë shumë të vjetra, që shumicës nga ato i ka kaluar edhe koha, nuk janë të harmonizuara, andaj propozoj që të kemi në pauzë, të ftohen ministrat këtu, që ne mos të mbesim peng i ministrave dhe të kthehemi prapë në pikën zero ku ishim më herët.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Unë mendoj që e bëra me kohë kërkesën dhe sigurisht Kabineti qeveritar do ta ketë parasysh këtë.

E kemi në radhë pikën e 14-të:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave

Urdhëro! Deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Përshëndetje, zoti Kryetar,

Ndoshta edhe më herët ma përmendët emrin, e arsyeja ka qenë pikërisht kjo që përfaqësohet e tha zoti Makolli. Kur ishte fjala për emrin e grupit, normalisht që nuk isha unë i autorizuar, por desha ta them këtë që u tha. Unë ju lus, se edhe ju e thatë në një mënyrë, por më duhet që edhe unë ta përsëris. Po ju lus që Ju, si Kryetar, mos t'ju qesin në pozitë të palakueshme e pastaj edhe ne. Le të dihet kush është i ngarkuar të prezantojë iks projektligjin, e kush jo. Normalisht, kush nuk është i ngarkuar, ai nuk vjen, por kjo që po na ndodhë, do me thënë fillimisht po ju detyrojnë juve që t'i përsëritni ose t'i thoni pikat. Ne, realisht, po na përgjysmohet rendi i ditës, prandaj edhe unë e mbështes atë që të jemi vërtetë më serioz, të jenë ministrat këtu dhe të dihet se cili është i ngarkuar me cilin projektligj, e jo të na ndodhë kjo që po na ndodhë. Do të thotë, të jetë një vërejtje që edhe ju e bëtë. Unë desha ta them edhe më herët të njëjtën gjë, por meqë tash mu dha rasti, e përsërita. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ne mendojmë që të vazhdojmë punën. Ne hymë në rendin e ditës, ta përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës dhe pastaj të marrim një pauzë.

Ju lutem, dëgjoni!

Projektligji ju është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim. Ftoj Ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

AHMET SHALA: I nderuari, zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar kolegë, zëvendëskryeministra,

Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave e kemi përgatitur, faktikisht është përgatitur edhe më herët, por mbase me një impet të vogël është paraqitur tani para jush për miratim.

Në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut është në fuqi për trajtimin e pastrimit të parave, e cila ka numrin 2004/2, origjinal, në vitin 2004, pastaj me një përmirësim Rregullorja 2005/9, bën disa përmirësime. Megjithatë, kjo rregullore e fundit, pra, 2005/9 ka mjaftë mangësi, ndërsa Projektligji që kemi përgatitur është më gjithëpërfshirës dhe i harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Për hartimin e këtij projektligji jemi mbështetur në praktikën e shteteve të Bashkimit Evropian, e veçanërisht në parimet e udhëzimet e Direktivës të Këshillit të BE-së nr. 91/308/EC, përkatësisht European Comition të datës 10.12.91, për parandalimin shfrytëzimit të sistemit financiar, me qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe të Direktivës 2001/97/EC të Parlamentit Evropian të datës 4.12.2001, për ndryshimin e Direktivës së Këshillit të BE-së, nr. 91/3008/EC. Ky projektligj është me rëndësi të veçantë, sepse parasheh ndërmarrjen e masave preventive për pengimin e pastrimit të parave.

Parandalimi i pastrimit të parave është një nga mjetet më efikase për luftimin dhe ndalimin e krimit të organizuar dhe të formave të tjera të aktivitetit kriminal. Ndalimi i keqpërdorimit të institucioneve financiare për legalizim të origjinës së parave të fituara nga aktivitete kriminale, është një domosdoshmëri e kohës për një sistem financiar dhe shërbime financiare të qëndrueshme dhe efikase. Kjo është gjithnjë në shërbim të rritjes së një imazhi dhe besimi më të mirë në këto institucione të rëndësishme të Kosovës.

Qëllimi këtij ligji, është që të krijohet një infrastrukturë ligjore për identifikimin e saktë të klientëve dhe për një raportim të çdo transaksioni të dyshimtë për pastrimin e parave, si dhe e gjitha kjo në funksion të parandalimit, zbulimit, luftimit dhe pastrimit të parave të fituara nga aktivitetet kriminale.

Neni 1 i këtij projektligji në mënyrë përmbledhëse i ka paraparë të gjitha institucionet dhe organizmat e tjerë që duhet të veprojnë, me qëllim të parandalimit, zbulimit, luftimit të këtij lloji të krimit, si janë: bankat, institucionet financiare, partitë politike, avokatët, noterët, auditorët, kontabilistët e certifikuar, OJQ-të, kazinot, agjentët e patundshmërive dhe bizneset e tjera.

Në bazë të nenit 6, paragrafi 1, pika 4 dhe 5, obligohen bankat dhe institucionet financiare, që për çdo transaksion në para, në shumë prej 15.000 euro, ta identifikojnë klientin. Në Rregulloren paraprake, e dini që ka qenë 10.000 euro.

Organi kompetent tek i cili duhet të raportohet është Njësia për Parandalimin e Pastrimit të Parave përbrenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Projektligji përmban gjithsej 16 kapituj dhe ka 34 nene. Thërras Kuvendin, deputetët e nderuar dhe Kryesinë, ta miratojë këtë projektligj.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Tani e ka radhën kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci.

GANI KOCI: Unë kësaj radhe do të flas në emër të Grupit Parlamentar, por mund të them edhe diçka në kuadër të asaj kompetence. Është interesant se gati janë bërë dy vjet që ky ligj iu ka proceduar Kuvendit të Kosovës dhe Komisioni i mandatit të kaluar për Buxhet ka pasur një vështirësi shumë të madhe në përmirësimin, harmonizimin me të gjitha standardet dhe konventat ndërkombëtare dhe ia ka arritur këtij qëllimi. Paraprakisht, dua të them se edhe atëherë e kemi përkrahur si grup parlamentar dhe si grupe parlamentare dhe sot e përkrahim, megjithëse është teksti i njëjtë nga teksti i para dy vjetëve. Unë konsideroj se është një lehtësi për gjithë Kuvendin, por edhe për Komisionin e tanishëm për Buxhet dhe Financa, sepse e gjithë procedura e amendimit të këtij projektligji është kryer, për fat të keq, në fund të mandatit, kur nuk ka pasur mundësi për shkak të zgjedhjeve të mbledhet Kuvendi dhe ta miratojë. Komisioni i kaluar ka përgatitur komplet në bashkëpunim edhe me USAID-in edhe me Zyrën Amerikane edhe me AER-in, por edhe me ekspertë vendorë të fushës, të them të fushave penale, sidomos të fushës së krimit ekonomik. Problematikë e vetme ka qenë vendosja e kësaj njësie për parandalimin e kundër shpëlarjes së parave a të jetë si një mekanizëm i veçantë në kuadër të Qeverisë, a të jetë në kuadër të Ministrisë së Rendit, apo në kuadër të Ministrisë së Financave ose të mbetet në mes këtyre tre mekanizmave qeveritar. Megjithatë, në konsultim me ekspertët e ndryshëm të kësaj fushe, jemi marrë

vesh që kjo të jetë në kuadër të Ministrisë të Ekonomisë dhe të Financave, dhe natyrisht t'i koordinojë punët edhe me segmentet e tjera që merren me këtë çështje.

Nuk dua ta arsyetoj ligjin, sepse tha vetë Ministri, por unë konsideroj se ne jemi vonuar shumë në miratimin e këtij Projektligji, prandaj konsideroj se edhe si komision në këtë rast jemi të gatshëm, që ndoshta mbas një jave, në seancën e ardhshme ta miratojmë këtë ligj sepse jemi të përgatitur me të gjitha amendamentet dhe ndryshimet që, duke pasur parasysh edhe rrethanat tani të krijuara, mund të futen edhe elemente të tjera nga ky ndryshim i statusit të Kosovës tani në Republikë të Kosovës.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Tani edhe unë po e bëj një kërkesë, që vërtet Qeveria t'i harmonizojë ligjet siç duhet pasi janë krijuar rrethanat e reja pas 17 shkurtit, dhe mendoj se duhet t'i ketë parasysh ligjet e tjera që procedohen në Kuvend.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë, konsideroj që Ligji në fjalë është një ligj i cili është proceduar në mandatin e kaluar, është amenduar, mirëpo ashtu siç e tha kolegu im, për shkak të ndërrimit të mandateve ka mbetur dhe konsideroj që Qeveria është dashur ta marrë ligjin e përpunuar në Parlament dhe ta procedojë si një draft të vetin dhe kështu edhe ishte kursyer Komisioni. Përndryshe, dua t'ju them që ky Ligj është punuar në bashkëpunim me Qeverinë amerikane dhe për këtë janë organizuar edhe debate profesionale, në mënyrë që të vijmë deri te një amendim apo një version sa më i përsosur.

Drafti i cili ka ardhur prej Qeverisë është thjeshtë një përcjellje e Rregullores që është në fuqi, që funksionon kjo njësi që udhëhiqet nga ndërkombëtarët dhe nxjerrja e ligjit nënkupton automatikisht edhe bartjen e kompetencës për këtë institucion tek vendorët.

Problemi më i madh me të cilin jemi ballafaquar gjatë hartimit, amendimit të mëhershëm të këtij ligji ka qenë vendosja e njësisë, pra, ku të jetë ajo. Shtetet e ndryshme e kanë të rregulluar në formë të ndryshme. Për shembull, në Amerikë kjo njësi është e vendosur në Thesar, në disa shtete është në Ministrinë e Financave, në Itali është e vendosur në punët e brendshme, do me thënë ekzistojnë forma të ndryshme dhe ne kemi ardhur në përfundim që duhet të formohet një Njësi i veçantë, i cili duhet të përbëhet nga tri ministri, do me thënë: Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, në kuptimin e asaj që të mund të përcillet sa më mirë.

Ky ligj, në njëfarë mënyre i rregullon edhe më mirë transferet e parave, si ato brenda dhe jashtë. Po ashtu, kemi pasur parasysh edhe bartjen e mjeteve nga jashtë në Kosovë, që kalojnë në kesh. Kjo fushë tash e tutje rregullohet me këtë ligj.

Unë konsideroj që në parim duhet ta përkrahim të gjithë dhe kur të procedohet në Komision, do të jetë një punë shumë e lehtë pasi që ne e kemi bërë më herët, e kemi amenduar ligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Myzejene Selmani

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Shqyrtimin e parë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Grupi ynë parlamentar e përkrah, në parim. Ky ligj ka për qëllim parandalimin e pastrimit të produkteve të veprave penale dhe të kryerjes së veprimtarive kriminale në fushën ekonomike dhe financiare. Mendoj që në prezantimet që janë bërë, mungojnë disa komponentë, të cilat do ta bënin këtë ligj vërtet funksional.

Një element që, paraprakisht, duhet ta kemi të qartë në këtë ligj, është se kujt i përgjigjet shefi i Njesisë së veçantë? Nëse ky i përgjigjet ministrit të Financave, atëherë dyshoj në funksionimin e tij. Që ky të jetë shumë i pavarur, ju propozoj që kjo njësi e veçantë t'i përgjigjet Parlamentit.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Sipas radhës, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë është paraqitur Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Siç e thanë kolegët e mi më herët nga Komisioni i Buxhetit, ne në mandatin e kaluar këtë ligj veç e kemi pasur, e kemi shqyrtuar, e kemi amenduar, kështu që nuk kemi çka të diskutojmë shumë rreth përmbajtjes të ligjit. Edhe pse ndoshta është një version tash më ndryshe, unë shpresoj shumë që prapë kolegët, me të cilët kemi punuar, do ta bartim atë punë në këtë projektligj, sepse vërtet kemi punuar në këtë drejtim.

Para se ta përkrah, e kam një vërejtje zoti Kryetar. Sot është data 26 shkurt, ndërsa më datën 17 e kemi shpallur Pavarësinë e Kosovës dhe ne ende kemi ligjet me logot e Administratës të Përkohshme Ndërkombëtare. Ju kisha lutur që ligjet, së paku edhe pse nuk po i hartoni të reja si Qeveri e re, së paku këto logo t'i ndërroni dhe të na i bini me logon e Qeverisë së re.

Do me thënë, Lidhja Demokratike e Dardanisë i jep mbështetje dhe do të japë kontributin e vet në Komisionin e Buxhetit.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Edhe njëherë faleminderit, por edhe ne e bëmë një kërkesë të tillë pak më herët. Grupi Parlamentar i AAK-së, fjalën e ka kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, Kryetar! Thonë një gjuhë është muzikë për veshë ta dëgjosh deputetin Gani Kocin duke i lavdëruar ligjet. Po më vjen shumë mirë!

Kuvendi i Kosovës është institucion puropolitik, do me thënë nuk ka institucion më politik se Kuvendi dhe me të vërtetë ne bëjmë politikë, duhet të jetë ashtu, në esencë. Të gjitha ato që i kam thënë për Ligjin më përpara vlejnë edhe për këtë ligj, do ta mbështesim, qëndrojnë ato vërejtjet të cilat i përmendëm më parë. Në komisionet të cilat do të shqyrtohet, do ta shqyrtojmë. Sido qoftë, më duhet të kthehem vetëm për një minutë, nuk do t'ju marrë shumë kohë, në këto elemente që po shihen sot, si shembull ta marrim.

Në secilën faqe të parë të ligjit, i cili sillet para nesh, në paragrafin e fundit të faqes së parë, nëse keni kohë ta lexoni shkruan kështu: "Ministri i Ministrisë përkatëse do ta prezantojë Projektligjin para Kuvendit të Kosovës, në rast të mungesës së ministrit",

pastaj thotë: “Projektligjin do ta prezantojë zëvendësministri në mungesë të këtij të dytit, Kryeministri, ose njëri prej zëvendëskryeministrave ose njëri prej ministrave të cilin do ta caktojë Kryeministri i Kosovës”. Do të thotë ekzistojnë diku nga 7 zëvendësime të mundshme edhe ne sot i kalojmë 8 ligje, pa i proceduar, për shkak se nuk është caktuar një person nga Qeveria, që ta prezantojë ligjin.

Zëvendësministrat i kemi votuar, për çka i kemi votuar zëvendësministrat? Ne e dimë se është politikë kjo, mirëpo i kemi votuar zëvendësministrat, e marrin rrogën, asnjë nuk është këtu, përpos një zëvendësministri.

Çështja tjetër është se, në këtë mënyrë agjenda e Kuvendit të Kosovës po i nënshtrohet agjendës së Qeverisë së Kosovës, e nuk duhet të jetë kështu, zoti Kryetar. Duhet të jetë e kundërta, për shkak se ka mundësi, e pamë sa zëvendësime të mundshme ekzistojnë për prezantimin e një projektligji.

Mendoj se, nëse Kuvendi i nënshtrohet agjendës së Qeverisë, atëherë kemi të bëjmë me diçka tjetër e jo me institucione demokratike në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Zoti deputet, sigurisht që Parlamenti nuk do të varet, nuk do t’ia bëjë agjendën Qeveria. Jam dakord që Kabineti qeveritar të mos na vijë në këtë formë, siç kanë prezantuar sot, se në rend të parë nuk është mirë për ta, e pastaj edhe për Parlamentin.

Përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të SLS-së nuk janë, andaj kalojmë te Grupi Parlamentar” 7+”. Fjalën e ka Zylfi Merxha

ZYLFI MERXHA: Zoti Kryetar, ju faleminderit!

Ne këtë Ligj edhe më parë e kemi pasur para nesh dhe shumë mirë e kemi përpunuar. Tani e përkrahim gjithqysh këtë ligj sepse është shumë i mirë.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Tani fjalën e ka, sipas radhës, deputeti Gani Koci

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Mua po me vjen mirë që po i pëlqen zëri im ish- ministrit Ardian Gjini, por duhet të them pikërisht pse ka qenë një ligj i tillë çfarë na e keni prezantuar në Qeverinë e kaluar. Dy vite është dashur të punohet në te dhe këto më duket i dëgjuat, absolutisht. Për dy vjet Komisioni i mandatit të kaluar ka arritur ta bëjë, vërtet, një ligj shumë të mirë dhe ta përmirësoj ministrin, ish- ministrin e Ekonomisë dhe Financave, dhe besoj që tash është më lehtë për ministrin e ri në këtë fushë. Por, të jeni të bindur që ligjet që na kanë ardhur këtu, kritika më e madhe e kësaj Qeverie është pse nuk i ka hedhur krejt poshtë dhe t’ia fillojë prej fillimit, por na ka ngarkuar neve, Kuvendin që të merremi me te, sepse janë ligje të punuara keq nga Qeveria e kaluar. Prandaj, ne po përballemi me këtë dhe do të përballemi, sepse është pasoja e keqqeverisjes suaj edhe me këto ligje këtu, po besoj për një 6 muaj i rregullojmë dhe pastaj i harmonizojmë zërat edhe me opozitën atje.

KRYETARI: Ju faleminderit!

I kemi edhe dy deputetë që janë paraqitur për debat. Urdhëro, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, Kryetar! E kam një dilemë, një konfuzion. Po më duket që vetë deputeti Koci para pesë minutave e tha që teksti i këtij ligj është i njëjti

që na ka ardhur para dy viteve e tash po thotë, kemi punuar dy vjet në këtë ligj për ta sjellë në Kuvend, në mënyrën qysh është tash. Nuk po di, domethënë, ta shohim kush ka punuar dy vjet. A është ai që ka qenë para dy vjetëve apo nuk është?
Ju faleminderit!

KRYETARI: Në Parlament fjala kërkohet, deputeti Gani Koci.
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SAMAKA: Respekt, Kryetar i Kuvendit,
Ministra, deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Ky Ligj është tepër i dobishëm, tepër i nevojshëm dhe parimisht, u mor vesh, angazhohem për të dhe e mbështesim. Nuk ka dokument i cili do të kërkonte një kohë të gjatë, bie fjala një vit e dy vjet, qoftë edhe Kushtetuta. E mbështes vërejtjen e padiskutueshme se kjo pako, ky grumbull i ligjeve që na ka ardhur, që me të vërtetë ka shumë lëshime onomo-teknike, gjuhësore, në të tri gjuhët nuk përputhet teksti. Nëse e lexon në një gjuhë, ka një diksion tjetër, në gjuhën tjetër një tjetër, e kështu me radhë. Vërejtje e përgjithshme është kjo.

Sa i përket ligjit konkret, ju lutem, nuk do të ishte ky ligj efikas sikundër të mos përfshihej edhe tematika e transaksioneve të tjera, sepse paraja e pistë nuk shkon vetëm nëpërmjet pagesave bankare, por edhe nëpërmjet transaksioneve të tjera - kesh. Bie fjala, blihen 100 hektarë tokë pjellore etj. Le t'i blejë kush i ka, mirëpo, në këtë ligj duhet të përfshihet edhe kaptina për regjistrimin e pasurisë, ju lutem, edhe për transaksionet jashtëbankare. Përndryshe, do të ishte një ligj formal, joefikas, kurse ne të gjithë jemi të interesuar që ky ligj, sikundër edhe të tjerët, po ky ligj të aplikohet me konsekuencë edhe me konsistencë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Mendoj se ka ardhur koha që ta bëjmë një pauzë prej 20 minutash. Pas 20 minutash do të shohim se si do të vazhdojmë.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI: Po vazhdojmë punën, zonja dhe zotërinj. Predsednik Skupštine je hteo malo da primenim multijezičnost u Skupštini, pa evo imate priliku malo da čujete vođenje Skupštine i na drugom službenom jeziku. Vidite gospogo mi smo došli do 15. tačke dnevnog reda.

- Prvo razmatranje Nacrta zakona o beležništvu ili notarstvu

Nacrt zakona su svi poslanici dobili na vreme i mislim da su se time stekli uslovi da počnemo sa razmatranjem u principu ovog zakona. S toga, ja u odsustvu ministarke Nekibe Keljmenđi, pozivam zamenika premijera gospodina Rama Manaja da se obrati i da u principu obrazloži ovaj Nacrt zakona.
Izvolite, gospodine Manaj!

RAMË MANAJ: Faleminderit, i nderuari kryesues i seancës!
Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Zëvendëskryeministër,
Në mungesë të ministres së Drejtësisë, një shpjegim të shkurtër për Draftligjin për Noterinë.

Ky është një Draftligj i cili mëton të rregullojë një fushë, respektivisht një institucion i cili deri më tani i ka munguar sistemit juridik të Kosovës.

Ky Draftligj ka një rol dhe rëndësi të veçantë për faktin se me nxjerrjen e tij gjykatat do të lirohen nga një pjesë e punës joprofesionale, nga një pjesë e punës e cila mund të themi se i ka ngarkuar edhe në përmbajtje edhe në kohë gjykatat deri më tani dhe ka të bëjë kryesisht me çështjet që janë të ngarkuara për gjykatat, siç janë: autorizimet e ndryshme, siç janë kontratat e ndryshme, siç janë vërtetimi i dokumenteve të ndryshme, testamenteve, nxjerrja e dokumenteve origjinale, respektivisht të duplikateve të tyre e të tjera.

Pra, ky Projektligj synon të ofrojë ndihmë juridike për qytetarët tanë nga kjo fushë, respektivisht nga ky kompleks i fushave.

Rëndësia e Projektligjit qëndron edhe mbi faktin se natyra e punëve me të cilat pretendohet të rregullohen çështjet e caktuara është e pjesës jo kontestimore nga fusha e çështjeve të marrëdhënieve jokontestimore.

Projektligji mbi Noterinë së bashku me Kodin e etikës dhe të sjelljes profesionale pretendon që në vazhdim të lehtësojë edhe më tutje punën e gjykatave dhe të zvogëlojë punën e tyre në kuptim edhe të zvogëlimit të paqartësive që deri më tani kanë ekzistuar në këto fusha.

Në këtë mënyrë, ky Projektligj do t'ju ofrojë të gjithë qytetarëve të interesuar ndihmën juridike duke obliguar noterin që t'u ofrojë këshilla palëve për natyrën dhe efektet ligjore të transaksioneve të ndryshme dhe të veprimeve të tjera të kryera përmes shërbimeve noteriale.

Në punën e deritanishme është arritur që nga fillimi që të bëhet harmonizim i plotë i përmbajtjes së Draftligjit me ligjet e tilla që ekzistojnë e që zbatohen në sistemin e avancuar të drejtësisë evropiane. Pra, është arritur në bashkëpunim me përfaqësuesit e Institutit për studimet e avancuara noteriale, selia e të cilit është në Zvicër, që të harmonizohet kjo dhe në këtë fushë kanë ndihmuar edhe ekspertët e kësaj lëmie nga USAID-i.

Besoj se pas kalimit të leximit të parë dhe me amendamentet që eventualisht do të bashkëngjiten do të plotësohet edhe më tutje dhe preferojmë që ky Draftligj të aprovohet bashkë me ligjet e tjera të cilat u prezantuan sot këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam na prezentaciju, gospodine zamenice premijera. Obaveštavam prisutne da skupštinskoj sednici prisustvuje 77 poslanika i mislim da možemo nastaviti sa radom. Nakon ove prezentacije Nacrta zakona otvaram debatu za usvajanje ovog Nacrta zakona, u načelu. Ja bih najpre pitao predsednika Komisije za zakonodavstvo, gospodina Bahri Hysenija, da li oseća potrebu da je javi za reč.

Urdhëroni!

BAHRI HYSENI: Në emër të Grupit Parlamentar do ta kemi fjalën.

Faleminderit shumë, zoti Kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar në parim Projektligjin mbi Noterinë dhe me rastin e rishqyrtimit në parim mendon se Projektligji mbi Noterinë është proceduar nga propozuesi në tri gjuhët në pajtim me Rregulloren 33.3 të

Rregullores së Punës së Kuvendit. Mirëpo, me rastin e shqyrtimit konsideron se në komisionin funksional gjithsesi duhet të bëhet harmonizimi në mes të këtyre tri versioneve sepse ka gabime shumë të mëdha gjuhësore dhe teknike.

Gjuha juridike në këtë Projektligj nuk është shumë evidente në tërë tekstin e Projektligjit.

Projektligjit i është bashkangjitur deklarata financiare vetëm për vitin 2007, që pasqyron koston totale të ndikimit buxhetor në vlerë 125 mijë euro, mirëpo sipas hartuesit të Projektligjit konsiderohet se viti 2008 nuk do të ketë implikime buxhetore dhe këto implikime mendohet që të mbulohen nga të ardhurat që kryhen prej institucionit që po e krijojmë.

Pjesa përbërëse e këtij Projektligji është edhe deklarata që është në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian me *acquis communautaire*. Projektligjit i është bashkangjitur edhe memorandum i shpjegues të cilin, pak më parë, në pika të veçanta e theksoi zëvendëskryeministri.

Konsiderojmë se në këtë Projektligj ka mangësi për teknikën juridike që është përdorur për hartimin e legjislacionit dhe këto mangësi më tepër janë vërejtur sepse në këtë Projektligj nuk ekzistojnë dispozitat e përgjithshme që do të duhej t'i kishte çdo projektligj i cili ofrohet në Kuvend, për miratim.

Vërejtje tjetër parimore që do të ishte me interes të dëgjohet këtu është se dispozitat e përgjithshme janë hasur diku në kapitullin e nëntë, që nuk është praktikë me rastin e hartimeve të projektligjeve sepse dispozitat e përgjithshme duhet të jenë në fillim të Ligjit, se më pastaj dispozitat themelore fillojnë ta normojnë me norma të veçanta. Mirëpo, duke e marrë parasysh që Projektligji në fjalë po e rregullon për herë të parë një lëmi të caktuar të cilën nuk e kemi pas deri më tash, duke marrë parasysh që është interes i përgjithshëm, jo vetëm për gjykatat e Kosovës, por edhe për qytetarët e Kosovës, që më shpejt dhe me procedura më të shpejta t'i kryejnë shërbimet nëpër gjykata dhe nëpër institucionet tjera, Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës konsideron se do ta japë përkrahjen, në parim, që të aprovohet ky Projektligj me kusht që komisioni funksional përgjegjës t'i ketë parasysh këto rekomandime dhe në bashkëpunim me deputetët e Kuvendit të Kosovës, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare që e mbështesin Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, që në leximin e dytë t'i modifikojë këto nene dhe, natyrisht, t'ia sjellë Kuvendit një Ligj i cili do të ishte i përpunuar pak më mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, gospodine Hyseni. A sada idemo po redosledu i pozivam šefove parlamentarnih grupa ili ovlašćenih predstavnika za komentare, odnosno diskusije. Evo, PDK je iskoristio, pozivam predstavnike Parlamentarne grupe Demokratskog Saveza Kosova. Gospodin Agim Velju se javio, izvolite gospodine Velju!

AGIM VELIU: Ju faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet, në parim, Projektligjin për Noterinë dhe e ruan të drejtën që të japë vërejtjet dhe plotësimet në procedurën e mëtejme parlamentare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam gospodine Velju.

Pozivam predstavnika Parlamentarne grupe AKR, javila se gospodjica Suzana Novobrdaliu. Izvolite, imate reč!

SUZANA NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i AKR-së, konsideron se Kosova ka nevojë për Ligjin për Noterinë. Gjithashtu, konsiderojmë se me këtë Ligj, në masë të madhe ju lehtësohet puna e gjykatave.

Në parim e mbështesim këtë Projektligj. Konsiderojmë se i njëjti në krahasim me projektligjet e tjera, disa projektligje të tjera, është punuar mjaft mirë. E ruajmë të drejtën që vërejtjet eventuale t'ia paraqesim në formë të shkruar komisionit përkatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala poslanici Novobrdaliu! Sledeći je predstavnik LDD-a. Pozivam predstavnika ili šefa Parlamentarne grupe. Izvolite, gospodin Blerim Ramosaj!

BLERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Edhe unë shfrytëzoj rastin t'i përshëndes kolegët deputetë. Sa i përket Ligjit për Noterinë, Grupi Parlamentar i LDD-së e mbështet, në parim, ndërsa sa i përket arsyeshmërisë dhe qëllimit, e tha edhe zëvendëskryeministri atë, dhe në preambulën e parë po shihet arsyeshmëria. Vërtet, rëndësia e këtij ligji do të shihet në aspektin praktik, sepse gjykatat e Kosovës do të lirohen prej të gjitha punëve, respektivisht çështjeve që njihen juridikisht si jo kontestimore, andaj shpresojmë që me këtë ligj do të përfitojmë edhe në aspektin e komunitetit në raport me gjykatat, por do të përfitohet edhe në aspektin e qartësisë dhe mundësisë së liritë edhe të subjekteve, edhe të personave juridikë në marrëdhëniet kontraktuese, që i bëjnë qoftë me personat juridikë, qoftë personat fizikë. Andaj, duke u mbështetur në të gjitha këto arsyeshmëri, edhe Grupi ynë parlamentar mendon se vërejtjet eventuale do të jepen në komisionet funksionale dhe shpresoj që do të kalojmë apo procedojmë më tutje. Ju faleminderit edhe njëherë!

KRYESUESI: Hvala vam, gospodine Ramosaj! Ja se izvinjavam Alijansi za budućnost Kosova, ali je prvo spomenuto LDD, tako je ovde u mom podsetniku. Očigledno, vi ste na reku. Evo, pozivam predstavnika Parlamentarne grupe AAK, gospodina Kosumi. Izvoliate, gospodine Bajram Kosumi!

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit, i nderuari Kryesues!

Të nderuar ministra të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Ky Projektligj ka ardhur në këtë legjislaturë sipas një vendimi të Qeverisë, të datës 17. janar 2008, për riprocedimin e të gjitha ligjeve, projektligjeve të Qeverisë Çeku, që nuk janë përfunduar në legjislaturën e kaluar. Ky Projektligj në legjislaturën e dytë është diskutuar njëherë dhe është miratuar, në parim, në legjislaturën e kaluar. Prandaj, e konsiderojmë si Grup Parlamentar që nuk ka nevojë shumë të diskutojmë sot rreth saj, meqenëse ka kaluar njëherë.

E pranojmë në parim dhe do të marrim pjesë në komisionet përkatëse, si individ, si deputetë apo në komisione në amendimin e tij për shqyrtimin e dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, gospodine Kosumi!

Pozivam predstavnika Parlamentarne grupe "7+" za komentuar. Izvolite, gospodin Sadik Idrizi ima reč! Molim režiju!

SADIK IDRIZI: Hvala, predsedavajući!

I Parlamentarna grupa "7+" će u principu podržati ovaj Nacrt zakona pošto ga je i u prethodnom sazivu Skupštine podržala. On je prošao prvo čitanje. Mislim da postoji potreba za ovim Zakonom na Kosovu i mi ćemo ga podržati danas i u daljoj proceduri učestvovaćemo na boljoj izradi ovog zakona.

KRYESUESI: Hvala, gospodine Idrizi!

Evo, parlamentarne grupe su završile sa svojim izlaganjima. Vidim da se prijavio gospodin Riza Smaka, za komentar. Evo, dajem vam reč, gospodine Smakaj. Izvolite!

RIZA SMAKAJ: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar ministra e deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Me këtë Ligj jam relativisht mirë i familjarizuar dhe, natyrisht, e kam lexuar me kujdes. Ky është një ligji i mirë, parimisht e mbështesim. Mirëpo, do të isha angazhuar parimisht, vërejtje parimore, rreth tarifës së shërbimeve. Tarifat e shërbimeve publike në përgjithësi janë shumë arbitrare në disfavorin e shfrytëzuesve të tyre. Kjo tematikë duhet të rregullohet në mënyrë të qartë dhe konsekuente, sepse zakonisht shfrytëzuesit e shërbimeve të Noterisë janë qytetarët e rëndomtë që nuk e njohin ligjin, që nuk i njohin të drejtat elementare, që janë viktima të burokratizmeve, teknoburokratike, e kështu me radhë. Çështja e përcaktimit të tarifave duhet të jetë publike dhe duhet të jetë e konfirmuar nga autoriteti publik, ju lutem. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Hvala vam, profesore! U redu. Ja smatram da, s obzirom da su svi šefovi ili predstavnici parlamentarnih grupa podržali u načelu ovaj prvi nacrt, mi idemo na sledeću tačku, ali ovog momenta sam primetio da se i poslanica Gjylnaze Syla prijavila za reč. Izvolilte, gospodjice Syla!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Unë do të flas në një aspekt tjetër sa i përket Noterisë, si një institucion i cili ka munguar deri më sot në Kosovë, prandaj është i rëndësishëm institucionalizimi i tij. Praktika e Noterisë duhet të ndryshojë ashtu që shërbimi të profesionalizohet dhe të ndihmojë në funksionimin më të mirë të gjykatave me qëllim që gjykatat të lirohen nga lëndët. E veçanta e asaj që desha të theksoj është mosngarkesa e buxhetit të Kosovës pasi që nga puna e noterëve buxheti i Kosovës mbushet, prandaj në parim e mbështes. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala vam, poslanice Syla. Evo, ja smatram da smo u načelu prihvatili i nakon ovih analiza, zakon ide u proceduru drugog čitanja, za popodnevni rad.

Gospodo, mi se nalazimo na 16. tački dnevnog reda, a to je:

- Prvo razmatranje Nacrta zakona o strateškoj proceni sredine

Primećujem da ministar ambijenta nije tu. U stvari, prethodni jeste i vidim da ulazi ali se ponavlja njegove primedbe od danas da nismo izgleda pripremili neku od više varijanti zamene kada je ministar odsutan, pa ćemo izgleda morati da predjemo na narednu tačku dnevnog reda. Dakle, idemo na 17. tačku dnevnog reda:

- Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o socijalnoj šemi.

Pošto je ta tačka bila odložena, i sekretar me obaveštava, zato idemo na 29. tačku. I ona je vezana za sredinu, tako da ćemo i nju preskočiti.

Onda, desilo se ono o čemu su debatovali danas gospodjin Gjini i gospodin Koci, tako da ja moram samo Skupštinu da obavestim da ćemo dati pauzu do 16,00 sati. Malo je duža pauza, ali nažalost, to je zbog neažurnosti ili nedovoljne pažnje. Nemamo drugih mogućnosti. Da li se neko javlja za reč? Izvolite!

Dakle, idemo na pauzu. Molim poslanike da ostanu u poslaničkim klupama. Sekretar će konsultovati Premijera kako dalje da postupimo. Molim vas malo strpljenja. Evo tu je zamenik Premijera. Možete li zameniče da date komentar ili će sekretar. Odlučeno je ipak da bude pauza, kako bi onda kompletno nastavili sa radom.

Pauza je do 16,00 sati, gospodo. Moramo biti svi prisutni u 16,00 sati, gospodo. Hvala lepa!

Vazhdimi i seancës në orën 16,00

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Para se t'ia fillojmë punës, besoj që edhe në emrin tuaj, kërkojmë nga Kabineti qeveritar që në prezantimin e ligjeve të jenë më të disiplinuar.

Nëse ministri përkatës që do të duhej ta prezantonte ligjin nuk është prezent në sallë, Kryeministri të autorizojë një nga ministrat e kabinetit ose zëvendëskryeministrat për të prezantuar ligjin, në mënyrë që të mos na përsëritet ajo që na ka ndodhur sot.

Vazhdojmë me seancën e pasditës lidhur me votimin në parim të 5 projektligjeve të shqyrtuara në pjesën e paraditës.

Fillojmë me projektligjin e parë:

- Miratimi, në parim, i Projektligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paraditës të deklarohen për miratimin në parim të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Në sallë janë 81 deputetë.

“Për” kanë votuar 73 deputetë, 2 “kundër”, abstenim nuk ka.

Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 Kuvendi i ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Buxhet e Financa, dhe
3. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afat jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raport me rekomandime, rregulla 35.6.

Kalojmë në miratimin, në parim, të:

- Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paraditës të deklarojnë për miratim, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 78 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për kooperativat e bujqve.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 Kuvendi i ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi.
3. Komisionin për Buxhet e Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportin dhe rekomandimet, Rregulla 35.6.

Vazhdojmë me miratimin, në parim, të:

- Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paraditës të deklarojnë për miratim, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë votë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve.

Pas miratimit në parim, në bazë të Rregullës 23.6 dhe të Rregullës 35.2, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi.
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandimet, sipas Rregullës 35.6.

Vazhdojmë me miratimin, në parim, të

- Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paraditës të deklarojnë për miratim, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.
Votojmë tash:

Konstatohet se me 80 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave.

Në bazë të Rregullës 23.7 dhe të Rregullës 35.4, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues.
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe
3. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime, sipas Rregullës 36.6.

Ndërkohë, numri i deputetëve në sallë është 84. Në radhë është:

Miratimi, në parim, i Projektligjit për Noterinë.

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paraditës të deklarojnë për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.
Votojmë tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Noterinë.

Në bazë të rregullave 35 .7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
3. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime, sipas Rregullës 35.6.

Ky ishte ligji i fundit që duhej ta miratonim, në parim.

Me kaq e mbyllim seancën e sotme. Seanca i vazhdon punimet nesër, në orën 10,00.

E mërkurë, më 27.02. 2008

Vazhdimi i Seancës plenare

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë, mirëmëngjes, mirë se keni ardhur në seancën e sotme që është vazhdimësi e seancës së djeshme dhe që ka për qëllim kalimin e ligjeve sipas rendit të ditës.

Kemi një pyetje parlamentare të cilës zonja Nekibe Kelmendi, ministre e Drejtësisë, nuk ka arritur t'i përgjigjet dje për shkak të gjendjes së saj shëndetësore. Pyetja është parashtruar nga deputeti Nait Hasani. Para se të filloj me procedimin e ligjeve, kërkoj që zonja Nekibe t'i përgjigjet pyetjes së deputetit Nait Hasani.

Atëherë, konstatoj që deputeti Hasani nuk është këtu.

Vazhdojmë me seancën e sotme.

Sipas numërimit të deputetëve, në sallë janë 70 deputetë, kushtet janë plotësuar për të filluar me debatin dhe shqyrtimin e ligjeve.

Vazhdojmë me shqyrtimin e debatit në parim, në radhë është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ftoj ministren e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI:

I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,

Ndryshimi dhe plotësimi i Kodit penal të Kosovës është paraqitur si nevojë e një rrethane të re të krijuar pas nxjerrjes së këtij ligji, e kjo është se ne, gjithnjë duke dashur t'i perfeksionojmë ligjet tona, kemi synuar që të fusim edhe Institucionin e marrëveshjes për pranimin e fajit, prandaj ka pasuar edhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit të kodit në fjalë.

Kam nderin që në emër të Ministrisë së Drejtësisë t'i paraqes për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës.

Ky Projektligj është rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj dhe për përfeksionimin dhe standardizimin e ligjit me ligjet evropiane.

Në gjendjen delikate nëpër të cilën ka kaluar sistemi i drejtësisë, jemi ballafaquar me vështirësitë e shumta të Gjyqësorit për zgjidhjen e problemeve të shumta. Me këto plotësime dhe ndryshime do të bëhet një kod i avancuar duke pasur parasysh inkorporimin e një instituti të ri për pranimin e fajësisë i cili do të ndikojë në shtimin e efikasitetit të gjykatave dhe të prokurorive si dhe do të ndikojë në thjeshtësimin e procedurës dhe në uljen e shpenzimeve procedurale.

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës paraqet jo vetëm një masë ndihmëse, por edhe një domosdoshmëri si për faktin se fut një institut të ri dhe modern, por edhe për faktin se ky ligj është ndërhyrje komplementare e fuqishme në përmirësimin e gjendjes së sistemit gjyqësor dhe stimulimin e koncepcioneve të reja për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme të karakterit juridiko- penal të cilin institut juridik sot e kanë akceptuar pjesa dërmuese e vendeve të zhvilluara dhe të atyre në tranzicion.

Instituti i pranimi të fajësisë nga ana e kryesit të veprës penale pas marrëveshjes paraprake me prokurorin e shtetit ka rëndësi shumë të madhe pasi që me futjen e këtij instituti të ri në sistemin juridik të Kosovës do të arrihen qëllimet e shumta, e ndër më të rëndësishmet është se do të ndikojë në përshpejtimin e procedurës penale, uljen e shpenzimeve dhe përfitimin e disa lehtësimeve nga ana e të akuzuarit.

Ky Projektligj është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me ekspertë të shquar të Kosovës, duke përfshirë edhe profesorët e Fakultetit të Drejtësisë, gjyqtarë, prokurorë si dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, të gjithë njohës të mirë të kësaj fushe penale.

Ky institut juridik është alternativë shumë e rëndësishme pasi që parasheh mundësinë që nëse i akuzuari e pranon kryerjen e veprës penale, në favor të tij vendos gjykata duke shqiptuar një aktgjykim më të butë, ndërsa në të kundërtën do të zhvillohet shqyrtimi gjyqësor me paraqitjen e provave për argumentimin e fakteve relevante juridike në mënyrë të gjithanshme, pra kondicionon zhvillimin e plotë të procedurës penale e cila gjithsesi do të jetë shumë më e kushtueshme dhe më pak e favorshme për kryesin e veprës penale.

Inkorporimi i një të drejtës të tillë të palëve proceduralo- penale në Kodin e përkohshëm penal të Kosovës do të ndikojë në avancimin e legjislacionit në këtë fushë, e me këtë edhe në avancimin e të drejtave të vetë të të akuzuarit pasi që dihet se qëllimi i dënimit nuk është hakmarrja, por është risocializimi i individit dhe bërja e tij të dobishëm për shoqërinë kosovare.

Fuqizimi i këtij Projektligji është i një rëndësie të veçantë sepse do t'i hapë rrugën shtimit të efikasitetit në punën e Gjyqësorit, pra shkurtohen procedurat me një seancë gjyqësore, menjëherë mund të përfundojë shqyrtimi kryesor dhe mund të arrihet deri te pranimi i fajësisë dhe, kur të pranohet fajësia, atëherë aktgjykimi, përkatësisht vendimi mbi pranimin e fajësisë bëhet i plotfuqishëm dhe menjëherë shkon në mbajtje të dënimit, gjithsesi dënimi do të jetë më i ulët.

Ky Projektligj rregullon në tërësi këtë fushë në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare.

I nderuari zoti kryesues,
Të nderuar deputetë,

Fuqizimi i këtij Projektligji është në funksion të komplementimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë. Është në përputhje me ligjet e Bashkësisë Evropiane, andaj propozoj që pas procedurave të shqyrtimit Projektligji të miratohet në Kuvend dhe të shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kelmendi!

Tani, pas prezantimit të Ligjit, në radhë është debati dhe sipas rregullave fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Përshëndetje i nderuari zoti Kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë.

Ne po e marrim fjalën në emër të Grupit Parlamentar. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës dhe me rastin e shqyrtimit konsideron se Projektligji është proceduar në tri gjuhët konform Rregullës 33.3 të Rregullores së Punës të Kuvendit. Gjuha juridike është evidente në tërë tekstin në masë të konsiderueshme.

Projektligji e ka deklaratën financiare dhe nuk ka implikime buxhetore. Projektligji është në përputhje me *acquis* komunitaire. Konsiderojmë se në këtë Ligji janë përdorur rregullat e teknikës juridike për hartimin e legjislacionit, shprehjet normative janë bërë përmes neneve dhe paragrafëve, e kështu me radhë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji ka konstatuar se është fjala vetëm për 2 nene.

Njëri nen është plotësim i një paragrafi të ri në nenin 66 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, i cili flet për pranimin e fajësisë nga kryesi i veprës penale në bashkëpunim me gjykatën me qëllim të aplikimit të një dënimi më të lehtë, apo edhe duke i marrë parasysht rrethanat plotësuese, dhe

Neni tjetër flet për hyrjen në fuqi, meqë është fjala vetëm për dy nene. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës nuk ka vërejtje, prandaj kërkon dhe jep pëlqimin që ky Projektligj të aprovohet, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni!

Zoti Hyseni foli edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, edhe në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Prandaj, sipas renditjes fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të LDK-së, kryetari i Grupit Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Ne edhe ashtu kemi pasur ndërmend ta mbështesim, në parim, këtë Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, po veçanërisht pas arsyetimit që e dha zonja Nekibe Kelmendi këtu, katërçipërisht jemi për mundësinë që ta mbështesim më tutje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeziu!

Sipas renditjes, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, për fjalë është paraqitur Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zotëri Kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar anëtarë të Sekretarisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Përkundër disa vërejtjeve parimore të cilat do të shkonin në favor të gdhendjes dhe të hartimit më të përshtatshëm të këtij dokumentit për etapën e dytë, fillimisht do t'i jap disa objeksione të shkurtra parimore dhe më në fund qëndrimin parimor të Grupit Parlamentar të partisë politike Aleanca Kosova e Re.

Fillimisht, ju lutem, me Projektligj nuk mund të bëhet as ndryshimi, as plotësimi i Kodit, kodi me kod, ligji me ligj, ose bie fjala, në qoftë se nuk do të ndryshojë, nëse nuk do të shtohet: “mund të”, këtu ku thuhet - parasheh zbutjen e dënimit, gjykata do të shqiptojë një dënim më të butë, do të delte se prokuroria e cila nuk është anëtare, pjesë, segment i Gjyqësorit, por më tepër inklinon kah ekzekutivi që do t'ia impononte Gjyqësorit vendimin, aktgjykimin, e që do të ishte interferencë e palejueshme në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve dhe të kontrolleve të pushteteve, që do të ishte një presidencë e papranueshme.

Edhe, ju lutem, përkthimi është i dobët. Nuk është fjala për përkthim kështu, si të themi, formal, porse një fjalë e ka domethënien në praktikë, sikur të miratohej, do të implikonte interpretime të ndryshme, sikur të mos rishikohej, po e zëmë, neni 2, nuk do të dihej se kur hynë në fuqi ky Ligj, kur do të bëhej ndryshimi dhe plotësimi i Kodit.

Dhe, përkundër vërejtjeve parimore, Grupi Parlamentar i partisë politike Aleanca Kosova e Re, parimisht e mbështet këtë dokument dhe në procedurat e mëtejshme do të diskutojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Smaka.

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka zoti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra të Qeverisë së Kosovës,

Ne dje kemi mbetur në përfundim të seancës tek pika e 15-të, e kemi kryer, sot jemi kthyer tek pika e 4-të. Kisha dashur vetëm si sugjerim për kryesuesin që nuk është mirë të kalohet prej pike në pikë kështu. Kemi mundur të vazhdojmë sot deri në fund, në ato pika që i kemi kaluar dje për shkak të mosprezencës së ministrave të kthehemi në fund edhe njëherë, po jo të kalojmë tashti prej pikës së 15-të në të 4-tën e tash përsëri ndoshta e 10-ta, e 11-ta s'është këtu, i kthehemi nesër, e tjerë, e tjerë.

Sa i përket Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, ne e kemi shqyrtuar, Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar këtë Projektligj që është, në fakt, një ndryshim i Kodit penal të Kosovës, i cili është si rrjedhojë e ndryshimit të Kodit të përkohshëm të procedurës penale, sepse në Kodin e përkohshëm të procedurës penale futet një institucion i ri juridik, ashtu si e tha edhe zonja ministre, dhe futja e këtij institucioni të ri juridik, i cili është pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, krijon rrjedhoja tjera edhe tek dënimi, dhënia e dënimit, zbutja e dënimit, për çka edhe futet ky institucion i ri.

Si të tillë, ne e përkrahim. Mendojmë se e ndihmon gjyqësinë në Kosovë, e ndihmon zbutjen e krimit në Kosovë, ndihmon dënimin e bërësve të krimit në Kosovë sa më shumë, etj.

Në shqyrtimin e dytë, në parim, do ta kishim ftuar ministren që të bashkëpunojë me komisionet përkatëse të Kuvendit rreth një çështjeje, rreth kufirit të ulët të dënimit, cili është kufiri më i mundshëm i fundit i zbutjes së dënimit, deri ku mund të shkojë kjo zbutje e dënimit. Kjo çështje nuk është përkufizuar tash, por duhet në shqyrtim të dytë të shikohet mundësia e përkufizimit të kësaj çështjeje.

Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah, në parim, këtë Projektligj dhe deputetët do të marrin pjesë në punën në Projektligj në komisionet përkatëse. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kosumi!

Sa për t'ju rikujtuar, ne kemi marrë një vendim që t'i kapërcejmë të gjitha ligjet që i ka sjellë Qeveria dhe të punojmë në mënyrë permanente që të mos na grumbullohen. Tani besoj që kemi më shumë përgjegjësi dhe më shumë detyrime. Sot dhe dje Qeveria ka qenë e ngarkuar me agjendë, sot e ka edhe mbledhjen e vet dhe jemi pajtuar që gjatë kohës kur Qeveria mbanë mbledhje, të jetë prezent njëri nga ministrat që do t'i lexojë ligjet. Prandaj, dëshira për të shkuar gjithçka sipas renditjes është e të gjithëve, megjithatë duhet ta kuptojmë njëri - tjetrin për hir të mbarëvajtjes së punës dhe për hir të kryerjes së obligimeve që i kemi.

Fjalën e ka përfaqësuesi i LDD-së, zoti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Dëgjuam me vëmendje shpjegimet e ministres lidhur këtë Projektligj dhe na vjen mirë që ka qenë gjithë ai angazhim edhe i Ministrisë, edhe i ekspertëve, profesorëve të universitetit, konsultime të ndryshe etj. E kemi një material prej 27 faqesh mjaftë të kompletuar me të gjitha aspektet dhe dua të theksoj faktin që ndoshta është materiali më i kompletuar prej të gjitha projektligjeve që na vinë këtu.

Fjala është, pra, se plotësimi dhe ndryshimi i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës është bërë vetëm me një paragraf, i cili përmban dy fjali në nenin 66, pra është shtuar paragrafi 3 i nenit 66 dhe krijon mundësinë që, kur kryesi i veprës ka pranuar fajësinë, atëherë krijohen kushtet për zbutjen e dënimit të tij.

Mendojmë se është një propozim në Projektligj, të themi pozitiv, që krijon mundësi për një efikasitet dhe për një formë të edukimit paraprak të atyre që kryejnë vepra penale.

Grupi Parlamentar i LDD-së e përkrah, në parim, këtë Projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Salihaj!

Sipas radhës, fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar "7+", zoti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona o izmenama i dopunama privremenog Krivičnog zakonika s tim što se radi o veoma, u formalnoj strani veoma sitnim, veoma značajnim izmenama. Mi ćemo ga u načelu podržati, priduržićemo sa ostalim grupama.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, nuk është, s'ka përfaqësuesin e vet.

Tani lus deputetët që sipas radhës dëshirojnë të diskutojnë lidhur me Projektligjin. Sipas tabelës, në radhë është deputeti, zoti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që duke ju përshëndetur ju, të përshëndes edhe nismën për ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal. S'mund të kontestoj edhe ato që u thanë në prezantimin e kësaj nisme legislative, të këtij Propozimligji për ndryshimin e Kodit penal, që e bënë edhe si procedurë të veçantë ndryshimin e një legjislacioni që te ne është i veçantë, është Kod i përkohshëm penal që ka edhe status të veçantë në legjislacionin tonë. Mua më bën përshtypje të mirë nisma për ta ndryshuar këtë, por megjithatë disa dilema më imponuan dhe e konsideroj të nevojshme t'i shtrojë këtu.

Kjo nismë ka ardhur nga Ministria e Drejtësisë, e cila edhe do të duhej të jepte shembullin e respektimit të procedurave dhe të metodologjisë ligjdhënëse, kurse ky Projektligj na ka ardhur pa tekstin origjinal, pa tekstin që synohet të ndryshohet. Sidomos kur të vijmë te Projektligji për Kodin e procedurës penale, do të shohim se vërtet ne jemi vënë në situatë që të ndryshojmë diçka në thes, pa e ditur çka është ajo. Nuk e kuptoj pse është bërë kjo.

E dyta, përshtypja ime është se i kemi hyrë këtij ndryshimi pa pasur një ekspertizë profesionale çka duhet ndryshuar në Kodin penal dhe në Kodin e procedurës penale. Shtrohet pyetja, athua është vetëm kjo çështje që duhet ndryshuar në Kodin penal pas përvojës disavjeçare që kishim dhe pas kufizimeve që kemi pasur? Unë kam pasur rastin të dëgjoj nga ekspertët, nga gjyqtarët e të interesuar të tjerë shumë vërejtje në Kodin ekzistues penal dhe në Kodin e procedurës penale. Pyes, pse nuk është bërë një ekspertizë dhe t'i hyjmë ndryshimit siç duhet, po të fillojmë tash me një çështje që është një risi, më lejoni ta quaj, e moçme te ne. Unë nuk mund tash të them cila ka qenë historia e kësaj dispozite, por mund të them se shumë prej nesh këtu jemi dëshmitarë se ky farë instrumenti, që po quhet institut për pranimin e fajësisë dhe pastaj marrëveshje lidhur me fajësinë, si kusht për lehtësime e abuzime, ka funksionuar në Kosovë dhe ka funksionuar shumë, ka funksionuar keq, zonja dhe zotërinj, është abuzuar me të madhe me te. Dhe nuk e kuptoj tash rëndësinë e veçantë të kësaj nisme, në kohën kur ne nuk e kemi transformuar edhe aq shumë sistemin e gjyqësisë në Kosovë. Për fat të keq, ende punohet shpesh jo vetëm me mentalitete të vjetra, por shpesh edhe me formula të moçme.

Shtrohet me të drejtë edhe dilema çka do të ndodhë me pavarësinë e Gjyqësorit nëse ne e legjitimojmë në këtë fazë këtë instrument, për mendimin tim, në kushte tona - abuziv. E theksoj këtë, jo për ta kontestuar nismën, por vetëm për të tërhequr vërejtjen në faktin se ne po hyjmë në një proces pa u përgatitur sa duhet, pa pasur ekspertizën e duhur dhe mendoj se do të duhej ta shfrytëzonim periudhën e mëvonshme për të angazhuar Shoqatën e gjyqtarëve, Shoqatën e avokatëve, Shoqatën e juristëve për të marrë mendimin e tyre dhe për të parë si do të duket kjo në praktikë. Ju faleminderit, zoti Kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni!

Për fjalë është paraqitur deputeti Mark Krasniqi!

MARK KRASNIQI: I nderuari Kryetar i parlamentit,

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Grupi Parlamentar i Koalicionit LDD-PSHDK e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, dhe në parim e përkrahë këtë Ligj, i cili është shembull i mirë se si duhet të korrigjohen ligjet e mëparshme konform nevojave dhe rrethanave të reja, kështu që të kemi ligje sa më të mira, të cilat i përgjigjen kohës. Kjo praktikë duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen, sidomos në lidhje me Pakon e zotëri Ahtisarit.

Unë me këtë rast do të propozoja që të bëhen përpjekje politike e juridike që shtetasit e Republikës së Kosovës në punë të përkohshme në botën e jashtme, për deliktet që mund t'i bëjnë eventualisht atje, të gjykohen, të dënohet dhe ta vuajnë dënimin në Republikën e Kosovës. Gjykimi ndoshta nuk mund të bëhet në Kosovë, sepse ekziston një rregull, sipas cilit aty ku bëhet krimi, bëhet edhe gjykimi, por të paktën vuajtja e dënimit duhet të bëhet në Kosovë. Këtë praktikë e kanë disa shtete, madje edhe Kosova në ish Federatën Jugosllave ka kërkuar dhe realizuar që shqiptarët e dënuar të transferohen nga burgjet e Serbisë në burgjet e Kosovës.

Nëse mund të realizohet ky propozim, do të ishte një lehtësim i madh për familjet e të burgosurve, por edhe për të burgosurit, të cilët në burgjet e huaja trajtohen shumë më keq së të burgosurit e nacionaliteteve të tjera. Përveç kësaj, realizimi i këtij propozimi do të ishte në favor të autoritetit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputeti Riza Smaka

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti Kryesues,
Anëtarë të Qeverisë,
Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Qëndrimi i AKR-së ishte ai që e prezantova. Unë jam i disiplinuar edhe e mbështes pikëpamjen e shumicës, por megjithatë unë kam objeksione tepër serioze në këtë Projektligj.

T'ju them se për këtë e kam konsultuar edhe teorinë, e kam konsultuar edhe një numër të konsideruar të ekspertëve më të mirë që i kemi, që e ligjërojnë të drejtën, që quhet - E drejta për procedurën penale. Ju lutem, disa që nuk janë juristë ndoshta nuk e kanë kuptuar sa dhe si duhet substancën e këtij Projektligji. Me këtë insistohet që Prokurori publik, i cili është institucion shtetëror për ta ndjekur krimin, ju lutem, për ta akuzuar kriminelin, do të kishte autorizime për të bërë kontratë me kryerësin e krimit, për t'i bërë koncesione, për t'i dhënë favore, në vend që ta ndjekë me konsekuencë dhe me konsistencë. Ju lutem, kjo është kjo! Prandaj, për mua kjo është totalisht e papranueshme. Kështu mendojnë edhe dy profesorë që e ligjërojnë këtë lëndë me dekada në Fakultetin Juridik, që i kam konsultuar. Ky është një institut juridik penal alla USAID, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë kontinent, atje ka shumë popuj, si të themi shumë konfesionë, shumë kultura, edhe lëvizshmëria është tepër e madhe, e tjera, e tjera.

Në sistemin juridik penal evropian nuk është i afirmuar ky institut. Por, edhe sikundër të ishte, qëllimi ynë është për ta luftuar krimin, ju lutem. Krimi nuk luftohet në qoftë se krimineli që ka bërë disa vepra, e që është detyrë e Prokurorisë për ta vërtetuar gjendjen e fakteve, për ta ngritur aktakuzën të bazuar në fakte, për ta kualifikuar juridikisht drejt, për ta prezantuar në gjykatë, për të akuzuar ashtu si duhet, apo jo, e jo të bëjë koncesione, bie fjala njërin e ka therë me thikë, tjetrin asi, për këtë po ta heq këtë, nuk të akuzoj. Ju lutem, ekzistojnë edhe instrumente të tjera për këtë. Ato quhen rrethana lehtësuese kur i akuzuari/e akuzuara e pranon krimin dhe pendohet thellë, e argumenton se është penduar. Gjithsesi, edhe prokurori ka pasur, ka dhe do të ketë autorizime që kur ta formulojë aktakuzën, të apelojë në ato pika, kurse gjykata, gjithsesi, gjithmonë, të gjitha rastet i vlerëson gjithanshëm, edhe rrethanat lehtësuese, edhe rrethanat vështirësuese. Prandaj, unë si deputet i Kuvendit të Kosovës nuk do të kisha votuar asnjëherë dhe kurrnjëherë për këtë Projektligj. Ju falënderohem!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit zoti Smakaj, Tani konsideroj se më nuk ka diskutues. Votimin siç jemi marrë vesh dje, do ta bëjmë duke filluar nga ora 16,00, pasdite. Sipas renditjes, fjalën e ka prapë ministrja e Drejtësisë, zonja Nekibe Kelmendi, për ta paraqitur edhe Ligjin, shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, por edhe për të thënë diçka lidhur me reagimet dhe debatin që është zhvilluar nga parafolësit, të nderuar deputetë. Zonja Kelmendi, e ke fjalën!

NEKIBE KELMENDI: I nderuari kryesues, Të nderuar kolegë deputetë, Unë me vëmendje i dëgjova vërejtjet që u bënë nga shefat e grupeve parlamentare dhe nga deputetët individualisht. Mendoj se, edhe pse s'jemi Amerikë, ne synojmë të bëhemi Amerikë dhe kjo asgjë nuk ka të keqe, sepse që të dy ligjet penale, si ai material, ashtu edhe ai procedural, janë tani, nuk janë ligje të pastra kontinentale, por janë ligje që janë të gërshetuara edhe me të drejtën *common law*, apo siç e quajmë të drejtën amerikane dhe të drejtën angleze penale.

Sa i përket ndryshimit të nenit 66, përkatësisht shtimit të një pike të saj, pa e ndryshuar atë nen, nuk ka mundësi të arrihet marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nga ana e kryerësit të veprës penale dhe lidhur me këtë nuk ka mundësi as të zbutet dënimi. Qëndron fakti se kemi rrethana lehtësuese në Kodin penal, të cilat me rastin e shqiptimit të dënimit merren parasysh, por ato nuk janë të detyrueshme. Në praktikë ne kemi vepra tejet të rënda dhe tash, së fundi, e patëm një vepër të tillë, ku u shqiptua dënimi maksimal prej 40 vjetësh, ani pse te ai njeri kishte së paku një rrethanë lehtësuese, e ajo ishte se ai deri në atë ditë nuk ka qenë i dënuar. Mirëpo, megjithatë ka shumë dallim midis pranimin të fajësisë dhe vlerësimit të rrethanave lehtësuese, të parapara me Kodin penal.

Kodi penal, është e vërtetë se e pati vetëm një ndryshim, në një nen, kurse neni i dytë tregon hyrjen e tij në fuqi. Por, ajo që e plotëson Kodin penal, është Kodi i procedurës penale. Pa u përcaktuar procedura penale se si do ta arrihet marrëveshja për pranimin e fajësisë midis prokurorit dhe kryerësit të veprës penale, por mos harroni se aty është i implikuar edhe i dëmtuari, edhe ai merr pjesë në atë marrëveshje. Pa u paraparë të gjitha procedurat, nuk mund realizohet instituti i pranimin të fajësisë konform Kodit penal të Republikës së Kosovës, që vërtet tani e tutje mund të quhet Kodi penal i

Republikës së Kosovës, sepse nuk jemi më institucione të përkohshme vetëqeverisëse, por jemi institucione të një shteti të sapoformuar.

Ky Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e procedurës penale, është vetëm plotësim apo lehtësim i arritjes së asaj marrëveshje për fajësinë, ndryshe nuk do të dihej se si do të mund të arrihej marrëveshja me një ligj material, sepse me ligjin material nuk rregullohen materiet procedurale, por vetëm materiet materiale.

Sa i përket prokurorit, u tha se nuk po ka atëherë dallim midis prokurorit edhe Gjyqësorit. Kjo nuk qëndron, sepse edhe prokurori gjatë hetimeve e zbaton, sikurse edhe Gjykata, ligjin, përkatësisht Kodin e procedurës penale të Kosovës, qoftë këtë në fuqi, qoftë Kodin i cili duhet të ndryshohet. Prandaj, rëndësia e ndryshimit të këtij Kodi të procedurës penale qëndron për funksionalizimin dhe realizimin e pranimi të institutit të fajësisë. Në të kundërtën, po të qëndronte vetëm ndryshimi i Kodit penal, nuk do të mund të dihej se cilat procedura, në ç'mënyrë, në cilën fazë, kur, cilat palë dhe kush mund të jetë i pranishëm kur të bëhet pranimi i fajësisë, kur bëhet aktgjykimimi i plotfuqishëm mbi pranimin e fajësisë dhe shkuarjen në mbajtje të dënimit etj., etj. Të gjitha këto i keni të përmbledhura në Projektligjin për ndryshimin e Kodit të procedurës penale të Republikës së Kosovës dhe unë ju ftoj që ta votoni, kurse në ecje e sipër, nëse ka mangësi, pse jo, do të jem e gatshme të marrë pjesë edhe vetë në komisione për përmirësimin dhe eliminimin e mangësive të këtij kodi. Por, mos harroni se edhe në hartimin e këtij Kodi për ndryshimin dhe plotësimin e procedurës penale, kanë marrë pjesë ekspertë të ndryshëm dhe kurrë nuk mund t'i paraprijë praktika teorisë, por teoria i paraprinë praktikës. Së pari nxirret një ligj, zbatohet në praktikë dhe në praktikë hetohen mangësitë e atij ligji, në mënyrë që më pastaj të pasojë ndryshimi, plotësimi dhe përmirësimi i ligjit të caktuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ministrat të cilët janë të obliguar të shkojnë në mbledhje të Qeverisë, janë të lirë. Besoj se do të kthehen kur ta kryejnë mbledhjen.

Sipas radhës, është si pikë e rendit të dytë:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim e tij, në parim.

Ftoj Ministren e Drejtësisë, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Atëherë, vazhdojmë me paraqitjen e grupeve parlamentare. Për fillim fjalën e ka Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues,

Është mirë që ta bëjmë një sqarim. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk ka arritur t'i shqyrtojë në parim këto projektligje, sepse janë proceduar me vonesë dhe janë proceduar diku të premtën pasdite, kështu që ka qenë e pamundur t'i shqyrtojmë, në parim, mirëpo shpresoj që herëve të tjera do të procedohen me kohë dhe ne do të kemi mundësi që, edhe pse nuk është e caktuar shumë edhe me Rregullore, t'i shqyrtojmë, në parim, së paku projektligjet, si Komision.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të procedurës penale të Kosovës, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/26, të datës 6. korrik 2003 dhe, natyrisht, si grup parlamentar i përkrahim plotësimet dhe ndryshimet e Kodit të procedurës penale. Mirëpo, konsiderojmë se me rastin e hartimit të këtyre plotësimeve dhe të ndryshimeve kemi hasur edhe vërejtje parimore. Kemi konstatuar se Projektligji i plotëson kriteret e përgjithshme për aprovim, mirëpo vërejtjet parimore, që janë identifikuar me rastin e plotësimeve dhe të ndryshimeve në tekstin e Projektligjit janë të shumta, të natyrës juridike, mandej ka vërejtje të karakterit gjuhësor, ka vërejtje të radhitjes së paragrafëve dhe të neneve. Mirëpo, ne po ndalemi te disa vërejtje konkrete të cilat do të shinin me interes për deputetët e Kuvendit t'i dëgjojnë.

Neni 309, pika 3, thotë: “në vend të pas pranimit të kërkesës për takim preliminar, prokurori do ta informojë kryeprokurorin e zyrës së tij”. Konsideroj se ky nen është shumë i paqartë, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat janë të krijuara institucioni i Prokurorisë Publike. Ne e dimë që, qoftë Prokuroria Publike Komunale, qoftë ajo e Qarkut, qoftë ajo publike në Kosovë, e kanë vetëm nga një kryeprokuror dhe nuk e kemi kuptuar se hartuesi çka ka dashur të deklarojë me ra fjalët:” ta njoftojë kryeprokurorin e zyrës së tij”. Kjo mbetet e paqartë dhe shpresoj që në takimin që do ta kemi në komisionin funksional, do ta qartësojmë këtë, sepse është e pamundur që çdo prokuror ta ketë nga një kryeprokuror në zyrën e tij. Nuk do të kishte mundësi as financiare dhe nuk e parasheh edhe vetë Ligji.

Çështje tjetër me interes, është neni 309.4, ku bëhet marrëveshje me shkrim për pranimin e fajësisë dhe kërkesën e prokurorit që gjykata ta japë urdhrin që të shpallë të akuzuarin dëshmitar bashkëpunëtor. Këtë e kuptojmë, është praktikë në shumë vende, është praktikë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe në Gjermani, që kryerësi i veprës penale ose i akuzuari të bëhet bashkëpunëtor, mirëpo në radhitjen e mëvonshme që vjen, pikërisht në këtë nen, thuhet se i akuzuari do të ketë dënim më të butë në rastin kur pranon të jetë informator i policisë. Tani mendoj që kjo pjesë ia humb kuptimin komplet nenit dhe këtë nuk e kuptojmë pse kërkohet që i akuzuari të bëhet informator i policisë. Do të ishte krejt në rregull që ai të jetë bashkëpunëtor edhe me rastin e hetimeve gjatë kryerjes së veprës penale, do të ishte në rregull që ai të jetë bashkëpunëtor edhe me organizatën kriminale që lidhet për çështjen e caktuar apo për veprën penale të caktuar, mirëpo ta detyrosh të akuzuarin vetëm për zbutje dënimi të bëhet informator i policisë, këtë e kemi të paqartë dhe shpresoj që në takimin edhe me ekspertët, me zyrtarët e Qeverisë dhe ekspertët e tjerë që do të na mbështesin, mendoj të kërkojmë qartësim, sepse të jetë informator i policisë, mendoj se tanimë luhet edhe me dinjitetin të akuzuarit dhe më nuk kemi të bëjmë me një gjyqësi që dëshirojmë të jetë e pavarur, por në përgjithësi po kërkojmë që të akuzuarit t'i fusim edhe në një rrugë e cila mandej nuk dihet se ku përfundon.

Vërejtje tjetër me interes për këtë Projektligj, si edhe për projektligjet e tjera, ka të bëjë me faktin që nenet që janë hartuar në këtë Projektligj janë shumë të gjata dhe me rastin e implementimit nga implementuesi nuk di si do të ketë mundësi të aplikohen, në rastin kur duhet të lëshojë ndonjë urdhëresë apo të thirret komplet në ato nene shumë të stërzgjatura. Mirëpo, duke pasur parasysh se Projektligji në fjalë i plotëson kriteret e përgjithshme, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e jep pëlqimin që ky Projektligj të aprovohet në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit zoti Hyseni. Sipas renditjes, fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Për fjalë është paraqitur kryetari Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zotëri Kryesues! Ne do ta mbështesim në parim edhe këtë Projektligj që ka të bëjë me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës. Por, jo rastësisht, ne dëgjuam këtu edhe qëndrime të thëna dhe të shikuara nga aspekti i ekspertëve.

Ne i mbështesim këto projektligje, sepse e shohim se dobia për shoqërinë është shumë më e madhe sesa po të shikohen në aspektin individual ose vetëm të një institucioni.

Në qoftë se bëhet pranimi i fajësisë, tani më nuk është në objektin ai që e ka bërë veprën penale, por është njëfarë lloji procedure shkencore-juridike për të zbuluar autonominë e veprave penale, kështu që, shoqëria në këtë rast, do të ndihmonte. Pranimin e fajësisë ne e kuptojmë si njëfarë lloji vetërrëfimi real se çka ka ndodhur, e jo vetëm një retorikë për të përfituar diçka. Ne jemi shumë të sigurt se ky vetërrëfim do të jetë tamam i asaj lëmie që unë e quaj anatomi të veprës penale, e në qoftë se është kështu do të ishte një kontribut shumë i madh, sepse e bëjmë një arkiv të tërë destruktivitetit të akteve njerëzore. Për këtë qëllim, pra, ne i mbështesim këto dy projektligje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Kryeziu! Sipas renditjes, fjalën e ka përfaqësuesi i Aleancës Kosova e Re, zoti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Disa vërejtje parimore në funksion të përgatitjes së këtij dokumenti për etapën e dytë. Po e zëmë, “nënparagraf” nuk ekziston terminologji juridike, ka “nen”, ka “paragraf”, ka “aline”. U mor vesh, përkthimi i dobët. Ose, bie fjala këtu te paragrafi 5, do të duhej për t’u fshirë alineja e fundit, ku thuhet: “përveç në rastet kur gjykata e lejon që procedura të vazhdojë pa mbrojtës”, sepse do të mund të kontestohet kurdoherë me sukses nga i akuzuari. Ju lutem, edhe një herë te them këtë se me këtë dokument amnistohet kriminel, favorizohet kryerësi i krimit, favorizohet neglizhenca, indolencia e inefikasiteti i prokurorit që duhet ta ndjekë krimin, ta luftojë krimin pa kurrfarë kompromisi, jo me kontrata, jo me marrëveshje, jo me koncesione. Edhe në faqen 6, diku thuhet i “pandehuri” e diku i “akuzuari” e gjithnjë është fjala për të akuzuarin. Për ata që nuk janë profesionistë, mos të them se shumë kush thotë - jam ekspertë, e ekspert është shumë vështirë të jesh, dhe duhet të dallojmë edhe profesionalistin edhe specialistin edhe ekspertin. “I pandehuri” është derisa aktakuza e merr formën e prerë, është institut shumë dallues nga “i akuzuari”. “I akuzuari” është kur aktakuza e merr formën e prerë, kështu që përkthimi duhet të rregullohet. Unë e kam krahasuar edhe me anglisht, edhe me serbisht, kështu që në paragrafin e dytë të nenit 309, duhet të bëhet, të shkruhet ashtu si duhet: “dhe i akuzuari”. Ndryshe, parimisht Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet edhe këtë dokument për shqyrtim të mëtejshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Smakaj.

Sipas renditjes, fjalën e ka përfaqësuesi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit, Kryesues!

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar edhe këtë Projektligj dhe e kuptojmë qëllimin dhe interesin e Ministrisë së Drejtësisë, të Qeverisë së Kosovës që edhe përmes këtij institucioni të ri juridik në Kodin e përkohshëm të procedurës penale të synohet luftimi i krimit sa më me efekt në të gjitha format dhe në të gjitha mënyrat. Prandaj, si të tillë ne e përkrahim, e pranojmë si qëllim të tillë të mirë dhe, si rrjedhim, edhe Projektligjin e përkrahim, në parim.

Mirëpo, janë disa çështje teknike që duhet të rishikohen edhe njëherë, i thanë edhe kolegët e mëhershëm, sidomos deputeti Bahri Hyseni i përmendi disa prej tyre. Unë do të kisha shtuar edhe një çështje që e përmenda edhe tek Kodi penal kur diskutuam, kufiri i fundit i dënimit të zbutur. Cili është kufiri i fundit i dënimit të zbutur? Në fakt, nuk thuhet cili është ai kufi, edhe pse marrëveshja në mes prokurorit dhe të akuzuarit nuk e detyron gjykatën, mirëpo i sugjeron, por megjithatë e ndikon fuqimisht, dhe meqenëse e ndikon, atëherë duhet me ligj të caktohet cili është kufiri i fundit të dënimit të zbutur, deri ku mund të shkojë, ta zëmë, mund të themi deri te një e treta ose 50% e dënimit të paraparë me ligj, etj. etj., por një kufi i fundit duhet të thuhet. Tek neni 309, pika 1, paragrafi 2, këtu po e lexoj fjalinë që ka të bëjë me këtë temë, thotë: “përfshirë dënimin që është nën minimumin e parashikuar me ligj”, do të thotë prokurori ka të drejtë ta arrijë atë marrëveshje me të akuzuarin dhe t’i propozojë gjykatës dënimin edhe nën minimumin e parashikuar me ligj. Këtë çështje duhet ta ridiskutojmë dalëngadalë në Komisionin parlamentar për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe të marrim një vendim të përbashkët aty, bashkë me Ministren.

Ne e përkrahim në parim dhe do të marrim pjesë në punën e Komisionin për Projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Kosumi. Sipas radhës, është përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, zoti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Së pari dua të hiqet qysh tash fjala “I përkohshëm” në të dy kodet që i kemi para nesh, ndërsa titulli të jetë: “Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës”, besoj se Qeveria duhet t’i bëjë me kohë këto ndryshime dhe ta shoh se Kosova tash i ka institucionet shtetërore të përhershme.

Së dyti, tash kemi të bëjmë me ndërlidhshmërinë në mes të dy kodeve, pra të kodit që e shqyrtuam pak më parë, dhe këtij të tashmit dhe, ne e kemi vërejtur se ka disa probleme në mes neneve, apo kolizion, siç e quajnë juristët. Unë do t’i theksoj me radhë disa prej vërejtjeve tona. Së pari, neni 303, paragrafi 2, i Kodit të procedurës penale është në kundërshtim me paragrafin e propozuar për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, sepse neni 2 me të cilin plotësohet paragrafi 5, thuhet se kur i akuzuari kërkon të pranojë fajësinë për vepra penale për të cilat mund të dënohet me një apo më tepër vite dënim, apo me dënim afatgjatë, i akuzuari duhet të jetë i përfaqësuar nga mbrojtësi.

Po ashtu, në kapitullin 22, pas nenit 308, shtohet neni 309 nën paragrafin (iii) thuhet se në interes të drejtësisë, është lirimi nga dënimi i paraparë në nenin 303 të KPPK-së, por në paragrafin 2 të nenit 303, është paraparë lirimi apo pezullimi i dënimit vetëm për ato vepra penale për të cilat është paraparë dënimi deri 10 vjet, por jo për dënimet mbi 10 vjet. Pra, në rastin konkret kemi të bëjmë me një kolizion në mes të nenit 303, paragrafi 2 të KPPK-së dhe marrëveshjes së propozuar, sepse dispozita e përmendur e

Kodit penal të Kosovës për lirim apo pezullim të dënimit për vepra penale për të cilat parashihet dënimi me mbi 10 vjet burg, ndërkaq marrëveshja mbi fajësinë që na është propozuar në këtë paragraf që e kemi para nesh, lë mundësinë që të akuzuarit mund t'i pezullohet dënimi apo mund të lirohet edhe për veprat penale për të cilat parashihet dënimi mbi 1 vit dënim apo dënim afatgjatë, ndërsa dënimi afatgjatë konsiderohet dënimi me kohëzgjatje prej 21 deri 40 vjet.

Gjithashtu, marrëveshja e propozuar mbi pranimin e fajësisë është në kundërshtim me nenin 300, paragrafi 4 dhe 5, sepse në paragrafin 5 thuhet se gjyqtari mund ta revokojë urdhrin për dëshmitarin bashkëpunues, nëse ai akuzohet si organizator apo udhëheqës i grupit prej 2 apo më shumë personash.

Në paragrafin 6 të këtij nenit thuhet se për veprat penale për të cilat dënimi parashihet mbi 10 vite, nuk mund të jepet urdhër për bashkëpunim me këtë dëshmitar.

Si përfundim i gjithë kësaj, mendojmë se është e nevojshme të bëhet ndryshimi i nenit 300, paragrafi 5 dhe 6 dhe neni 303, paragrafi 2, në mënyrë që të bëhet i mundur aplikimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Ne do t'i përcjellim vërejtjet tona dhe në procedurat e mëtejshme në komisionet përkatëse, kështu që shpresojmë se do të merren parasysh dhe ky ligj do të jetë pa kundërshtime në mes neneve të tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit zoti Salihaj.

Sipas renditjes, në emër të Grupit Parlamentar "7+" është paraqitur Mufera Shinik.

MÜFERA ŞİNİK:

Sayın başkan,

Sayın milletvekilleri,

Hepinizi saygıyla selamlıyorum,

Sözkonusu Yasa tasarısını, 7+ Parlamenter grubu olarak kabul ederken, funksional komisyonda vereceğimiz katkılarının dikkate alınacağına inanarak hepinize teşekkür ediyorum.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Grupi Parlamentar i SLS-së nuk është. Për fjalë shtë paraqitur deputeti Hydajet Hyseni. Urdhëroni, zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryesues,

Ndryshimi në Kodin penal në të vërtetë ka qenë në funksion të ndryshimeve të propozuara në Kodin e procedurës penale, prandaj edhe nuk është e befasuese që ne do ta vazhdojmë, në njëfarë mënyre diskutimin aty ku e lamë në ligjin paraprak.

Nuk kam gjë për t'i shtuar asaj që u theksua më përpara si vërejtje, por imponohet edhe një dilemë, zonja ministre, sidomos ju që keni qenë e angazhuar edhe në proceset më të gjëra sesa tash në fushën e drejtësisë.

Kodi penal dhe Kodi i procedurës penale janë legjislacion i rëndësisë së veçantë, kurse ne këtu tani po i ndryshojmë pjesërisht dhe në një procedurë tjetër nga pakoja e ligjeve që janë konsideruar të rëndësisë së veçantë. Shtrohet pyetja: a e kanë edhe kodet atë rëndësi që e kanë, ta zëmë, dokumentet e udhëtimit ose privilegjet e diplomatëve, e të tjera. Për më tepër, e ripërsëris edhe një herë faktin se ndryshimeve të Kodit të

Procedurës Penale i është hyrë pa ekspertizën paraprake, pa konsultuar opinionet e Gjyqësorit dhe të ekspertëve në fushat e përafërta, për shembull opinionet e Shoqatës së gjyqtarëve, të Shoqatës së Odës së Avokatëve, të Shoqatës së juristëve, të ekspertëve nga jeta akademike etj., sepse ka shumë vërejtje edhe në Kodin penal, edhe në Kodin e procedurës penale, kurse ndryshimet e propozuara janë kufizuar kryesisht në tri çështje, në atë që është quajtur marrëveshje e fajësisë, atë që derivohet prej kësaj si zbutje, lehtësim i dënimit gjithnjë nga Prokuroria e Policia dhe, e fundit, ajo kategoria që tani po legjitimohet - e informatorëve të Policisë e Prokurorisë, etj.

E ritheksoj se në Kosovë këto fenomene nuk janë të reja. Ne i kemi pasur këto shumë të pranishme dhe shumë keq të pranishme, shumë abuzive. Tani po legjitimohet një praktikë që në Kosovë ka qenë e lëndueshme dhe po legjitimohet para se të transformohet në masën e duhur sistemi i drejtësisë në Kosovë. Shtrohet pyetja, çka do të ndodhë me pavarësinë e Gjyqësorit? A do të lejohet mundësia që pushteti i prokurorit, i policisë në ndarjen e drejtësisë të rritet dhe të cenohet në këtë mënyrë pavarësia e gjyqtarit dhe e Gjyqësorit në përgjithësi? Ne e kemi një fjalë: “Dy pa shpirt, një pa këmbë”.

Nëse gjithë fajtorëve u krijohet mundësia që ata ta zbusin dënimin duke pranuar fajin dhe duke u bërë informatorë të policisë, druaj që policia jonë do të ketë tepër shumë informatorë dhe nuk është mirë për Policinë dhe Prokurorinë nëse ajo kufizohet kryesisht në informatat ose informatorët e fajshëm. Unë e kuptoj që praktika të tilla ka në botë dhe s’e kam ndërmend të kundërvihem, aq më tepër kur përmendet Amerika, por ne jemi shumë prapa Amerikës, zonja ministre. Jemi shumë prapa dhe është mirë të synojmë të bëhemi Amerikë, por jo tash dhe të fusim, po e zëmë institucionin e sherifëve dhe ta bëjmë Teksas të shekullit XIX. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni! Për fjalë është paraqitur deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja ministre,

Të nderuar kolegë,

Edhe ligji i mëparshëm që ka të bëjë me Kodin, edhe ky për procedurën penale më duket se përafërsisht e kanë një frymë. Fryma është jo kjo qysh po diskutohet, me karakter të përgjithshëm, dhe ndoshta pikërisht është ajo që u mungon të dyja këtyre kodeve për arsye se personalisht unë i kam kuptuar sikur është fjala për diçka ose për raste tepër specifike, jo për krime ordinere. Atëherë, nëse është kështu, duhet të specifikohet në ligj që nuk është fjala për krime ordinere, se nëse një person e ka kryer një vrasje dhe ajo argumentohet, atëherë nuk ka se çka t’i kërkohet atij bashkëpunim. Por, të përkujtojmë se jemi duke jetuar në një kohë kur, për shembull, terrorizmi është aktiv, kontrabandat e lloje të ndryshme janë aktive dhe, ndoshta, nëse do të kapni në një rast të tillë një person shumë të rëndësishëm dhe ai do të dëshironte që, duke shpëtuar veten, të japë informacion shtesë, mendoj se në këtë frymë mundemi ta shikojmë këtë çështje, por kjo kërkon që të specifikohet. Kosova është një vend i përshtatshëm tranzitor për veprime ose veprimtari të ndryshme të mundshme kriminale dhe ne duhet t’i krijojmë parakushtet ligjore që policia, prokuroria dhe gjyqësia të jenë efikase për të vepruar në parandalim.

Unë këtë do ta ilustroj vetëm me një shembull. Le ta marrim si mundësi që është kapur një person i një bande terroriste që planifikon të kryej një akt terrorist, le të themi diku në Prishtinë, në një vendbanim ku viktimë do të mund të ishin me mijëra. Çfarë do të ishte kjo nëse ai do të pranonte të bashkëpunojë dhe t’i zbutej dënimi dhe të zbulohej vepra

ende pa u kryer. Me këtë dua të them se do të ishte mirë që të precizohet se për çfarë konteksti është fjala dhe të fshihet vija që është e paqartë tani midis krimit ordiner dhe krimeve specifike që mund të kenë rëndësi të veçantë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Abazi! Për fjalë është paraqitur deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Zoti kryesues,

Të nderuar kolegë,

Unë dëgjova me vëmendje diskutimin këtu dhe ajo që më brengos më shumë është sfera etike e Gjyqësorit dhe procedura gjyqësore. Mendoj se këto propozime bëjnë pjesë pikërisht në këtë sferë, sferë më të ndjeshme të etikës gjyqësore që po instalohet në Kosovë dhe i kam shqetësimet e mia se duke i aprovuar këto dispozita ligjore, këto norma ligjore, mund të vijë deri te abuzimet e mëdha nga institucionet shtetërore. Për shembull, në rast se një i pandehur fiton statusin e informatorit, mua më brengos shumë se a do të abuzojë policia procesin hetimor, hetuesia me informacionet që i jep i pandehuri. E para, sa janë të besueshme ato informacione dhe mos po e shndërrojmë të pandehurin në një peng në duar të institucioneve të akuzës dhe të hetuesisë.

Unë, në parim do të mbështes këtë projektligj, mirëpo besoj se në procedurat e mëtutjeshme duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe t'i specifikojmë mirë dispozitat të cilat i garantojnë qytetarët e Kosovës se nuk mund të jenë viktimat të arbitraritetit të institucioneve të Kosovës dhe të informacioneve të cilat kanë për qëllim përfitimin e statusit të favorshëm në burg të të pandehurve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Buçinca. Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vetëm do të kërkoja nga ministrja, nuk di a është e njoftuar se ka pasur një komision në këto grupet e tranzicionit që është marrë me përshtatjen e legjislacionit në fazën tash, të Republikës së Kosovës, dhe a i ka pasur parasysh vërejtjet e atij komisioni edhe në Kodin penal, edhe në Kodin e procedurës penale, po edhe në Kodin e ekzekutimit të sanksioneve penale dhe, nëse s'i ka pasur, unë mendoj se kjo do të duhej të ishte pjesë e atyre ndryshimeve që do të duhej të pasonin. Një çështje që mua më preokupon është kjo se deri më tash, jo vetëm në këtë Kuvend, por edhe në të gjithë shoqërinë tonë kosovare ka mbretëruar konstatimi se Gjyqësori në përgjithësi ka qenë i dështuar, ka qenë i dështuar për shumë fakte dhe për shumë arsye. Shpesh na ka ndodhur, rrugëve të kemi kryerës të veprave penale, janë marrë, janë lëshuar dhe ne nuk e paskemi ditur se ata kanë qenë në cilësinë e informatorit dhe nuk janë gjykuar për veprat penale, të cilat i kanë kryer.

Shqetësuese është se gjykatat, në këtë rast, nuk do të kenë rolin e ndarjes së drejtësisë, por do të na shndërrohen në institucione të marrëveshjeve dhe në institucione të kontratave, në mes institucionit të drejtësisë dhe kryerësve të veprave penale. Do të dëshiroja të dija se çka do të thotë pranim i fajit në këtë rast dhe çka do të thotë pranim i bashkëpunimit. Unë e kuptoj bashkëpunimin dhe bashkëpunëtorët dhe informatorët në një shoqëri qindramilionëshe, sikur që i kanë shtetet e tjera, por në një shoqëri dymilionëshe nuk e besoj se i duhen shumë informatorë, as policisë, as prokurorisë dhe as gjykatave. Dhe, kjo për mendimin tim është krejtësisht e papranueshme sepse, siç e thanë edhe parafolësit e tjerë, prokuroria do të rrijë dhe nuk do të kryejë punën e vet, policia nuk do të kryejë punën e vet dhe punën e tyre do ta kryejnë informatorët ose, me një fjalë, ata që kanë kryer vepra penale dhe secili që është i rrezikuar me një dënim deri me 10

vjet, unë jam i bindur se ai do të bëhet informator vetëm të shpëtojë. Por, kemi pasur edhe raste të tilla në cilësinë e informatorëve që s'kanë qenë ligjërisht ose të paraparë me dispozita të Kodit penal dhe as procedurës penale që kanë përfituar nga kjo marrëveshje dhe kanë kryer prapë vepra penale dhe kanë kaluar disa herë nëpër dyer të institucioneve të ndjekjes, po edhe të burgjeve dhe prapë i kemi rrugëve. Unë mendoj se legalizimi i një çështjeje të tillë në këtë fazë dhe në këtë periudhë, pa e ngritur në mënyrë të mirëfilltë bazën e drejtësisë dhe të sistemit të drejtësisë, është e papranueshme dhe nuk do të duhej ta lejojmë në këtë fazë, absolutisht. Kemi emra mjaft që na sillen rrugëve dhe nga vepra në vepër dhe kur bisedon edhe me prokuror, kur bisedon edhe me gjyqtar, thua jo se kjo ka qenë një marrëveshje e tillë për të hyrë në bërthamë ose në gjenezë ose, siç tha ai, në embrion të krimit ose të bazave të krimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Koci! Nuk ka më diskutues. Zonja Kelmendi, në qoftë se doni koment? Jo. OK. Shpresoj se të gjithë parafolësit dhe gjithë ata që do të kontribuojnë në legjislacion, do ta ndjekin procedurën e amendimit të ligjeve në fjalë.

Në radhë është pika e tretë e rendit të ditës:

– **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën kontestimore**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim. Ftoj ministren e drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

NEKIBE KELMENDI: I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më në fund, në korpusin e legjislacionit bazik të Kosovës vjen një ligj të cilin deri më tani nuk e kemi pasur fare, por ka qenë një ligj i një shteti të huaj dhe jam shumë e lumtur që sot kam rastin dhe nderin që para jush të prezantoj Projektligjin për procedurën kontestimore. Është ky një ligj që e zëvendëson aplikimin e gjertanishëm të Ligjit të procedurës kontestimore të ish Jugosllavisë. Është një ligj i cili është shumë më i avancuar sesa ai ligj. Është një ligj me të cilin definitivisht bëhet një diskontinuitet edhe formalo-juridikisht me ligjet e shtetit të huaj. Është ligj i cili është i zhveshur edhe nga premiset e sistemit të kaluar monist dhe gjithnjë është ligj i cili u mundëson qytetarëve të Kosovës që nëpërmjet procedurave të parapara me të t'i realizojnë të drejtat e tyre para gjykatave të Republikës së Kosovës.

Në gjendjen shumë delikate, sa i përket sistemit të drejtësisë nëpër të cilën ka kaluar dhe po kalon Kosova, e ballafaquar me vështirësi të shumta të Gjyqësorit për zgjidhjen e problemeve të shumta pronësore - juridike si dhe të çështjeve të lëmisë civile në përgjithësi, Projektligji për procedurën kontestimore paraqet jo vetëm një masë ndihmëse, por një domosdoshmëri si për faktin se është një ligj i ri dhe modern, por edhe për faktin se ky ligj është ndërhyrje komplementare e fuqishme në përmirësimin e gjendjes së sistemit gjyqësor dhe stimulimin e koncepcioneve të reja për zgjidhjen e kontesteve të ndryshme, pa të cilat sot nuk mund të paramendohet sundimi i ligjit dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik as në vendet më të përparuara të botës. Ky Projektligj është përgatitur para se të themelohej Ministria e Drejtësisë, mirëpo gjatë vitit 2005 i është kthyer nga Kuvendi i Kosovës në ripunim Qeverisë, pas kërkesës së UNMIK-ut, për shkak të kompetencës së rezervuar si dhe të gabimeve dhe të të metave të cilat janë konstatuar nga Kuvendi.

Në këtë kontekst, ne si Ministri përgjegjëse në këtë fushë, kemi formuar grupe të reja punuese dhe kemi bërë plotësime dhe ndryshime të nevojshme, duke pasur parasysh edhe rekomandimet e Kuvendit të Kosovës me rastin e kthimit të tij në ripunim. Ky Projektligj është përgatitur nga ekspertë të shquar të Kosovës, duke përfshirë profesorë të Fakultetit të Drejtësisë, gjyqtarë më eminentë të Kosovës, duke filluar nga Gjykata Supreme, Gjykata e Qarkut dhe ajo Komonale, ekspertë të Qeverisë, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të ministrive të tjera, si dhe ekspertë të huaj, të gjithë këta njohës të mirë të lëmisë civile, e sidomos të lëmisë së procedurës civile.

Ky projektligj përcakton parimet themelore prej momentit të inicimit të procedurës kontestimore, pra, të ushtrimit të padisë e deri te përfundimi i saj me vendim gjyqësor të formës së prerë, duke synuar krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore për zëvendësimin e legjislacionit të zbatueshëm, i cili është trashëguar nga sistemi i kaluar, ku shumë nga dispozitat ligjore të tij tanimë janë të tejkaluara. Fuqizimi i këtij i një rëndësie projektligji është të veçantë sepse do t'i hapë rrugë shtimit të efikasitetit në punën e Gjyqësorit, gjë që do të ndikonte në parandalimin e kryerjes së vetë gjyqësisë nga ana e qytetarëve për shkak të zvarritjes së procedurave gjyqësore civile, si dhe do të ndikojë në shtimin e besimit të qytetarëve në gjykatat tona. Ky projektligj është voluminoz, ka mbi 500 nene dhe rregullon në tërësi procedurën kontestimore në përputhje me standardet e larta ndërkombëtare, pra në harmoni edhe me standardet e ligjeve të Bashkësisë Evropiane.

I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Fuqizimi i këtij projektligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e gjyqësisë, përkatësisht të Gjyqësorit, andaj propozoj që pas procedurave të shqyrtimit të projektligjit të miratohet në Kuvend dhe të shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kelmendi! Sipas renditjes, fjalën duhet ta ketë kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po i ngreh vetëm disa shqetësime lidhur me projektligjin në fjalë. Sipas informacioneve që i kemi nga Komisioni për Legjislacion nga mandati i kaluar, kemi kuptuar se ky projektligj ka qenë në shqyrtim edhe në Komisionin funksional për Legjislacion dhe me këtë rast, Komisioni funksional për Legjislacion në bashkëpunim me Qeverinë, me Kuvendin dhe me organizatat të cilat e kanë mbështetur Kuvendin, ka hartuar edhe amendamente. Mirëpo, nga ajo që tani kemi parë, Projektligji është proceduar prapë në Kuvend dhe nuk janë marrë parasysh fare amendamentet të cilat janë hartuar në Komisionin funksional për Legjislacion. Do të ishte shumë më lehtë dhe do të ishte shumë më mirë që të ishin marrë parasysh amendamentet e komisionit funksional që janë punuar në atë kohë edhe pse, megjithatë, në aspektin juridik kjo kuptohet një çështje që ka mbetur e pakryer, por do të ishte me interes, sepse organizatat të cilat e kanë mbështetur Kuvendin kanë dhënë rekomandime. Gjithashtu, edhe anëtarët e Komisionit për Legjislacion kanë dhënë rekomandime, mirëpo në versionin që është proceduar tani në Kuvend nuk janë asnjë nga këto rekomandime. Mirëpo, megjithatë ne konsiderojmë të nevojshme që për shkak të natyrës që rregullon ky ligj, për shkak të kërkesës imediate për këtë ligj, ta japim mendimin që ky projektligj të aprovohet, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës fjalën e ka deputeti Ramadan Gashi.

RAMADAN GASHI: Faleminderit zoti kryesues!

E nderuar zonja ministre,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i PDK-së ka shqyrtuar në parim Projektligjin për procedurën kontestimore dhe gjen se është procedurë në përputhshmëri me Rregullën 33 pika 3 a) të Rregullores së Punës të Kuvendit, se Projektligji e ka deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane, se projektligji e ka deklaratën financiare dhe implikimet financiare në 3 vitet në vijim, por gjithashtu kemi gjetur se në Projektligj mungon një normë ligjore, e cila do t'i përcaktonte termat ligjore të cilat në mënyrë konsistente përdoren në ligj dhe mendojmë se duhet të jenë. Mungon edhe pjesa hyrëse e ligjit, e cilat është një çështje teknike dhe hartuese dhe mendojmë se duhet të jetë. Mandej, në kapitullin 13, 14 dhe 15 ku janë të renditura mjetet ankimore të rregullta dhe të jashtëzakonshme, mungon kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk e di pse mungon. Përndryshe, konsiderojmë se është një ligj i rëndësishëm së veçantë, është një punë shumë e madhe që është bërë dhe e përkrahim në parim në shqyrtimin e mëtutjeshëm, kurse shpresojmë se gjatë shqyrtimit sidomos në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi do të jepet kontribut i veçantë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gashi! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së zoti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Zoti kryesues, Grupi ynë mbështet në parim këtë Projektligj për procedurat kontestimore, të paktën për tri arsye. Natyrisht, mbështetja nuk nënkupton edhe përjashtimin e mundësisë tonë që në procedurën e mëtutjeshme të japim edhe propozime, ato që mendojmë se do të duhej të ishin në këtë projektligj. Arsyeja e parë për të cilën ne e mbështesim këtë projektligj është rëndësia e tij. Në qoftë se do të mund të sigurojmë që të aplikohet ky ligj në shoqërinë kosovare, atëherë do të kemi atë dukurinë e zbutjes, madje edhe të eliminimit të vetë gjyqësisë së qytetarëve tanë, për fat të keq, të kultivuar shekuj me radhë nga regjimet antipopullore që kanë qenë këtu. Arsyeja e dytë është edhe vlera e tij, ta quaj edhe patriotike në një farë forme, sepse zëvendësohet një ligj i një creature që tashmë nuk ekziston, i asaj Jugosllavisë së përparme. Dhe, arsye e tretë është, se ky ligj bazohet mbi premisa moderne, procedura moderne dhe bashkëkohore në pajtim me vlerat e kondenzuara tashmë të botës demokratike. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeziu! Në radhë është përfaqësuesi i Aleancës Kosova e Re, Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zotëri kryesues!

E nderuara zonja ministre,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet në parim Projektligjin për procedurën kontestimore. Konsiderojmë se Kosova ka nevojë për këtë ligj. I njëjti ka gabime gjuhësore, gabime sa i përket përdorimit të terminologjisë juridike, gabime përmbajtësore që janë si rezultat i përkthimeve të dobëta. Ky projektligj ka nevojë për ndryshime në mënyrë që të jetë sa më i aplikueshëm, Grupi Parlamentar i AKR-së shprehet në favor të miratimit të tij pas kalimit nëpër komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryesues!

E nderuara zonja ministre,

Të nderuar deputetë,

Sikurse dje, edhe sot projektligjet po procedohen serish në Kuvend pa u bazuar në një program legjislativ, i cili duhej të ishte pjesë e programit të Qeverisë që nuk është paraqitur ende para Kuvendit. Projektligji për procedurën kontestimore është hartuar nga Qeveria e kaluar dhe është miratuar, në parim, në mandatin e kaluar. Prandaj, shqyrtimi i serishëm i sotëm i tij, në parim, është i po të njëjtit ligj, pa asnjë ndryshim.

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Projektligji për procedurën kontestimore është i nevojshëm për plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e së drejtës procedurale civile. Qëllimi i këtij projektligji është që të rregullojë procedurat në bazë të të cilave gjykata i shqyrtton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko - civile të personave fizikë dhe juridikë të natyrës kontestimore.

Nevoja për këtë projektligj është imperativ i kohës duke marrë parasysh se ligji i mëparshëm i vitit 1977 është i tejkaluar dhe tani duhen rregullat e reja që u përgjigjen rrethanave ekzistuese në Kosovë. Gjyqësori sot ballafaqohet me vështirësi të shumta për zgjidhjen e problemeve të natyrës civilo - juridike, prandaj Projektligji për procedurën kontestimore paraqet ndihmesë në përmirësimin e punës së Gjyqësorit të Republikës së Kosovës. Projektligji modernizon dhe lehtëson procedurën kontestimore dhe është i bazuar në standardet dhe praktikën e mira ndërkombëtare, sidomos ato të Bashkimit Evropian. Megjithatë, ligji është voluminoz dhe përbën 530 nene.

Sa u përket implikimeve buxhetore, ato kryesisht janë të parapara të kryhen brenda strukturave ekzistuese, siç është Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor. Megjithatë, vlerësohet se mund të ketë shpenzime shtesë që për 3 vite prej vitit 2008 deri në vitin 2010 vlerësohet të jenë 30.000 euro, që do të thotë se kjo shumë është e përballueshme për buxhetin e Kosovës. Sikurse në mandatin e kaluar, edhe tani Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah, në parim, këtë projektligj dhe do të kontribuojë në amendimin e mëtejshëm të tij për ta bërë ligjin më të kuptueshëm dhe më të përdorshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues! Grupi Parlamentar i LDD-së në parim mbështet edhe aprovimin e këtij projektligji dhe ne jemi të lumtur që Kosova, më në fund, si shtet do ta ketë Ligjin mbi procedurat kontestimore dhe do të hiqet nga përdorimi, besoj, nuk e kam të qartë tash, si do të veprojmë në kohën derisa s'ekziston ky ligj. Jemi shtet dhe nuk vlen ai ligji që ka vlejtur më herët, por besoj se do të sqarohet kjo çështje.

Megjithatë, Projektligjit mund t'i bëhen shumë vërejtje. Duhet shqyrtuar me kujdes vërejtjet që i ka bërë Departamenti i OSBE-së për të Drejta të Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete. Ne kemi këtu 26 propozime për ndryshim, por ka edhe vërejtje të shumta në terminologji, si dhe në përkthim. Konsiderojmë se këto të meta duhet evituar gjatë procedurave të mëtutjeshme dhe ne, siç thashë në fillim, në parim e përkrahim atë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Salihaj! Në emër të Grupit Parlamentar “7+” fjalën e ka Shpresa Murati.

SHPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsedavajući! Pozdravljam sve prisutne u sali. Parlamentarna grupa „7+“ takodje podržava ovaj Nacrt zakona u načelu i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure u funkcionalnoj komisiji. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Të paraqitur të tjerë për diskutim lidhur me ligjin në fjalë nuk ka. Propozoj që të kemi një pauzë prej gjysmë ore dhe pastaj të vazhdojmë me ligjet e tjera. Faleminderit!

(Vazhdimi i seancës pas pauzës)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, në radhë është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbaruese

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbarshur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

NEKIBE KELMENDI: I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ja, kam nderin që para jush ta prezantoj edhe një Projektligji, i cili ngjashëm sikur ligji paraprak për procedurën kontestimore, i jep fund legjislacionit që është aplikuar në Kosovë e që ka mbetur nga sistemi i kaluar. Me këtë projektligj synohet që të shtohet efikasiteti i punës së gjykatave, sidomos në fazën pa të cilën nuk mund të mendohet se është realizuar drejtësia në gjykatat tona, sepse me një vendim të natyrës deklarative, i cili nuk mund të përmbarohet, atëherë thuaja se nuk kemi fituar asgjë, kemi fituar një letër, me të cilën nuk mund të realizojmë asgjë. Prandaj, Ligji për procedurën përmbarimore, apo për procedurën e përmbarimit, apo përmbaruese, sido që të quhet, nuk është asnjë gabim, i bën gjykatat tona më funksionale, ua kthen besimin gjykatave tona nga ana e qytetarëve, sepse po thuaj se numri më i madh i lëndëve të cilat sot janë nëpër sirtarët e gjykatave tona i përkasin materies përmbaruese, përkatësisht janë vendime të cilat presin përmbarimin dhe me këtë ligj do të lehtësohet pak a shumë dhe do të thjeshtësohet procedura e përmbarimit në mënyrë që kreditorët të realizojnë të drejtën e tyre sa më parë që është e mundur.

Ky projektligj është përgatitur para se të themelohet Ministria e Drejtësisë, mirëpo gjatë vitit 2005 është kthyer nga Kuvendi i Kosovës për ripunim, njësoj sikurse edhe ligji paraprak, pas kërkesës së UNMIK-ut për shkak të kompetencës së rezervuar të UNMIK-ut në këtë fushë, si dhe për shkak të disa gabimeve dhe të metave të cilat janë konstatuar nga ana e Kuvendit. Në këtë kontekst, Ministria e Drejtësisë në këtë fushë ka formuar grupe të reja punuese, ku ka bërë plotësimin në ndryshimin e nevojshëm, duke pasur parasysh edhe rekomandimet e Kuvendit të Kosovës me rastin e kthimit të tij në ripunim.

Ky projektligj është përgatitur nga ekspertë të shquar, të fushës përkatëse, duke përfshirë profesorë të Fakultetit të Drejtësisë, gjyqtarë eminentë të Kosovës, si ata të Gjykatës

Supreme dhe të gjykatave të qarqeve dhe ato komunale, ekspertë të Qeverisë, të Ministrisë së Drejtësisë, të ministrive të tjera dhe ekspertë të huaj, të gjithë këta njohës të mirë të lëmisë civile, sidomos të fushës së procedurës së përmbartimit.

Projektligji përcakton parimet themelore prej momentit të inicimit të procedurës përmbartuese deri në përfundimin e saj, duke synuar krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore për zëvendësimin e legjislacionit të zbatueshëm, i cili është trashëguar nga sistemi i kaluar, ku shumë nga dispozitat e tij ligjore tanimë janë të tejkaluara. Fuqizimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë, sepse ia hap rrugën shtimit të efikasitetit të punës së Gjyqësorit, gjë që do të ndikojë në parandalimin e kryerjes së vetë gjyqësisë nga ana e qytetarëve për shkak të zvarritjes së procedurave gjyqësore civile, si dhe do të ndikojë në shtimin e besimit, siç e ceka, të qytetarëve ndaj gjykatave.

Ky Projektligj është mjaft voluminoz, ndoshta do të mund të reduktohej nëse ndodhë diçka në ecje e sipër të themelimit të ndonjë agjencioni për ekzekutimin e vendimeve me para të gatshme, por kjo është tash çfarë është, është paraqitur para këtij Kuvendi dhe unë i propozoj që, meqë ky ligj është hartuar sipas standardeve ndërkombëtare, sidomos standardeve të ligjeve të Bashkësisë Evropiane, i propozoj Kuvendit që këtë ligj ta miratojë në lexim të parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre! Sipas radhës, fjalën duhet ta ketë kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje e nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo që shqetësimet që i ngrita me rastin e shqyrtimit të Projektligjit mbi procedurën kontestimore, vlen edhe për këtë ligj, sepse mendoj që është përdorë e njëjta procedurë dhe të njëjtat shqetësime i kemi edhe me rastin e Ligjit të procedurës përmbartuese, sepse amendamentet të cilat janë bërë nga Komisioni funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk janë marrë parasysh me rastin e procedimit për herë të dytë në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo, unë do të ndalem pak të çështjet pak më konkrete. Vërejtje konkrete në ligj janë hasur:

Në nenin 1.3, termi “mjetet e fluturimit”, është plotësisht i paqartë.

Neni 3.1 dhe 3.2, meqenëse nuk e qartëson komplet procedurën, atëherë do të ishte mirë të jetë një nen i vetëm, sepse janë dy nene, të cilat flasin për çështje të ndryshme, mirëpo në parim kanë të bëjnë vetëm me një çështje dhe duhet të jetë vetëm një nen i vetëm.

Neni 7.1, në fjalë është i paqartë dhe nuk e kuptojmë hartuesin pse e ka përdorur fjalët “pasuri natyrore dhe nëntokësore”.

Neni 8.1, komplet paragrafi është i paqartë. Thotë: “Gjykata me aktvendim e cakton përmbartimin me anë të atij mjeti” dhe nuk qartësohet për çfarë mjeti është fjala, për mjet të rregullit juridik, apo për mjet të jashtëzakonshëm juridik, por vetëm e përmend fjalën “mjet”.

Neni 38, përmbartimi në bazë të dokumenteve të besueshme, pse është i renditur në kreun e dytë, kur kreu i tretë i Projektligjit fillon me rregullimin e kësaj çështjeje. Është

domethënë vetëm në një nen, në kreun e dytë, ku e përmend këtë çështje e mandej fillohet në kreun e tretë dhe e rregullon komplet çështjen në fjalë.

Neni 53.2 është plotësisht i paqartë kur flet për veprimet e dhunshme të parapara në këtë ligj.

Neni 53.4, ky nen duhet të plotësohet sepse thotë: “personi zyrtar i gjykatës nuk ka të drejtë të urdhërojë përdorimin e forcës siç është paraparë në këtë nen”. Neni paraprak, që e përmenda, jep mundësi që në rast të problemit të shkaktuar me rastin e përmbarimit të ndonjë çështjeje të caktuar, thotë: “urdrin e jep një zyrtar i gjykatës për përdorimin e forcës” dhe kjo padyshim nuk është në kompetencë të zyrtarëve të gjykatës që të urdhërojnë për përdorim të forcës, sepse kjo mbetet çështje e forcës që janë thirrur për me ruajtur rendin dhe qetësinë publike dhe ato konsiderojnë kur duhet të intervenohet në raste të tilla, prandaj me rastin e shqyrtimit duhet të kihet parasysh.

Projektligjit i mungojnë afatet e veçanta kohore, për disa veprime. Për shembull në nenin 42.4.

Edhe pse neni 501 i Projektligjit, kur flet për masat e sigurisë, për marrjen e fëmijës, thirret në nenin 309 dhe 310 të Projektligjit, këto nene fare nuk janë në Projektligj. Prandaj, konsiderojmë se me rastin e shqyrtimit në komision, duhet t’i kemi parasysh dhe natyrisht do të krijojmë amendamente për këtë projektligj. Por, në parim, si projektligj e përkrahim meqë është i natyrës së veçantë dhe do ta përmbushë fushën e caktuar edhe është i ndërlidhur me procedurën kontestimore dhe me procedurën jashtëkontestimore. Si projektligj, e përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zoti Hyseni. Sipas radhës, në emër të Partisë Demokratike, deputetja Selvije Halimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, Zoti kryetar!

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke pasur parasysh faktin e disa procedurave nëpër të cilat ka kaluar ky projektligj më herët, duke pasur parasysh faktin se në komisionin e mandatit të kaluar janë hartuar disa amendamente, por që nuk kanë arritur deri në fazën përfundimtare dhe duke u munduar që me vërejtjet që dhanë deputetët sot, edhe ne si Grup parlamentar do të mundohemi që në komisionin funksional këtë ligj ta bëjmë sa më funksional dhe të zbatueshëm në praktikë. Duke u thirrur në të gjitha këto, si Grup parlamentar kemi vendosur që ta përkrahim këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Sipas radhës, Lidhja Demokratike, kryetari i Grupit Parlamentar, Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ne natyrisht që do ta mbështesim këtë projektligj, në parim, por më lejoni të them edhe një dy-tri gjëra të tjera. Ne besojmë se ka ardhur koha që të përpiqemi me të madhe për saktësinë e terminologjisë. Nuk është kjo vërejtje për ministrinë, e as për Qeverinë madje, por ndoshta do të ishte mirë që të bëjmë një grup ekspertësh me iniciativën e Kryetarit të Parlamentit ose të Parlamentit që pak a shumë të kemi një terminologji stabile. Ne vetë e pamë edhe këtu se praktikisht dy nocione u përdorën – edhe përmbarimore edhe përmbaruese. Po, kjo, hajde se janë nuanca ndoshta shumë të përafërta, mirëpo në qoftë

se gjuha shqipe do të jetë gjuha referuese për të gjitha dokumentet tash e mbas në Kosovën e pavarur, atëherë një kujdes i tillë i terminologjisë është jashtëzakonisht i nevojshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit zoti deputet. Për sqarim, mendoj se deri në këtë fazë çështja e terminologjisë dhe e gjuhës që përdoret në ligj i përket Qeverisë dhe po të përzihet Kuvendi është përzierje – konflikt interesi, kështu që ne, Kuvendi tani e tutje e kemi punën tonë. Në emër të AKR-së, deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar! Grupi Parlamentar i AKR-së, e mbështet në parim Projektligjin mbi procedurën përmbaruese. Konsiderojmë se ky projektligj dukshëm do të ndikojë në efikasitetin e punës së gjykatave. Grupi ynë e ruan të drejtën që vërejtjet tona eventuale t'ia paraqesim me shkrim komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Sipas radhës për AAK, deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Sikurse edhe Projektligji për procedurën kontestimore, edhe Projektligji për procedurën përmbaruese është i nevojshëm për plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e së drejtës procedurale civile. Ligji ka për qëllim që të rregullojë procedurën e përmbarimit, ashtu që të mos ketë zvarritje të procedurave gjyqësore civile dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Kjo eviton grumbullimin e lëndëve të pazgjidhura në gjykata. Me këtë po ashtu përmirësohet dhe ndihmohet gjendja e Gjyqësorit në funksionimin më efikas të tij. Edhe pse legjislacioni evropian nuk parasheh parim obligativ në çështjen e procedurës përmbaruese, megjithatë Projektligji për procedurën përmbaruese është në pajtim me parimet themelore të *acquis communautaire*.

Sa i përket kostos së ligjit, janë të parapara shpenzimet që barten kryesisht nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor, megjithatë mund të ketë shpenzime shtesë të cilat vlerësoj që për periudhën trevjeçare nga viti 2008 deri në vitin 2010 janë 20.000 euro, shumë kjo që është e përballueshme për buxhetin e Kosovës dhe që siguron zbatimin e këtij ligji.

Megjithatë, duke marrë parasysh se ky projektligj është voluminoz me 304 nene, është i nevojshëm përpunimi i mëtejshëm i tij. Duhet të thjeshtohet ashtu që procedurat e përmbarimit të jenë më efikase dhe ligji më funksional. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet në parim, por insiston që para amendimit të tij të mbahen dëgjimet publike në mënyrë që ligji të përpunohet dhe të arrijë qëllimin e vet. Faleminderit, për vëmendjen tuaj!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Sipas radhës, Grupi parlamentar i LDD-së, deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar! Ne dëgjuam se kemi të bëjmë me një ligj shumë të rëndësishëm dhe aprovimi i këtij ligji do të mundësonte zgjidhjen e shumë problemeve të qytetarëve që janë grumbulluar nëpër gjykata. Ligji rregullon një sferë

shumë të rëndësishme, pra ekzekutimin e vendimeve të gjykatave civile. Është një ligj mjaft voluminoz, me 304 nene.

Ne kemi vërejtje në shumë nene, janë të paqarta dhe ka një leksik dhe terminologji jo stabile. Pra, kjo vlen jo vetëm për këtë ligj, por edhe për ligjet e tjera dhe në procedurat e mëtutjeshme konsideroj se Ministria e Drejtësisë ka nevojë të bashkëpunojë ngushtë me Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi në mënyrë që të evitohen të gjitha këto të meta që janë vërejtur në këtë ligj. Ne do t'i bëjmë vërejtjet tona në procedura të mëtutjeshme. Në parim, e mbështesim dhe konsiderojmë se mund të shkojë më tutje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Sipas radhës, Grupi Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati.

XHEZAI MURATI: Hvala predsedniče! Evo, i mi se pridružujemo načelnoj saglasnosti oko ovog Nacrta zakona, ali je činjenica da je on stvarno preglomazan, da ima mnogo nepoznatih ili nepreciznih izraza i dosta nejasnoća, ne samo jezičkih. Nadam se, što su i kolege realni, da treba pridonijeti dosta kako bi ovaj zakon jednom vrlo ozbiljnom i stručnom doradom dobio namenu koja je potrebna. U načelu ga podržavamo i nadamo se da će ove primedbe da budu u daljem radu prihvaćene. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk paraqitet askush, s'janë prezent. Deputetë të tjerë për fjalë nuk ka.

Kalojmë në pikën vijuese:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

NEKIBE KELMENDI: I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kam nderin që në emër të Ministrisë së Drejtësisë t'i paraqes për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj. Në gjendjen shumë delikate sa i përket kontrollit të prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, me anë të këtij projektligji synohet që të gjithë zyrtarët e lartë publikë të deklarojnë pasurinë e tyre dhe prejardhjen e saj me rastin e punësimit në shërbimin publik, gjatë ushtrimit të pozitës së tyre si zyrtar dhe pas largimit të tyre nga funksioni publik.

Projektligji për deklarimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë paraqet jo vetëm një masë ndihmëse, por edhe një domosdoshmëri si për faktin që është ligji i ri dhe modern, por edhe për faktin se ky ligj është ndërhyrje komplementare dhe e fuqishme në përmirësimin e gjendjes ekzistuese, pa të cilën sot nuk mund të paramendohet sundimi i ligjit as në vendet më të përparuara të botës.

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me ekspertë të shquar vendorë dhe ndërkombëtarë. Projektligji përcakton parimet themelore dhe krijon mekanizma efikas për mbikëqyrjen dhe kontrollimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, të anëtarëve të ngushtë të familjeve të tyre si dhe të personave të lidhur me ta duke synuar krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore. Fuqizimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë dhe do të ndikonte në shtimin e efikasitetit në punën e Prokurorisë dhe të Gjyqësorit në përgjithësi për zbulimin e veprave të ndryshme penale të korrupsionit, të marrjes së ryshfetit dhe të formave të tjera të kundërligjshme, tek të cilat do të ndikonte si preventivë. Gjithashtu, do të shtonte besimin te qytetarët në punën e zyrtarëve të lartë publikë dhe në përgjithësi.

I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Fuqizimi i këtij projektligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë, andaj propozoj që sipas procedurave të parapara me Rregulloren e Punës të Kuvendit, ky ligj të miratohet në lexim të parë.

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre! Sipas radhës, kryetari i Komisionit për legjislacion dhe gjyqësi, e ka fjalën zoti Bahri Hyseni, nëse do. Nuk paraqitet. Atëherë vazhdojmë. Në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike, e ka fjalën Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Konsiderojmë se në këtë projektligj nuk janë zbatuar shumë rregulla të teknikës juridike të legjislacionit sepse, me rastin e fillimit të normimit në projektligj, ka filluar me nene e pastaj ka vazhduar me viza, që edhe ne që e kemi marrë në shqyrtim në parim e kemi pasur vështirë t'i japim komentet që në rastin e parë, sepse kanë qenë shumë viza dhe ka qenë vështirë për t' i renditur sa viza që kanë qenë të renditura në projektligj. Mirëpo, ajo që vlen të përmendet për projektligjin në fjalë, është njëri ndër projektligjet. i cili ka ardhur me gabime të shumta gjuhësore dhe teknike. Unë po i përmendi vetëm nenet, në të cilat kemi hasur gabime.

Nenet 3.1, 4, 5, 5.1, 6, 7, 9, 11, 11.3, 11.6, 11.7, 12, 13, 14, 18, 19, 21, domethënë, është njëri nga projektligjet rekord për gabime gjuhësore, teknike dhe në renditje.

Kurse si vërejtje që vlen të përmendet sa i përket përmbajtjes, më e rëndësishme është neni 3.1 ku përdoret vazhdimisht fjala “udhëheqësit e sekretariateve”. Kjo është shumë e paqartë dhe mendoj që duhet të shikohet që kjo fjali të mos përdoret, sepse, ndoshta, më mirë do të ishte të përdoret “udhëheqësit e sekretarive”, apo “seksioneve” që i kanë ndarë, sepse flitet për rregullimin e brendshëm. Domethënë, është fjala për strukturën e organizimit të Shërbimit Civil dhe aktualisht Shërbimi Civil organizohet në departamente apo drejtoritë që i kemi, në divizione, seksione, njësi, mirëpo sekretariate nuk e kemi përdorur, sepse rregullat aktuale të Shërbimit Civil nuk e njohin këtë terminologji.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës konsideron, meqë është fjala për një projektligj shumë të rëndësishëm dhe meqë i plotëson kriteret e përgjithshme, është i mendimit që ky projektligj të miratohet në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Sipas radhës, fjalën e ka Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryetari i Grupit, zoti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti Kryetar. Grupi i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet në parim këtë projektligj, përkatësisht Projektligjin për deklarimin e prejardhjes së pasurisë së qytetarëve të lartë, madje e sheh si shumë të domosdoshëm. Duke qenë se në qoftë se në hapësira të një shoqërie çfarë është edhe Kosova nuk fuqizohet ligji ose nuk vepron ai ligj, në raste të tilla çdo gjë është e vërtetë dhe nga ana tjetër asgjë nuk është e vërtetë. Për këtë arsye, për hir të transparencës dhe të kredibilitetit që do të duhej të kishin zyrtarët publikë, për më tepër edhe institucionet publike, ne e mirëpresim këtë projektligj, e përkrahim, ndërkaq, në debatet e ardhshme do të marrim pjesë aktive në pasurimin dhe saktësimin e tij.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Sipas radhës, Grupi Parlamentar i AKR-së, deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet zotërinj ministra,

Kolegë deputetë,

U bashkohem konstatimeve të parafolësve lidhur me rëndësinë që ka ligji për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe pa i ditur ne, si parti e re, ecejaket e këtij ligji në legjislaturat e mëhershme, konsiderojmë se ligji vjen shumë me vonesë në shoqërinë kosovare kur në njëfarë mënyre korrupsioni del sheshazi dhe ne tash përballemi me pasoja të mungesës së një ligji të tillë ose të mekanizmave parandalues që kjo të ndodhë. Sidoqoftë, ne e përsëritim që më në fund erdhi ky ligj dhe në parim AKR-ja e mbështet, po sigurisht, që në përmbajtje të këtij ligji mendojmë që duhet dhe ne në procedurat e mëvonshme të amendimit do të japim vërejtje konkrete. Unë do të ndalem te tri momente: autoriteti kompetent për evidentimin, për procedimin e krejt hetimit rreth deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë t'i lihet Agjencionit Antikorrupsion, që unë, natyrisht, pajtohem, sepse kjo bëhet në shumicën e vendeve demokratike të botës, por duke e njohur fuqinë që ka Agjencioni Antikorrupsion, tashmë e krijuar në Kosovë dhe mbështetjen institucionale që ajo e ka, mendoj se është mekanizëm i pafuqishëm për ta bërë këtë.

Kam vërejtje edhe te nenet 11, 9, 12.3 që merren me koincidencën e informacioneve lidhur me deklarimin e pasurisë, të cilat mendojmë se duhet të jenë edhe më të theksuara, në mënyrë që ende pa filluar procedura e hetimit të pasurive të zyrtarëve të lartë nëpër medime dalin informacione që nuk do të duhej të ndodhte kështu. Pra, këtu mendoj se duhet shtuar diçka, në mënyrë që këto coincidenca të jenë komponentë shumë e rëndësishme e këtij ligji.

Dhe, në fund, te sanksionimi, te pjesa që ka të bëjë me sanksionimin për mosdeklarimin e pasurisë me kohë ose të pasurisë reale, nenet që e sanksionojnë, neni 15, pika a), b), c), d), mendojmë që masat sanksionuese janë tepër të buta dhe si i tillë ligji nuk inkurajon se do ta parandalojë korrupsionin e këtyre kategorive të zyrtarëve në Kosovë. Po, sigurisht, këto vërejtje do t'i japim në mënyrë të shkruar në procedurën e leximit të dytë dhe pranë Komisionit përkatës. Natyrisht, ligjit mund t'i bëhen edhe disa vërejtje. Shihet se është përgatitur në legjislaturën e kaluar dhe janë disa instanca që tash më s'ekzistojnë. Për shembull "kryeshefat ekzekutiv të komunave", "nënkryetarët e kuvendeve komunale". Këto duhet të korrigjohen, gjithsesi, sepse dihet se ato më tash nuk janë ose janë zëvendësuar me instanca udhëheqëse të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Ibrahim Selmanaj.

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përkrah dhe mbështet në parim ligjin në fjalë. Projektligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë e konsiderojmë si njërin ndër ligjet mjaft të rëndësishëm, si kompletim i legjislacionit në Kosovë dhe, sigurisht, se do të jemi shumë aktiv në komisionet përkatëse që do të japim kontributin tonë, në mënyrë që ligji të jetë sa më i kompletuar dhe do ta mbështesim, do ta miratojmë në parim.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Sipas radhës, fjalën e ka deputetja e Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zonja ministre dhe ju ministra të tjerë që arritët tash, ju përshëndes,

Zoti Kryetar,

Projektligji për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë për zyrtarët e lartë, natyrisht, se është i mirëseardhur për të rregulluar edhe këtë fushë. Ne kemi parasysh se Agjencioni kundër Korrupsionit vepron qysh në mandatin e kaluar dhe, kryesisht, ai ka pasur të bëjë me këtë fushë, por ky ligj unë mendoj se e begaton dhe e ndihmon këtë agjencion, por është e vërtetë se ky ligj ka ardhur nga mandati i kaluar këtu tek ne deputetë dhe pa keqkuptim, zoti kryetar, është, në të vërtetë, papërgjegjësi totale, që në këtë formë ta na vijë ligji, duke pasur parasysh që ka edhe vërejtje, po mendoj defekte gjuhësore, teknike që pak më përpara thatë - ia latë fajin Qeverisë, Qeveria, vërtet, e ka fajin për gabime gjuhësore, teknike, por Kuvendi duhet të marrë një herë e përgjithmonë vendim që Qeveria të jetë më e kujdesshme dhe t'i sjellë ligjet më të përgatitura në Kuvendin e Kosovës.

Përveç vërejtjeve që janë të shumta, ndoshta, gjuhësore, teknike, por edhe përmbajtjesore, unë po ndalem te vlerësimi i ndikimit buxhetor. Do me thënë, ne kemi parasysh se Agjencioni kundër Korrupsionit vepron nga viti 2007, ndërsa ne na vjen ligji me këtë vlerësim në vitin 2007 deri në vitin 2009, që ne tash si deputetë nuk e dimë, sepse atje është një staf dhe nuk e dimë çka ka parashikuar ky ligj për këtë vit, domethënë çfarë kostoje buxhetore na vjen me të njëjtën kosto buxhetore që ka qenë që nga viti 2007, kjo nuk është serioze. Bile, sa për seriozitet, ju përkujtoj, zoti Kryetar, që në faqen e fundit, kreu 7 - hyrja në fuqi, neni 21 thotë: “Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Kuvendi i Kosovës dhe në ditën e shpalljes nga PSSP-ja, kryetari i Kuvendit, Kolë Berisha”. Ju kisha lutur që të jeni pak më korrekt në këtë drejtim.

Unë, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë që realisht nuk ish dashur për t’ ia dhënë pëlqimin në lexim të parë, sidomos, duke pasur parasysh vlerësimin e ndikimit buxhetor, sepse duhet të na vijë kostoja buxhetore për këtë ligj, në mënyrë korrekte e të saktë, unë kam parasysh ndoshta, bashkëpunimin tash me pozitën, me kolegët nga Komisioni i Buxhetit, që Ministria të na sjellë koston reale dhe ne pastaj ta shqyrtojmë në Komisionin e Buxhetit.

Pasi që grupet parlamentare para nesh i dhanë përkrahje në parim, unë mendoj se edhe në qoftë se nuk e përkrah LDD-ja, nuk do të ketë peshë, prandaj e mbështesim dhe premtojmë se do të japim kontributin tonë në të gjitha komisionet funksionale.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete!

Po, për sqarim, mendoj që ligjet nuk i shkruan Kryetari i Parlamentit, as Parlamenti deri në këtë fazë. Në leximin e dytë, sigurisht, që do të ketë përmirësime.
Sipas radhës Grupi Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati.

KRYETARI: Besa Gaxherri e ka fjalën edhe njëherë.

BESA GAXHERRI: Zoti Kryetar, shumë respekt. Ju lutem, ligjet, në qoftë se ju vetë personalisht nuk mund të arrini, është logjike që t’i shfletoni qysh vjen së paku struktura e tyre, e keni stafin për këtë. Unë personalisht nuk kisha pranuar të më vijë ky ligj në shqyrtim, në qoftë se kisha qenë Kryetare e Kuvendit, nuk kisha pranuar të më vijë me këto defekte të këtij lloji. Edhe njëherë po ju tërheq vërejtjen, ju ose ne, bashkë me juve, duhet të jemi ata të cilët Qeverisë duhet t’ia tërheqim vërejtjen, ta kthejmë ligjin, ndoshta, pa ardhur fare në Kuvend.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Edhe një sqarim. Çështja e Kuvendit është vetëm pasi të miratohet ligji, në parim. Atëherë, administrata dhe lektorët janë të obliguar që ta përmirësojnë, por në këtë fazë ligji vjen nga Qeveria dhe ne e procedojmë, ashtu siç na vjen. Nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë.
Fjalën e ka Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Evo, da iskoristimo momenat da pitam da li su prevodioci još otišli ranije na ručak, pošto prevoda u nastavku uopšte nema, tako da jedan deo poslanika ne mogu da prate regularno rad Skupštine. To traje čitavo vreme, kako radimo nonstop, možda su ogladneli, ja ih razumem ali ne pratimo regularno rad Skupštine.

Drugo, Skupština je postigla bogami ovaj nivo da se niko ničemu ne suprostavlja, znači ovo ubrzano usvajanje zakona dovelo je do prefekcije njihovo usvajanje. Nemamo primedbe, nemamo uopšte predloge i izgleda da ćemo postati šampioni u usvajanju zakona. Nije mi preostalo drugo nego da podržim sve kolege da, u načelu, podržavam ovaj Zakon. Znam da svih ovih godina popunjavam neke papire o poreklu imovine i da me nikad niko nije pitao šta imam a šta nemam, sve ostaje na papirima. Ne znam dali će donošenje ovog zakona nešto da izmeni u tom pogledu. Ako izmeni, mislim da će tek tada početi borba protiv korupcije. Hvala vam!

KRYETARI: Ju njoftoj se sa i përket përkthimit, përkthyesit janë në kabina. Unë e dëgjova përkthimin në gjuhën shqipe, por shpresoj që është përkthimi edhe në gjuhën serbe, apo edhe boshnjake.

Nuk kemi më të paraqitur, SLS, mungon.

Deputetë të paraqitur për debat nuk kemi.

Kalojmë në pikën tjetër të radhës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe në miratim, në parim.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari Kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Kolegë ministra,

Projektligji që tani e kemi në shqyrtim është nismë e reformës së Shërbimit Korrektues të Republikës së Kosovës. Kur e them këtë, kam parasysh se edhe në Shërbimin Korrektues fillojnë të respektohen të drejtat, dinjiteti dhe të gjitha ato që janë të lidhura me të dënuarit, që gjenden në mbajtje të dënimit, në mënyrë që, në të ardhmen, të mos kemi shqetësime, të mos kemi trazira, të mos kemi gjëra të pakëndshme në shërbimet tona korrektuese.

Në gjendjen delikate të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë edhe Shërbimin Korrektues dhe Sprovues të Kosovës, nëpër të cilin ka kaluar vendi, jemi ballafaquar me vështirësi të shumta në zgjidhjen e problemeve, siç e ceka më parë, kemi pasur edhe disa trazira. Prandaj, me këto plotësime dhe ndryshime të propozuara, do të bëhet një ligj më i avancuar, duke pasur parasysh inkorporimin e disa dispozitave të reja, të cilat do të ndikojnë në shtimin e efikasitetit të punës së Shërbimit Korrektues dhe Sprovues të Kosovës, që janë në pajtim me aktet juridike ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe do të ndikojë në uljen e tensioneve të të burgosurve për shkak të dhënies së disa beneficioneve të cilat atyre u takojnë dhe duhet ta meritojnë.

Qëllimi parësor i këtij projektligji është krijimi i një baze ligjore që do të mundësojë risocializimin e të gjithë personave që gjenden në mbajtje të dënimit apo që quhen ndryshe edhe të të dënuarve, përgatitjen e tyre për jetë dhe sjellje të ndërgjegjshme, si dhe mbrojtjen e shoqërisë duke parandaluar kryerjen e veprave të reja penale. Ky qëllim synohet të arrihet përmes ndryshimeve dhe plotësimeve të cilat janë bërë në këtë projektligj.

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale paraqet jo vetëm një masë ndihmëse, por edhe një domosdoshmëri për faktin se, fut disa dispozita të avancuara, por edhe për faktin se ky ligj është ndërhyrje komplementare e fuqishme në përmirësimin e gjendjes së Shërbimit Korrektues dhe Sprovues të Republikës së Kosovës, duke proklamuar konceptione të reja të cilat tani zbatohen në pjesën dërrmuese në vendet e zhvilluara dhe në vendet në tranzicion.

Projektligji është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë.

Inkorporimi i këtyre dispozitave ligjore në ligjin ekzistues për ekzekutimin e sanksioneve penale do të ndikojë në avancimin e legjislacionit në këtë fushë e me këtë edhe avancimin e të drejtave të të dënuarve pasi që, siç dihet, qëllimi i dënimit nuk është hakmarrja ndaj individit, ndaj të dënuarit për veprën e kryer penale, por është korrektimi, risocializimi dhe përgatitja e tyre për jetë normale në liri.

Prandaj, i nderuari, zoti Kryetar, të nderuar deputetë, Ministria e Drejtësisë është e bindur se miratimi i këtij projektligji në parim në Kuvend dhe shpallja nga Presidenti i Republikës së Kosovës është në funksion të

kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe në avancimin e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut dhe është në përputhshmëri edhe me standardet e legjislacionit të Bashkësisë Evropiane. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre!

Sa për njoftimin tuaj, pas ardhjes së deputetes Vlora Çitaku, në sallë janë 73 deputetë. Pas prezantimit të Projektligjit, hapi debatin për diskutim, në parim. Sipas radhës, kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni. A e dëshiron fjalën, në emër të Grupit. Urdhëro!

Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe me rastin e shqyrtimit të projektligjit, konstaton, se gjuha juridike është evidente në tekstin e Projektligjit. Konsiderojmë se në këtë ligj janë përdorur edhe rregullat e teknikës juridike. Mirëpo, me rastin e shqyrtimit të parë ka konstatuar se hartuesi i ligjit me rastin e përpilimit ka bërë lëshime të karakterit teknik që janë evidente në nenin 38.4, nenin 20, mandej në nenin 121, nenin 27 të Projektligjit, dhe në nenin 136, paragrafi 5. Ndërkaq, lëshime në aspektin përmbajtësor janë hasur në nenin 4 të Projektligjit, ku thuhet: “Kudo që shkruan organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, zëvendësohet me termin Ministria e Drejtësisë”, kurse në nenin 19 të Projektligjit neni 121, paragrafi 3 në vend të fjalës “organi publik kompetent” shtohet tani fjala “komisionari”, që mendojmë se bie ndesh tani ky nen me nenin 4, në fillim është Ministria e Drejtësisë, më pastaj në nenin 19 jep të drejtën komisionarit. Fjala është me siguri për komisionarin e policisë.

Neni 10 i Projektligjit që kërkon plotësimin e neni 69 paragrafi 3, duhet të sqarohet për çfarë urdhërese është fjala. Do me thënë, flitet që ministri i Drejtësisë do të nxjerrë një urdhëresë, mirëpo nuk caktohet a është fjala për një akt individual apo është fjala për urdhëresë administrative, e cila do të bie, atëherë, në sferën komplet të Ministrisë së Drejtësisë e jo të ministrit përkatës. Nuk është çështja se kush do ta nënshkruajë edhe ministri, natyrisht, që ka të drejtë, mirëpo ky do të jetë një akt, nëse është urdhëresë administrative, që bie në fushën e Ministrisë.

Neni 27 i Projektligjit, nën ku kërkohet ndryshimi dhe plotësimi i neni 136, paragrafi 3 duhet të qartësohet. Është fjala për ndërprerje të dënimit dhe tani kemi të njëjtin nen 136.4, ku të dy nenet flasin për të njëjtën çështje për ndërprerje të dënimit, mirëpo neni i parë nuk e thekson për çfarë ndërprerje të dënimit është fjala, kurse neni 136.4 e thekson se është fjala për ndërprerje të përkohshme. Dhe, shtrohet pyetja - çka të bëjmë, ta unifikojmë në një nen të vetëm, apo ta sqarojmë me rastin e hartimit të amendamenteve nenin 136.3? Të theksojmë se a është fjala për ndërprerje të përkohshme apo të përhershme apo për çfarë ndërprerje?

Neni tjetër, neni 27 duhet të qartësohet. Edhe neni 27 ndërlidhet me nenin 135 paragrafi 2 ku bëhet fjalë për formimin e komisioneve me rastin e ekspertizave mjeko- ligjore.

Këtu thuhet, në këtë nen se: “Komisioni do të përbëhet nga shumica e anëtarëve doktorë”, mirëpo nuk e specifikon sa janë ata anëtarë dhe nuk i specifikon anëtarët e tjerë të Komisionit. Prandaj, me rastin e implementimit tash në praktikë, do të mbetet në dëshirën e formimit të këtij komisioni, organi që e formon këtë komision se sa njerëz do t’i vendosë nga mjekët që konsiderohet se është e nevojshme dhe sa nga anëtarët e tjerë, por fare nuk specifikohet kush do të jenë anëtarë të tjerë nga cila fushë e caktuar. A do të jenë anëtarë të Ministrisë së Drejtësisë, a do të jenë anëtarë të gjykatave, të prokurorive e kështu me radhë.

Prandaj, duke marrë parasysh që nevoja është shumë e madhe për ndryshime dhe plotësime të këtij projektligj, sepse me rastin e implementimit në praktikë ka për të hasur pamundësi për implementim dhe meqë ka zbrazëtira juridike, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, konsideron se Projektligji duhet të miratohet, në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Hyseni!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, kryetari Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me ardhjen e asistentit tim shpresova që do të kem pak pushim, por sidoqoftë mirë edhe kësaj radhe do ta japë kontributin tim me kënaqësi.

Ne tash për ligjet përdorim me drejt epitetet ligj i drejtë, ose më pak i drejtë, ose i padrejtë, ligj i aplikueshëm ose më pak i aplikueshëm, i pamundshëm për tu aplikuar. Natyrisht, dëshira e shoqërisë sonë, do të thosha , unanime, duke përfshirë të gjitha partitë, do të ishte që të kemi ligje të drejta, moderne edhe të aplikueshme, maksimalisht. Mirëpo, për këtë rast unë do të thosha që marrë guximin t’ia shtojë edhe një epitet këtij projektligji dhe do ta quaja” fisnik”, sepse përpiket me të gjitha format që të risocializojë çka është e mundshme nga ata njerëz që hyjnë, rastësisht, në veprime penale. Prandaj, për këtë arsye e ka mbështetjen, avancë, prej nesh. Faleminderit !

KRYETARI: Faleminderit, zoti kryetar i Grupit Parlamentar.

Sipas radhës, fjalën e ka Grupi Parlamentar i AKR-së, deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Grupi Parlamentar i AKR-së, në parim e mbështet Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

I kemi disa vërejtje në këtë projektligj, mirëpo ato nuk mendojmë t’i përmendim tani, por do t’ia paraqesim Komisionit përkatës, në formë të shkruar.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete!

Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Donika Kadaj.

DONIKA KADAJ: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në parim e përkrah ligjin. Ligji plotëson infrastrukturën ligjore të Ministrisë së Drejtësisë, ndërkaq Projektligji synon plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, në mënyrë që, do të thotë të dënuarit të kenë kushte më të avancuara. Të gjitha vërejtjet eventuale ne do t’i paraqesim pranë komisionit dhe do të kontribuojmë me punën tonë.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale synon trajtimin më njerëzor të të dënuarve, riedukimin e tyre, risocializimin dhe përgatitjen e tyre për t'u kthyer në shoqëri, si të përmirësuar, në mënyrë që ata të jenë të aftë të japin një kontribut pozitiv për shoqërinë dhe familjen.

Grupi Parlamentar i LDD-së e përkrah në parim edhe këtë projektligj, por po e vërejmë një dukuri se disa aspekte të këtij projektligji, por edhe të tjerëve tashmë janë të tejkaluara dhe mendoj se Qeveria në të ardhmen nuk duhet t'i sjellë projektligjet e Qeverisë së kaluar, të përgatitura para një apo dy vjetësh, pa i lexuar fare, sepse shumë aspekte ka ndryshuar në Kosovë pas 17 shkurtit dhe këto projektligje kanë nevojë të korrigjohen në disa aspekte.

Sa i përket kuorumit, zoti Kryetar, në fillim kur e filluam seancën ishin vetëm 50 deputetë në sallë, tash ndoshta janë më shumë, por nuk janë aq sa ka kartela nëpër këto aparate, sepse ka kartela më shumë se deputetë. Prandaj, mendoj që nuk duhet të konstatohet kuorumi në bazë të kartelave, por të prezencës reale të deputetëve.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Sipas kartelave i kemi 89-90 deputetë, por unë e dhashë sipas numrit që janë prezentë, numrit fizik, pjesëmarrjes fizike dhe jo në bazë të kartelave.

Sipas radhës, fjalën e ka deputeti i Grupit Parlamentar “7+” Xhezair Murati”

DŽEZAIR MURATI: Evo, gospodine predsjedniče, i mi u načelu podržavamo ovaj Zakon o izvršenju krivičnih sankcija i podržavamo mišljenja da ga treba što više usklađivati sa zakonima demokracije razvijenih zemalja su uslovi boravka i prilikom izvršavanja kazni u svakom slučaju treba da budu što humaniji, što ljutskiji. U tom pogledu imamo sigurno iskustva razvijenih zemalja, pa bi možda u daljoj proceduri trebalo radi malo više kako bi uslovi boravka kažnjenika bili nešto povoljniji. Hvala vam!

KRYETARI: Shpresojmë deputetë, që Qeveria do të ketë parasysh përmirësimin e kuadrove profesionale në hartimin e ligjeve dhe në aspektin gjuhësor.

Me radhë do të ishte Grupi Parlamentar SLS-së, por mungojnë.

Tani është radha e deputetëve të paraqitur për debat. Në radhë është deputeti Hydajet Hyseni – Kaloshi.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuar ministre,

Të nderuar ministra,

E përshëndes nismën për ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, veçanërisht synimin për të ndryshuar gjendjen në shtëpitë korrektuese dhe për ta humanizuar edhe më shumë vuajtjen e dënimit.

Megjithatë, që në fillim shtrohet një pyetje: A thua a janë përfshirë të gjitha nevojat për ndryshime në këtë fushë? A janë marrë parasysh ankesat e shumta të atyre që janë në burgje ose që kanë qenë në burgje dhe veçanërisht të asociacioneve të ndryshme humanitare që kanë bërë vërejtje sa e sa herë. Ia përkujtoj Kuvendit se edhe Komisioni i mëparshëm Legjislativ ka vizituar burgjet dhe ia kishte bërë disa rekomandime edhe Qeverisë, edhe pranisë ndërkombëtare. Mund të konstatoj se me ndonjë përjashtim ato edhe pse kanë qenë të drejta dhe të pakontestueshme, në të vërtetë, ende nuk janë implementuar dhe për fat të keq nuk janë as në ligjin që kemi përpara.

Ky ligj është sponsorizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe, e përsëris, Ministria e Drejtësisë duhet të japë shembullin e pedanterisë, të rregullsisë dhe të respektimit të metodologjisë ligjvënëse. Në të vërtetë, na është sjellë një ligj për ndryshimin e ligjit, kurse ne nuk e kemi ligjin në fuqi. Edhe unë mund të pyes tash: Çka do të thotë, për shembull, amendamenti që kërkon, amendamenti numër 8, "të paktën 24 orë", çka? Nuk e kemi referencën, nuk e kemi pjesën tjetër të ligjit. Është vërejtje që në të ardhmen, kur ndryshohet një ligj, t'i kemi edhe dispozitat që ndryshohet, që të shohim gjithë kontekstin.

Ky ndryshim bën disa ndryshime terminologjike dhe mund të konstatoj se edhe ato, në një pjesë të madhe janë të diskutueshme. Ndonjërin e theksoi edhe drejtuesi i Komisionit. Për shembull, kërkesa që gjithkund ku është organi kompetent në lëmin e gjyqësisë, organi publik kompetent, veni re, në lëmin e gjyqësisë duhet të zëvendësohet „Ministria e Drejtësisë“. A është Ministria e Drejtësisë organi kompetent publik në lëmin e gjyqësisë? Jo, ministra, dhe më vjen mirë që e pohoni, sepse ju, po ta kishit pasur këtë ligj nuk do ta kishit lejuar këtë. Për më tepër ka, pastaj, përzierje atje me komisionarin, kurse në ndonjë vend edhe i jepen Ministrisë kompetenca, siç është ajo, ta zëmë, për pezullimin e dënimit për disa muaj ose për ndërprerjen e dënimit, që nuk është krejt në rregull, sepse ka organe të tjera kompetente në lëmin e gjyqësisë, të cilat janë injoruar këtu. Duhet të rregullohet, s'është do të thotë vetëm çështje terminologjike.

Kudo në ligj është kërkuar, ku flitet për riedukim ose shërbim riedukues, të zëvendësohet me "risocializim" dhe "risocializues". Nuk e mbulon gjithkund risocializimi edhe riedukimi, aq më tepër kemi në një nen të posaçëm atje një kapitull madje që rregullon çështjen e të drejtës në edukim, madje me certifikata dhe ajo s'është risocializim.

Ose kërkohet që i burgosuri të evidentohet, jo në regjistrin, por në kartonin personal. Kartoni personal nuk e përjashton edhe regjistrin që duhet të jetë, është çështje shumë profesionale, por është edhe elementare.

Sido që të jetë, ligji bën disa ndryshime pozitive, të cilat s'mund të mos i mbështesim, por mendoj që duhet bërë edhe ndryshime të tjera. Ky ligj, për fat të keq, bën edhe disa ndryshime restriktive dhe unë dua që tani t'i kontestoj. Për shembull, thuhet të ndryshohet ligji kur është fjala për telefonatat dhe thuhet shprehimisht: "I burgosuri ka të drejtë të bëjë telefonatë," por jo edhe tekstualisht kështu, "të pranojë, shqip," too accept," anglisht, dhe "da prihvati", asnjëra nuk janë shprehje, së pari, gjuhësisht të sakta. Telefonata as nuk "pranohet", as nuk "akceptohet" si thuhet, as nuk "prihvatitet", ka shprehje të tjera. Kurse edhe thellësisht, funksionalisht shtrohet pyetja: Pse duhet tash t'u merret të burgosurve një e drejtë që e paskan pas deri tani? Ne, a po flasim për humanizmin, apo për shtrëngimin e statusit të dënuarve, e tjera, aq më tepër kur ne e

dimë që kemi shumë të dënuar që atje vuajnë dënim të pafajshëm për shkak të atyre informatorëve dhe dëshmitarëve të rrejshëm që e kanë pasur atë status, e tjera.

Ose “vizita e lirë është mundësuar të lejohet kjo, nëse lejon drejtori e të tjerët në çdo 3 muaj” Në praktikat e mëparshme ka qenë kjo e mundësuar edhe çdo muaj. Pse të jetë patjetër në çdo 3 muaj?

Ka edhe, për shembull, ajo që thashë -24 orë përpara. Po të lexohet ligji, shihet se është fjala për mundësinë që përfaqësuesit e asociacioneve ndërkombëtare, të ose institucioneve ndërkombëtare të vizitojnë burgjet dhe ata duhet ta njoftojnë 24 orë përpara drejtorinë. Ka edhe një arsye, por shtrohet çështja çka duhet bërë në raste emergjente? Çka në raste kur mund të jetë një nevojë e ngutshme? Mendoj që ligji nuk duhet të pamundësojë transparencë, sidomos kur është fjala për subjektet ndërkombëtare, qoftë edhe pa e respektuar këtë 24 -shin.

Ka edhe çështje që janë mospërputhje gjuhësore. Për shembull, në një tekst në gjuhën shqipe në nenin 6 thuhet:” të fshihet kjo fjali”, në anglisht dhe në serbisht nuk është fare, kurse ju e dini që varianti përfundimtar mbetet teksti në anglisht, kështu që nëse nuk fshihet atje, atëherë bëhet një ramasis që s’mund ta merr vesh kush ç’është.

Zoti Kryetar, nëse më lejoni, unë dua të shtojë edhe një çështje të madhe që ka të bëjë pikërisht me synimin për humanizmin e gjendjes në burgje, e të tjera. Thonë se kjo është tregues i gjendjes në një shoqëri. Kosova, për fat të keq është nga vendet e pakta, nëse s’është i vetmi, që nuk zbaton institutin demokratik të amnistisë, të abolimit dhe të faljeve.

Në Kushtetutën që po qarkullon është paraparë një mundësi që Presidenti ta bëjë këtë, por ta bëjë në mënyrë individuale, e jo edhe grupore. Shtrohet pyetja, pse? Mendoj që janë krijuar kushtet që Kosova ta implementojë edhe këtë instrument, sidomos një shoqëri pas konfliktit, ka edhe më shumë arsye.

Në dokumentin e Rambujes, ua përkujtoj të gjithëve, ka qenë paraparë amnistia dhe kanë kaluar 7 – 8 vjet , por asgjë nuk është bërë në këtë drejtim dhe ka aq shumë nevojë.

Shfrytëzoj rastin , po ashtu, që ta adresoj këtë kërkesë edhe në adresën e Misionit Ndërkombëtar në Kosovë. Ne kemi bërë si komision një vit më parë edhe zyrtarisht. Do të ishte e pakuptueshme që Misioni Ndërkombëtar në Kosovë të përfundojë mandatin e tij në një fushë që e ka konsideruar të rezervuar, në mënyrë bukur përjashtuese për institucionet e Kosovës dhe nuk e ka zbatuar asnjëherë institucionin që zbatohet në të gjitha vendet demokratike të amnistisë, faljes ose abolimit. Kaq, kisha, zoti Kryetar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Sipas radhës së deputetëve, fjalën e ka deputeti ose kryetari i Grupit të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Në të vërtetë, meriton përkrahje edhe mbështetje çdo nismë që ka të bëjë me përmirësimin e kushteve për vuajtjet e dënimeve në Kosovë.

Pa hezitim e them se, ndoshta, të dënuarit dhe vuajtësit e dënimeve në Kosovë janë kategoria më e anashkaluar, më e përjashtuar prej shoqërisë kosovare, përkundër faktit se ka pasur përpjekje kohëve të fundit që të ketë ndryshime në këtë rrafsh.

I përmendën edhe parafolësit disa prej çështjeve mjaft të ndjeshme, por mendoj se arsyeja kryesore për këtë gjendje të përgjithshme në këto shtëpitë të cilat do të duhej të ishin shtëpi përmirësuese, ka të bëjë, pikërisht, me mungesën e implementimit të ligjeve në fuqi që jo rrallë herë kanë prodhuar dhe pakënaqësi të të burgosurve, të cilat, për fat të keq kanë përfunduar edhe tragjikisht, siç e kemi rastin e shtatorit të vitit 2003, kur 5 të burgosur kanë humbur jetën tragjikisht në Burgun e Dubravës.

Madje, mund të them se pikërisht këto institucione janë institucione më jo transparente në Kosovë dhe, për fat të keq, vazhdojnë të mbeten si të tilla. Kam pasur fatin, qoftë të mirë, qoftë të keq, që t'i vizitoj me dhjetëra herë burgjet gjithandej Kosovës dhe të njihem përafërsisht me të drejtat e tyre, që mund të them se në Kosovë, ka abuzim me të drejtat e të burgosurve dhe nuk ka penalizim ndaj atyre të cilët abuzojnë me këto të drejta. Në të vërtetë, në Kosovë edhe më tutje kjo kategori e njerëzve vazhdon të shihet me një sy tjetër dhe jo si pjesë përbërëse e shoqërisë.

Të burgosurit në Kosovë janë të privuar nga shumica e të drejtave elementare, të cilat i gëzojnë të burgosurit në vendet e tjera edhe në rajon, por edhe më gjerë. Janë të privuar nga e drejta e pushimeve që i takon gjithsecilit prej tyre. Madje janë të privuar edhe nga e drejta e krijimit të familjes, që bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Janë të privuar nga e drejta e shkollimit, kemi një numër mjaft të madh të miturve në burgun e Lipjanit, sidomos, janë të privuar nga zhvillimi i jetës kulturore, sportive, e të tjera. Po pajtohem me parafolësin që në vendet tashmë demokratike, shkalla e demokracisë në atë vend matet me të drejtat që i gëzojnë të burgosurit dhe pakicat kombëtare, që në Kosovë, gjithsesi, lënë për t'u dëshiruar.

Në Kosovë edhe më tutje pothuaj se pjesërisht ka filluar lirimi me kusht. Mendoj se një numër mjaft i madh i të burgosurve në Kosovë i kanë plotësuar kushtet që të lirohen me kusht në bazë të ligjeve në fuqi dhe që këtë të drejtë nuk po mund ta realizojnë, edhe përkundër faktit se shumica prej tyre kanë ankesat në institucionin, i cili është për këtë çështje, por që kryesisht ai institucion ua kthen përgjigjen pas një apo dy vjetëve. Ka nevojë për një reformë të thellë në sistemin e burgjeve në Kosovë, në mënyrë që ai të jetë në pajtim edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve. Po ashtu, dua ta ritheksoj atë që e tha zoti Hyseni, që në Kosovë janë pjekur kushtet që të ketë amnisti për një pjesë të burgosurve. Ju e dini, para disa muajve kemi pasur pakënaqësi të të burgosurve, pakënaqësi e cila është ndërprerë me rastin e premtimit se për ta do të ketë amnisti pas pavarësisë së Kosovës, dhe në këtë drejtim po kërkoj edhe nga Ministrja e Drejtësisë, por edhe nga Presidenti i Kosovës që ta ketë parasysh, sepse Kosova ka pasur një kalim mjaft të madh dhe meritore për këtë ditë, janë edhe një pjesë mjaft e madhe e të burgosurve të cilët meritojnë që në këto ditë ta gëzojnë të drejtën e amnistisë, ashtu siç do ta gëzonin në çdo pjesë tjetër.

Po ashtu, ju besoj jeni të njoftuar që ditëve të fundit, këto dy tri ditët e fundit kemi, po ashtu, shfaqje të pakënaqësive nga ana e të burgosurve, e sidomos në Burgun e Dubravës, të cilat do të duhej të jenë një shenjë e mirë për ne, që të ketë ndërmarrje të veprimeve të drejta dhe të zbatimit me përpikëri të ligjeve të cilat janë në fuqi. Ju faleminderit!

Për fjalë është paraqitur i fundit, deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Kolegë deputetë,

Nismën për sjelljen e këtij ligji në Parlament unë e përshëndes, duke qenë vetë i interesuar për këtë sferë, se edhe duke u nisur nga përvoja e shkeljeve personale të drejtave dhe lirive të mia, unë konsideroj se ligji është shumë i rëndësishëm dhe shumë i vonuar që të vijë në këtë Kuvend.

Jeta, të cilën e bëjnë të burgosurit, gjykuar nga informacionet që vijnë, qoftë nga mediat, qoftë nga protestat, qoftë nga organizatat joqeveritare, që kanë pasur rast të monitorojnë, të vizitojnë të burgosurit tonë, është shumë e margjinalizuar dhe bëhet jashtë, larg syve të opinionit. Ne si shoqëri, duhet të jemi të kujdesshëm në shtetin tonë të ri që po e ndërtojmë që ta ketë një fytyrë njerëzore dhe në thelb dhe themel i të gjitha proceseve të sistemit juridik në Kosovë, duhet të qëndrojnë liritë dhe të drejtat e njeriut. Të gjithë këta qytetarë tanë që gjenden aty, qoftë aksidentalisht dhe e bëjnë një pjesë të jetës së vet në institucionet korrektuese, duhet ta kenë vëmendjen e institucionit të Kosovës. Aty bëhen shkelje drastike të drejtave të njeriut.

Dramat personale të të burgosurve në Kosovë shpesh janë shndërruar edhe në drama familjare, për shkak të pasojave dhe të çrregullimeve të mëdha emocionale që paraqet njëfarë forme e izolimit total të tyre nga shoqëria dhe nga familja.

Unë e kam lexuar me vëmendje këtë ligj dhe konsideroj se ky ligj ka mjaft mangësi të mëdha. Është shumë i kufizuar në trajtimin e problemeve që i kanë të burgosurit tanë nëpër burgje dhe besoj se gjatë procedurave të ardhshme do të rishqyrtohet mirë, me vëmendje të posaçme. Por, për të qenë sa më komplet ky ligj, mua më interesojnë dy çështje: A e kanë autoritetin organet shtetërore të Kosovës, a e kanë autoritetin e vetëm në zbatimin e këtij ligji, a ka edhe legjislacion tjetër ndërkombëtar i cili e bën të pamundur zbatimin e këtij ligji në shtetin tonë? Kjo është e para. E dyta, kisha propozuar që në një seancë të ardhshme të formohet një komision ad-hoc nga Kuvendi i Kosovës, i cili do t'u bëjë një vizitë të gjitha institucioneve korrektuese, që për së afërmi të njihet me gjendjen që është aty, dhe pastaj t'i bëjë edhe propozimet për disa nene dhe dispozita të tjera ligjore, të cilat do ta rregullonin më mirë jetën që organizohet aty. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Po, për sqarim mendoj që duhet ta dimë se sot është e 10-ta ditë që e kemi shpallur Deklaratën e Pavarësisë dhe besoj që vetëm pas miratimit të Kushtetutës, Presidenti dhe organet e Kosovës mund t'i ushtrojnë kompetencat e tyre.

Për fjalë është paraqitur deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Nuk do ta zgjas shumë. Mendoj se ajo çka u tha në fillim do të vlejë dhe do ta votojmë këtë projektligj. Mendojmë se vlen, mendojmë se ne do t'i arrijmë standardet të cilat i synojmë, por me sa mbaj në mend unë, është hera e tretë që në Kuvendin e Kosovës diskutohet shumë gjatë për të drejtat e të burgosurve, të cilat duhet të përmirësohen në vazhdimësi. Vetëm po ia përkujtoj Kuvendit se shumë klasa nëpër shkollat tona duken më keq se burgjet, që të burgosurit hanë më mirë se të sëmurit në spital. Kjo nuk do të thotë që ne nuk duhet t'i

përmirësojmë kushtet, por do të thotë definitivisht që njerëzit në Kuvendin e Kosovës, deputetët edhe Qeveria, duhet t'i vendosin prioritetet. Po e përsëris edhe njëherë, kemi klasa të shkollave të cilat duken jashtëzakonisht më keq se dhomat e burgut. Shkoni e shikoni se si hanë të sëmurit në spitale dhe krahasoni me atë që hanë të burgosurit nëpër burgje.

Nuk do të shkoj më tutje, vetëm do t'ju them se disa diskutime nuk përkojnë me Kuvendin e Kosovës. Ne nuk guxojmë të mendojmë se ky Kuvend mund ta zëvendësojë Gjyqësorin dhe të tregojë se kemi heronj diku tjetër. Janë elementet të cilat përcaktohen në mënyra të ndryshme, kërkoj që Kuvendi t'i vendosë prioritetet, që secili deputetë të mendojë cilat janë prioritetet. Ta shikojmë gjithë shoqërinë, kur e shohim burgun, mos ta shohim vetëm burgun, ta shohim se ku jemi. Ta shohim se si jeton pjesa tjetër e shoqërisë.

Ju faleminderit!

KRYETARI: A dëshiron të replikojë, Ibrahim Makolli ?

IBRAHM MAKOLLI: Vërtet, nuk do të doja se nuk është çështja për replikë, por thjesht e vlen që deputetët e Parlamentit të Kosovës t'i vizitojnë burgjet e Kosovës dhe të njihen për së afërmi me gjendjen që është atje. Po e përmendi vetëm një rast. Pothuaj se askund në botën demokratike nuk ekziston që të miturit të mbahen në vetmi aq gjatë, sa mbahen në Kosovë. Po që se vizitoni, kemi me dhjetëra, sepse kujtoj se nuk është vendi këtu të krijojmë dëshmorë ose të tjerë, por kemi me dhjetëra të sëmurë, me dhjetëra të cilët kanë pjesë të eksplozivëve në trupin e tyre dhe të cilët nuk mund të shërohen brenda mureve të burgjeve e të cilët kanë nevojë për trajtime shëndetësore jashtë atyre hapësirave, ndoshta edhe jashtë vendit. Prandaj, jo gjithçka, duhet të lidhet me çështjen e ushqimit dhe çështjen e hapësirës së tyre të brendshme.

Hapësira të cilat i kanë burgjet e Kosovës, po pajtohem të gjithë për shkak edhe të kushteve të përgjithshme në Kosovë, nuk i plotësojnë as për së afërmi nevojat. Për më tepër, këto burgje, në rrethana të zakonshme do të duhej të ishin vende ku të mbahen të paraburgosurit dhe jo ata të cilët e vuajnë dënimin.

Institucionet e burgjeve në Kosovë, ose burgjet janë institucionet më të mbyllura, të cilat nuk komunikojnë me opinionin. Ju e dini se sa kanë administruar ndërkombëtarët, i kanë përjashtuar të gjithë, madje edhe deputetët e këtij Kuvendit e kanë pasur vështirë që t'i vizitojnë të burgosurit dhe të njihen me kushtet e tyre. Kujtoj se Kuvendi i Kosovës duhet të kujdeset edhe për atë pjesë të shoqërisë, duke mos u përzier asnjëherë në çështjet e drejtësisë, të cilët e kanë thënë fjalën për ta. Por, megjithatë, vlen që të diskutohet dhe të shihen mundësitë që të përmirësohen kushtet e jetesës së tyre.

KRYETARI: Për fjalë është paraqitur deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar, prapë shumë shkurt, detyrimisht duhet të pajtohem me gjithë atë që e tha deputeti Makolli.

Ajo për të cilën fola unë është kjo: kur kemi diskutuar për buxhetin e Kosovës për vitin 2008, nuk i kemi marrë as 2 minuta të bisedojmë për gjendjen në të cilat ndodhen shkollat në Kosovë. Definitivisht, deputetët duhet t'i vizitojnë burgjet, duhet t'i përmirësojmë kushtet në burgje, disa prej nesh i kemi vizituar, por mendoj se deputetët definitivisht duhet t'i vizitojnë edhe shkollat dhe ta shohin se si janë.

Krejt çka po flas, është përshtypja që e lëmë edhe njëfarë mesazhi implicit që del prej Kuvendit, kur marrim kaq shumë kohë të bisedojmë për një çështje, e cila realisht në Kosovë ka avancuar shumë më tepër se çështjet e tjera për të cilat fola pak më parë. Kjo është ajo, përndryshe pajtohem se të gjitha kushtet duhet të plotësohen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Mendoj se të gjithë e dimë se pushtetet në Kosovë janë të ndara, por Legjislativi ka të drejtë të hartojë ligje të mira dhe të bëjë kontrollin në shfrytëzimin e buxhetit edhe në shëndetësi, edhe në arsim. Konsideroj se debati ka përfunduar.

Vazhdojmë në shqyrtimin e ligjit në vazhdim:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën jokontestimore

Projektligji i është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim,

Ftoj ministren e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë të Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Ju faleminderit, zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Kolegë ministra,

Para jush sot kam nderin ta prezantoj Projektligjin për procedurën jo jokontestimore, i cili ç'është e vërteta, ka ekzistuar që nga vitin 1984 në Kosovë, si ligji i atëhershëm i Krahinës së Kosovës, mirëpo për shkak të ndryshimit të sistemit juridik të rendit shoqëror, natyrisht se edhe ky ligj duhet të gjejë një rifreskim dhe të shkëputet nga e kaluara moniste që deri në çlirim ekzistonte në Kosovë. Ky ligj, përndryshe, i rregullon të gjitha çështjet të cilat nuk janë të rregulluara me procedurat kontestimore dhe mbulon shumë fusha, gati, gati po aq fusha të cilat i rregullon ky ligj sa edhe vetë Ligji i procedurës kontestimore, mirëpo për shkak të natyrës së çështjeve që i rregullon ky ligj, duhet të ekzistojë si ligj i procedurës jokontestimore.

Ky ligj sikur që edhe disa ligje të mëparshme ka qenë i hartuar nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2005, mirëpo kur është kthyer në rihartim, është kthyer me vërejtjet edhe të Qeverisë, pas kërkesës së UNMK-ut, për shkak të kompetencës dhe për shkak të gabimeve dhe të të metave që janë konstatuar në diskutimin e parë në Kuvend.

Në këtë kontest, ne si Ministri përgjegjëse në këtë fushë, kemi formuar edhe grupe të reja punuese, të cilat kanë bërë përpjekje që t'i evitojnë të gjitha ato të meta dhe t'i plotësojnë të gjitha ato hapësira, kurse gjëja kryesore, që është eliminuar, është se tani më ky ligj nuk është në kompetencën për ta promovuar, nuk është në kompetencën e tjetërkujt, por në kompetencën e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Në hartimin e këtij ligji kanë marrë pjesë, sikur edhe në ligjet e tjera, shumë ekspertë të kësaj fushe, ekspertë nga Fakulteti Juridik, nga Gjyqësori, nga shoqatat e juristëve e të tjerë. Krejt kjo me qëllim të hartimit të një ligji sa më koherent me ligjet e tjera bashkëkohore, të një ligji i cili e lehtëson edhe funksionimin e gjykatave dhe zgjidhjen e çështjeve jokontestimore që paraqiten para gjykatave.

Ky projektligj përcakton edhe parimet themelore, prej momentit të inicimit të procedurës jokontestimore, e cila mund të iniciohet me propozim ose me kërkesë e deri te përfundimi i saj me vendim gjyqësor të formës së prerë, duke synuar krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore për zëvendësimin e legjislacionit të zbatueshëm, siç thashë, të trashëguar nga sistemi i kaluar, ku shumë dispozita ligjore të tij tanimë veç janë të tejkaluara.

Fuqizimi i këtij projektligji, është i një rëndësie të veçantë, sepse i hapë rrugën shtimit të efikasitetit të punës së Gjyqësorit, gjë e cila do të ndikonte në parandalimin e kryerjes së vetë gjyqësisë, sidomos kur janë në pyetje rregullimi i mezhdave apo i kufijve në mes patundshmërive të personave të ndryshëm, pra që lidhen me pronën, me të drejtat e servitutit e tjera. Ky ligj mëton që ta zvogëlojë zvarritjen e procedurave për zgjidhjen e këtyre çështjeve jokontestimore. Është mjaft ligj voluminoz, ndoshta, edhe gjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm mund të zvogëlohet sepse edhe vet kam vërejtur se ka çështje të cilat janë të tepërta, por megjithatë është punë e Kuvendit, së pari, kurse ne si Qeveri mund ta ndihmojmë edhe komisionin funksional të Kuvendit në eliminimin e atyre të metave që ka ky Projektligj. Dhe ne fund, propozoj të nderuar deputetë që në parim këtë Projektligj ta mbështetni, kurse në procedurat e mëtutjeshme, është çështja e funksioneve që ai të amendohet

Ju faleminderit!

KRYTARI: Ju faleminderit, zonja ministre!

Pas prezantimit të Projektligjit, hapi debatin për diskutim, në parim.

Për Grupin e Partisë Demokratike, fjalën e ka Ramadan Gashi.

RAMADAN GASHI: Ju faleminderit, i nderuar Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi i Partisë Parlamentare i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar në parim edhe Projektligjin për procedurën jokontestimore dhe vërtet konsiderojmë se po bëhet një kompletim i ligjeve të fushës civile, e cila fushë është mjaft e rëndësishme dhe konsiderojmë se ky ligj ka rëndësi të madhe për arsye se edhe vërtet po e zëvendëson një ligj të aplikueshëm dhe po e kompletton normën e fushës së tij.

Shpresojmë se në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, në shqyrtimin e mëtutjeshëm do të japim kontribut më konkret. Për momentin e përkrahim që ligji të shkojë më tutje.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të LDK-së, kryetari i Grupit, Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit zoti kryetar!

Ne edhe ashtu e kemi pasur ndërmend që ta mbështesim në parim këtë projektligj, por jemi të inkurajuar nga pohimi i zonjës Kelmendi, ministres së Drejtësisë, se edhe vet ka vërejtur mjaft raste kur, ndoshta, do të duhej ndërhyrë, sepse të jemi të qartë ne si deputetë, që në fillim kemi njëfarë respekti për ligjet që na vijnë nga Qeveria. Dhe në qoftë se edhe ministrja ka vërejtur një gjë të tillë, atëherë na vjen mirë edhe bashkë me

ndihmën tonë, do të kontribuojmë që në debatet e ardhshme të kemi një ligj pak a shumë të përkryer. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AKR-së, Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit zoti Kryetar, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, në parim e mbështet Projektligjin për procedurën jokontestimore. Konsiderojmë se Kosova ka nevojë për këtë ligj. Konsiderojmë se i njëjti ka nevojë për korrigjime në mënyrë që të jetë më i aplikueshëm, duke pasur parasysh gjithmonë implikimet buxhetore. Grupi Parlamentar i AKR-së, vërejtjet eventuale do t'ia paraqesë Komisionit përkatës në formë të shkruar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Gjylnaze Syla

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Edhe Projektligji për procedurën jokontestimore është shqyrtuar në mandatin e kaluar në parim dhe është miratuar, prandaj Projektligji i sotëm, të cilin e shqyrtojmë në parim, është i njëjti Projektligj.

Ky Projektligj është i nevojshëm si edhe dy projektligjet e mëparshme, Projektligji për procedurën kontestimore dhe Përmbartues, për kompletimin e infrastrukturës ligjore në fushën e së drejtës procedurale civile. Duke marrë parasysh se ligji i deritanishëm, i cili është zbatuar nuk u përgjigjet më nevojave në Kosovë, do të thotë nuk u përgjigjet rrethanave të reja shoqërore dhe ekonomike në Kosovë, atëherë është e nevojshme që të zëvendësohet me këtë ligj të ri, prandaj ne i mbështesim përpjekjet për ta kompletuar këtë fushë me legjislacion modern dhe praktik.

Projektligji synon që të rregullojë procedurat sipas të cilave gjykatat vendosin dhe veprojnë mbi të drejtat dhe interesat personale, familjare dhe pasurore. Po ashtu, Projektligji modernizon dhe lehtëson procedurën jo jokontestimore dhe është në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Është Projektligj voluminoz me 282 nene.

Sa i përket zbatimit të ligjit, në bazë të deklaratës për implikim buxhetor, nuk ka kosto të theksuar, megjithatë vlerësohet se në tri vjetët, nga viti 2008 deri në vitin 2010, mund të ketë shpenzime plotësuese prej 20.000 eurove, shumë kjo që është e përballueshme për Buxhetin e Kosovës.

Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet në parim këtë projektligj dhe angazhohet në përpunimin e mëtejshëm të tij në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Adem Salihaj

ADEM SALIHAI: Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së në parim e mbështet këtë projektligj. Ne konsiderojmë se projektligji i mëparshëm për procedurat kontestimore dhe ky për ato jokontestimore plotësojnë aspekte të ndryshme të njeri - tjetrit dhe në këtë mënyrë plotësohet edhe gama e ligjeve në Kosovë.

Mendojmë që është interes i qytetarëve që të nxirret sa më parë ky ligj dhe vërejtjet tona do t'i bëjmë në procedurat e mëtutjeshme në komisionin përkatës.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputetja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala predsedniče!

I Parlamentarna Grupa "7+", takodje u načelu podržava ovaj Nacrt zakona i smatra da ovaj Zakon pruža izuzetnu priliku za brže rešavanje sporova, naravno ako se pruži prilika učesnicima u postupku da dodje do njihove nagodbe.

S toga treba takvu mogućnost maksimalno podržati. Dakle, Parlamentarna grupa "7+", u načelu podržava i daje svoj doprinos u toku dalje njegove procedure. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Nuk ka deputetë të tjerë që janë paraqitur për fjalë. Ligji i radhës është:

-Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ftoj ministrin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara Kryesi,
Të nderuar deputetë,
Kolegë, ministra,

Qëllimi i këtij projektligji është që me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve të sigurohet shkalla e lartë e mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

Sigurimi i kornizës ligjore për shfrytëzimin më efikas të mjedisit dhe të resurseve natyrore, si dhe forcimi i përgjegjësisë për zhvillim e vet, harmonizimi me direktivat e BE-së, ku do të përcaktohen kushtet, mënyrat dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis.

Nevoja për nxjerrjen e Projektligjit është që të sigurohet korniza ligjore për shfrytëzimin më efikas të mjedisit dhe të resurseve natyrore, si dhe forcimi i përgjegjësisë për zhvillimin e vet, harmonizimin me direktivat e BE-së, ku do të përcaktohen kushtet, mënyra dhe procedurat e vlerësimit, të ndikimit të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis.

Në legjislacionin mjedisor të Kosovës, kjo lëmi nuk ishte e rregulluar në Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit, i cili ishte në procedurë të miratimit. Është paraparë që vlerësimi strategjik mjedisor të rregullohet me ligj të veçantë.

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji është t'i adresojë çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture komplete gjithëpërfshirës dhe përmbytjesore të shtjelluar në shatë kapituj sipas teknikës juridike, bashkëkohore dhe në harmoni me standardet dhe direktivat e Unionit Evropian.

Qëllimi tjetër i Projektligjit është, që me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurohet shkalla e lartë e mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit të njeriut. Ky projektligj përmban 7 kapituj, ku pas miratimit do të ketë mundësi për nxjerrjen e akteve nënligjore për implementimin e ligjit. Rëndësia e projektligjit është se mbulon këtë zbrazësinë ligjore që i mungon Kosovës.

Gjithashtu, risi është se në Kosovë po nxirret ligji i parë që do të rregullojë vlerësimin strategjik mjedisor dhe do të shërbejë si bazë për nxjerrjen e akteve nënligjore. Projektligji është hartuar në bazë të rregullave të përcaktuara në nenin 28 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese. Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete shtesë nga buxheti. Ju ftoj ta miratoni në parim dhe në procedurat e mëtutjeshme, besoj që ligji do të implementohet me sukses.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Pas prezantimit të Projektligjit, hapi debatin për diskutim, në parim.

Sipas radhës, kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zoti Lulzim Zeneli, do duhej ta kishte fjalën. Nëse e dëshiron fjalën? Mirë!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Selvije Halimi

Është mirë që deputetët që donë ta marrin fjalën në emër të grupeve, ta shtypin sustën.

SELVIJE HALIMI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Sa i përket këtij projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor, Grupi Parlamentar i PDK-së, vërejtjet që i ka pasur lidhur me këtë projektligj i ka paraqitur në mandatin e kaluar. Është i njëjti ligj, nuk dua t'i përsëris që t'ju marr kohë. Mirëpo, dua të shpreh një shqetësim tjetër të Grupit. Aktualisht, ekziston në fuqi Ligji për mjedisin, i miratuar në vitin 2003, dhe në rend ditës e kemi Ligjin tjetër për mjedisin, i cili është i hartuar në tetor të vitit 2007, kurse Projektligji për vlerësimin strategjik është në pjesën e parë të vitit 2007.

Përveç asaj që do ta mbështesim, unë dua ta them edhe një gjë. Në Komision do të kemi shumë punë lidhur me harmonizimin e këtij Projektligji, tash në Projektligjin e ri që ka ardhur për të njëjtën çështje, kurse më gjatë për Ligjin për Mjedisin do të flasim kur t'i vjen radha. Ligjin për mjedisin mendojmë se ka ardhur kot në Kuvend, ngase nuk i ka tejkaluar ato procedura apo ato norma që ai ligj të plotësohet apo të ndryshohet, por

vjen ligji i ri, derisa aktualisht ne e kemi një ligj në fuqi dhe nuk ka arsyetim pse po bëhet një ndërrim i ligjit, derisa ato dy ligjet janë miratuar tashmë .
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Zoti Kryetar, ne me kënaqësi do ta përkrahim në parim këtë ligj. Madje, sugjerimi ynë do të ishte, gjithashtu, parim për të gjitha ligjet që përpiqen të rregullojnë këtë lëmi, që dispozitat të jenë në fakt sa më të ashpra të mundshme, sepse çështja e ambientit është një çështje krejt globale. Unë e dëgjova ministrin, sikurse edhe gjithë ne që tha se është një ligj bashkëkohor, besoj qind për qind, sepse, para pak kohësh këto çështje nuk kanë qenë aq të mprehta, po tani edhe shoqëria kosovare, me të drejtë do të duhej të sensibilizohej maksimalisht. Për këtë arsye ne e mbështesim në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Heset Cakolli

HESET CAKOLLI: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor edhe pse ky projektligj përcillet me disa lëshime përmbajtjesore, besojmë se ne do të kontribuojmë me propozime konkrete në komisionet ku do të shqyrtohet ky projektligj.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, në parim pajtohet që ky projektligj të procedohet më tutje.
Ju faleminderit !

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Donika Kadaj

DONIKA KADAJ: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke marr parasysh që ky ligji është hartuar me herët, ne si grup kemi qenë të informuar dhe në parim e mbështesim, ndërkaq, të gjitha vërejtjet eventuale do t'i paraqesim në Komisionin përkatës.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kryetari i Grupit, Lulzim Zeneli.

LULZIM ENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Është fat i mirë që, të paktën, në aspektin e rregullimit ligjor po e rregullojmë këtë sferë që është shumë e rëndësishme dhe përfundimisht, ndoshta, është koha që edhe institucionet e Kosovës, po edhe shteti i Kosovës, politikat mjedisore t'i vendos në planin meritore.

Projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor është një projektligj i cili adreson përgjegjësi, krijon obligime të mëdha, që mundëson një zhvillim të qëndrueshëm mbi bazën e parimit të qëndrueshëm. Pra, në qoftë se arrijmë ta përmbyllim këtë kapitull me sukses në fazën e implementimit të këtij projektligji, të paktën do të kemi një qasje që zhvillimi ekonomik, mbrojtja e mjedisit të vendosen në ekuilibër. Prandaj, Kosova me këtë projektligj që kujtoj që në të ardhmen do të duhej shumë mirë të funksionalizohet përmes mekanizmave kompetent, adreson një çështje që është jetike, jo vetëm për mbrojtjen e mjedisit, por edhe për mbrojtjen e shëndetit të popullatës së Kosovës.

Ajo çka do të duhej të thuhet konkretisht për këtë projektligj, i cili është shumë i lidhur edhe me Projektligjin që do të adresohet pikërisht pas këtij projekti për ndikimin në mjedis, ne mund të themi se vërejtjet eventuale si Grup Parlamentar, por edhe si deputetë do t'ia adresojmë, kryekëput, Komisionit Parlamentar. Mirëpo, ajo çka është me rëndësi tash, thuhet se ky Projektligj paraqet një bazë të fuqishme që drejtpërsëdrejti institucionet e vendit të krijojnë përgjegjësi për mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe të mjedisit. Prandaj, ne e mbështesim, në parim, ndërsa vërejtjet do t'i adresojmë gjatë procedurës së amendimit.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar” 7+” Enis Kervan

ENIS KERVAN: Teşekurler sayın Başkan

Saygılar vekilerö

Qevrenis stratejik deyerlermesi yasata sarısında etkıyor usumusu sıylerle paylaşmak istıyorum

Qevarede bir sorun var galıba arvnauçā devam etecem

Ne e kemi shqyrtuar këtë projektligj. Qëllimi i këtij projektligji është që me vlerësimin strategjik mjedisor të planeve dhe të programeve, duke përfshirë edhe modifikimet e tyre, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit të njeriut, në harmoni me standardet dhe direktivat e BE-së.

Si Grup Parlamentar “ 7+” e përkrahim, në parim.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Me lejen tuaj, do ta shqyrtojmë edhe një ligj. Mirë, atëherë keni të drejtë, në orën 16,00 vazhdojmë seancën me votimin e ligjeve të shqyrtuara deri më tash.

Vazhdimi i seancës në orën 16,00

KRYETARI: Të nderuar deputetë. Vazhdojmë me seancën e pasditës lidhur me votimin në parim të projektligjeve të shqyrtuara në pjesën e paraditës.

Ju njoftoj se në sallë janë 77 deputetë dhe kemi kuorum të mjaftueshëm për të vazhduar punën.

Fillojmë me Projektligjin e parë:

– Miratimi në parim i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës

Tani në sallë janë 79 deputetë.

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paraditës, të deklarojnë për miratim, në parim, të këtij projektligji.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 73 vota “për”, 2 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Buxhet e Financa, dhe
3. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raporte me rekomandime, sipas Rregullës 35.6.

Vazhdojmë me ligjin tjetër:

- Miratimi në parim i Projektligjit për ndryshime dhe plotësime të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paraditës, të deklarojnë për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 74 vota “për”, 2 vota “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës.

Në bazë të Rregullës 23.7 dhe 35. 4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Buxhet e Financa dhe
3. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raporte me rekomandime, sipas Rregullës 35.6.

Në vijim kemi:

- Miratimin në parim të Projektligjit për procedurën kontestimore

Kërkoj nga deputetët që sipas zhvillimit të debatit të paraditës, të deklarojnë për miratim në parim të këtij projektligji.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë.

Konstatoj se me 79 vota “për”, me asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për procedurën kontestimore.

Në bazë të Rregullës 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Buxhet e Financa dhe
3. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raporte me rekomandime, Rregulla 35.6.

Në vazhdim kemi:

- Miratimin në parim të Projektligjit për procedurën përmbaruese

Kërkoj nga deputetët që, pas zhvillimit të debatit të para ditës, të deklarojnë për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për procedurën përmbaruese.

I kisha lutur deputetët të votojnë, e mos të përtojnë ta prekin sustën, sepse vërtet jeni duke harruar.

Në bazë të rregullave 23. 7 dhe 35. 4 Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Buxhet e Financa dhe
3. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raporte me rekomandime, Rregulla 35. 6.

Vazhdojmë me miratim në parim të:

- Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Kërkoj nga deputetët që, pas zhvillimit të debatit të paraditës, të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash;

Konstatohet se me 80 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Në bazë të Rregullës 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Buxhet e Financa dhe
3. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raporte me rekomandime, Rregulla 35.6.

Vazhdojmë me miratimin në parim të:

- Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kërkoj nga deputetët që, pas zhvillimit të debatit të para ditës, të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Në sallë janë të pranishëm 80 deputetë.

Konstatohet se me 79 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Në bazë të Rregullës 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Buxhet e Financa dhe
3. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raporte me rekomandime, Rregulla 35. 6.

Vazhdojmë me miratimin e:

- Projektligjit për procedurën jokontestimore

Kërkoj nga deputetët që, pas zhvillimit të debatit të para ditës, të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 76 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për procedurën jokontestimore.

Në bazë të Rregullës 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Buxhet e Financa dhe
3. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime, Rregulla 35.6.

Vazhdojmë me miratimin, në parim, të:

- Projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paraditës, të deklarojnë për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 78 vota “për”, 1 votë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor.

Në bazë të Rregullës 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe referues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet e Financa dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime, Rregulla 35. 6.

Dhe, me këtë votim të fundit, seanca e sotme mori fund.

Puna e seancës do të vazhdojë nesër, në orën 10,00.

Vazhdimi i seancës, më 28 shkurt 2008, në orën 10,00

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës, duke qenë se në sallë tani për tani janë të pranishëm 66 deputetë, është numër i mjaftueshëm që të mund të fillojmë me vazhdimin e seancës plenare.

Në radhë është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Fjalën ia japim menjëherë ministrit Yagcillar.

MAHIR YAGCILLAR: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë, ministra,

Qëllimi i këtij ligji ishte që të bëjë parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis të projekteve të propozuara nga aplikuesi, që do të thotë se personi juridik për realizimin e projektit konkret duhet të kërkojë pëlqimin mjedisor.

Sa i përket nevojës, Ligji për vlerësimin në ndikim mjedisor është i nevojshëm për të rregulluar procedurat për identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe administrimin e ndikimeve mjedisore të një projekti të propozuar, me qëllim që të sigurohet konsiderimi i plotë i të gjitha informatave relevante mjedisore.

Ky ligj është në përputhje me rregulloret evropiane të kësaj fushe. Së bashku me aktet nënligjore që do të nxirren në bazë të këtij ligji, ofrohet bazë për zbatim të plotë standardeve evropiane.

Të nderuar deputetë,

Sa i përket strukturës, ky ligj përmban në kreun e parë - dispozitat e përgjithshme, si dhe qëllimi dhe lënda e rregullimit të këtij ligji, përkufizimet dhe emërimi i autoritetit kompetent.

Kreu i dytë përcakton mënyrën se cilat projekte do t'i nënshtrohen VNM-së, detyrimet e aplikuesit për pëlqim mjedisor dhe detyrimet e Ministrisë ndaj aplikuesit.

Kreu i tretë trajton çështjen për procedurat e VNM-së ose të vlerësimit të ndikimit në mjedis, fazat e procedurës së VNM-së, kërkesën për fillimin e procedurës së VNM-së dhe shqyrtimin e saj. Pastaj udhëzimin e studimit, raportin e VNM-së, përmbajtjen, përpiluesit dhe shqyrtimin e këtij raporti, kyçjen e ekspertëve të jashtëm në shqyrtim, debatet publike. Vendimin për pëlqim mjedisor, të drejtën për ankesë, ndërprerjen e vlefshmërisë së pëlqimit mjedisor, respektimin e kushteve mjedisore nga raporti i VNM-së, tërheqjen e kërkesës për pëlqim mjedisor si dhe cakton bartësin e shpenzimeve.

Në kreun e katërt përcaktohen rregullat për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut, ndikimet ndërkufitare, arkivimin e dokumentacionit, qasjet në dokumentacionin dhe mbikëqyrjen.

Kreu i pestë përcakton rregullat për dispozitat ndëshkuese dhe të kundërvajtjes.

Kreu i gjashtë paraqet dispozitat përfundimtare dhe kalimtare dhe ka për qëllim përcaktimin e afatit për nxjerrjen e akteve nënligjore, zgjidhjen e kërkesave të paraqitura më herët, ndërprerjen e vlefshmërisë së rregulloreve të mëhershme si dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Të nderuar deputetë,

Ky draftligj ka edhe shtojcat I, II, dhe III.

Shtojca e parë përmban listën e veprimtarive dhe projektet të cilat duhet të nënshtrohen procedurës së VNM-së.

Shtojca e dytë përmban veprimtaritë dhe projektet të cilat duhet të nënshtrohen sipas rastit dhe kriteret nga shtojca III.

Shtojca e tretë ka të bëjë me kriteret e përzgjedhjes së projekteve, karakteristikat e projektit, vendndodhja e zbatimit të projektit dhe karakteristikat e ndikimit të mundshëm.

Duke ju falënderuar për vëmendje, ju ftoj ta përkrahni Projektligjin, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Duke qenë se Projektligjin e keni marrë më parë, atëherë konstatojmë se janë plotësuar kushtet për debat dhe me këtë rast e hapim debatin, në parim, por jo pa i përshëndetur përfaqësuesit e Qeverisë, zëvendëskryeministrin dhe ministrat. Ju faleminderit!

Do t'i ofrojmë rastin zotit Lulzim Zeneli, në qoftë se dëshiron diçka të thotë. Nuk është. Atëherë, sipas radhës, e kemi zonjën Selviqe Halimi, në emër të PDK-së.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sa i përket Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, është një projektligj i cili në mandatin e kaluar është kthyer mu për shkak të mungesës së shtojcave që përcakton veprimtaritë të cilat duhet të pajisen me pëlqimin për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Andaj, në këtë rast, ne kemi Projektligjin e kompletuar me shtojca dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ne e përkrahim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Meqë jeni deklaruar edhe për grupin tuaj, atëherë po shkojmë me radhë. Është paraqitur për fjalë Myrvete Pantina, nga LDK.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës parimisht është për miratimin e këtij ligji dhe mendon se miratimi dhe implementimi i këtij ligji është më se i nevojshëm për faktin se Kosova ka probleme të dukshme, të mos themi të mëdha, mjedisore që kanë të bëjnë me ndotjen e ujërave, me ndotjen e ajrit, menaxhimin e mbeturinave si dhe përdorimin e pakontrolluar të pasurive natyrore dhe të mineraleve.

Prandaj, me këtë ligj, i cili ka për qëllim parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis të projekteve të ndryshme të propozuara nga ana e aplikuesit, shpresojmë dhe duam të besojmë se do të vijë deri te realizimi i qëllimit të parashtruar. Ndërsa, nga gjobat e parapara me këtë ligj për kundërvajtje, për të gjithë personat juridikë dhe fizikë të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shpresojmë se do të ndihmojnë në realizimin e qëllimit të parashtruar me këtë ligj si dhe do të mundësojnë realizimin e të hyrave buxhetore, të cilat pritet të jenë të mjaftueshme për përmbushjen e shpenzimeve dhe të obligimeve ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në radhë është zoti Eset Cakolli, nga AKR-ja.

ESET CAKOLLI: I nderuari kryesues,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar Aleanca Kosova e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe ka konstatuar se ky projektligj është shumë me rëndësi për Republikën e Kosovës sepse tani, pas zgjidhjes së statusit, priten investime të shumta në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, të cilët mund të kenë ndikim edhe në mjedis. Prandaj, është mirë që kjo fushë të rregullohet edhe me ligj.

Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis i ka gjithsej 36 nene dhe 3 shtojca, në të cilat ne në parim kemi disa vërejtje konkrete, por edhe përkundër këtyre vërejtjeve që i kemi, Grupi ynë parlamentar pajtohet në parim që ky projektligj të procedohet më tutje. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Cakolli. Me radhë është Donika Kadaj, deputete nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

DONIKA KADAJ: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në vendet në tranzicion, ku problemet janë të shumta, filluar nga papunësia, kriza sociale dhe ekonomike, shpeshherë bëjmë të harrohet që kemi vetëm një tokë të cilën e kemi obligim ta ruajmë për gjeneratat që vijnë pas nesh. Gjithashtu, planet e shumta ambicioze të politikanëve për ndërtimin e një infrastrukture moderne drejtë një zhvillimi ekonomik që realisht është edhe në kërkesë e qytetarëve të Kosovës, bën që mbrojtja e mjedisit shpeshherë të lihet anash. Prandaj, konsiderojmë se ky ligj do të arrijë që të bëjë parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis.

Para se të kaloj te vërejtjet për ligjin në fjalë, do të ritheksoj edhe një herë nevojën urgjente dhe kjo do të jetë edhe një kërkesë për ekzekutivin, respektivisht ministrinë përkatëse që të bëjë implementimin e këtij ligji, do të thotë sa më parë dhe pa neglizhencë, gjë që edhe parashihet në nenin 31 të tij.

Të nderuar,

Sot kujdesi për mjedisin dhe ndikimet që kanë industritë e ndryshme në mjedis, është për të të ardhur keq. Neve të gjithë jemi dëshmitarë të eksploatimeve të ndryshme që u bëhen zonave të mëdha në Kosovë dhe për shkak të mosrehabilitimit të tyre ashtu siç parashihet në këtë projektligj, ato mbesin gërmadha. Në anën tjetër, kemi edhe shkaktime të shumta dhe probleme të cilat shkaktohen përmes vibracioneve, përmes zhurmës dhe ndotjes së ambientit të qytetarëve të Kosovës, e cila përmes këtij ligji mund të minimizohet apo të parandalohet.

Sa u përket vërejtjeve, tek neni 11 paragrafi 2, kemi një sugjerim, ndoshta edhe pyetje për ministrin, ka të bëjë me përcaktimin e afatit kohor në ankesa.

Neni 2 thotë “nëse aplikuesi nuk pajtohet me vendimin e ministrisë, ka të drejtë ankese në afat prej 3 ditë nga dita e pranimit. Ankesa i dorëzohet Ministrisë”. Mirëpo, nuk përcaktohet afati kohor që për sa kohë ministria duhet të japë përgjigje.

Prandaj, mendoj se kjo nuk duhet të mbetet në vullnetin e mirë të administratës përkatëse, por duhet të përcaktohet me ligj, në mënyrë që aplikuesi të ketë afatin e caktuar kohor kur do të merr përgjigje.

Gjithashtu, kemi edhe nenin 32, ku flasim për dispozitat ndëshkuese. Neve, si Grup, mendojmë se gjatë prej 3.000 deri në 10.000 euro duhet të jenë më të rënda duke marrë

parasysh që kemi të bëjmë me një fushë shumë të rëndësishme që ndërlidhet, ndër të tjera, edhe me shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Prandaj, duke konsideruar se këtij ligji do t'i nënshtrohen industri të rënda të cilat përfitojnë mjaft shumë nga eksploatimi, atëherë edhe gjrobat, në rast të mosaplikimit të ligjit, duhet të jenë më të rënda.

Në parim, Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah ligjin, duke e konsideruar si të favorshëm për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e ndotjes në formë të kompromisit në mes të ambientit të pastër, masës së përmirësimit të cilin industritë janë në gjendje ta arrijnë sa i përket teknologjisë dhe efektin e përgjithshëm të çmimit dhe ekonomisë kombëtare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka zoti Berim Ramosaj, nga LDD-ja.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ekipin qeveritar dhe kolegët e nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në parim e përkrah ligjin.

Ndërsa, sa i përket arsyeshmërisë, respektivisht qëllimit të zbatimit të këtij ligji, nuk kam çka të shtoj tjetër përveç asaj që tha ministri. Kurse sa i përket rolit dhe rëndësisë së këtij ligji, padyshim, duke marrë parasysh se në Kosovë lëvizjet e të gjelbërve nuk janë aq aktive, andaj shpresojmë se me këtë ligj sigurisht do të ruhet dhe menaxhohet ambienti, mirëpo dhëntë zoti që të jemi të gjithë prezent te zbatimi i tij, sepse kur vjen momenti i zbatimit të këtij ligji, ashtu siç është paraparë, shpresoj se do të kemi edhe konsekuenca edhe me industrinë, respektivisht me biznesin i cili deri sot ka vepruar pa u mbështetur ndoshta në kujdesin për ambientin.

Duke marrë parasysh të gjitha konsekuencat e mundshme që mund të ndodhin si rezultat i zbatimit të këtij ligji dhe të zhvillimit ekonomik, të cilin pretendojmë ta kemi më intensiv, respektivisht më dinamik, ne si Lidhje Demokratike e Dardanisë shpresojmë se do të kontribuojmë edhe me ndonjë amendament, respektivisht me ndonjë element të ri që kemi dilemat tona, por shpresojmë që do t'i bëjmë me shkrim dhe përmes komisioneve funksionale, respektivisht ndonjë forme tjetër të komunikimit.

Si Lidhje Demokratike e Dardanisë, në parim e përkrahim ligjin dhe do të japim kontributin tonë me kohë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Ramosaj! Tani do ta marrë fjalën zoti Enis Kervan nga "7+".

ENIS KERVAN:

Faleminderit zoti kryesues!

Uygun görülen eklemelerle birlikte çevreye etki eden etkenlerin değerlendirilmesi Yasa Taslağını Avrupa kriterlerine uyumlu gördüğümüzü, bu Yasa ile çevreye etki eden etkenlerin ancak ortadan kaldırılacağına inandığımızı ve şlk okunuşunu desteklediğimizi sizlerle paylaşmak istiyorum. Ancak Yasa Taslağının 32. maddesinde 300 ile 10000 euroluk ceza miktarı öngörülmektedir. Düşüncemize göre bu ceza miktarının çoğaltılmasıyla birlikte bazı istenmeyen olayların ve engellerin ortadan kaldırılacağına inanıyoruz. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Kervan! Në këtë mënyrë ne kemi ekspluatuar listën e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, tani shkojmë me të paraqiturit për debat. I pari në këtë listë është zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po e ngreh një shqetësim që është përsëritur edhe ditëve të kaluara. Shumë projektligje që po procedohen në Kuvend, po mbështeten në referenca dhe në Rregulloren 2001/19, që nuk ishte dashur të jetë kështu, sepse Rregullorja 2001/19 nuk i jep të drejtë qeverisë, domethënë, për miratim, siç po përmendet në referencë dhe nuk po e di pse. Gabime teknike nuk janë, sepse është në të tri versionet kështu dhe referencat e përmendura më poshtë janë referenca që kërkojnë harmonizimin e legjislacionit mjedisor në Kosovë me atë të Bashkimit Evropian. Prandaj komplet preambula e këtij projektligji është gabimisht dhe kërkojmë nga komisioni funksional përgjegjës që me rastin e shqyrtimit të kërkojë qoftë nga sponzorizuesi, qoftë vetë që të vendosë preambulë të re për këtë ligj, duke u bazuar në referencat përkatëse, domethënë në rregulloren apo në Kornizën kushtetuese të Kosovës, që është aktuale. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni. Tani e ka fjalën zoti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit zoti kryesues! Unë dua të falënderoj Ministrinë për këtë projektligj që e ka sjellë sot në Parlament për ta diskutuar. Edhe më herët është diskutuar mjaft për problemet mjedisore në Kosovë dhe si mund të arrijmë që sadopak t'i zbusim këto probleme mjedisore dhe, siç e potencuan edhe kolegët tanë, si mund të bëjmë harmonizimin në mes zhvillimit ekonomik, shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe të mbrojtjes së mjedisit. Është një problem shumë i madh se si t'i harmonizojmë këto dy, të them, projekte kapitale në këtë drejtim.

Për mua, që është brengosëse në këtë rast, është se vlerësimin në ndikimin në mjedis e bën aplikuesi dhe Ministria duhet ta bëjë vlerësimin e aplikantit në këtë rast. Marrim shembull një kompani që është shumë prestigjioze, që bën aplikimin dhe ministria duhet ta vlerësojë. A e kemi të përgatitur dhe a kemi strukturë profesionale në këto kushte dhe në këto rrethana, kur jemi duke zvogëluar për çdo ditë përkrahjen e ekspertëve në fushat e caktuara, që ta bëjnë vlerësimin e ndikimit në mjedis – kur e marrim për shembull një kompani shumë prestigjioze me renome botërore që konkurren te ne.

Në këtë drejtim unë ftoj edhe njëherë Qeverinë që të rishqyrtojë politikat e saj në drejtim të përkrahjes së ekspertëve brenda strukturave ministrore, posaçërisht për sektorët vitalë.

Prandaj, kjo është ajo brenga jonë dhe ne do ta mbështesim atë që e thamë, në parim, si grup parlamentar, por shtrohet pyetja se sa jemi të përgatitur me këto politika qeveritare që po i ndjekim për t'i afruar ekspertët dhe për t'i mbajtur që të bëjnë vlerësimin e ndikimit në mjedis. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Çeku. Tani për fjalë është paraqitur zoti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje Kabinetit qeveritar,
Përshëndetje të nderuar kolegë,

Ky ligj vërtet është për t'u përshëndetur, sepse tregon se po fillojmë t'i qasemi me seriozitet asaj që ta zhvillojmë një të ardhme me përgjegjësi dhe të përkujdesemi që të mos ndodhë një zhvillim i pakontrolluar dhe me efekte shumë negative.

Unë vetëm desha të jap një kontribut timin këtu se, duke lexuar me vëmendje ligjin, kam konstatuar se ka disa kundërthënie në kuadër të këtij ligji dhe që nuk lë mundësi të gjendet zgjidhja.

Për shembull, neni 7, decidivisht e thotë se “aplikuesi nuk mund të marrë lejen për ndërtim”, apo “nuk mund të fillojë realizimin e ndonjë projekti të planifikuar pa e zbatuar procedurën e VNM-së dhe marrjen e pëlqimit mjedisor nga ministria”.

Ndërkaq, neni 8, thotë se “për këtë, për ta dhënë një vlerësim është e obliguar ministria që të sigurojë të dhënat e duhura”, do të thotë që t'ia bëjë të mundur aplikuesit për të konstatuar gjendjen. Dhe, kontradikta tash qëndron me alinenë 3 të nenit 8, ku thotë se “nëse ministria nuk disponon me të dhëna dhe informata të kërkuara, me shkrim e njofton aplikuesin në afatin nga paragrafi 2 i këtij neni” dhe nuk tregon se çfarë do të ndodhë nëse ministria nuk i ka këto të dhëna, si do të procedohet më tutje, qysh do të gjendet zgjidhja dhe kjo mungesë mund të bëjë të lë hapësirë qoftë për moskorrektësi, qoftë për keqpërdorime, qoftë edhe pa dashje për ta bllokuar një veprimtari që mund të jetë me interes për zhvillimin e ekonomisë ose të vendit tonë. Prandaj, do të ishte mirë që gjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm të merret parasysh dhe, ose të krijohet një mundësi se si të eliminohet kjo bllokadë këtu ose të hiqet njëherësh prej alineve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Abazi! Duke qenë se më nuk ka të paraqitur oratorë për këtë debat, në parim, kalojmë te shqyrtimi tjetër i projektligjit në radhë:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale

Duke qenë se Projektligjin e keni secili prej jush, atëherë s'na mbetet tjetër, veç t'ia japim fjalën sponsorizuesit, zotit Ramë Manaj që, në emër të Qeverisë së Kosovës, ta prezantojë këtë projektligj.

RAMË MANAJ: Faleminderit, kryesues i seancës!

Deputetë të nderuar,

Të nderuar ministra,

Ligji për skemën sociale, duket se është ndër ato ligje, i cili ka pasur nevojë që herët të plotësohet dhe eventualisht të ndryshohet.

Ligji numër 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 11 korrik të vitit 2003, ndërsa është fuqizuar me Rregulloren 2003/28, e nënshkruar më 18 gusht 2003 nga PSSP të OKB-së. Kjo ka për qëllim të thotë se ky ligj është ndër ligjet e para në periudhën e pasluftës në vendin tonë.

Me këtë ligj rregullohet skema e ndihmës sociale në Kosovë me qëllim të mbrojtjes dhe të përkujdesjes së të gjitha familjeve të cilat janë në gjendje të rëndë sociale dhe materiale.

Përkundër faktit se me dispozitat e këtij ligji rregullohet skema e ndihmave sociale në Kosovë, që nga viti 2003 mekanizmat kompetente dhe përgjegjëse për mbikëqyrje dhe

kontroll të zbatimit të këtij ligji, në vazhdimësi, kanë reaguar dhe vlerësuar se ekzistojnë pengesa të ndryshme për zbatimin e drejtë dhe efikas të Ligjit 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Këto pengesa dhe vështirësi në zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij ligji kanë qenë dhe kanë mbetur pasojë e disa dispozitave kontradiktore, të pazbatueshme ose vështirë të zbatueshme, të paqarta, konfuze dhe jofunksionale.

E gjithë kjo ka ndikuar në joefikasitetin dhe jofunksionalitetin e duhur në ushtrimin e mbikëqyrjes dhe të kontrollit të punëve, si dhe ka mundësuar interpretimet e ndryshme të dispozitave të caktuara ligjore.

Pas analizave të bëra nga niveli politik dhe ai administrativ i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të qendrave për punë sociale, që përndryshe janë implementuese të ligjit ë fjalë, lidhur me nismën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, njëzëri është vlerësuar se duhet të bëhet amendimi i Ligjit në fjalë.

Konstatimi i përgjithshëm për këtë ligj ishte se veprimet në efikasitetin e punës, ndryshimet dhe plotësimet e ligjit do të kenë efekt të drejtpërdrejtë në veprimet dhe në efikasitetin e punës së qendrave për punë sociale, sepse me këto ndryshime dhe plotësime do të evitohen disa paqartësi rreth interpretimit të dispozitave ligjore të Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Ndër arsyet kryesore të cilat kanë ndikuar në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, janë:

- përkufizimi dhe qartësimi i drejtë i disa shprehjeve dhe nocioneve të përdorura në këtë ligj;
- përcaktimi i kriterëve të reja për të qenë përfitues i ndihmave sociale;
- eliminimi i disa kriterëve financiarë për ndihma sociale të cilat nuk kanë qenë në funksion dhe në përputhshmëri me gjendjen reale materiale të familjes përkatëse; dhe
- përlllogaritja e pensioneve bazë, të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara dhe të pensioneve të luftës si të hyra materiale të llogaritshme me rastin e përzgjedhjes së familjes si përfitues i ndihmës sociale.

Deputetë të nderuar,

Bazuar në arsyet e lartpërmendura, vlerësojmë se qëllimi themelor i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndihmë sociale është avancimi i rrjetit të mbrojtjes sociale për familjet e përzgjedhura në skemën e ndihmës sociale në Kosovë ose, më mirë të themi, për familjet përfituese.

Gjithashtu, qëllim tjetër është që, në njërën anë të bëhet ashpërsimi i kushteve dhe kriterëve për familjet të cilat nuk janë në nevojë sociale dhe nuk do të mund të realizojnë ndihmën sociale, ndërsa në anën tjetër, do t'u bëhet ngritje e shumë financiare të ndihmës sociale, është menduar fillimisht për 5 euro, personave të familjeve të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret për realizimi e ndihmës sociale.

Po ashtu, vlerësojmë se kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Ligjin numër 2003/15 për skemën e ndihmës sociale, duhen ndryshuar dhe plotësuar ngase edhe rrethanat në kohën e aprovimit të Ligjit në fjalë kanë qenë të tjera, krahasuar me rrethanat e tanishme të gjendjes ekonomiko-sociale në Kosovë.

Me këtë rast theksojmë se me shqyrtimin dhe aprovimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, kursimet buxhetore, në qoftë se mund t'i quajmë kështu, nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës do të arrijnë diku në 3.321.756 euro, sipas një parallogarie, për çka vlerësojmë se edhe kjo komponentë është shumë e rëndësishme për vendin tonë dhe duhet të ketë ndikim në aprovimin e këtij ligji, shpresojmë, edhe në përmirësimin ose ngritjen e shumës së trajtimit të familjeve që përfitojnë këtë të drejtë.

Duke çmuar kohën tuaj shumë të vlefshme, ju falënderoj shumë për vëmendjen dhe ju lus që me përkushtim të jepni kontribut në përmirësimin e cilësisë së këtij ligji, natyrisht përmes amendimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Do ta pyesim zotin Sadik Idriz, a dëshiron të japë kontributin e vet si kryetar i Komisionit përkatës. Lus regjinë t'ia mundësojë qasjen zotit Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Komisija za zdravstvo, rad i socijalno staranje nije, zbog ovih vremenskih ograničenja, raspravljala o ovom nacrtu zakona, jer juče – prejkjučer usvojila je u stvari Nacrt plana za 2008. godinu. Sigurno će nakon usvajanja ovog zakona u načelu, Komisija raditi na tome. Međutim, postoji nešto što se odnosi na jedan set zakona koji su bili procesuirani u prethodnom sazivu Parlamenta i koji su ponovo sada, to je ovaj zakon – Zakon o inspektoratu rada. To su znači izmene i još neki zakoni koji su vezani za jedan drugi zakon, a to je Zakon o radu, koji će biti verovatno u strategiji zakonodavstva za ovu godinu. I ovi zakoni su direktno vezani za taj zakon i Komisija u prethodnom sazivu je zaustavila te zakone, baš iz razloga što nije bio usvojen Zakon o radu, koji je bazični – osnovni zakon za ove zakone.

Inače, iz naše Parlamentarne grupe o ovom zakonu će govoriti Shpresa Murati.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Idriz! Tani do të shkojmë sipas grupeve parlamentare. Nga PDK-ja është paraqitur deputetja Teuta Hadri.

TEUTA HADRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

U tha edhe më parë se Ligji në fjalë ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/15. Ky ligj është miratuar, siç e thamë edhe më parë, me

11. 07. 2003 dhe u aplikua nga Sekretari i Përgjithshëm i PSSP më 18 gusht 2003. Mirëpo, është shumë interesant, edhe pse u fuqizua nga Sekretari i Përgjithshëm, ka dalë më vonë nga disa mekanizma që kanë shërbyer në zbatimin e këtij ligji gjëja se ka pasur pengesa, ka pasur konfuzitet, ka pasur çrregullime në dispozitat ligjore. Mirëpo, këta mekanizma, që kanë shërbyer në zbatimin e mëtutjeshëm të këtij ligji, asnjëherë Parlamentit nuk ia kanë dorëzuar ato ndryshime që janë paraparë në mënyrë që në riprocedimin tjetër mos të hasim përsëri në pengesa dhe ky ligj të zgjatet.

Zotërinj deputetë,

Ju e dini shumë mirë se shfrytëzues të skemës sociale në Kosovë janë mbi 40.000 shfrytëzues, kur dihet se nga çrregullimi dhe parregullsitë, joefikasiteti i këtyre dispozitave ligjore kanë mbetur edhe shumë familje të nevojshme në Kosovë për ta realizuar të drejtën e shfrytëzimit të kësaj skeme sociale.

Prandaj, Komisioni i kaluar, ka bërë tryzni në Departamentin e Mirëqenies Sociale, ka bërë tryzni po ashtu edhe në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale që këto amendamente të jenë sa më shpejt të efektshme në realizimin e tyre. Mirëpo, u pa edhe puna e Ministrisë dhe Departamentit, dhe ata në fund e arsyetuan se do të vijnë me amendamentet e tyre për plotësimin e këtij projektligji.

Zotërinj deputetë,

Ne tani presim riprocedimin e tashëm. Kësaj Qeverie dhe Komisionit të Shëndetësisë dhe të Punës e të Mirëqenies Sociale i takon një angazhim, mirëpo nuk kemi dëshirë përsëri të zgjatet aq shumë, siç është zgjatur dhe kur ka nevojë kaq shumë për këtë ligj, kur dihet se ky ligj ka qenë edhe në programin e Qeverisë për ndihmat sociale.

Prandaj, kisha dëshiruar këtu edhe një propozim për të ardhmen, që për të shkuar sa më efektshëm ky ligj, të bazohemi në kritere dhe një ndër kriteret në të cilin duhet të bazohemi është numri i individëve që shfrytëzojnë dhe pensioni bazë i këtyre shfrytëzuesve. Prandaj besoj, duke u bazuar në këto kritere, në të ardhmen nuk do të kemi pengesa në formimin dhe riprocedimin e tij.

Partia Demokratike pajtohet me këtë projektligj, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja Hadri! Nga LDK, zotëri Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë është proceduar në Kuvend konform dispozitave procedurale.

Me dispozitat e mëparshme të Ligjit numër 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë janë paraqitur disa paqartësi në zbatimin e drejtë dhe efikas të tij.

Prandaj, për ta bërë të zbatueshëm dhe të qartë, është parë nevoja që të ndryshohet dhe të plotësohet ky ligj me amendamente.

Arsyet kryesore, të cilat i kanë paraqitur për ndryshimin dhe plotësimin këtij projektligji, janë në nenin 2 pika 2; nenin 4 pika 1 – shtojca b); nenin 5 pika 3, 5 dhe 7; nenin 9 pika 1 e 2 dhe nenin 11 pika 3.

Në deklaratën financiare të paraqitur nga Ministria për Ekonomi e Financa nuk ka shpenzime shtesë për këto ndryshime dhe plotësime, por vlerësohet se do të ketë kursime në bazë vjetore.

Këto ndryshime dhe plotësime janë në pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së dhe nuk i cenojnë parimet themelore të *acquis communautaire*.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka parë të arsyeshme që me këto ndryshime dhe plotësime në skemën e ndihmës sociale në Republikën e Kosovës do të arrihet një avancim i rrejtë të mbrojtjes sociale për familjet, të cilat janë të përzgjedhura dhe gëzojnë ndihmën nga kjo skemë sociale.

Prandaj, ne e mbështesim në parim, por duke ruajtur të drejtën që të japim vërejtjet dhe sugjerimet në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj! Nga AKR-ja do të paraqitet deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me plotë konsideratë ndaj Ministrisë gjegjëse për hartimin dhe plotësimin e këtij projektligji, edhe pse ky projektligj po shihet qartë se është nga Qeveria e kaluar dhe komplet nuk është prekur fare nga Qeveria e tanishme, ne si Grup parlamentar i AKR-së e mbështesim në parim këtë Projektligj për ndryshimet dhe plotësimet e skemës sociale. Mirëpo, mbase është shumë i nevojshëm për qytetarët e Republikës së Kosovës, ka vërejtje dhe besoj janë shumë të kontestueshme lidhur me mundësinë e implikimeve të larta buxhetore. Edhe pse këto mjete janë të ndara nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës, mirëpo ne kemi vërejtur se këtij ligji i mungon dispozita kryesore. Rritja e fondeve që do të ndikojë drejtpërsëdrejti në mirëqenien e qytetarëve andaj kërkojmë nga Qeveria që të ndikojë që ky fond të rritet dhe të jetë ky ligj më i implementueshëm dhe më i zbatueshëm.

Andaj, ne si Grup parlamentar i AKR-së, në procedimin e mëtutjeshëm garantojmë dhe do të jemi shumë kontributdhënës në procedimin e mëtutjeshëm në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Hajzeraj. Nga Aleanca, do të paraqitet zonja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti kryesues,

Zotërinj ministra,

Deputetë të nderuar,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e skemës për ndihmën sociale i është kthyer Qeverisë në ripunim për arsye se ndryshimet e ofruara esencialisht nuk do të ndryshonin situatën ekonomike të familjeve që kanë nevojë për ndihmë sociale, por përkundrazi, do të rëndohet edhe më tepër situata ekonomike e atyre familjeve të cilave do t'iu hiqet ndihma sociale.

Në arsyetim për ndryshimin e Ligjit të mëhershëm, thuhet se situata në Kosovë ka ndryshuar prej vitit 2003 në kohën kur është miratuar ky projektligj, por, analizat e situatës sociale të tanishme në Kosovë nuk flasin për zhvillim ekonomik, krijim të vendeve të reja të punës, ngritje të të ardhurave personale të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e mirëqenies sociale të popullatës, kështu që arsyetimi nuk qëndron.

Projektligji, që kemi në shqyrtim sot, është i njëjtë me atë që e kemi kthyer në rishqyrtim, pa ndryshim të asnjë pike e as prese, e të mos flasim për anën përmbajtjesore të tij, e cila ka mbetur konfuze dhe jo e qartë.

Në formën e tanishme, Projektligji sjell amendamente të cilat nuk kuptohen lehtë, prandaj edhe mbesin me dykuptimësi. Prandaj, do të ishte e dobishme që teksti të konsolidohet për të pasqyruar ndryshimet në mënyrë të duhur dhe atëherë t'i sillet Kuvendit në shqyrtim.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk e përkrah në parim në këtë formë që i është ofruar Kuvendit të Kosovës dhe propozon që t'i rikthehet Qeverisë në ripunim dhe pastaj të sillet ashtu si duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Hundozi. Në emër të LDD-së, deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në parim mbështet këtë projektligj, që ka për synim ndryshimin e Ligjit për skemat e ndihmës sociale.

Konsiderojmë se në Ligjin në fjalë kanë ekzistuar shumë paqartësi, pengesa dhe këto kanë qenë rezultat i disa dispozitave kontradiktore dhe të paqarta, që kanë ndikuar në vështirësitë e implementimit efikas të tij.

Me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji mendojmë se do të avancohet rrjeti i mbrojtjes sociale për familjet e përzgjedhura në skemën e ndihmës sociale si dhe me përcaktimin e drejtë të kriterëve për ndihmën sociale kjo do të mundësojë ngritjen e shumës financiare të ndihmës sociale të personave të familjeve të cilët kanë të drejtë në realizimin e ndihmës sociale.

Andaj, këtë projektligj e mbështesim, në parim, kurse vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i shqyrtojmë në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Morina! Në emër të Grupit “7+”, zonja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala!

Poštovani predsedavajući, ministri,

Kolege poslanici,

Nadležni mehanizmi za kontrolu sprovođenja Zakona o šemi socijalne pomoći ocenili su da postoje razne prepreke za efikasno i pravilno sprovođenje ovog zakona. Ove prepreke i poteškoće bile su i jesu posledica nekih kontradiktornih, nejasnih i nefunkcionalnih odredbi. Ove izmene i dopune imaće neposrednog efekta na delovanjima i efikasnosti centra za socijalni rad i otkloniće mnoge nejasnoće oko tumačenja zakonskih odredbi.

Osnovni cilj ovog nacrtu zakona je avansiranje mreže socijalne zaštite za određene porodice u šemi socijalne pomoći, pooštavanje kriterijuma za korisnike socijalne pomoći, povećanje finansijskog iznosa socijalne pomoći kao i eliminisanje nekih smetnji u toku primene ovog zakona.

Predložene izmene i dopune verovatno će uticati na podizanju kvaliteta rada službenika socijalne pomoći na pružanju socijalnih usluga. Na funkcionalnoj komisiji je zaista težak

zadatak da detaljno razmotri kriterijume za korisnike socijalne pomoći, koji su, po nama, dovoljno oštri.

Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržava ovaj nacrt zakona i daće svoj doprinos u toku njegovog daljeg procesuiranja. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit zonja Murati! Më lejoni të konstatoj se Grupi SLS, nuk është i pranishëm, prandaj do të shkojmë me listën e deputetëve të paraqitur. Në radhë të parë është zonja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Pajtohem se skema sociale në Kosovë ka pasur nevojë për ndryshime sepse janë vërejtur të meta në praktikë dhe pengesa në implementimin e skemës sociale, madje ka pasur edhe mundësi për keqpërdorime në këtë lëmi dhe këto keqpërdorime në të kaluarën edhe kanë ndodhur. Por, a është projektpropozimi për ndryshime të kësaj skeme sociale pikërisht propozimi që rregullon tani gjendjen në skemën sociale të Republikës së Kosovës.

Ky ndryshim është propozuar nga një qeveri tjetër, në një kohë tjetër dhe për tjera qëllime dhe këtu nuk shihet dora dhe as politika e Qeverisë së re. Në Kosovë kanë ndodhur ndryshime edhe politike, kanë ndodhur ndryshime edhe legjislative në lëmin e mbrojtjes sociale. A ka nevojë për ndryshime tjera në këtë skemë? Kujtoj se do të duhej një skemë ndryshe. A është në përputhje sot raporti financiar i këtij projektligji dhe a është kompatibil me kohën dhe politikën sot. A është kompatibil ky projektligj i propozuar me legjislacionin aktual në këtë lëmi? Do të shohim se nuk është. Konkretisht do të përmendi një shembull.

Zoti zëvendëskryeministër, ju thatë se me këtë projektligj do të merren parasysh si bazë edhe pensionet e personave me aftësi të kufizuara. Ne sot do të diskutojmë edhe për personat me aftësi të kufizuara, mirëpo aty thuhet se baza materiale e këtyre personave nuk merret, prandaj këtu do të shohim se kemi jopërpjeshmëri në ligjet e nxjerra nga e njëjta ministri.

Çka mund të arrijmë me këtë projektligj? Të kursejmë! Nga kush? Nga të varfërit! Nga ata që kanë nevojë shumë për dorën e Qeverisë sonë.

Me këtë a e sanojmë gjendjen sociale, a e zvogëlojmë duke sanuar numrin e vartësve apo duke shtuar simbolikisht të ardhurat e atyre që kanë nevojë për ndihmën tonë?

Në kohën e papunësisë së madhe, të shtimit të varfërisë së skajshme dhe të inflacionit, kujtoj se nuk është kjo skema sociale që duhet aprovuar.

Ky projektligj ka qenë dashur të jetë më përmbajtjesor dhe të mos nxirret për ngutë.

Këtë përmbajtje nuk mund ta përmirësojë një komision, siç është Komisioni për Çështje Sociale me amendimin që do ta bënte apo me çfarëdo vërejtje që do të jepte, sepse kujtoj që prej fillimit duhet të shkruhet një ligj i ri ose përmirësimi i këtij ligji.

Qeveria duhet ta kishte studiuar mirë këtë projektligj para se ta sillte në Parlament dhe të debatonte në Qeveri për sfidën më të madhe që e pret, domethënë, për çështjet sociale dhe problematikat sociale. Kujtoj se në të ardhmen këtë duhet ta bëjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Brovina! Tani, në radhë është zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Kemi përpara një shqyrtim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e skemës sociale. Konsideroj se Ligji duhet të kthehet prapa për arsye se kërkon një ndryshim substancial, sepse edhe Kosova ka ndryshuar me shumë elemente, prandaj korniza e parë që ka qenë e kësaj skeme sociale ka mundësuar funksionimin e një pakti social në Kosovë në rrethanat që i kemi pasur. Por, tani, në Republikën e Kosovës duhet shikuar aspekte të zhvillimit të gjithmbarshëm, duke ia përshtatur edhe një ligj, i cili mbron denjësisht shtresat sociale në Kosovë.

Nuk ka të bëjë me efektet në skemën e Ligjit i cili është për aftësi të kufizuara, sepse është ligj i veçantë, por konsideroj se duhet një qasje shumë e drejtpërdrejtë duke llogaritur një bashkëpunim shumë të mirë të komisionit parlamentar në këtë rast dhe të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me ekspertët të cilët i njohin për së afërmi problemet që e mundojnë Kosovën sot.

Prandaj, konsideroj se duhet një qasje shumë më e mirë, sepse në të ardhmen nuk do të mundemi të kemi një pakt social i cili ka qenë i qëndrueshëm deri tani dhe ju e dini se ka pasur mirëkuptim në mes të Odës Ekonomike të Kosovës, Sindikatës së Pavarur të Kosovës dhe po ashtu Qeverisë. Në të ardhmen, rrethanat janë ndryshe, prandaj një qasje më e drejtpërdrejtë e ndryshimit të ligjit dhe me një efektivitet më të mirë do të mund të jemi në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Isufi. Fjalën e ka tani zoti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë pajtohem me diskutuesen paraprake ku tha se gjendja sociale në Kosovë faktikisht është e mjerueshme dhe shuma që është planifikuar të ndahet për ekzistencën në minimumin social, është e tillë çfarë është dhe determinohet nga mundësitë e kufizuara të buxhetit. Mirëpo, ajo çka mua personalisht më brengosi, ishte kur, tek pjesa ku bëhet arsyeshmëria ekonomike, po thuhet se nga skema e re sociale që propozohet do të ketë kursime dhe këto kursime, do të thotë, bëhen pikërisht nga një kategori që e ka gjendjen më të dobët, më të keqe ekzistenciale. Prandaj, personalisht mendoj se këtu do të duhej jo të bëjmë kursime, por këtu ka nevojë që të bëhet shtesë me qëllim që sadopak të përmirësohet gjendja ekzistenciale e tyre dhe po ashtu kjo pjesë do të ndërlihet më pas edhe me pjesën tjetër të Ligjit për personat me aftësi të kufizuara dhe mendoj se këtu duhet të jetë një përmirësim i gjendjes.

Kategorizimi si është bërë këtu, shpesh nuk është fort i qartë se çka humbet, kush përfiton. Prandaj, do të kisha dashur që komisioni adekuat funksional, që është për këtë problem, të punojë me seriozitet dhe të evitojë të gjitha paqartësitë dhe të bëjë sa është e mundur që të mos dëmtohet asnjë kategori sociale për shkaqe se mund të ketë një paqartësi në atë vend. Thjeshtë, duke qenë se e thanë edhe parafolësit tjerë, ka ndryshuar shumëçka, duhet të ndryshojë edhe gjuha juridike, të hiqen ato, tashmë disa herë të përfolura këtu – jo pjesë të UNMIK-ut, jo Korniza kushtetuese, meqenëse të gjitha këto ligje do të aprovohen pasi të miratohet Kushtetuta dhe gjithçka do të bëhet konform asaj që vërtet të jenë në harmoni e të mos detyrohem pastaj pas 6-7 muajsh përsëri të marrim

ligjet në shqyrtim e t'i përmirësojmë disa gabime që mund t'i bëjmë paraprakisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Abazi! Tani e ka fjalën zoti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: I nderuari zoti kryesues, Të nderuar ministra dhe ju kolegë deputetë, Ligjin, të cilin po e shqyrtojmë tani në parim, padyshim duhet ta shikojmë si një ligj me një prioritet shumë të rëndësishëm për interesat e qytetarëve të Kosovës. Gjatë diskutimit për këtë ligj, nuk duhet të privohemi nga ndjenja e solidaritetit dhe pikërisht këtë ligj për këtë arsye duhet ta shqyrtojmë me një ndjeshmëri shumë më të madhe dhe me një ndjenjë shumë më të madhe solidariteti me qytetarët tanë.

Ky ligj ka të bëjë me dy kategori të rëndësishme kushtetuese:

A do të njehë Kushtetuta e Kosovës në dispozitat e saj, në pjesën normative të saj, të drejtën për të jetuar dhe a do të njehë Kushtetuta e Kosovës të drejtën për punë?

Nëse në Kushtetutë nuk parashikohet e drejta në punë për të gjithë ata qytetarë të moshës madhore, që shteti i ardhshëm i Kosovës iu garanton punë, atëherë padyshim si kategori për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe individit në Kushtetutë duhet të futet e drejta për të jetuar.

Dhe, duke u nisur nga kjo e drejtë, e cila është e sanksionuar në shumë kushtetuta të shteteve të botës së lirë, atëherë shteti duhet të marrë obligime edhe për mbështetjen materiale të qytetarëve të vet.

Në Kosovë gjendja sociale është përkeqësuar shumë. Janë rrënuar ekuilibrat social dhe ata të cilët pretendojnë se në këtë fazë nuk ka nevojë për mjete shtesë për të ruajtur ekuilibrat social dhe për të mbrojtur jetën e qytetarëve të Kosovës dhe të drejtën e tyre për të jetuar, e kanë shumë gabim.

Ligji, jo vetëm që duhet të trajtohet me ndjeshmëri, por ky ligj është shumë i vonuar dhe ligji nuk duhet kthyer Qeverisë, siç pretendojnë disa kolegë, por duhet dhënë prioritet që të shqyrtohet me shumë vëmendje, të plotësohet dhe gjatë rishikimit të buxhetit të Kosovës, siç është parashikuar në fund të gjashtëmujorit të këtij viti, të rishikohet mundësia që të shtohen dhe derdhen mjete në buxhet për të shtuar bazën e përfituesve nga ky ligj dhe për të ngritur edhe nivelin e të ardhurave të cilat do të mundësonin një jetë më të dinjitetshme të qytetarëve tanë.

Së këndejmi, unë do ta përkrah në parim, mirëpo është shqetësuese tendenca që Qeveria të kursejë buxhet në ato shtresa të qytetarëve të cilat kanë nevojë për ndihmë. Për mua, si deputet i Kuvendit të Kosovës, problem social janë edhe ata të cilët punojnë në Kosovë e lëre më ato kategori që janë të papunë.

Niveli i pagave, të buxhetorëve, në Kosovë dhe në përgjithësi – nuk siguron një ekzistencë dhe një qëndrueshmëri të familjes sonë në Kosovë. Dhe, shteti i cili ka problem në familje - familjet kanë problemin ekzistencial, ai shtet ka probleme shumë të mëdha.

Unë ju kisha lutur të gjithëve, që ky ligj të shqyrtohet me ndjeshmëri dhe t'i jepet prioritet nga të gjitha këto ligje dhe të jetë i gatshëm që gjatë shqyrtimit të buxhetit në gjashtëmujorin e parë të krijohet mundësia që të shtohen mjete për kategori të qytetarëve të Kosovës e jo të kursehen mjete në këto kategori. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Buçinca. Tani do ta marrë fjalën zonja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Ja bih se zahvalila svima vama ovde. Srdačno bih vas pozdravila i sve kolege poslanike i predsedništvo. Ja sam se javila povodom ovog zakona za socijalnu šemu. Mi vidimo ovde ispred nas da je jednostavno u pitanju neka resavska škola, prepisali smo neke zakone od pre dve-tri godine i onda ih intenzivno ovde Skupština servira nama poslanicima da ih analiziramo, da ih čitamo. Neću da uvredim sve kolege, ali potrebno je da sve zakone jako pažljivo pročitamo, analiziramo i da vidimo da li su uskladjeni sa prosotorom i sa vremenom. Ja, koliko vidim, ovaj zakon smo imali i u prošlom sazivu, i vidim da je jednostavno prepisan. Ovde postoji i neka resavska škola, čak i prepisi nisu dobri, a tako su loši i prevodi, ali kada se radi o tehničkom pitanju, da ostavimo to tehničko pitanje na strani.

Ako smo mi ovde potpisnici Deklaracije i ako hoćemo, ne da hoćemo nego praktično imamo državu, trebalo bi pojedini zakoni da se vrte na doradu. Da se vidi u regionu, kada je socijalna šema u pitanju i da se osvrnemo na region kolika su ta socijalna davanja... Mi u svakom zakonu ovde nastojimo da se uskladjuju sa zakonima međunarodne zajednice. Pa da vam iskreno kažem, naši zakoni krše konvencije međunarodne zajednice. Po Međunarodnom sporazumu o ekonomskim, socijalnim i kulturnim pravima od 16. decembra 1966.godine, mi kršimo prava. Iako smo danas država, mi i dalje dajemo 30 i 40 evra. Molim vas, ja imam konkretan predlog. Za socijalnu šemu, neću da opterećujem sve kolege ovde, trebamo mi da glasamo da se doradi i da bude povećano 100%. Zašto kažem? Zato što se u regionu kreću od 7 do 17.000, a to je od 100% ,a mi smo u regionu i tu gde smo, ne možemo da promenimo prostor, ne možemo da promenimo vreme ali da promenimo naš mozak – to možemo. Da razmišljamo malo korisnije, to možemo.

Vidite, iskreno. Mi smo usvojili budžet od 1.050.000.000. Negde biće 50, pošto smo 211 miliona imali suficit. Ovako, ako imamo 40.000 korisnika socijalne šeme, ako to bude približno 100 evra, pošto sam ja ekonomista, ja sam napravila jednu malu računicu koliko bi opteretili mi budžet Kosova, to bi bilo negde oko 4.800.000. Kada je ovaj zakon u pitanju, imaćemo i zakon o ograničenim spobosnostima, kao i zakon za penzionere gde moramo da napravimo više jedan red, gde bi opteretili budžet Kosova negde oko 1%. Ljudi, da li je to mnogo za budžet Kosova. Da li ćemo i dalje da štedimo? Da li ćemo da produžavamo da budemo privremena vlada ili ćemo početi da budemo prava vlada. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Emrush. Fjalën e ka zoti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues! Të nderuar kolegë, Mendoj se ky ligj ka qenë një ligj tekst, te i cili kemi ardhur dhe përmes të cilit e shohim se çka po ndodhë në dy muajt e fundit në Kosovë.

Është ky Kuvend që e ka kthyer këtë ligj. Kuvendi i Kosovës, po them. Janë deputetët të cilët e kanë kthyer pak më përpara dhe sot thonë se është prioritet dhe duhet të jetë prioritet. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se njerëzit, të cilët para 6 muajve kanë

besuar se nuk duhet të jetë prioritet, sot besojnë se duhet të jetë prioritet. Kjo është e para
çka ndodhë.

Dëgjuam këtu njerëzit që thanë ka ndryshuar shumëçka në Kosovë, kanë ndryshuar ligjet,
kanë ndryshuar qeveritë. Nuk e di çka ka ndryshuar! Asgjë nuk ka ndryshuar, vetëm se
sot e kemi një qeveri që nuk po mund të besojë se duhet të ulemi bashkë dhe të shikojmë
se qysh të veprojmë me ligje. Na i kanë sjellë të gjitha ligjet e njëjta, edhe ato që kanë
qenë të gabueshme. Ky është kulmi i moskompetencës së një qeverie. Realisht, dikush
mund të thotë – një qeveri si total – totalisht e padijshme. Unë e di që ka njerëz të
dijshëm në Qeveri, por si po funksionon Qeveria, është totalisht e padijshme, nuk po di as
çka po sjell këtu. Nuk janë duke ditur çka po sjellin. Kjo është definitivisht pasojë që nuk
ka program të qeverisë dhe normalisht nuk ka program të qeverisë. Kur nuk ka program,
kjo do të thotë se Qeveria nuk e di për çka është aty ku është. Çka duhet bërë. Programi
është diçka, përmes të cilit Qeveria thotë – ne duam ta bëjmë këtë. Do të thotë, Qeveria
nuk di çka do të bëjë. Nuk ka program. Kur nuk ka program, nuk e di as çfarë ligjesh sjell
në Kuvend. Domethënë, i ka marrë paket ato që i ka gjetur – 30 ligje dhe i ka prurë. Po e
kuptojmë këtu se shumica e njerëzve në Qeveri as që i kanë lexuar ligjet të cilat i kanë
sjellë, definitivisht. Nuk mund të ketë politika autentike kur nuk ka program, kur nuk na
ka treguar askush prej Qeverisë çka donë të bëjnë këta njerëz. Ne e dimë që donë të
qeverisin, gjithkush do të qeverisë, por duhet ditur çka do të bëjë kur qeverisë. Kjo është
mënyra se si mbërrijmë deri këtu. Është totalisht jokompetente, është totalisht e
padijshme dhe mund të them se nuk mund të vazhdojë kështu. Duhet ta dijë se çka po na
sjell. Në fund të fundit, më mirë bre vëlla le të dalin e të hanë drekë, në kafë, mos të rrinë
të uritur, e pastaj të mos dinë çfarë ligjesh po sjellin. Më mirë të hanë, se po më duket
prej urisë, domethënë, nuk po e dinë çfarë ligjesh po na sjellin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gjini! Fjalën e ka zoti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Unë kisha për t'iu bashkëngjitur shumicës së deputetëve dhe do t'ua rikujtoja të gjithëve
këtu se në këtë tempull kemi ardhur duke iu premtuar qytetarëve pikësëpari mirëqenien
dhe mendoj se nuk do të ishte korrekte nga ana jonë që ta miratojmë këtë ligj për shkak të
mangësive të mëdha që i ka. Të paktën, flas në emrin tim këtu. Unë nuk kisha për ta
votuar këtë ligj për shumë arsye. Njëra nga to janë edhe shifrat apo statistikën e
stërvjetëruara. Këtu kam parasysh shportën e konsumit. Edhe më tutje përdoret ajo figura
1 dollar e paritetit, të cilën Banka Botërore e ka futur në përdorim në vitin 1980. Nga ajo
kohë dollari, por edhe valutat e tjera kanë pësuar inflacion – devalvim. Domethënë, me
një dollar, atë që ke mund ta blesh në vitin 1980, në vitin 2008 nuk mund ta blesh. Të
vyejnë, të paktën, 2 dollarë. Domethënë, në këtë kuptim shuma simbolike, e cila
përmendet në atë ligj, është joreale. Nuk mund të jetohet. Nuk mund të sigurohet
minimumi i atyre të cilëve dëshirojmë t'iu ndihmojmë dhe atyre të cilëve iu kemi
premtuar se do t'u ndihmojmë. Shembull kemi këtë vitin e fundit. Çmimi i bukës është
ngritur 60%, e mos të flas për produktet e tjera elementare të shportës së konsumit.

Andaj, unë do të apeloj tek deputetët që mos ta votojnë këtë ligj. Le të rishqyrtohet edhe
një herë, le të rishkruhet konform kërkesave momentale të cilat ekzistojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Tali. Në radhë është zoti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues! Të nderuar kolegë,

Unë do të shfrytëzoj rastin edhe njëherë që të kërkoj prej koalicionit qeveritar dhe në veçanti prej Kryeministrit që para këtij Kuvendi të ofrojë programin qeveritar, nga se ne po miratojmë ligje, të cilat kanë qenë pjesë e programit dhe e prioritetëve të qeverisë së kaluar.

Parafolësit dhe kolegët e mi thanë mjaft fjalë sa i përket Projektligjit, të cilin po e shqyrtojmë. Sa më përket mua, ky projektligj, në vend që të shënojë një avancim, ka shënuar kthim prapa.

Ligjet e natyrës së tillë, kujtoj se duhet të kenë një vëmendje të veçantë, sepse atakojnë një pjesë mjaft të ndjeshme të shoqërisë sonë dhe këto ligje duhet të jenë më të hapura, sikurse që ministria duhet të shqyrtojë mundësitë e gjetjes së fondeve ose të burimeve me të cilat do të shënohej rritja e shumës të cilën e përfitojnë këto familje, sikurse edhe kriteret.

Kam frikë se ashpërsimi i kriterëve, që edhe ashtu kanë qenë të ashpërsuara mjaft shumë në Kosovë, do të detyrojë edhe më tutje që numri i madh i familjeve tona, i fëmijëve tanë, të detyrohen të kërkojnë lëmshë dhe shumë fëmijë në vend që të jenë në bankat shkollore, për të mbajtur veten dhe familjet e tyre, do të detyrohen që të kërkojnë lëmshë ose të shesin gjësende të ndryshme në rrugë, e që rrezikohen seriozisht edhe fizikisht, por edhe psikikisht.

Prandaj, Qeveria duhet të mendojë, jo në ashpërsimin e këtyre kriterëve, por në gjetjen e mundësive të tjera me të cilat do t'u dilet në ndihmë këtyre kategorive që, për fat të keq, numri i tyre po rritet dita më ditë.

Vërejtje, po ashtu, do të duhej të shiheshin edhe në keqpërdorimet të cilat kanë ndodhur në të kaluarën sa u përket përfituesve të skemës sociale. Jemi shumë të vetëdijshëm se një numër i madh i familjeve të cilat në të vërtetë kanë pasur nevojë për ndihma sociale, janë përjashtuar nga kjo e drejtë, ndërkaq, po ashtu, sipas statistikave ka një numër të familjeve të cilat, pa pasur nevojë për diçka të tillë, gjenden brenda skemës sociale.

Po sugjeroj dhe po kërkoj që këtij ligji t'i kushtohet një rëndësi e veçantë dhe të përpunohet në mënyrë që të jetë sa më i implementueshëm dhe të jetë sa më gjithëpërfshirës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Makolli. Fjalën e ka tani zoti Armend Zemaj. Për kënaqësi të të gjithëve, qenka tërhequr! Në radhë është zonja Selviqe Halimi.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sa u përket ligjeve apo projektligjeve, se cilat kanë prioritet, aktualisht në Kosovë secili nga këndvështrimi i lëmisë që mbulon – është prioritet në vete. Mirëpo, duhet një harmonizim.

Sa u përket keqpërdorimeve të caktuara nëpër skema të caktuara, njerëz të cilët kanë lejuar keqpërdorimet, janë sot ulur në Kuvend.

Kurse, sa i përket inkompetencës për Qeverinë, unë kisha për të thënë se, pikërisht, kur ta thuash se është inkompetencë, ose s'është kompetente se s'paska aftësi një qeveri e

caktuar për një çështje të caktuar – duhet njeriu t’ia parashtrojë vetes pyetjen, sidomos ata të Qeverisë, se sa ishin të aftë dhe sa patën kompetenca sa ishin me mandat.

Jo për ta replikuar me dikë, mirëpo për të gjuajtur fjalë pa i analizuar mirë ndaj një organi qeverisës në Kosovë, duhet secili ta shoh vetveten se çka ka lënë pas vetes në kohën kur ai ishte në post apo jo, qofshim edhe ne vetë deputetët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Halimi! Tani do ta marrë fjalën zoti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Së pari përgëzoj kolegët e pozitës për qasjen e tyre ndaj këtij ligji të skemës sociale. Është bërë e pakapërcyeshme që të mos përmendet mungesa e programit qeveritar për të mundur që realisht të studiohet kjo skemë në raport me programin qeveritar dhe atë çka qeveria parasheh brenda kësaj skeme, çfarë kategorish t’i përfshijë në skemën sociale. Pra, edhe njëherë, iu bashkëngjitem zërave që programi qeveritar më në fund duhet të mbërrijë në këtë Kuvend.

Nuk mund të kuptoj intencën e Qeverisë që të kursehet në kurriz të të varfërve. Tjetra, që është për habi, të gjitha këto projektligje që po i debatojmë këtu, janë projektligje që janë kthyer në shqyrtim nga Qeveria e re. Po më habit fakti se në secilin prej këtyre projektligjeve thuaja se ka vërejtje nga deputetët, sepse nuk ka ndryshuar asgjë ose fare pak gjëra kozmetike janë bërë. Nuk e kuptoj si Qeveria nuk e merr vesh këtë gjë dhe këtë reagim të deputetëve e të ulet njëherë dhe t’i sheh realisht, sepse kur kthehen projektligjet mbrapa, atëherë ato duhet realisht të rishqyrtohen, realisht të trajtohen dhe ta kenë një diçka ndryshe nga projektligjet që kanë qenë dikur në këtë Parlament e janë kthyer mbrapa. Nuk e kuptoj pse bëhet kaq e shurdhër që të mos i sheh realisht shqetësimet, mos t’i ndjejë shqetësimet e deputetëve.

Unë kam një mendim lidhur me këtë gjë. Nuk e di, nëse ka menduar Qeveria që në skemën sociale ta lehtësojë, në realitet buxhetin në skemën sociale duke parë mundësinë e angazhimit të këtyre kategorive në ndonjë gjysmë orari të punës, varësisht nga afinitetet a aftësitë e tyre, gjë që është prapë mungesa e programit qeveritar që nuk na bën të njohur a është menduar në këtë segment fare a jo. Pra, të tërhiqen nga skema sociale ato kategori që janë të zotët, si të them, të punojnë qoftë gjysmë orari, sepse ndryshe, nuk e di cila është shporta e kësaj kategorie. Sa është ajo në këtë skemë sociale që na ofrohet neve?

Edhe njëherë po them, mungesa e programit qeveritar na bën edhe neve të hutuar që të jemi më koncizë e të dimë se në çfarë segmentesh mund të ndihmohen saktësisht këto kategori.

Propozimi im edhe njëherë është që mundësisht të shihet dhe nga këto kategori të nxirren ato grupmosha, varësisht nga gjendja e tyre shpirtërore, fizike, të angazhohen në punët me gjysmë orari ose dyorarëshe dhe mos të ngelin vetëm brenda një skeme sociale, por të japin kontributin e tyre, pra të fitojnë nga puna e tyre në mënyrë që çdo gjë të mos sillet në qarkun e një skeme sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Brajshori! Tani e ka fjalën zonja Kaçusha Jashari.

KAÇUSHA JASHARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë nuk do të hyj në këto propozimet konkrete që janë në këtë Projektligj, por mendoj se ne e kemi Ligjin për ndihmën sociale. Ky Projektligj është për plotësim dhe ndryshim, prandaj nuk e shoh të arsyeshme që ky propozim të kthehet, por të aprovohet si propozim.

Andaj, edhe ne si deputetë e kemi për obligim që të punojmë më seriozisht në disa segmente. Te kriteret se kush e fiton të drejtën, të shikojmë në këtë propozim a janë të mundshme keqpërdorimet dhe ato të përjashtohen. Andaj, duhet edhe të kemi më shumë kujdes te kjo skemë sociale.

Edhe mua më ka penguar shumë vlerësimi që bëhet në këtë skemë, i cili ka propozuar se kursimi i buxhetit do të shtohet dhe kjo është qesharake. Mirë e tha zoti Gani se edhe ata që marrin të ardhura janë të varfër, e lëre më ata që nuk punojnë. Prandaj, në vlerësimet që i kemi për varfërinë e skajshme, e që po rritet çdo ditë, duhet të shikojmë edhe këtë skemë sociale. Sigurisht se është mirë dhe duhet t'iu ofrojmë punë dhe ta zvogëlojmë numrin e atyre që janë në kategori të të varfërve. Nëse këtë propozim e lëmë për t'i bërë ndryshimet më vonë, mendoj se nuk ka kuptim.

Këtu, në nenin 7, shikoni: “Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale obligohet për 6 muaj, pas miratimit, t'i zbatojë ndryshimet dhe të nxjerrë aktet nënligjore”. Në qoftë se nuk i aprovojmë sot këto ndryshime dhe punojmë më seriozisht në plotësimin e tyre, atëherë kur të vjen në rend le të bëhet plotësimi. Edhe ashtu kemi vlerësuar se skema sociale nuk është ajo që ka nevojë të ketë kjo ministri, prandaj unë jam për të pranuar dhe do të votoj “për”, por me siguri seriozisht të angazhohemi për ndryshimin dhe plotësimin më të mirë të ligjit ekzistues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Jashari.

Tani do ta marrë fjalën zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Nuk po më habisin ata që janë për herë të parë në Kuvend, por kolegët e mi me përvojë tremandatore, po më habisin që nuk dallojnë leximin e parë nga leximi i dytë. Andaj duhet ta dimë qartë se leximi i parë çka analizon, çka peshon dhe si mund të aprovohet ose të mos aprovohet ligji. Dhe, unë ju kisha lutur, meqë agjenda është çfarë është, të mos e ngarkojmë shumë me këto fjalët tona, por t'i shkurtojmë shkurt dhe të bëjmë punën, nëse ky Ligj aprovohet për me shkuar në lexim të dytë, faktikisht, jo në lexim të dytë, shkon në lexim të dytë vetë çështja e plotësimit dhe e analizimit të ligjit. Andaj, ju lus që të mos e zgjasim shumë me këto diskutime, t'ia lëmë mundësinë vetes që këtë ta bëjmë në leximin e dytë dhe në komisionet profesionale të caktuara. Ndërsa, ta që e kanë nisur fushatën shumë herët, ju kisha lutur që të jenë më të kujdesshëm sepse mbase mund t'ju harxhohen fjalët më vonë.

Por ju lus edhe njëherë, kolegë të nderuar, që t'i shkurtojmë çështjet e diskutimeve, edhe grupin tim parlamentar dhe të tjerët, që marrëveshja brenda grupeve të jetë më racionale në mënyrë që të dihet çfarë po bëjmë dhe t'i ndajmë këto gjëra. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Buja!

Tani do ta marrë fjalën zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë.

Edhe unë, vazhden e njëjtë. Zëvendëskryeministri, në emër të Kabinetit qeveritar paraqiti arsyet e domosdoshme që ky Projektligj të kalojë. Unë e kuptoj ndjenjën e shumicës deputetëve që diskutuan për politikën sociale, por jemi në leximin e parë dhe krejt roli ynë si deputetë do të jetë në komisione funksionale dhe si deputetë përmes vërejtjeve konkrete t'i amendojmë ato që janë të domosdoshme. Por, neve po na irritojnë bisedat në kuptimin e marrjes së fjalës. Besoj që ne e bëmë të qartë përmes Grupit Parlamentar, zoti kryesues, është e domosdoshme që, edhe pse mund të kualifikohen ndryshime të vogla të skemës sociale, mund të konstatojmë dy çështje.

Skema sociale merr përqindjen më të madhe të buxhetit të Kosovës, por na nuk jemi shtet social, as nuk guxojmë të lejojmë që buxheti të konsumohet në vazhdimësi për shkak nevojave që i ka Kosova sot në atë që quhet drejt një shteti, i cili e konsumon buxhetin për nevoja sociale, përkundër kërkesave të mëdha.

Nën dy, fakt është që përdorimi në skemë sociale është sipas aplikantëve apo kërkesave që paraqiten në zyrat tona në nivele të ndryshme dhe nuk kemi të bëjmë me abuzime të kartelave sociale nga Ministria përkatëse apo organet qeveritare. Me vetë faktin që kjo politikë do të koncentrohet dhe komuna do të kenë të drejtën ta rifreskojë skemën sociale, t'i eliminojë defektet që janë paraqitur gjatë këtyre 7 – 8 viteve, t'i detektojë rastet sociale. Një kategori e qytetarëve tonë që quhen të marrshëm për të trokitur në dyer, vuajnë për ndihma sociale, dhe kemi kategorinë tjetër që vazhdon të bëjë presion dhe të shfrytëzojë skemën sociale. Prandaj, në këtë rrafsh mendoj që përmes leximit të dytë komisionet funksionale do të kenë mundësi të japin kontributin e tyre.

Nën tre, duhet të jemi të kujdesshëm, sepse kemi të bëjmë me kategori të ndjeshme dhe me vetë faktin që janë paraparë zhvillime drejt dekoncentrimit të kësaj drejte në nivel komunal, besohet thellë që do të eliminohen krejt këto që u përmendën deri tash.

Dhe nën katër, nëse e keni lexuar letrën e Kryeministrit të Kosovës, 33 ligje, thuhet qartë në letër, të miratuara nga Kabineti Çeku, duhet të procedohen dhe në këtë rrafsh është parimi i kontinuitetit, nuk kemi të bëjmë me asgjë tjetër pos me kontinuitet. Edhe ky Parlament, edhe Qeveria punon në parimin e njëjtë dhe këto ligje janë përgatitur, por duhet të miratohen nga kjo legjislaturë, sepse është pjesë e punës tonë të përbashkët që e kemi bërë pa dashur të japim kualifikime, sepse disa zona po thonë se është punuar, jo s'është ndryshuar, jo është bërë kjo punë, apo angazhimi tjetër.

Zoti Kryesues, ju kisha kërkuar që, meqë grupet parlamentare janë deklaruar, është shteruar nevoja për debat më të shumë, të procedohet sepse rendi i punës kërkon që edhe shumë ligje sot të kalojnë në lexim, për t'u votuar në orën 16,00.

KRYESUESI: Faleminderit për sugjerimin, por sidoqoftë unë kam një listë me emra këtu. Disa madje për herë të dytë janë paraqitur. Unë po u kërkoj falje këtyre që janë paraqitur për herë të dytë, kam frikë se nuk do të guxoj, përkundër vullnetit tim, t'ua jap fjalën edhe njëherë.

Në radhë tani është zoti Naim Maloku. Unë do të kisha dëshirë që ta keni parasysh këtë.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vetëm shkurtimisht. Po më duket që nuk janë gjërat shumë të qarta. Ky ligj ka qenë i proceduar në Kuvend të Kosovës nga Qeveria e kaluar dhe në lexim të parë, me shumicë votash, kemi qenë pjesë, si Grup Parlamentar i atij votimi, ju ka kthye Qeverisë. Dua t'ju përkujtoj se ministri ka qenë nga radhët e AAK-së në atë kohë dhe e kemi kthye këtë ligj. Por, ne s'po bëjmë asgjë tjetër vetëm që ligjet që ju kanë kthyer Qeverisë së kaluar mos të vinë prapë në procedim në Kuvend të pandryshuara. E njëjta gjë është me ligjet nën pikën 18, 19, 22 edhe 24 të rendit të ditës, të mos i lexoj se për cilat ligje është fjala. Pra, këto ligje kanë qenë të proceduara nga Qeveria e kaluar në Kuvend dhe ky Kuvend me shumicë votash ia ka kthyer Qeverisë dhe të njëjtat ligje tash po vinë te pandryshuara dhe janë në rend të ditës sot. Ky është qartësimi që desha unë t'ua bëjë deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Maloku!

Mandej kisha me thanë për sensin për të kursyer edhe kohë tonë, fjalën tuaj.

Në radhë është zoti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky Projektligj mua po më përkujton atë fjalën e urtë popullore: “Shyqyr që ra kjo deké e u pamë”. Këtu po shihet haptas profilizimi politik i spektrit politik të Kosovës në të majtë dhe në të djathtë. Në të majtë po shihet haptas orientimi politik i pozitës, ku është për rritjen e kostos sociale, dhe në të djathtë, profilizimi politik i partive të tjera për uljen e kostos sociale dhe për rritjen apo shtimin e vendeve të punës dhe për zhvillimin ekonomik, dhe orientimet e djathta të cilat dëshirojnë që ne në zhvillimin ekonomik të mos merremi shumë tepër me fjalë boshe, por që koston sociale ta zvogëlojmë dhe t'i shtojmë vendet e punës.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, ne si opozitë besoj se dëshirojmë që ky Ligj të kthehet edhe njëherë dhe atje të rishqyrtohet, dhe më vonë të kthehet në Kuvendin e Kosovës, për votim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Geci.

Tani radhën e ka zoti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit zoti kryesues!

Unë mendoj që me arsye të plotë kemi një debat shumë më të gjerë sot për këtë Projektligj për çështjet e skemës sociale, për arsye se aspektet sociale janë më të theksuara në Kosovë. Ne kemi shumë analiza dhe vlerësime se një pjesë shumë e madhe e popullatës së Kosovës jeton në varfëri, një pjesë në varfëri të skajshme. Pra, shifrat sillen prej 37 deri 43%, që gati prekë gjysmën e popullatës së Kosovës. Sigurisht që ky Ligj nuk ofron zgjidhje të duhura, nuk ofron për arsye se mungojnë fondet në Kosovë dhe buxheti i Kosovës nuk ka mundësi ta përballojë në masë të duhur këtë aspekt social në Kosovë.

Por, këtu u shtruan shumë çështje, shumë pyetje dhe unë dëshiroj të pyes, si edhe shumë të tjerë, a është ky Ligj pjesë e politikës sociale të kësaj Qeverie, apo ne jemi duke zbatuar politikën sociale të Qeverisë së kaluar? Pra, kjo Qeveri, në fakt, me 30 ligje që na i ka sjellë këtu para nesh dhe me 9 ligje që ne tashmë i kemi aprovuar, në fakt është duke zbatuar dhe konsumuar politikën e Qeverisë së kaluar. Kjo Qeveri nuk ka politikë të saj

as për çështje të arsimit, as për çështjet sociale, as për kulturë, as për mjedis dhe për asnjë aspekt tjetër.

U bë një pyetje këtu nga një kolege, se çka kanë bërë ata që sot po flasin këtu. Ata që sot po flasin këtu, i kanë bërë këto 30 ligje dhe kjo qeveri është duke i konsumuar edhe në aspektin politik ligjet që i ka përgatitur Qeveria e kaluar, është duke konsumuar programin e Qeverisë së kaluar, sepse kjo Qeveri nuk ka program, nuk ka për një aspekt, për asnjë aspekt të veprimtarisë së saj. Mua më habit ngathtësia e kësaj Qeverie që doli me një pompozitet, në fillim me disa improvizime të kufizimeve të telefonave e të tjera, që ishin vetëm reklamë për ta fshehur aftësinë e saj që të ketë një program të mirëfilltë qeveritar për vitin që jemi dhe për vitet që na presin.

Dhe, nëse aprovohet ky Projektligj, sipas procedurave që ne i kemi, në fakt ky Projektligj gati se gjatë këtij viti nuk mund të aplikohet, sepse do të shkojnë nga 2 – 3 muaj ose 4 muaj derisa të aprovohet dhe janë 6 muaj tjerë që mund të hyjë në fuqi dhe ky Ligj për këtë vit nuk do të vlejë dhe nuk e di sa do të jetë e vlefshme deklarata për implikimet buxhetore dhe ato aspekte të tjera.

Unë edhe një herë kërkoj që Qeveria e tashme të mos vazhdojë me aplikimin e programit të Qeverisë së kaluar, po të dalë me një program të saj dhe ne ta shohim cilat janë politikat e kësaj Qeverie në skemën sociale dhe gjitha aspektet që ne i diskutojmë sot këtu dhe gjatë ditëve dhe muajve të ardhshëm.

Politika e Qeverisë shihet përmes ligjeve që i propozon edhe në aspektin social dhe në të gjitha aspektet e tjera. Politika e Qeverisë nuk mund të shihet se sa vizita bën, sa ndërmarrje i viziton, sa shkolla i viziton Kryeministri e tjera, e tjera. Ato janë veç improvizime dhe një reklamë politike, kurse programi i vërtetë qeveritar reflektohet në ligjet që i propozon Qeveria. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Salihaj!
Fjalën e ka zoti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala! Ja ću da se uključim kao predsjednik Komisije, mada Komisija nije o ovome raspravljala iz razloga što su ti zakoni stigli pre par dana. Ali, zašto su zakoni vraćeni posle prvog čitanja u prethodnom mandatu, znači svi ovih zakoni, set zakona, četiri koje je pomenuo kolega Naim Maloku, vraćeni su nakon prvog čitanja, pošto su bili usvojeni u ovom Parlamentu. Razlog je bio što je funkcionalna komisija i druge komisije su ocenile da će ovi zakoni biti defektni ako budu usvojeni pre nego što bude usvojen Zakon o radu, bazični Zakon o radu.

Danas smo dobili strategiju da će do kraja marta meseca za ovu godinu Vlada dostaviti, odnosno pripremiti Zakon o radu. Ukoliko se raspravlja taj Zakon, znači ako bude dostavljen do kraja marta, ovi zakoni koji su danas na redu, ovaj Zakon o šemi socijalne pomoći, o izmeni i dopuni, takođe Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o Inspektoratu rada, znači Zakon o izmeni i dopuni Inspektorata rada, koji je direktno vezan sa Zakonom o radu, biće usvojeni prije Zakona o radu i onda će morati osnovni Zakon o radu da bude korigovan u odnosu na ove zakone ili će ovi zakoni nakon toga biti vrlo brzo korigovani u odnosu da se usklade sa osnovnim Zakonom o radu. Tu treba da se uključi sindikat, tu treba da se uključe ostale kategorije i tako dalje, i mislim da je to bio razlog zašto je vraćen u prethodnom mandatu. Svi zakoni koji nisu bili završeni u prethodnom mandatu,

danas su pred nama i mi ćemo imati sigurno problema, jer ćemo doći u neku diskrapancu. Havalala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Idriz!

Zonja Selvije Halimi, kërkon të drejtën për të replikuar.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, Kryesues!

Kolegë deputetë,

Qeveria është duke hartuar programin e Qeverisë, mirëpo tash në kushte të reja një program për shtetin e Kosovës. Nuk kemi mundur të hartojmë program derisa ishim në një procedurë tjetër, në një proces tjetër.

Tjetra, çka desha të them. Asnjë Qeveri që e merr mandatin, nuk mund të fillojë prej zeros, sepse një hap është i bërë. Qeveria, normalisht që po ndërmerr hapat për t'i evituar mangësitë dhe lëshimet e keqpërdorimet që janë bërë në mandatin e kaluar dhe është duke punuar në përcaktimin e prioritetëve të saja.

Një çështje tjetër. Ne jemi duke proceduar në ligj dhe nuk jemi duke diskutuar për politikën e skemave sociale. Andaj, duhet të kemi kujdes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zotëri Ardian Gjini, unë besoj se edhe ju po kuptoni se duhet të replikoni, apo. Urdhëroni!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kam kërkuar shumë më herët për të njëjtat arsye dhe nuk e kam marrë fjalën, por krejt në rregull është.

Besoj se shumica prej nesh e dinë që, një parti që synon pushtetin, ka program para se ta marrë pushtetin. Nuk bën program 3 muaj pasi ta merr pushtetin. Kjo, sa për sqarim, për programin e ri, për Kosovën e re. Dikush mund t'i marrë sloganet prej billdeve dhe t'i qesë në letër, dhe që, e bëjnë programin, bile e dimë çka po do dikush. Kjo është e para. Programi bëhet përpara, partitë serioze e bëjnë programin përpara, jo pasi të vinë në pushtet.

Çështja tjetër është, edhe një herë po kthehem, zoti Buja tha, kalon në lexim të dytë. Zoti Buja, në lexim të dytë nuk ka kaluar në Kuvendin e kaluar, nuk ka kaluar në lexim të dytë. Komisionet e kanë refuzuar dhe nuk është votuar në Kuvend. Tash, do të thotë, duam me t'i qojmë edhe një herë në lexim të dytë. Kjo, veç sa për sqarim, do me thënë, ta japë një sqarim, kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gjini.

Tani, natyrisht, do të detyrohemi edhe zotëri Buçincës t'ia japim fjalën.

GANI BUÇINCA: Falënderoj shumë, zoti kryesues!

Parafolësit tim, kolegët të nderuar Ardian Gjinit, i them unë dhe e kuptoj shumë mirë që është shumë i brengosur për pozitën që e ka tash dhe ku ka qenë. Mos u brengos shumë, sepse Partia Demokratike e ka programin, edhe koalicionin qeverisës e ka programin qeverisës dhe ki për ta përsëritur shumë gjatë këtë refren që je duke e përsëritur sot. Përgatitu që për një 4 vjet ta përsëritësh këtë refren.

Unë desha të ndërlidhem edhe në diskutimin e mëhershëm të zotit Gjini, i cili aludoi dhe devijoi krejt nga rendi i ditës dhe filloi të flasë për Qeverinë, e nisi fushatën parazgjedhore dhe desha t'i përgjigjem tani këtui.

Edhe ju zotëri kryesues, duhet t'ua tërhiqni vëmendjen deputetëve kur e anashkalojnë rendin e ditës, sepse nxiten debate pastaj dhe nuk dihet kur kryhet seanca parlamentare.

Desha ta falënderoj shumë Qeverinë e Kosovës, Kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar, i cili po na i procedon këto ligje të ish Qeverisë për të parë si janë shpenzuar paratë e taksapaguesve dhe sa mangësi kanë këto ligje këtu. Kjo është një gjë shumë pozitive që po e bën Qeveria për të na dhënë mundësinë ne që në rrethana të reja ku gjendet sot Kosova, në procedurat e mëtutjeshme t'i përmirësojmë ndjeshëm edhe nga aspekti profesional, edhe përmbajtësor këto ligje. Kaq sa për tash. Besoj që në të ardhmen do të kemi akoma kohë për t'u marrë me programet e qeverisë, edhe të qeverive të kaluara, edhe të kësaj të resë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Buçinca edhe për këshillën, por unë jam këtu në punë të përkohshme, kështu që s'po guxoj të imponoj ndonjë qëndrim. Zoti Ramë Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: Unë besoj që zoti Gjini e di që unë e di çka do të thotë leximi i parë dhe i dytë. Unë nuk kërkoja që të ndërpriten debatet logjike, përmbajtësore dhe profesionale, por të kemi parasysh çka nënkupton leximi i parë dhe çka nënkupton leximi i dytë, që duhet t'ia përkujtoj kolegut tim. Kolegu im i nderuar e di po kështu se Partia Demokratike e Kosovës, në sajë të programit të vet shumë të kuptimshëm i ka fituar zgjedhjet. Andaj, besoj, kjo nuk ka nevojë të sqarohet.

Dhe, ju kisha lutur përsëri, ne mund ta kthejmë edhe pas leximit të dytë të kësaj radhe, por megjithatë unë nuk po shoh që ka fryt ky debat. Dua t'ju kujtoj përsëri, kolegëve të nderuar, disave që harrojnë dhe e kanë përvojën bukur të gjatë, se asnjë legjislaturë nuk nis prej limitit zero të ligjeve. Gjithsesi, trashëgon disa ligje që, unë e pranoj një kritikë që vërtet ka qenë përmbajtësore, se nuk janë korrigjuar sa duhet dhe si duhet ato ligje, janë prur pa shumë kujdes, por megjithatë më vjen keq që akoma do të duhej të debatojmë nëse kanë prur ligje të legjislaturës së kaluar dhe të Qeverisë së kaluar. Është për të ardhur keq, sinjerisht. Prandaj, unë ju lus edhe një herë, si kolegë të nderuar që jemi, që debatet të jenë në kuadër të pikës së rendit të ditës, për ligjin e caktuar dhe të jenë kontribuuese për këtë gjë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Buja!
Radhën e ka zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Pa dashje që t'ju marr kohë, mirëpo, meqë po diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme dhe jemi futur tash jo shumë në temën që po e diskutojmë, por po diskutojmë më tepër për politikat sociale dhe çështjet sociale. Nëse duhet të diskutojmë për politikat sociale dhe për çështjet sociale, është mirë që në një takim të veçantë të Kuvendit të Kosovës si grupe parlamentare ta ngrehim këtë çështje, sepse e kemi këtë të drejtë, dhe të diskutojmë se a ka mundësi Kosova t'i ndryshojë këto politika sociale dhe çështjen sociale për kategoritë e caktuara të njerëzve për të cilët po flasim. Pra, ta bëjmë temë të veçantë dhe, natyrisht, nëse ka mundësi, atëherë t'i rekomandojmë Qeverisë së

Kosovës që në të ardhmen të ndryshojë qoftë rritjen apo zvogëlimin të politikave sociale për njerëzit e adresuar.

Mirëpo, tani këtu po diskutojmë për një çështje shumë konkrete, po diskutojmë për plotësimin dhe ndryshimin e disa amendamenteve, të cilat, me rastin e implementimit në praktikë të ligjit që ekziston një kohë të gjatë, e është provuar në këtë Kuvend të Kosovës, kemi hasur në problematike konkrete. Do të ishte mirë që këtë çështje ta kishim ngritur pak më herët, në kohën kur kemi aprovuar buxhetin e Kosovës, në seancat paraprake që i kemi pasur dhe askush nga ne nuk është ndalur shumë të politikave sociale. Prandaj, nuk është sot shumë në interes edhe kategorive të caktuara që po na dëgjojnë, nuk është në interesin e tyre të na dëgjojnë se vetëm po e ngrehim çështjen dhe nuk po bëjmë asgjë praktike, sepse ne sot mund të diskutojmë tërë ditën, mirëpo ne nuk mund të ndryshojmë asgjë në këtë aspekt, as mund t'i risim, as t'i ulim ato përkufizime që i kanë në politikën e caktuar, apo në objektivat, në buxhetin e aprovuar të Kosovës.

Prandaj, meqë grupet parlamentare e përkrahën të gjithë me përjashtim të një grupi parlamentar, unë konsideroj që do të ishte mirë që ta votojmë tash Projektligjin, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Hyseni.
Zonja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, i nderuari zoti kryesues!
Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,
Me qëllim që të ndihmoj punën e Kuvendit, dëshiroj të thirrëm në Rregullën 18.2 që ka të bëjë me programin e Qeverisë, ku thuhet se kandidati i propozuar për Kryeministër, brenda 15 ditësh pas nominimit të tij, duhet t'ia paraqesë Kuvendit programin.

Prandaj, po ju lë të gjithëve të mendoni se a është shkelur kjo rregullë, apo jo. Me këtë, shpresoj që së shpejti do ta kemi programin e Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, shumë!
Në radhë është zoti Agim Veliu.

AGIM VELIU: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar kolegë,
Unë mendoj se do të ishte i mirëseardhur një shpjegim i Qeverisë, a dëshiron kështu, pa ndryshime, ta procedojë këtë ligj, meqë ky ligj është kthyer nga ky Kuvend, dhe për deputetët e Kuvendit do të ishte një sqarim i mirëseardhur, mendoj.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Veliu!
Zoti zëvendëskryeministri do të përgjigjet.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: Edhe ashtu kisha dilemën që t'i them 2 - 3 fjalë pas zhvillimit të këtij debati lidhur me Draftligjin për plotësimin dhe ndryshimin e një ligji. Ju kisha lutur që në start, të kuptojmë se bëhet fjalë për një draftligj për plotësim për ndryshim të ligjit bazë. U tha edhe nga shumë parafolës se nuk e kemi temë të rendit të ditës, nuk e kemi pikë të rendit të ditës shqyrtimin e skemave dhe të ligjit të tërësi, por vetëm një draftligji që ka të bëjë me plotësime dhe ndryshime, i cili është kthyer nga legjislacioni i kaluar. Ndonëse pa dashur të merret si kritikë, nuk është gjithmonë e

kuptueshme që të kthehet draftligji për plotësim të një ligji, sepse ai gjithmonë mund të bëhet edhe ashtu drejtpërdrejt nga deputetët, natyrisht, me kontribut të komisioneve përkatëse, e para.

E dyta, mendoj se nuk them asgjë të panjohur nëse them se asnjë ligj, në kuptimin absolut të fjalës, asnjë draftligj nuk mund të jetë i përkryer. Në qoftë se ai do të ishte i përkryer, atëherë nuk do të kishte nevojë për debat dhe për plotësime e ndryshime nga deputetët, por do të bëhej vetëm miratimi formal dhe do të shkonte më tutje.

Më tutje, ju lutem, është një parim në drejtësi, sipas të cilit, është padrejtësi e konsiderueshme drejtësia e vonuar. Praktikant e zbatimit të ligjit themelor për skemat sociale kanë dëshmuar vështirësi dhe probleme. Vetëm një ilustrim. Një kriter, ta zëmë, e ka penguar një familje ta gëzojë këtë ndihmë. Mungesa e një kriteri të këtillë ka favorizuar familje të tjera. Ideja është që me këtë plotësim të përmirësohen dhe të sqarohen kriteret, të plotësohen ato. Nuk është ideja të kursehet nga ky fond. Me ato shuma të mjeteve që eventualisht, po e përdori fjalën “padrejtësisht” i ka marrë dikush, një familje e caktuar, le të favorizohen familjet që i plotësojnë kriteret realisht dhe të përmirësohet thjesht një mbështetje, një ndihmë, sepse bëhet fjalë për ndihmë, e nuk zgjidhen problemet ekonomike me ndihma sociale. Deputeti Haziri e tha se nuk jemi vend social, nuk jemi shtet social dhe, natyrisht, s’ka nevojë të elaborohet më tutje kjo.

Më tutje, ju lutem. Çështjet konkrete nuk sqarohen me shpjegime të përgjithshme, çështjet juridike nuk shpjegohen me fjalime politike. Duam këtu kontribut të drejtpërdrejtë për përmirësim, për plotësim ose për kthim. Në qoftë se nuk pranohet ky, e kthejmë pas. Ideja ka qenë që të mos ketë vonesë më tutje në zbatimin ose eliminimin e dobësive që janë manifestuar në praktikant e deritanishme. Kështu, Qeveria e ka sjellë këtë ligj, ashtu siç është kthyer më herët, bashkë me setin prej 30 e sa ligjeve, por më lejoni të kujtoj se Qeveria në agjendën e saj, në strategjinë legjislative ka pesëfishin e këtij numri për këtë vit t’i ofrojë dhe do t’i ofrojë. Kështu që ne mendojmë se ky Draftligj për plotësimin e Ligjit mund të plotësohet dhe ndryshohet me kontributin e juaj, deputetë të nderuar, pa vonesa të mëdha dhe, natyrisht, të evitohen edhe kolizionet, sepse mund të ketë kolizione. Nuk themi se është i përkryer, por më e rëndësishmja është që t’i eliminojë dobësitë që janë manifestuar deri tash dhe të shkohet më tutje në një zbatim më prefektë, kushtimisht ta them, më të përmirësuar të Ligjit themelor për ndihmat sociale qytetarëve tanë dhe familjeve që kanë në Kosovë të gjithat komunat familjet e tilla dhe kategoritë e tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër. Unë besoj se shpjegimi juaj ka pajtuar shumë shpirtra të trazuara me të drejtë këtu të deputetëve. Sidoqoftë, kemi edhe tre oratorë edhe pse janë për herë të dytë, por unë po ju propozoj që shpejt e shpejt t’u japim fjalën dhe ta meritojmë një pauzë të mirë ndoshta mbi 30 minuta.
Zotëri Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Isha në dilema të replikoj, por patronizimi i disa deputetëve më irritoi dhe pa dashur kështu u irritova që të replikoj.

Nuk është korrekte, zoti kryesues, nëse në leximin e parë një ligj dikur është tërhequr, të tentohet të qitet për së dyti pa u përmirësuar fare. Po e shfrytëzoj këtë, po e them se jam nga kritikuesit më të mëdhenj të Qeverisë së kaluar dhe nëse ky Projektligj është kthyer

në leximin e parë, tash të njëjtit kritikues nuk mund të bëhemi hipokritë dhe ta aprovojmë.

Kështu bëme edhe me buxhetin, se u përmend këtu buxheti. Me presion na u imponua që ta miratojmë buxhetin, buxhetin e asaj Qeverie që e kemi kritikuar. Po them, unë jam nga ata më të mëdhenjtë që e kam kritikuar deri në fund. Dhe, me imponim nga ata që së bashku me mua e kemi kritikuar atë buxhet, atë politikë, atë strategji të asaj Qeverie, na u imponua që ta miratojmë. Nuk po dua të hyjë në lojërat e imta politike qeveri – opozitë, po sinqerisht, ta përdorim pak vetëdijen tonë, korrektësinë tonë në rastet specifike kur kemi të bëjmë me ligje, mos të vazhdojmë me një hipokrizi, me një demagogji të kaluar. Të paktën, le të ndryshohet krejt ajo që e thamë këtu disa, që e kundërshtuam, le të merret dhe të rishqyrtohet konform kërkesave.

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Tali!

Herëve të tjera, në qoftë se unë jam këtu, do të detyrohem t'ju tërheq vërejtjen që mos të përdoren kualifikime shumë të rënda, por ndoshta nuk do ta kem rastin, po them, kështu që shkojmë më tutje.

Zonja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNODZI: Zoti kryesues, pasi kam qenë në mandatin e kaluar anëtare e Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale edhe kam punuar në këto ligje, desha vetëm të sqaroj diçka edhe pse po bëhet ky debat.

Ky Projektligj është kthye në leximin e dytë. Komisioni ynë ka kaluar kohë, orë të tëra në Kuvend duke punuar, kemi pasur ndihmësa, këshilltarë nga OSBE-ja, nga UNMIK-u, por nuk kemi mund ta rregullojmë ligjin në atë mënyrë që të jetë i kuptueshëm për përdoruesit e këtij ligji.

Prandaj, krejt ky debat po më duket shumë i arsyeshëm, se faktikisht koha është në pyetje, koha është para, nuk kemi më kohë, ky Kuvend që tash një pako të tërë të ligjeve të punës dhe mirëqenies sociale, të cilat janë kthyer në rishqyrtim, prapë ta bëjmë të njëjtën punë dhe për çka. Po prashitim në ujë, zoti Kryetar. Me të vërtetë, s'po di, gjithë ky debat edhe nuk u kuptua esenca. Ky ligj nuk duhet të votohet, duhet t'i kthehet Ministrisë ta punojë se nuk ka koherencë, nenet s'kanë koherencë, nuk po kuptohen, s'po mund të përpunohen, aty është krejt esenca. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hundozi!

I fundit, para pushimit, është zoti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Nuk e kisha në plan të ndërldhem, megjithëse zoti zëvendëskryeministër dha shumë shpjegime që, vërtet, të gjithë ne i mirëpritëm. Mirëpo, duke i dëgjuar kolegët deputetë duke folur, mu kujtua boksi. Ata që bëjnë boks të padrejtë, shpesh japin goditje të ulëta. Edhe këtu po shfrytëzohen disa raste për të dhënë goditje të ulëta.

Unë mendoj se qytetarët që na përcjellin, e dinë se çka është konstruktiviteti, e dinë se çka janë njerëzit që kanë kontribuar dhe që janë ndjekur vazhdimisht me skandale dhe nuk mund të shfrytëzohet këtu rasti për t'u përmirësuar reputacioni duke dalë jashtë temës.

I ftoj të tillët që të angazhohen konkretisht në temën ku kontribuojmë, të japin kontribut për ligjet, për nenet, alinetë se ku çka duhet të ndryshohet dhe kështu do të dëshmojnë se kanë bërë një katarzë shpirtërore dhe duan vërtet të përmirësohen, e jo të përpiqen që përmes kritikave të hedhin gjithçka poshtë.

Unë konsideroj se ndoshta pak debate këtu të atyre që kishin qëllime vërtet të mira, sidomos te neve që jemi deputetë të ri në këtë legjislacion, është se këtu kemi vetëm projektet e propozuara për ndryshim, por nuk na është përcjellë edhe vetë ligji. Kështu, unë e kuptoj se administrata ka qenë e ngarkuar, por e lus edhe administratën sepse i kemi edhe disa ligje të tilla ku janë vetëm ndryshimet dhe ne nuk kemi mundësi që t'i shohim çka është ndryshuar konkretisht në atë ligj dhe a është ndonjë përmirësim, apo jo.

Dhe, së fundit, zoti kryesues, të kisha lutur që të mos e përdorësh fjalën orator, se ne të gjithë jemi deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit për këshillën!
Do t'i kemi 30 minuta pushim.

(Vazhdon seanca pas pauze)

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë punën.
Tani kemi:

- Shqyrtimin e parë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ftoj ministrin Idriz Vehapi, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Inspektimi i vendeve të punës në kuptimin e kontrollit të kushteve të punës tek punëdhënësit, si fushëveprim me interes të veçantë, është i rregulluar me Rregulloren numër 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë, dispozita këto të cilat janë në përputhje të plotë me Konventën Ndërkombëtare numër 81 për inspektimin e punës dhe të rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Sot para jush gjendet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës, sponsorues i të cilit është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ekspozeja ka për objektiv të ofrojë shpjegime të nevojshme lidhur me propozimin e Projektligjit të lartpërmendur.

Aktualisht në Kosovë është në fuqi Ligji për Inspektoratin e Punës numër 2002/9, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19.12.2002 dhe i nënshkruar më 21.2.2003 nga PSSP-ja.

Me këtë Ligj është themeluar Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës si organ ekzekutiv, i cili mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Rregullores numër 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë dhe dispozitat e tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit.

Fushëveprimi i Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës është: sigurimi i zbatimit në mënyrë unike për të gjitha vendet e punës i dispozitave të Rregullores numër 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë dhe të dispozitave të tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit që kanë të bëjnë me kushtet në vendin e punës, orarin e punës, pagat, sigurinë dhe shëndetin, mos diskriminimin e të punësuarve, e të tjera.

Të nderuar deputetë,

Mendojmë se me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit numër 2202/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, veprimet dhe aktivitetet e Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës në mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Rregullores numër 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë dhe të dispozitave të tjera të aplikueshme në fushën e punësimit në tërësi do të jenë më efikase, funksionale dhe më racionale.

Me këto plotësime dhe ndryshime të këtij ligji janë eliminuar paqartësitë në rolin e ushtrimit të kompetencave dhe të përgjegjësi duke u nisur prej kryeshefit të Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, zëvendësve të tij dhe inspektorëve të punës. Në anën tjetër, ndryshimet dhe plotësimet e këtij Ligji do të ndikojnë pozitivisht edhe në rritjen e bashkëpunimit dhe të sinkronizimit të punëve dhe detyrave të punës me qeveritë komunale, inspektoratet e tjera, me autoritetet e tjera relevante dhe me Shërbimin Policor të Kosovës.

Me zbatimin e drejtë dhe efikas të dispozitave të propozuara në Projektligjin e përmendur sigurisht që Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës do t'i realizojë objektivat e përcaktuara në dokumentet programore, afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Ndryshimet dhe plotësimet në përmbajtjen e Ligjit për Inspektoratin e Punës konsistojnë në:

Përcaktimin e drejtë të fushëveprimit të Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, qartësimin dhe konkretizimin e funksioneve të Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, rregullimin dhe përcaktimin e përbërjes dhe mënyrat e emërimit të stafit drejtues të Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, definimin dhe përcaktimin e autorizimeve për kryeshefin e Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, të zëvendësve të tij dhe të inspektorëve të punës.

Rregullimin dhe qartësimin e procedurave administrative të ankimit në përputhje me Ligjin për procedurën administrative dhe legjislacionin tjetër të aplikueshëm, ndryshimet dhe plotësimet e tjera të karakterit teknik dhe administrativ.

Të nderuar deputetë,

Ndryshimet dhe plotësimet me këtë Ligj nuk paraqesin implikime buxhetore sepse ekzistojnë resurset njerëzore dhe buxheti për funksionimin e këtij organi ekzekutiv.

Përkundrazi, me miratimin e këtyre plotësimeve dhe ndryshimeve në këtë ligj krijohen kushte të favorshme për krijimin e të hyrave për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Duke çmuar kohën tuaj, ju falënderoj për vëmendje dhe kujdesin tuaj me shpresë se gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji me qasjen dhe angazhimin tuaj do të ndihmoni në avancimin e tij. Në këtë mënyrë do të jepni kontributin tuaj të cilin ne e vlerësojmë dhe që njëkohësisht është shumë i vlefshëm e me interes të veçantë për rregullimin e raporteve në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Pas prezantimit të Projektligjit, hap debatin për diskutim, në parim.

Renditja e diskutuesve, kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Sadik Idriz nëse e do fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Komisija nije razmatrala ovaj nacrt zakona pre prvog čitanja, ali obećavamo da će, ako bude usvojen ovde danas posle prvog čitanja, Komisija raditi na amandmanima na ovaj nacrt zakona, a ako može sada ili kasnije, kada bude došao red za Parlamentarnu grupu „7+“.

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe, në parim, ne mendojmë se është e nevojshme të bëhet një ndryshim i tillë, duke marrë parasysh se Ligji si i tillë është ndër ligjet e para dhe ka pasur nevojë të bëhen ndryshime dhe intervenime brenda Ligjit.

Mirëpo, në Projektligjin i cili na është ofruar, nuk vërehen që bëhen ndryshime substanciale brenda këtij Ligji, përveç ndryshimeve në fjalë, do të thosha, më saktësisht janë fjalët, për shembull “inspektorat” është zëvendësuar me “Agjencion Ekzekutiv” apo fjala “kryeshef” e cila është zëvendësuar me “kryeinspektorat”. Kjo është një ndër vërejtjet, mirëpo vërejtje tjetër të cilën ne mendojmë se do të ishte shumë e rëndësishme është edhe ekzistenca e Ligjit për punën. Do të ishte shumë mirë sikur Parlamenti ta kishte miratuar më herët këtë ligj dhe t’i paraprinte Ligjit apo Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Pavarësisht nga këto vërejtje, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah Projektligjin e tillë dhe e ruajmë të drejtën që brenda komisioneve përkatëse t’i drejtojmë këshillat dhe vërejtjet që i kemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

I nderuari Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Ligji për Inspektoratin e Punës 2002/9 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 dhjetor 2002, ndërsa është fuqizuar me Rregulloren 2003/4 të nënshkruar më 21 shkurt 2003 nga PSSP-ja.

Sipas mekanizmave kompetentë për mbikëqyrje dhe kontroll të zbatimit të këtij ligji në vazhdimësi kanë vlerësuar se ekzistojnë pengesa të ndryshme për zbatimin e drejtë dhe efikas të këtij akti ligjor. Pse ka ndodhur kjo? Sepse vetë organet e Ligjit për Inspektoratin e Punës, siç ka qenë e paraparë në ligj, janë quajtur si Agjencion Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, siç thuhet edhe tani në dokumentin e memorandumit shpjegues dhe e citoj këtë: “Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës ka ndërmarrë iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës” Konsideroj se nuk mund të thuhet kështu kur Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës ende nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe nuk është përpunuar përmes komisionit.

Andaj, konsideroj se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës, konsiston në:

1. Themelimin dhe zgjerimin e fushëveprimit të mekanizmit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit nga fusha e punësimit.
2. Qartësimin dhe konkretizimin e funksioneve të Agjencionit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës.
3. Ndryshimet dhe plotësimet e tjera të karakterit teknik dhe administrativ.

Projektligji është harmonizuar me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane. Implikimet buxhetore janë të ndërlidhura me organet e personelit që janë të parapara rreth 70 të punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe konsideroj se ka pak implikime buxhetore dhe kjo mbështetet në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Esencialja e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës është se fjala “Autoritet i Inspektoratit të Punës” që ka qenë në Ligjin e Inspektoratit të Punës të zëvendësohet me fjalën “Agjencion Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës”, andaj nuk kanë mundur ta quajnë Agjencion Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës pa u miratuar dhe pa kaluar nëpër Kuvendin e Kosovës.

Prandaj, duke ditur rëndësinë e këtij ndryshimi, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah, në parim, këtë Projektligj dhe në procedura të mëtejme do të japim kontributin tonë në komisionin funksional. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete!

Tani është radha e Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Respekt për të gjithë deputetët në sallë,

Me plotësimet dhe ndryshimet që i bëmë sot në leximin e parë dhe, besoj, ne si Grup Parlamentar, jo që do t'i aprovojmë, në parim, po sot kishim pranuar që edhe të aprovohen këto plotësime dhe ndryshime, për shkak se nga ky moment me këto ndryshime dhe plotësime ky mekanizëm ekzekutiv institucional i Qeverisë së Kosovës merr hapa drejt funksionimit të mbarshëm të fushëveprimit të tij.

Sa për fjalët “autoritet” dhe “agjencion” gjithçka është e harmonizuar me Konventën Ndërkombëtare numër 81 dhe besoj se nuk paraqet ndonjë laramani, edhe pse është quajtur ashtu deri sot, se me këtë është rregulluar në mënyrë konvencionale. Mirëpo, çka e bën shqetësuese të ardhmen për zbatimin apo implementimin e këtij Ligji dhe funksionimin e tij në mbarë territorin e Kosovës, është se ky ligj është ligj derivativ që buron nga Rregullorja 2001/27 mbi Ligjin themelor të punës në Kosovës. Kësaj radhe besoj se edhe Qeveria, por edhe Parlamenti duhet të ketë në konsideratë që ta sjell sa më shpejt Ligjin themelor të punës në Kosovës, Projektligjin të cilin e ka kthyer mbrapa, sepse rregullorja implementohet sot në Kosovë dhe, besoj, ajo kostoja financiare që është e paraparë në Projektligjin, në Ligjin themelor të punës në Kosovës nuk praqet ato implikime buxhetore që të mos vijnë në pakt dhe ta lëmë pezull funksionimin e këtij Projektligji me këto plotësime dhe ndryshime që sot i kemi para vetes.

Unë konsideroj se me aprovimin edhe ardhjen e Ligjit themelor të punës në Kosovë, ku rregullohet marrëdhënia e punës në Kosovë dhe fushëveprimtaria tjetër në këtë lëmi, aty përmban, në përbërje të dispozitave të atij Projektligji është edhe krijimi i Shërbimit Qendror të Punësimit që sot e tutje, ne si shtet si Republikë e re, duhet të krijojmë marrëdhënie ndërkombëtare lidhur me numrin e të punësuarve që janë në Kosovë dhe jashtë Kosovës, duke ditur se aty paguhet kontribute që deri tash i ka realizuar Serbia në emër të Kosovës, si banorë të ish Jugosllavisë. Besoj se ky është një element i shtetësisë dhe konsideroj edhe një herë në emër të Grupit Parlamentarë, por edhe timin personal, që sa më shpejt Kuvendi t'i bëjë kërkesë Qeverisë që Ligjin themelor të punës të Kosovës, atë projektligj ta sjell në Kuvend, për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputetja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zotëri Kryetar,

Zotëri ministër,

Deputetë të nderuar,

Projektligji për Inspektoratin e Punës është kthyer nga ana e Komisionit për Punës dhe Mirëqenie Sociale, sepse në esencë nuk ka sjellë ndryshimet për të cilat është iniciuar ndryshimi dhe plotësimi i ligjit të mëhershëm, por edhe që të harmonizohet me Ligjin për punën, i cili do të jetë dokumenti bazë për funksionimin e Inspektoratit të Punës.

Në këtë Projektligj i vetmi ndryshim që ofrohet është propozimi që vetëm t'i ndërrohet emri i “Autoritetit” të Inspektoratit të Punës në “Agjencion” të Inspektoratit të Punës dhe emri “kryeinspektor” të ndërrohet në “kryeshef”.

Edhe në këtë version që e ka pru Qeveria e re, teksti është i njëjtë me atë të Qeverisë së kaluar, pos që ndërrohet në faqen e parë nënshkrimi i Kryeministrit. Edhe unë u bashkëngjitem të gjithë deputetëve të opozitës që po kërkojnë program të Qeverisë dhe unë mendoj se është e domosdoshme që të na ofrohet një program dhe mos të na i sjell kjo Qeveri ligjet e Qeverisë së kaluar, të cilën e kanë kritikuar vazhdimisht për joefikasitet.

Nuk po flas vetëm si deputete e opozitës, por si njeri i cili e respekton punën dhe zotësinë e tjetrit dhe të cilit dëshiron t'ia shtrijë dorën për sukseset e arritura të cilat në këto kohëra na nevojiten shumë, e le të jetë ai edhe oponent politik.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk e përkrah në parim këtë Projektligj. Propozon që t'i kthehet Qeverisë që ta harmonizojë me Ligjin për punën, i cili është i gatshëm për procedim në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Anëtarë të Kabinetit qeveritarë,

Të çmuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Realisht, edhe këtu vërehen mangësi të mëdha, qoftë të aspektit procedural sepse është rikthyer ky ligj dhe nuk kemi vërejtur ndryshime serioze, substanciale për çka edhe është e nevojshme që ky Parlament thjesht t'i bëjë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme. A është e nevojshme që të ndryshohet dhe të plotësohet ky Projektligj me amendamente të reja përmbajtësore që do ta rregullonin sistemin e punëdhënësit dhe të punëmarrësit dhe të raporteve të reja tani në shtetin e ri, në Republikën e Kosovës, domosdo që janë të nevojshme. Ka edhe implikime buxhetore dhe ka paqartësi rreth mbulimit të shpenzimeve të ekzistimit tani të Agjencionit të Inspektoratit të Punës, të cilat janë lënë që në ecje t'i mbulojë Ministria përkatëse që do ta mbikëqyrë këtë Agjencion, por që ky ligj nuk i cenon parimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Është e nevojshme që ky ligj të diskutohet me vëmendje ose të rikthehet edhe një herë, ose gjatë punës së komisioneve funksionale dhe raportuese të bëhen ndryshime substanciale për arsye se ky është një ligj derivativ pasi që nuk është miratuar nga ky Parlament Ligji themelor i punës dhe unë konsideroj se mund të kemi më vonë edhe implikime buxhetore, po edhe konfuzion në kompetenca.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, thjesht e mbështet, në parim, me vërejtje shumë serioze dhe duam të besojmë që mos të na kthehen në ecje ligjet e tilla bazike që rregullojnë çështje shumë të rëndësishme të jetës dhe të punës në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Edhe unë shpresoj se Qeveria komplet po i dëgjon vërejtjet tona dhe do t'i eliminojnë këto vërejtje që po jepen nga Parlamenti.

Fjalën e ka deputeti i Grupit Parlamentar "7+" Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče! Ja se predružujem ovim primedbama koje su date, jer ovaj zakon je nakon prvog čitanja vraćen od strane funkcionalne komisije iz najmanje dva razloga. Jedan razlog je bio što Zakon o radu, znači bazični zakon, osnovni zakon nije usvojen, i drugi razlog je bio što Nacrt zakona o dopunama Zakona o Inspektoratu

rada ima nekoliko članova koji su isključivo vezani za formiranje Izvršne agencije u mesto Autoriteta.

Ovaj zakon ima budžetske implikacije i predviđa zapošljavanje. Ovaj Nacrt zakona zapošljava 60 radnika godišnje i predviđa te budžetske implikacije koje su prikazane u Aneksu.

Druga stvar, nije mala razlika između Autoriteta i Izvršne agencije. Bile su preporuke Monotornog fonda prethodnoj Vladi da ne može formirati nove agencije u određenom periodu. I to je bio jedan od razloga što je ovaj Zakon bio vraćen.

Ukoliko u međuvremenu bude došao, kako se najavljuje krajem marta, i Zakon o radu, Komisija će radi na ovom Zakonu. Mi ćemo verovatno ili čekati da ovaj Zakon bude nakon Osnovnog zakona o radu i daćemo doprinos u komisiji.

Unačelu ćemo podržati ovaj Zakon kao Parlamentarna grupa, ali vidimo odmah na početku da ovaj zakon ima određenih defekata. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar SLS, mungon.
Ndoshta për replikë, është lajmëruar deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIM DEMALIAJ: Fjalën time për të dytën herë nuk do ta quaja replikë, por do ta quaja më shumë si mbështetje profesionale, në këtë rast, lidhur me dispozitat që i përmbanë ky Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e tij, sepse nuk do ta replikojë askënd pasi në këtë moment unë jam edhe vetë anëtar i opozitës. Mirëpo, në këtë rast besoj se jemi duke folur dhe thjeshtë jemi duke folur për një mekanizëm ekzekutiv të institucioneve qendrore të Kosovës, që është Inspektorati i punës, sepse në veçanti këtë Inspeksion askush nga Qeveria dhe nga ministritë përkatëse nuk e kanë mbikëqyrur dhe nuk kanë kërkuar asnjëherë asgjë prej tij, duke ditur se ky mekanizëm nuk është mekanizëm special, siç janë të gjitha inspektoratet tjera që janë të specializuara, do të thotë janë vetëm për një fushë, siç është shëndetësia, bujqësia apo të tjera forma. Ky është një mekanizëm që rregullon lëmin e punës dhe të punësimit, që deri në masën më të lartë përfshin edhe dikasterët e Qeverisë në kontrollin e marrëdhënies së punës dhe të sigurisë në punë.

Sot u tha këtu se ne jemi deputetë të ri, mirëpo duke qenë të ri, kemi ardhur për të zëvendësuar ata të vjetrit që nuk kanë punuar deri tash edhe nuk kanë mbështetur asnjëherë ligjet që ata i kanë aprovuar nga ky Kuvend dhe nuk kanë kërkuar mbikëqyrjen e tyre se sa zbatohen në praktikë. Ne kemi qenë pjesë e komunitetit që u kemi besuar atyre ligjeve që ne duhet t'i zbatojmë në praktikë. Tani, sot e tutje ne jemi këtu dhe për gjithçka që nuk shkon në favor të qytetarit dhe të mekanizmave institucional të Kosovës, ne do të jemi një katalizator, një kondenzator shumë i mirë që diçka çka buron, edhe kur e qojmë dorën "për" ose "kundër", të jetë në veprime pozitive që Kosova mos të vuaj nga teket e deputetëve këtu. Më vjen keq që më duhet të drejtohem në këtë formë, mirëpo ne jemi deputetë, nuk jemi pjesë e Qeverisë, dhe do ta luajmë rolin tonë profesional. Për fjalët "autoritet" apo "agjencion" nuk prish punë. Me Konventë ndërkombëtare është rregulluar, me Konventën numër 81, se këto janë agjencione ekzekutive dhe nuk ...

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Për këtë arsye bëhen zgjedhjet dhe, natyrisht, është mirë që kanë ardhur njerëz me energji të reja. Nuk ka diskutues të tjerë.

Vazhdojmë me pikën tjetër:

- Shqyrtimi i parë të Projektligjit për përkrahjen materiale të familjeve dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ftoj ministrin Idriz Vehapi, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: I nderuar, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, njëra prej detyrave dhe përgjegjësiive themelore të kësaj Ministrie është përkrahja dhe siguri i ndihmave financiare nga mjetet e akorduara të Buxhetit Konsoliduar të Republikës së Kosovës për familjet dhe qytetarët nevojtarë të Kosovës.

Kësaj çështjeje në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale niveli politik dhe ai administrativ i ka kushtuar vëmendje të veçantë. Kur vlerësojmë kështu, kemi parasysh faktin se kjo Ministri është bartëse e shumë aktiviteteve të cilat kanë ndikuar në sensibilizimin e opinionit lidhur me të drejtat dhe integritet e qytetarëve nevojtarë në jetën shoqërore dhe publike.

Posaçërisht vlen të theksohet fakti se vëmendje e veçantë i është kushtuar sektorit të aftësisë së kufizuar, i cili ka pasur për qëllim përkrahjen financiare dhe sigurimin e shumë beneficioneve për këtë kategori të personave.

Të nderuar deputetë,

Kur është fjala për legjislacionin i cili rregullon sektorin e aftësisë së kufizuar, mendoj se në këtë kuadër Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka arritur rezultate evidente. Kur konstatoj këtë, kam parasysh faktin se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka qenë njëri prej aktorëve kryesor në hartimin dhe përgatitjen e kornizës gjithëpërfshirëse të politikave mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Republikën e Kosovës, i cili është një dokument që përcakton politikat, strategjitë dhe objektivat e sektorit të aftësisë së kufizuar pothuajse në të gjitha fushat, si në arsim, punësim, sigurimin material, sigurimin social, kulturor, sport, eliminimin e barrierave dhe çështje të tjera me interes të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.

Po ashtu është shumë i rëndësishëm fakti se në vitin 2003 ky Kuvend ka shqyrtuar dhe aprovuar Ligjin nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, i cili objektiv të vetin themelor ka ofrimin dhe përkrahjen me ndihmë financiare personave të cilët janë përherë dhe plotësisht me aftësi të kufizuara. Këtë të drejtë e realizojnë të gjithë personat me aftësi të kufizuara nga mosha 19 vjeçare deri në moshën 64 vjeçare.

Pra, siç po dihet, me këtë ligj nuk janë trajtuar personat me aftësi të kufizuara nga lindja deri në moshën 18 vjeçare. Për shkak të mospërfshirjes së personave me aftësi të kufizuara nga lindja deri në moshën 18 vjeçare në Ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuara, në Kosovë ka qenë shumë e nevojshme dhe e arsyeshme që edhe kjo

kategori e kësaj grupmoshe të trajtohet me ligj të veçantë për ta mbështetur dhe përkrahur materialisht.

Projektligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme rregullon dhe përmban dispozita ligjore për përkrahje materiale familjeve të cilat ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët e tyre të cilët janë me aftësi të kufizuara të përhershme.

Ky Projektligj përbëhet nga 7 kapituj dhe ka këtë përmbajtje:

Kapitulli 1, Dispozitat themelore,
Kapitulli 2, Realizimi i të drejtës në ndihmë materiale,
Kapitulli 3, Komisioni i ekspertëve për vlerësimin dhe kategorizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme,
Kapitulli 4, Procedura për ekspertizë,
Kapitulli 5, Mjetet financiare për zbatimin e ligjit,
Kapitulli 6, Parashtrimi i kërkesës dhe vendosja, dhe
Kapitulli 7, Dispozitat kalimtare.

Të nderuar deputetë,

Qëllimi themelor i nxjerrjes së këtij Projektligji është zhvillimi dhe avancimi i shërbimeve sociale dhe familjare për të gjitha familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme në mënyrë që t'ju mundësohet këtyre fëmijëve të bëjnë një jetë normale dhe më dinjitoze.

Ndihma dhe kujdesi institucional i takon çdo fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme të moshës 1 deri 18 vjeç, që është qytetar i Republikës së Kosovës dhe nuk është i aftë që në mënyrë të pavarur të lëviz dhe t'i kryejë aktivitetet e përditshme jetësore brenda 24 orëve.

Po ashtu, Projektligji ka një rëndësi të veçantë sepse do të mbrojë fëmijët nga mosha 1 deri 18 vjeçare që janë pjesë e shoqërisë tonë, duke i ikur kështu diskriminimit dhe përjashtimit të cilësdo kategori shoqërisë nga të drejtat elementare në mbrojtje dhe shërbime sociale.

Po kështu, me këtë Projektligj e proklamojmë ndihmën për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme dhe në të njëjtën kohë deinstitutionalizimin duke i dhënë një rëndësi të madhe mbrojtjes së qytetarëve tonë brenda familjes në çdo rast kur kjo është e mundur.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh përmbajtjen, arsyen dhe veçmas qëllimin e nxjerrjes së këtij Projektligji, vlerësojmë se Projektligji në fjalë duhet të përkrahet nga ju. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, ministër për prezantimin!

E hapim debatin.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Ju faleminderit, Kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar dhe në emrin tim personal e përkrah Ligjin për përkrahjen materiale të familjeve edhe të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme. Është një ndër Projektligjet më humane që po diskutohet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, sepse mbron kategorinë më të ndjeshme dhe me nevojë shumë të madhe që është mbrojtja e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme. Ligji është punuar shumë mirë. Është një ligj i shkurtër dhe i qartë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës edhe në mandatin e kaluar, kur është shqyrtuar ky ligj, në shqyrtim të parë, ka dhënë mendimin pozitiv. Gjithashtu, anëtarët e këtij grupi në Komisionin gjegjës kanë dhënë një kontribut bazik në amendimin e ligjit, prandaj neve na vjen mirë shumë që ky ligj është ndër ligjet e para që po shqyrtohet në këtë Parlament. Do të vazhdojmë të kontribuojmë në komisionet gjegjëse, që ligji sa më parë të vijë në shqyrtim të dytë dhe të miratohet.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit deputete! Sipas radhës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Duke u nisur nga fakti se pas luftës problemet sociale në Kosovë janë të shumta, të ndryshme dhe shumë komplekse, ardhja në shqyrtim në parim e Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, rrit interesimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, që këto kategori të veçanta të shoqërisë sonë, të merren në përkujdesje institucionale.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, këtë projektligj e ka vlerësuar dhe e përkrah në parim, për këto arsye. Projektligji bën pjesë në vazhden e kompletimit të legjislacionit tonë nga sfera e shërbimeve sociale dhe të familjeve, plotëson zbrazësinë juridike sa i përket ndihmës dhe kujdesit institucional, që i takon çdo fëmije me aftësi të kufizuar, prej moshës 1 deri në 18 vjet, si dhe përkrahjen materiale në pajtim me mundësitë buxhetore familjeve të tyre.

Projektligji ofron zgjidhje adekuate dhe të avancuar në këtë fushë dhe zëvendëson ligjin ekzistues në fuqi për mbrojtje sociale të vitit 1976. Projektligji ka për qëllim përmirësimin e politikës së punës sociale nëpër qendra sociale, që rezulton me zhvillimin e programeve sociale të cilat përmirësojnë, sadopak, kushtet jetësore të këtyre fëmijëve që kanë nevojë për përkujdesje dhe lehtësojnë mënyrën e të jetuarit. Projektligji është i veçantë, sepse paraqet një hap të rëndësishëm në rrugën e ndërtimit të një sistemi të ri dhe të qëndrueshëm të sigurisë materiale për fëmijët me nevoja të veçanta. Dispozitat e Projektligjit përcaktojnë kriteret e punës profesionale të komisioneve mjekësore të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, kompetencat e Qendrës për Punë Sociale, si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave.

Përkundër faktit se Projektligji ka dispozitat e qarta dhe konkrete dhe garanton të drejtat e përcaktuara me konventat për të drejtat e fëmijëve, do të veçoja, se është i padefinuar

fati i mëtejshëm i këtyre fëmijëve pas moshës 18 vjeçare, si dhe rehabilitimi dhe arsimimi i tyre, sikur me këtë projektligj përkujdesja institucionale përfundon pas kësaj moshe.

E përgëzoj Qeverinë për hartimin e këtij projektligji, me një dëshirë, që sa më parë, të zbatohet në jetë edhe pse këtë projektligj e përshkon një kosto shumë e lartë financiare.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim dhe gëzojmë të drejtën që të japim kontributin tonë me rastin e amendamentimit të këtij projektligji në komisionet funksionale.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!
Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Rita Hajzeraj

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar,
Kabinet qeverisës,
Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se deri diku i plotëson nevojat e kësaj kategorie, mirëpo ka vërejtje të shumta, duke mos harruar se ky projektligj është në shpërputhje dhe në kundërshtim me ligjin e mëparshëm për skemën sociale, sepse në ligjin për përkrahjen materiale të familjeve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, parashihet se një fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme duhet të gëzojë një pension jetësor, kurse në ligjin paraparak kjo mundësi zhvlerësohet. Pra, këto dy ligje janë në kundërtënie të mëdha njëri me tjetrin. Duhet që edhe një herë të rishqyrtohen këto dy ligje dhe të harmonizohen.

Ne si grup parlamentar e përkrahim ligjin me arsyen që këto shtresa të shoqërisë të mos mbesin fare pa këto ligje dhe me vullnetin që këto ligje të jenë sa më të favorshme për ta, ne do të punojmë dhe në komisionet përkatëse do t'i japim vërejtjet dhe kontributin tonë për këtë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!
Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti Kryetar,
Zotërinj ministra,
Deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim miratimin e këtij ligji nga ky Kuvend, bash për shkak të arsyes që këto familje me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme kanë ngarkesë të madhe emocionale dhe materiale, kështu që Grupi Parlamentar, në komisionin përkatës do ta japë kontributin e vet që ta begatojë me amendamente sa më mirë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!
Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në parim e mbështet këtë projektligj. Konsiderojmë se ky projektligj është i rëndësishë së veçantë, meqë ka dimension tejet humanitar, avancoi shërbimet sociale për të gjithë fëmijët, familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vlerësojmë se projektligji është në përputhje me standardet ndërkombëtare, konkretisht në pajtim me të drejtat e fëmijëve.

Vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i shqyrtojmë në Komisionin përkatës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!
Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputetja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: U mnoštvo socijalnih problema koje zaokružuju kosovsko društvo, vrlo je značajno što je danas pred nama jedan Predlog zakona koji ima za cilj pružanje potpore i pomoći porodicama koji se brinu za decu sa trajnim poremećajima i oštećenjima. Poseban značaj ovog Nacrta zakona je, ne samo u tome što pruža pomoć porodicama čija deca imaju potrebe za posebnom negom i brigom lekovima, pomagalima i slično, već je u tome što ta deca zaslužuju da žive bolje i dostojanstvenije kao deo našeg društva. Radi se o deci od 1 do 18 godina, kojima je neophodna pomoć prilikom obavljanja svakodnevnih životnih aktivnosti. Takodje, ovaj Nacrt zakona podstiče i poboljšanje praktičnog socijalnog rada u centrima za socijalni rad. Posebno smatramo značajnim član 18. koji uređuje da materijalnu podršku može realizovati osoba, tačnije porodica bez obzira na njegovo ili porodično materijalno stanje, ukoliko ima dete sa stalnim ograničenim sposobnostima.

Ono što bi trebalo uraditi, jeste obratiti pažnju na način odredjivanja visine materijalne pomoći porodicama. U Nacrtu se navodi da će to biti urađeno podzakonskim aktom, kao i finansijsku deklaraciju koja nudi dve varijante. Treba istaći da je ovaj Nacrt zakona takođe bio u skupštinskoj proceduri i u prošlom sazivu, ali nije dalje procesuiran i usvojen iz razloga što je njegova implementacija očekivana par godina nakon njegovog usvajanja, tačnije rečeno je 2011. godine, i danas imamo istu odluku da će primena ovog Zakona biti od 2011. godine. Verujem da će ova Vlada učiniti napore i iznaći mogućnosti da omogući implementaciju usvojenih zakona što je moguće pre nakon njihovog usvajanja.

Dakle, Parlamentarana grupa „7+“, smatra da ovaj Zakon ispunjava uslove za jedan zakon ovakve prirode i u načelu ga podržava. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!
Tani kemi tre deputetë që kërkojnë të marrim pjesë në debat. Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!
Të nderuar të pranishëm,
Fillimisht më lejoni të deklarohej se në parim e mbështes këtë ligj, duke marrë parasysh natyrën e këtij ligji dhe duke i injoruar të gjitha ato që janë parregullsi përbërëse të këtij projektligji.

Po, megjithatë, do të ndalesha te aspekti financiar, gjithmonë duke pasur parasysh atë që na është servuar me këtë projektligj. Këtu i kemi dy skenarë, njëri është i përkrahjes

materiale, siç thuhet 100 euro, dhe skenari tjetër është 60 euro. Kështu, automatikisht, parashtrohet pyetja se në këta dy skenarë çka është marrë parasysh, gjithmonë duke marrë parasysh natyrën e individëve për të cilët bëhet ligji dhe kërkesat specifike që i kanë ata. Do me thënë, në këto 60 € a është marrë parasysh shërimi mjekësor, medikamentet, të cilat janë pjesë e jetës së tyre apo, thjeshtë, ekzistenca e tyre biologjike, domethënë, shporta e konsumit që i referohemi, që edhe ajo aty është pikëpyetje se a ju del.

Pastaj, nuk ka nëngrupe këtu, ngase te njerëzit apo individët e këtij rangu shoqëror ekzistojnë grupe të ndryshme. Bie fjala, fëmijët e prekur nga menxhinitisi kanë pasoja të papërmirësueshme në shumicën e rasteve, mjerisht, dhe kërkesat e tyre janë shumë më të mëdha. Pastaj, vjen në kundërshtim ky limiti i pjekurisë prej 1 deri në 18 vjet për shkak se e humb kuptimin aty, këta fëmijë mbesin fëmijë të përjetshëm, mendoj, në zhvillimin psikik.

Një tjetër gjë që do të doja ta diskutoja këtu, është gjuha, terminologjia që e përcjell secilin ligj, të mos të them, por shumicën e ligjeve. Siç po shihet, praktika e ligjbërësve është, që në momentin kur merret iniciativa për një ligj, ata të futen në internet, të shkarkojnë sa më shumë ligje dhe ato nga burimet anglosaksone, pastaj në gjuhën shqipe t'i adaptojnë aq sa të kenë mundësi për nevojat e Kosovës dhe këtu kemi një humbje në përkthim. Në anglishte thuhet: "Lost in translation" shumë gjëra për shkak të mosprofesionalitetit apo për shkak të mosnjohjes së gjuhës, humbin në përkthim në gjuhën shqipe, pastaj, ajo përpilohet në gjuhën shqipe dhe i dërgohet një përkthyesi, që në shumtën e rasteve është gjuhëtar, i cili terminologjinë nuk e ka familjare. Këtu, veç shihet se, pothuaj se të gjitha ligjet nga gjuha shqipe janë përkthyer nga i njëjti person në gjuhën angleze për shkak të gabimeve në strukturë të fjalive dhe të leksikut.

Shembull konkret: në gjuhën angleze me të plotë të drejtë këtu është përdorur fjala disabilities, domethënë që në gjuhën shqipe është i paaftë Pra, në ligje përdoret kjo terminologji, nga se kemi të bëjmë me personat, të cilët nuk janë të aftë ta mbikëqyrin vetveten, andaj kërkohet ndihmë, kujdestari, kërkohet mbikëqyrës për ta. Ligjëshkruesi këtu ka tentuar të bëhet politikisht korrekt me fjalët "personat me aftësi të kufizuara". Por, problemi është se ky term në leksikon, në vokabullarin e korrektësisë politike është i vjetruar tashmë, është zëvendësuar goxha me "limitet abilities" në "challenged persons", do me thënë "persona të sfiduar" dhe këtu mbetet ajo, do me thënë ligji mbetet as me "shehër as me Barilevë", as juridikisht e as politikisht korrekt.

Pastaj, i kemi fjalët "përkrahje materiale", që në gjuhën shqipe apriori është përkrahja financiare, por në gjuhën angleze, jo ka kuptime tjera, jo domosdoshmërisht ndihmën financiare, por për përkrahje financiare është dashur të përdoret financial assistance ose financial support.

Duke marrë parasysh atë se ligjet tona përfundimtare duhet të jenë në gjuhën angleze, po them, që tash të mos i hymë çdo termi, por nëse dëshirojmë të jemi politikisht korrekt, atëherë të jemi me trendet kontaparare të korrektësisë politike. Mendoj se ne deputetët duhet të jemi, të paktën, si shtazë tipike politike që jemi, mos të ngecemi nëse dëshirojmë... Më falni, fjala "shtazë politike" apo "kafshë politike" është term goxha i përdorur që i shpjegon, nuk e thashë me nënçmim, me gjithë respektin, po flas nga anglishtja, është "political animals" që i karakterizon personat të cilët politikën e kanë opsesion. Domethënë, nuk është fjalë për t'u qeshur, është fjalë goxha intelektuale që përdoret në vakubularin e leksikut politik. Nuk desha ta ofendoj askënd,

më falni, dhe nuk dua ta patronizoj askënd. Por, të mos e zgjas këtë mesele, më ngacmoi fjala që shpesh po e përdorim: “ me aftësi të kufizuara”, është term i viteve '80-ta apo '90-ta, nga ajo kohë veç përdoret termi, nëse dëshirojmë politikisht të jemi korrekt gjithmonë “ personat me aftësi të sfiduara, apo personat të aftë ndryshe “diffenthy eibell” që thuhet në gjuhën angleze. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet për sqarime. Tani fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar,
Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,

Fillimisht dëshiroj të shpreh kënaqësinë e veçantë që sot shqyrtojmë sërish Projektligjin nga mandati i kaluar, por që është i rëndësishë së veçantë dhe që ka një qasje të re, prandaj personalisht e konsideroj si ligj që është risi. Ky projektligj plotëson infrastrukturën ligjore në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare. Duke marrë parasysh gjendjen sociale, që është mjaftë e rëndë dhe e komplikuar, ne si shoqëri konsideroj se duhet t'u japim përparësi, sidomos atyre që janë më të cenuarit dhe më pak të mbështetur në shoqëri.

Fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre, prandaj kërkohet që vazhdimisht, pranë tyre dhe përhershëm të jenë personat të cilët do të kujdesen, realisht, 24 orë për ta, që domethënë këta persona as nuk mund të punësohen.

Deri me tani, situata në Kosovë ka qenë e tillë që, kryesisht, familjet janë përkujdesur për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme, domethënë se familjet është dashur të ballafaqohen jo vetëm me gjendjen e përkujdesjes së vazhdueshme, rritjes së këtyre fëmijëve, duke përfshirë, siç e tha zonja Hundozi, edhe gjendjen e tyre emocionale, por edhe me vështirësi të shumta materiale. Prandaj, Projektligji për përkrahje familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme është i domosdoshëm, sepse siguron bazën ligjore për përkrahje financiare familjeve. Me këtë, do të thotë, u zbutet barra familjeve dhe ju mundësohet fëmijëve që ta kenë një jetë më normale dhe më të dinjitetshme.

Projektligji është i qartë, kuptohet lehtë dhe parasheh mënyrat e dhënies së ndihmës, si dhe mekanizmat përgjegjës. Kjo do të thotë se në një mënyrë përmirëson edhe mekanizmat dhe praktikën e punës sociale nëpër qendrat e punës sociale dhe, gjithashtu, krijon kushte për zhvillimin e programeve sociale më të avancuara.

Kryesisht, ky projektligj trajton moshën prej 1 deri në 18 vjeç dhe siguron zgjidhje adekuate, të cilat janë në pajtim me standardet ndërkombëtare, por edhe me ligjet dhe parimet e legjisllacionit të Bashkësisë Evropiane. Si i tillë, ky ligj i plotëson kushtet për miratimin e tij, në parim. Megjithatë, dëshiroj të theksoj një sfidë me të cilin do të ballafaqohet vetë ligji. Vlerësohet se përafërsisht, 3000 fëmijë kanë nevojë për këtë përkrahje, që do të thotë 3000 familje kanë nevojë për ndihmë financiare. Është paraparë sipas Projektligjit që prej vitit 2007 deri në vitin 2009, domethënë në periudhën tri vjeçare, shpenzimet buxhetore mund të bëhen ose mund të jenë në një rast, në qoftë se bëhet pagesa mujore prej 100 eurove, diçka më shumë se 8 milion, dhe në qoftë se pagesa bëhet prej 60 eurove, do të jetë, përafërsisht, 5 milion. Prandaj, sfida është

lidhur me përballimin e kësaj shume që duhet ta bartë Buxheti i Kosovës. Mirëpo, përkundër kësaj, duke e ditur rëndësinë e veçantë që ka kjo përkrahje, ne duhet t'i bëjmë të gjitha përpjekjet dhe të gjenden të gjitha mundësitë që ligji të jetë i zbatueshëm plotësisht, prandaj unë e përkrah në parim dhe do ta votoj.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete! Tani fjalën e ka deputeti Armend Zemaj

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë do të ndalem prapë, ndoshta, do të ndërlihem me terminologjinë, me të vërtetë, nuk është e drejtë, nuk është humane, që në ditët e sotme të quhen “personat me aftësi të kufizuara”, por të quhen, ashtu siç e meritojnë: “persona me nevoja të veçanta”. Prandaj, kjo le të jetë edhe vërejtje për Komisionin, i cili duhet ta ketë parasysh, pas miratimit në parim, pasi që është i domosdoshëm. Ne më vonë e kemi edhe shqyrtimin e Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave, i cili prapë quhet “me aftësi të kufizuara.” Kjo terminologji duhet të ndërrohet dhe duhet të jetë: “persona me nevoja të veçanta”, sepse edhe ashtu e karakterizon “me nevoja të veçanta” e jo të kufizuara.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti i fundit për diskutim, është Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Ju faleminderit, Kryetar!

Në të vërtetë ky ligj është, jo vetëm për t'u përshëndetur, por edhe si ligjet paraprake që ishin lidhur me mjedisin, tregojnë se shoqëria jonë po përgatitet për të hyrë në një fazë ku do të përkujdeset për të gjitha aspektet e saj. Pa dashur të hyjë në polemika intelektuale këtu rreth asaj se a duhet të thuhet “kafshë politike” apo “qenie politike”, sepse ka interpretime të ndryshme, do të ndalem, kryesisht, te terminologjia, edhe pse nuk jam në Komisionin përkatës, dëshiroj ta jap një kontribut, që më duket se është, qëndron në shpërputhje.

Neni 2, alineja 1 e përcakton kështu: “Fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme fizike, mendore apo shqisore, konsiderohen fëmijët e moshës 1 deri në 18 vjeç”, ndërkaq në alinenë nr. 14 të të njëjtit nen thuhet: “me fëmijë nënkuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçare”. Pastaj është edhe një fjali e ndërruar, “me përjashtim kur mosha madhore arrihet më përpara.” Kjo, domethënë, është një kundërshtim me atë që thotë: “nga mosha 1 deri në moshën 18”, kurse këtu thotë: “deri në moshën 18,” që e inkludon edhe moshën njëvjeçare. Prandaj, do të ishte mirë që këtu të ketë një mundësi që të harmonizohen këto dy aline, që të mos ketë ndonjë kontradiktë dhe mundësi të interpretimeve të ndryshme.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!
Nuk kemi më të paraqitur për diskutim.

Vazhdojmë:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ftoj ministrin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë të Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin.

MAHIR YAGCILAR: I nderuari Kryetar,
Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që para jush të paraqes Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore. Të drejtat banesore dhe pronësore janë shumë komplekse në Kosovë. Krijimi i kushteve për rregullimin e tyre për të gjithë qytetarët e Kosovës, në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese në lidhje me banesat për të cilat është e themeluar e drejta banesore, mundësohet përmes këtij ligji.

Projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrën e shitjes së banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës, si dhe mënyrën e përcaktimit të çmimit shitës të banesës dhe shuarjen e të drejtës banesore.

Në Kosovë, banesat në pronësi, të ndërtuara nga ndërmarrjet shoqërore dhe institucionet publike me bashkëfinancimin e të punësuarve, janë dhënë në shfrytëzim në bazë të kontratës për shfrytëzimin e banesës, bartësve të të drejtës banesore, në bazë të Ligjit për marrëdhënie banesore të ish- Krahinës Autonome të Kosovës nga viti '83.

Sipas Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë, një numër i konsiderueshëm i bartësve të të drejtës banesore, respektivisht 70% e numrit të përgjithshëm të tyre, kanë realizuar të drejtën pronësore gjatë procesit të privatizimit të banesave deri në vitet 1999, ndërsa, përafërsisht, 30% prej tyre nuk kanë arritur ta realizojnë atë të drejtë, ose kanë qenë të privuar për shkak të largimit të dhunshëm nga puna.

Të nderuar deputetë,

Me miratimin e këtij ligji do t'u mundësohet blerja e banesave bartësve të të drejtës banesore dhe mbyllja e një procesi shumë të rëndësishëm shoqëror, i cili tanimë ka përfunduar pothuaj në të gjitha vendet e rajonit ish-vendet socialiste, të cilat janë ballafaquar me një problem plotësisht të njëjtë.

Projektligji ka ndarë në mënyrë të qartë kompetencat ndërmjet institucioneve për procedurën e shitjes dhe ka paraparë afatet. Po ashtu, në mënyrë të veçantë rregullon edhe mënyrën e shpërndarjes së mjeteve të realizuara nga shitja e banesave. Me këtë projektligj nuk trajtohen banesat e papërfunduara në pronësinë shoqërore, sepse është vlerësuar që kjo çështje duhet të rregullohet me ligj të veçantë, i cili do të krijojë mundësi për përfundimin e tyre, si dhe për kryerjen e kontrollit për përmbushjen e kërkesave të veçanta të Ligjit të ndërtimit.

Ky projektligj ka 7 kapituj dhe 47 nene. Shpresoj, se me vërejtjet dhe sugjerimet tuaja eventuale, ky projektligj do të kompletohet dhe do t'u shërbejë të gjithë atyre që kanë konteste banesore.

Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit, zoti ministër për prezantimin.
Hapi debatin për diskutim në parim.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, në legjislaturën e kaluar i ka kaluar pothuaj se të gjitha procedurat kuvendore, madje është bërë edhe amendimi i tij. Tash mbetet të vazhdohet procedura e re e miratimit.

Ligji është i nevojshëm pasi vlerësohet se në Kosovë ende e kemi një fond të konsiderueshëm të banesave, rreth 6000 sosh, të ndërtuara nga ish-ndërmarrjet shoqërore dhe publike, që kanë mbetur ende të pa privatizuara. Një numër i shfrytëzuesve të këtyre banesave, bartës të së drejtës banesore, për shkak të problemeve dhe pengesave nga ish-regjimi, nuk e kanë fituar të drejtën e blerjes apo të pronësisë në procesin e privatizimit deri në vitin 1999. Kjo ka ndodhur si pasojë e politikës diskriminuese apo e zbatimit të Ligjit serb për banim të vitit 1992, kur shumë banues të ligjshëm janë nxjerrë nga banesat e tyre apo janë privuar nga e drejta e blerjes, sepse ishin larguar dhunshëm nga puna.

Mjetet e fituara nga shitja e banesave, sipas këtij ligji, shkojnë në buxhetin shtetëror dhe në atë komunal në proporcionin 55 me 45, me kusht që ato mjete të shfrytëzohen për zgjidhjen e banimit për personat me status të benificuar. Mirëpo, me ligj nuk përcaktohet se kush, cili organ do t'i menaxhojë këto mjete dhe cila është mënyra për angazhimin e mjeteve të realizuara, sidomos kur dihet se me ligj nuk lejohet formimi i fondeve të posaçme. Duhet të theksojmë se ky ligj, ky projektligj është hartuar, duke iu referuar Ligjit për shitjen e banesave të Bosnjës dhe Hercegovinës. Një çështje mjaft komplekse është se kush ka të drejtë t'i shet banesat: komunat, Ministria, ish-ndërmarrjet apo dikush tjetër?

Duke pasur parasysh procedurën e mëparshme kuvendore të këtij ligji, si dhe nevojën që ka Kosova për këtë ligj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike pajtohet për miratimin e tij, në parim.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike. Për diskutim është paraqitur deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar,
Ministra,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore. Ky projektligj përcakton: mënyrën, rregullat dhe kriteret administrative për ato hapësira në të cilat ekziston e drejta banesore, duke e nxjerrë edhe çmimin e shitjes për banesë.

Projektligji në fjalë është shumë i rëndësishëm, pasi nga fondi i banesave të ndërtuara nga ndërmarrjet e mëparshme shoqërore dhe institucionet publike, ka një numër të banuesve, të cilët ende nuk e kanë fituar të drejtën e blerjes së këtyre banesave, deri në kohën, siç e cekën edhe më parë, domethënë deri në vitin 1999, për shkak të veprimeve diskriminuese të sistemit të atëhershëm të Serbisë. Prandaj, me këtë ligj u bëhet e mundur blerja e banesave bartësve të të drejtës banesore, të gjithë atyre që i kanë

banesat në shfrytëzim dhe në këtë mënyrë, në mënyrë ligjore kanë mundësi të bëhen pronarë të këtyre banesave të gjithë ata që kanë të themeluar këtë të drejtë.

Në këtë projektligj, mjaft qartë janë të përcaktuara e drejta për blerje të banesave dhe përjashtimi i të drejtës për blerje të banesave, nga kreu i dytë dhe i tretë. Në kreun e katërt të këtij projektligji janë përcaktuar kompetencat e institucioneve për caktimin e statusit të banesës, duke përfshirë: Qeverinë, ministritë, komunat, institucionet e bamirësisë e tjera. Në këtë projektligj janë përcaktuar forma dhe përmbajtja e kontratës. Ajo që për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, është e një rëndësie të veçantë ka të bëjë me çmimin dhe kriteret për caktimin e këtij çmimi për metër katror të banesës. Gjatë punës në komisione, do të japim kontributin tonë në përcaktimin e drejtë të kriterëve për të nxjerrë çmimin për metër katror të banesës e shumë çështje të tjera siç janë: përcaktimi i kriterit amortizues të banesës sipas rregulloreve që e përcaktojnë koeficientin e amortizimit, varësisht, nga vjetërsia e banesës ose e objektit, në mënyrë që ky projektligj, gjegjësisht ligj i cili pas miratimit dhe dekretimit, të jetë sa më i përshtatshëm për qytetarët, në mënyrë që banesat t'i blejnë me çmim adekuat. Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah këtë në parim.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Sipas radhës, fjalën do duhej ta kishte Grupi Parlamentar i AKR-së, kryetari Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Dua t'iu bashkëngjitëm parafolësve se Kosova ka pasur nevojë kaherë për një ligj të tillë dhe përkundër faktit se ligji nuk përcakton me saktësinë më të madhe edhe instrumentet, që do të duhej ta implementonin dhe mekanizmat e tjerë. Gjithnjë, kur kemi parash tashmë problemet që janë me pronësinë ose me të drejtën në pronësi të shumë prej banesave ose me pronësi të dyfishtë që kemi si rezultat i politikave diskriminuese të viteve të '90-ta, që deri tash kanë qenë, kryesisht, nën përgjegjësi të HABITAT-it dhe tash të Agjencisë Kosovare të Pronës ose për Prona dhe problemet me të cilat do të ballafaqohet gjatë implementimit të këtij ligji kanë të bëjnë, kryesisht, me përcaktimin ose me organin, i cili do ta vërtetojë të drejtën e pronarit të ligjshëm sa u përket këtyre banesave. Në të vërtetë, diku kemi rreth 5000 banesa, nga të cilat janë dëbuar shqiptarët gjatë viteve të '90-ta, të cilat tashmë kanë një pronar krejt tjetër. Në këtë pikëpamje ligji do të duhej të ketë qartësi më të mëdha në formën e implementimit. Po ashtu, në nenin që ka të bëjë me përjashtimin nga e drejta për blerjen e banesës, thuhet: "Banesat të cilat gjenden- është 15 – II, në ndërtesat administrative, të cilat shfrytëzohet për ushtrimet e veprimtarisë së administratës shtetërore", ju e dini që e kemi një numër të banesave që kanë pronarë të ligjshëm dhe që gjenden në ndërtesat administrative për të cilat duhet të kihet kujdes.

Në parim, Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet projektligjin në fjalë dhe do ta japë, pastaj, kontributin e vet në komisionet përkatëse.

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet këtë ligj në parim, dhe mendon se është ligj i mirë. Ky ligj nuk merret me përcaktimin se kujt i takon e drejta banesore, por vetëm krijon mekanizmin e shitjes të asaj banese, pasi që të jetë përcaktuar se kush është ligjërish në favor të blerjes, domethënë, ka një ndarje këtu. Pra, Mendoj se duhet të kalojë ligji.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, pas shqyrtimit të këtij projektligji, u morëm vesh që në parim ta mbështesim këtë projektligj dhe mendojmë se është i nevojshëm dhe i domosdoshëm nga fakti se ligji bëhet për shitjen e banesave në pronësi shoqërore, e që u është e njohur e drejta e banimit, me vendim të veçantë shfrytëzuesve aktual të banesave.

Ky ligj është i nevojshëm edhe për faktin tjetër për fazën e tranzicionit nëpër të cilin po kalon Kosova, ka të bëjë me shndërrimin e pronës shoqërore në pronë publike apo private. Ky ligj mundëson që ky proces të përfundojë në mënyrë sa më të suksesshme. Pra, sa më parë që ne do ta miratojmë dhe do ta bëjmë të aplikueshëm, procesi do të kryhet më shpejtë.

Unë do t'i jap dy vërejtje të vogla sa i përket çështjes së kërkesës për njohjen e investimeve të neni 21 ku nuk është e precizuar drejt dhe saktë. Në momentin, kur shfrytëzuesi aktual i banesës do ta paraqesë kërkesën për blerjen e banesës, ai paraprakisht, duhet ta paraqesë dhe një kërkesë me investime, por dhe këtu nuk është e precizuar saktë apo drejtë se në çfarë forme do t'u njihet e drejta e investimeve, pasi që duhet, ndoshta, të kemi një mbështetje me faturë, me një regjistër të veçantë apo kjo formë nuk është e precizuar. Sido që të jetë, do ta analizojmë më tepër dhe në komisionet funksionale do t'i japim vërejtjet tona.

Gjithashtu, vërejtja tjetër është te neni 36, ku mjetet e grumbulluara nga Fondi i shitjes së banesave ndahen në mënyrë proporcionale, domethënë, 55% në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës, ndërsa pjesa tjetër 45% për komuna. Ne mendojmë se kjo ndarje duhet të jetë në formën tjetër që 55% t'u ndahen komunave, pasi që kanë projekte të veçanta për skema sociale në komuna, ndërsa 45% të mbeten për Buxhetin e konsoliduar apo edhe do të jetë me një destinim që deri diku nuk është i precizuar drejt. Sido që të jetë, kontributin tonë do ta japim në komisionet përkatëse, me qëllimin më të mirë që ky ligj të jetë sa më i zbatueshëm.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit "7+", deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala predsedniče!

Evo, i mi se pridružujemo analizi ovog Nacrta zakona, koji po nama ima veliki značaj, s toga je potrebna malo bolja analiza, jer on reguliše vrlo osetljivo materiju. Na Kosovu,

kao što je poznato, nakon rata je došlo do nagle promene vlasništva stanova, pa svakako ima slučajeve gde se mogu pokretati dodatna prava i dodatni sporovi i tako dalje.

Mišljenja smo da treba malo više poraditi na dopuni dela koji govori o kupoprodajnim ugovorima, znači treba im pokloniti veću pažnju, kako se ne bi dala mogućnost takozvanih pravnih praznina ili rupa, kako to kažu pravnici. S toga, mi predlažemo da treba ostaviti i mogućnost kada se pojedini delovi gradova ili naselja posturbanizuju, tako da postoje neophodne potrebe društvenog, odnosno državnog otkupa ali i adekvatne ili tržišne nadoknade ili preseljenja stanara u takvim slučajevima. Treba sigurno koristiti slična iskustva drugih u ovoj oblasti, jer ćemo svakako doći u istoj ili sličnoj situaciji u daljem razvoju društva i države.

S toga, naša Parlamentarna Grupa će vrlo pažljivo dalje analizirati, u daljoj proceduri razmotriti odredbe ovog Nacrta zakona, i mi ga u načelu prihvatamo. Hvala lepo!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Për fjalë janë paraqitur edhe dy diskutues. Fjalën e ka deputeti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, nga AKR-ja, Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar,
Përshëndes ministrat e pranishëm,
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë iu bashkohem vërejtjeve që i dhanë parafolësit. Natyrisht, në parim e përkrah këtë ligj, i cili vjen, sigurisht, si shumica e ligjeve me mjaftë vonesë dhe ishalla nuk do të ketë vonesa në miratimin e këtyre ligjeve për t'iu ardhur në ndihmë institucioneve që të procedojnë me probleme të natyrave të ndryshme që janë grumbulluar në shoqërinë kosovare dhe në shtetin e ri të Kosovës.

Mendoj që, ajo që konsiderohet si vërejtje, është këtu që ligji përcakton vetëm procedurat e shitjes, por në Kosovë janë shumë çështje të kontestueshme nga aspekti i të drejtës së pronësisë në banesat, që dikur janë konsideruar si shoqërore - tash publike. Ne kemi një kompleks të tërë të banesave në lagjen e Universitetit të Prishtinës, që në fakt, në ndërkohë, domethënë me procedura jashtë administrative, pra të shtetit të Kosovës, dikush është bërë pronar i atyre banesave, një pjesë e të cilave ka qenë e papërfunduar akoma, por pronarët janë bërë jashtë Kosovës. Në ndërkohë, një pjesë e njerëzve jo shumë të ndërgjegjshëm janë paraqitur që t'i blejnë ato dhe i kanë blerë dhe kanë bërë tashmë kontratat e shitblerjes për ato banesa që janë në kuadër të një kompleksi, domethënë që është ndërtuar me qëllime, me destinime të qarta institucionale për Universitetin e Prishtinës.

Tash ky ligj paksa e komplikon këtu në disa nene, ku u jep të drejtën banuesve që janë aty, që të kenë, domethënë u jep të drejtën e blerjes së atyre banesave dhe një pjesë që nuk kanë pronarë, sepse kanë qenë të papërfunduara, e në to nuk janë futur ose shumë pak raste janë akomoduar punëtorë, punonjës të Universitetin e Prishtinës. Në shumtën e rasteve janë njerëz që kanë ardhur në formë të ndryshme dhe janë vendosur aty dhe Universiteti i Prishtinës ka ngritur një procedurë kontestimi të futjes së atyre njerëzve aty dhe lënda është në gjyq që disa vjet. Ligji duhet të ketë parasysh që këto kategori të njerëzve që kanë hyrë arbitrarisht dhe i kanë uzurpuar këto, të mos u sigurojë të drejtën që të jenë pjesëmarrës, domethënë me të drejtë, e mos të flasim me prioritet për blerjen e këtyre banesave. Kjo ishte vërejtja.

KRYETARI: Ju faleminderit deputet! Mendoj që Ardian Gjini e sqaroi se lënda e këtij ligji është e drejta për shitje, por nuk bën fjalë për drejtën kontestimore të banesave që janë në kontest. Prandaj, këtë duhet ta keni parasysh në diskutimet e ardhshme.

Ne radhë është deputetja Vezira Emrush!

VEZIRA EMRUŠ: Hvala! Ponovo pozdravljam Predsedništvo i sve svoje kolege poslanike,

Ja sam se javila ode u svoje ime i hoću da kažem da malo bolje analiziramo ovaj Zakon. Zašto? Zato što se radi o jednom posebnom zakonu koji reguliše svojinski status. Svojinski status kada znamo, čuli smo gospodina Ardijsana Gjinijsa da je rekao da će se prvo vlasništva, utvrdjivati nekim drugim zakonom i biće to pravno pitanje. Ali, ovde se daje u ovom zakonu mogućnost, gde se kaže da u slučaju kada je prodavac nepoznat, prenosi se vlasništvo prodaje na opštinu. Vidite, ovo je vlasništvo, ovo je stan. Ja mislim da ovaj zakon zadire u interese ostalih zajednica. Ovde nije definisano do koje godine se stambeni fod prodaje, sa kojim stanarskim pravom....

(Ndërhyn Kryetari i Kuvendit: Ju lutem, ju lutem nuk është lënda e pronësisë.

... sa kojim stanarskim prvom mora se u Zakonu definisati zato što ovde mi kršimo neka ljudska prava. Ako ljudi imaju stanarsko pravo i ako su na terenu, sada odsutni, kao što je slučaj sa mojom zajednicom, Goranskom zajednicom i ostalim zajednicama, i ako ima politikëu moć ova Skupština da oduzima nečije stanarsko pravo, onda računajte da ja ovu primedbu dala nisam. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Po, të jemi në rend të ditës dhe për ligjin përkatës. Për fjalë është paraqitur deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: I nderuari Kryetar, një pjesë të diskutimit e kam për atë temë që ku keni intervenuar, por unë e kam edhe një propozim.

E përkrah projektligjin që është në diskutim. Mendoj se është më në fund një angazhim për t'u ndihmuar atyre që janë të diskriminuar para luftës dhe nuk kanë pasur mundësi ta privatizojnë banesën për të cilën e kanë të drejtën banesore. Por, janë anashkaluar një numër i njerëzve që u është kthyer e drejta banesore. Nuk është fjala për ata që e kanë ende konteste, por është kthyer se HABITAT-i ka qenë i vetmi institucion pasa luftës që ka pasur të drejtën në këto raste kontestuese. Në shumë raste është kthyer e drejta banesore, me kusht, kurse atë kusht HABITATI nuk e ka definuar deri në fund, ka mbetur që njerëzit të mos i marrin vendimet, kurse faktikisht e kanë kthyer të drejtën banesore.

Pasi që HABITAT-i tash nuk funksionon, e kemi Agjencinë Kosovare të Pronës, e cila është pranë Ministrisë, por, me siguri, nuk ka mundësi të caktimit të vlerës së banesës. Ata punojnë në këtë drejtim dhe do ta bëjnë, por është problem se të gjithë këta që kanë humbur të drejtën banesore, a kanë pasur drejtë e blerjes që është mundësuar para luftës nga pushteti serb, tash po kërkojnë, jo rikthimin në rishqyrtim, por po kërkojnë pronën. Prandaj, unë mendoj se me këtë ligj duhet të theksohet a pranohen ato vendime të HABITAT-it, i cili ka punuar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut edhe t'u miratohet e drejta banesore atyre që ju është kthyer edhe të

merren këto që është në ligj, konkretisht, vlera e cila duhet të paguhet. Në qoftë se në këtë ligj mbetet pa u përmendur kjo, atëherë e kemi diskriminuar një numër të njerëzve. Së pari se kanë pasur të drejtë t'i blejnë banesat e nuk janë lejuar. Kanë mundur t'i blejnë me 200 deri 500 marka e tash duhet të paguajnë me mijëra euro. Por, diskriminim bëhet edhe ndaj atyre që kanë të drejtë për t'i blerë banesat. Prandaj, unë mendoj se afati prej dy vjetësh do ta kalojë, edhe do t'i marrin këta që kanë të drejtë, por ata që janë diskriminuar, mendoj se meritojnë që këtu me një nen të sqarohet pozita e sotme e tyre, pas pavarësisë, HABITAT-i, vendimet e tyre dhe e drejta e KPE-së a duhet vazhduar me pranimin e kërkesës për pronën, e cila është humbur me vendimin e HABITAT-it Prandaj, propozoj që të shqyrtohet mundësia të futet në kuadër të ligjit edhe ky numër i njerëzve, të cilët nuk kanë mundur t' i blejnë banesat.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Diskutuesi i radhës është Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Pa dashur ta zgjasë, unë këtu në njëfarë forme, Kryetari i Kuvendit e tha atë, por e tha po më duket shumë shkurt. Nuk është objekt i këtij ligji asnjë banesë që ka probleme kontestimore, respektivisht janë lëndë e kontestueshme nëpër gjyqe. Kryesisht, është fjala, për shfrytëzuesit e banesave që kanë të drejtën banesore në atë periudhë regjimi ua ka pamundësuar blerjen. Kryesisht, shumica e atij 30% të këtyre banesave që janë në pyetje, janë të Universitetit të Prishtinës. Njëri nga ata jam edhe unë, që në fakt, regjimi na ka diskriminuar, nuk na ka lejuar të drejtën e blerjes, por nuk jemi të kontestuar. Do me thënë nuk ka qenë e kontestuar e drejta e banesës, por na u ka pamundësuar blerja. Prandaj, unë mendoj se me këtë ligj, në mënyrën më të mirë, barazohen të gjithë qytetarët e Kosovës. Ndoshta, është ligji që vërtet i barazon të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët kanë pasur të drejtë të shfrytëzimit të banesave. Mendoj se, mu për atë është arsyshmëria më e madhe, mirëpo esenca qëndron që kur bëhen kalkulimet, ai diskriminim që u është bërë këtyre qytetarëve, shfrytëzuesve të banesave nga ai regjim, mos te përsëritet tash, që këta qytetarë, shfrytëzues të banesave t'i blejnë me çmime shumë të larta, por përafërsisht, t'ju jepet e drejta e barabartë sikur atyre që kanë mundësi t' blejnë, ndoshta, me pak para. Po ndërlihem këtu edhe me diskutim edhe të zonjës Kaqusha, sepse, si duket, edhe ajo është veç në frekuencat e njëjta.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit deputet! Tani, ju e dini që ka diskriminim, por diskriminimi është pozitiv. Radhën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti Kryetar,
Kolegë deputetë,

Unë do të flas shumë shkurt. Më lejoni vetëm të sforcojë atë që e tha, më duket zonja Rysha, sepse do të kemi mundësi që fjalën dhe mendimin tonë ta japim edhe më vonë, por këtu do të doja në një formë të lobimit, kushtimisht ta them. Posaçërisht, tek ajo që parashihet rreth ndarjes së përqindjes, mendoj që është shumë e padrejtë ajo që është propozuar 55-45 në favor të nivelit qendror. Kur e them këtë, e kam parasysh edhe një fakt që, në shumicën e rasteve investitor i atyre objekteve janë komunat dhe është e padrejtë që investitorit, kushtimisht t' i thuhet në rastet e tilla edhe t' i cungohet e

drejta që në buxhetin e tyre, në këtë rast e kam fjalën për komunat, të mos hyjnë shumica e atyre mjeteve nga shitjet eventuale.

Prandaj, jam për atë që, gjithsesi, minimumi të jetë 60 me 40%, në favor të komunave, me rastin e shitjes së tyre. Arsyet janë të shumta, sepse komunat janë ato që ofrojnë edhe shërbime përkatëse të natyrave të ndryshme. Por, në këtë rast, po e përsëris edhe njëherë ku është e qartë që investitor, eventualisht, mund të jetë ose është Qeveria, mund të ketë edhe këtu një ndarje të tillë, por në shumicën e rasteve e thashë atë që janë investitorë komunat dhe kjo përqindje në asnjë mënyrë nuk do të duhej të ishte çfarë figuron tash, por të jetë në favor të komunave.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Për një sqarim është paraqitur ministri Mahir Jagcilar.

MAHIR JAGCILAR: Edhe unë do mundohem të jem sa më i shkurtër. Ligji është pak më specifik, e ka afatin e vet, sepse me realizimin e ligjit nuk do të ketë nevojë për këtë ligj. Brenda dy vjetëve duhet të realizohet ky ligj, në qoftë se miratohet. Është specifik, sepse thuhet: "për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore". Për çështjet të tjera ky ligj nuk ka kompetenca. Shumë mirë e ka elaboruar deputeti i nderuar, zoti Berim Ramosaj. Gjithashtu ish-ministri, edhe kryetari i Parlamentit. Pra, ky ligj është për të gjithë qytetarët, të cilët kanë të drejtë, nuk ka elemente diskriminuese. Nuk është përpiluar për një komunitet ose për një bashkësi etnike. Ky ligj do të jetë për çdo qytetar të Kosovës, që deri me sot nuk ka rregulluar çështjen e blerjes së banesës, për të cilën ekziston e drejta banesore. Pra, këto janë sqarimet. Besoj që duke marrë parasysh edhe sugjerimet tuaja në Komision, ky do të jetë ligji i aplikueshëm.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!
Të shpresojmë se do të lexohen më me vëmendje ligjet dhe nuk do të ketë nevojë për sqarime shtesë. Deputeti i radhës është Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti Kryetar,
Me sa duket, kam problem me këtë farë aparati. U paraqita për të replikuar me zotin Hajdini, por tash çështja u amortizua dhe nuk do të doja që ta maltretoj Parlamentin. Kështu, zotin Hajdini do ta sfidoj intelektualisht në korridor për terminologjinë intelektuale.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Në korridor, jo, por këtu është vendi për ta sfiduar. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, Kryetar!
U paraqita për herë të dytë, sepse dua ta them një shqetësim timin. Po frikohem që ngutshëm, ka rrezik që të bëjmë diskriminimin e dyfishtë që qindra pronarëve të cilët janë diskriminuar në vitet e '90-ta për shkak të vendimeve politike.

KRYETARI: Ju lutem, zoti deputet, në të vërtetë, kjo është një lëndë krejt tjetër...

IBRAHIM MAKOLLI: Jo, Kryetar, nuk është tjetër. Po e përfundoj vetëm me këtë. Me këtë ligj po japim të drejtën që të shesin...

KRYETARI: Lexoje burrë titullin, e pastaj paraqitu, nëse nuk e ke lexuar tekstin, lexoje titullin.

IBRAHIM MAKOLLI: Me këtë ligj po u japim të drejtën të blejnë banesa edhe ata të cilët janë bërë pronarë me ligje diskriminuese pas vitit '92. Zoti kryetar, institucionet e Kosovës ...

KRYETARI: Nuk është tema e ligjit kjo, ju lutem!

IBRAHIM MAKOLLI: Është e njëjta, zoti Kryetar! Institucionet e Kosovës kanë deklaruar me dhjetëra herë se nuk do të njohin vendimet diskriminuese të regjimit të kaluar. Ju e dini shumë mirë se shumë punëtorëve shqiptarë u janë marrë banesat në vitin '92 –'93 dhe tash pronarët e ligjshëm janë të tjerët.

KRYETARI: Të lutem, lëndë tjetër është ajo.

IBRAHIM MAKOLLI: Nuk është lëndë tjetër Kryetar, sepse ju, këtyre njerëzve ua mundësoni t'i shesin banesat. Zoti kryetar, me këtë ligj ju mundësojmë njerëzve që t'i blejnë banesat që janë bërë pronarë të dhunshëm pas vitit '92. Ndërkaq, kemi banesa të cilat kanë dy pronësi dhe ky është problem që ju po e shkaktoni me ose pa dashje. Prandaj, po kërkoj që të jemi shumë të vëmendshëm sa i përket kësaj çështjeje. Jam i obliguar ta them këtë, sepse praktika do të tregojë se kam të drejtë. Ju faleminderit, Kryetar, për sqarime dhe sugjerime!

KRYETARI: Folësi i fundit, Bahri Hyseni,

BAHRI HYSENI: Po tërhiqem nga fjala, sepse e arsyetoi ministri.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Urdhëro, ministër Jagcilar!

MAHIR YAGCILAR: Te neni i dytë, jepet përkufizimi: “Bartës i së drejtës banesore është personi të cilit i ishte ndarë banesa, i ishte dhënë në shfrytëzim dhe i cili ka lidhur kontratë për shfrytëzimin e banesës, respektivisht personit të cilit i ishte ndarë banesa me vendim të ligjshëm gjyqësor, si dhe personit të cilit banesa i ishte dhënë në bazë të veprimt, vendimit të organit të autorizuar, në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet banesore, Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 11/83 edhe 29/86 dhe 44/86.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Ministër!
Të nderuar deputetë, po e ndërpresim seancën për ta vazhduar në orën 16,00.

(Vazhdimi i seancës pas pauzës)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën e pasdites, lidhur me votimin në parim të projektligjeve të shqyrtuara në pjesën e paradites.
Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 74 deputetë, andaj fillojmë me Projektligjin e parë.

- Miratimi në parim i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në

mjedis

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites, të deklarojnë për miratim në parim të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, asnjë votë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime sipas rregullës 35.6.

Me radhë është:

- Miratimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites, të deklarojnë për miratim në parim të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 46 vota “për”, 19 vota “kundër” dhe 9 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto Komisione:

1. Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Legjislacion dhe Bujqësi,
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në bazë të rregullës 35.6.

Në sallë janë 76 deputetë.

Tani, në radhë është:

- Miratimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites, të deklarohen për miratimin në parim të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota “për”, 9 vota “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin Raportin me rekomandime, në bazë të Rregullës 35.6.

Vazhdojmë me:

- **Miratimin në parim të Projektligjit për përkrahje materiale të familjeve me aftësi të kufizuara të përhershme.**

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites, të deklarohen për miratimin në parim të këtij Projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë votë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për përkrahjen materiale të familjeve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme.

Në bazë të rregullave 23.7, dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime, sipas Rregullës 35.6.

- **Miratimi në parim i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore**

Edhe njëherë po ua lexoj titullin e ligjit.

Miratimi në parim i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore.

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites, të deklarojnë për miratim në parim të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 10 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore.

Në bazë të rregullave 23.7, dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet e Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime, sipas Rregullës 35.6.

Të nderuar deputetë, i miratuar ligjet që i kemi lexuar sot në seancën e paradites dhe vazhdojmë seancën nesër, në orën 10,00.

Mirupafshim!

Më 29.02.2008

Vazhdimi i seances plenare

KRYETARI: Të nderuar deputetë dhe ministra të kabinetit qeveritar, mirëmengjesi!

Para se t’ia fillojmë punës, e kemi një kërkesë.

Administrata ka shpërndarë formularë për të dhëna personale dhe do të kishte qenë mirë që në fillim të javës së ardhshme t’i dorëzojë secili deputetë, natyrisht ata të cilët nuk i kanë dorëzuar.

Mirëserdhët në vazhdim të seancës së filluar 3 ditë më parë.

Konstatohet se të pranishëm në sallë janë 71 deputetë, andaj vazhdojmë me debat dhe shqyrtimin në parim.

Në radhë është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ushqimin.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij, në parim.

Ftoj ministrin Idriz Vehapi që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

IDRIZ VEHAPI: I nderuar, zoti Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i kornizës ligjore për parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me sigurinë e ushqimit dhe shëndetin publik, në përgjithësi, dhe arritja e objektivave të përgjithshme për një siguri më të madhe të qytetarëve të Kosovës që si konsumatorë të jenë plotësisht të sigurt sa i përket sigurisë së ushqimit.

Projektligji ka shtrirje në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, deponimit dhe distribuimit të ushqimit për njerëz dhe të ushqimit për kafshë. Pra, qëllimi kryesor i këtij projektligji është të siguroarit e qytetarëve të Republikës së Kosovës që ushqimi që prodhohet, përpunohet, importohet, tregtohet dhe konsumohet të jetë i sigurt për çka edhe do të kryhen mbikëqyrjet inspektuese me qëllim të evitimit të çfarëdo parregullsie lidhur me afarizmin me ushqim.

Ky projektligj parasheh mundësinë e themelimit të Agjencionit për ushqim dhe veterinar, ku do të hyjnë: Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës, i tanishëm; Inspektorati Sanitar; Inspektorati Fito-sanitar; pastaj Inspektorati i Pikave Kufitare të Kontrollit; inspektoratet komunale dhe e tërë kjo me një qëllim të vetëm - për një siguri më të madhe në ushqim e me këtë edhe ruajtja e shëndetit publik.

Projektligji për ushqimin ka një strukturë complete dhe përmbajtjesore të shtjelluar në 13 kapituj, me 51 nene.

Veç këtyre kapitujve, ky projektligj ka edhe aneksin e tij, në të cilin janë theksuar artikujt ushqimor dhe është përcaktuar kompetenca e inspektorëve se kush e çka duhet të kontrollojë.

Ky ligj është hartuar nga ekspertët e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe është mbështetur nga ekspertët ndërkombëtar dhe vendor - të angazhuar nga Organizata Botërore e Ushqimit.

Gjatë fazave të shqyrtimit të këtij projektligji janë kyçur institucione të ndryshme nga kjo lëmi, e sidomos: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Zyra ligjore e USAID-it.

Shpenzimet e tërësishme për zbatimin e këtij ligji për një vit do të ishin 1.146.600 euro. Mirëpo, me zbatimin e këtij ligji, Agjencioni i Ushqimit dhe i Veterinës, pa i llogaritur mjetet nga inkasimi i gjobave për mosrespektimin e këtij ligji, e në emër të taksave për licencim dhe kompensimeve të tjera, planifikon të gjenerojë mjete në shumë prej 4.000.000 euro në vit, të cilat do të derdheshin në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Edhe pse, në shikim të parë, mund të krijohet përshtypja se kostoja e zbatimit të këtij ligji, duke pasur parasysh kapacitetin buxhetor të Kosovës, është e lartë, megjithatë duhet vlerësuar edhe mundësinë reale të Agjencionit për gjenerimin e mjeteve buxhetore dhe derdhjen e tyre në buxhetin e Kosovës, e çka është edhe me rëndësi të veçantë se aprovimi dhe zbatimi i këtij ligji siguron qytetarët e Kosovës të konsumojnë ushqim të sigurt për çka, sidomos kohën e fundit, janë mjaft të shqetësuar.

Duke u nisur nga rëndësia e kontrollit të cilësisë së ushqimit, i propozoj Kuvendit që ta miratojë, në parim, këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zoti ministër! Në radhë të diskutimeve do të jenë kryetarët e komisioneve. Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë, ministra të Kabinetit qeveritar, Projektligji për ushqimin është një projektligj i cili është proceduar në seancë plenare gjatë mandatit të kaluar. Do të thotë, është një projektligj i cili në këtë Kuvend ka kaluar në leximin e parë. Historiku i këtij projektligji daton shumë herët, do të thotë, sepse kemi pasur seanca shumë maratonike, mirëpo edhe puna e Komisionit ka qenë një punë e cila duhet vlerësuar në mandatin e kaluar.

Mirëpo, në këtë seancë prapë debatohet për një gjë të tillë, për një materie e cila ka rëndësi kapitale në aspektin e rregullimit të sferës së sigurisë dhe të cilësisë së ushqimit.

Ajo çka do të duhej të adresohet me këtë rast nga ana e Komisionit, apo si shqetësim i Komisionit për Qeverinë dhe për Ministrinë përkatëse, është që në raport me këtë projektligj Qeveria duhet të qartësojë konceptin e vet të rregullimit të kësaj materie.

Kur flas kështu, e kam për bazë se, edhe pse në dukjen e parë, përmes këtij projekti krijohet përshtypje se Qeveria ka koncept të qartë për rregullimin e kësaj sfere, por kjo politikë duhet të përcillet në vazhdimësi. Pra, ta ketë një politikë konsistente në raport me këtë materie – në këtë sferë. Pra, të mos ndodhë, sikur në mandatin e kaluar, kur ka pasur dualizmi dhe konflikt në qasje ndaj kësaj sfere ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe qëndrimit të Kryeministrit. Domethënë, njëherë e përgjithmonë, kjo çështje duhet të sqarohet, prandaj për vetë faktin se është një materie shumë e rëndësishme dhe implikon shumë sektorë, Qeveria e Kosovës duhet ta qartësojë pozicionin e vet.

Ky ka qenë shqetësimi ynë që është përcjellë edhe në mandatin e kaluar, prandaj besoj se në këtë mandat nuk do të ndodhë një gjë e tillë.

Sa i përket këtij projektligji që tani po e shqyrtojmë në parim, është Projektligji i cili është i njëjtë dhe që është punuar nga Qeveria e kaluar. Kurse, të metat dhe ndoshta mangësitë e këtij projekti, edhe pse janë adresuar shumë qartë se implikon shumëçka, do të thotë shumë sfera, kurse në anën tjetër është projekt i cili nuk ka implikime financiare, dhe në anën tjetër edhe regjeneron mjete, pra ka anën pozitive në kontekstin financiar. Ajo çka duhet të theksohet është se me këtë projektligj përfundimisht Kosovës apo qytetarëve të Kosovës do t'i garantohet një qasje shumë më serioze dhe më e përgjegjshme e institucioneve dhe mekanizmave përkatës të rregullimit të kësaj sfere. Është një projekt që adreson obligime, adreson përgjegjësi dhe mbi këtë bazë edhe ne e mbështesim në parim dhe këtë mbështetje parimore njëkohësisht e jap edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zoti deputet! Sipas radhës, fjalën e ka Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, deputetja Teutë Hadri.

TEUTË HADRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për ushqimin ka qenë një ndër projektligjet më të diskutuara të Parlamentit të mandatit të kaluar në Komisionin e Shëndetësisë. Ky projektligj ka dalë në shqyrtim të

parë më 21. 11. 2005 dhe që atëherë, prej 2005-tës e deri më tani asnjëherë nuk ka qenë në gjendje të bëhet amendimi i ligjit dhe të bëhet edhe shqyrtimi i dytë.

Unë mendoj se Komisioni për Shëndetësi, vazhdimisht me punën e vet të palodhur, e ka dhënë kontributin e vet që Projektligji për ushqimin ta marrë destinimin e vet dhe t'i përket Ministrisë së Shëndetësisë, sepse është një ndër projektligjet më të rëndësishme që i përket jetës së qytetarëve tanë.

Të nderuar deputetë, në këtë projektligj ka qenë bërë fjalë për shëndetin e njerëzve më shumë se të shtazëve, prandaj ky projektligj, në mënyrë të padrejtë iu ka ndarë Ministrisë së Bujqësisë, për çka është bërë edhe diskutim dhe ka qenë temë e diskutueshme. Mirëpo, Komisioni i shëndetësisë ka organizuar vazhdimisht takime, debate publike dhe ka mbledhur të gjithë ekspertizën për ta shqyrtuar se kujt i përket ky projektligj. Mirëpo, në bazë të debateve të ekspertëve edhe të shërbimeve publike dhe Institutit Shëndetësor të Kosovës, është marrë një qëndrim se ky projektligj duhet t'i përkasë Ministrisë së Shëndetësisë. Por, edhe nga mosharmonizimi i punëve, që i kemi pasur në mes dy ministrive, të asaj të Bujqësisë dhe Shëndetësisë, është parë një neglizhencë e punëve dhe kemi vendosur që atëherë si Komision për t'u marrë një qëndrim që ky projektligj të kalojë në kuadër të Kryeministrisë për çka jemi pajtuar të gjithë si Komision dhe tani si Parti Demokratike e Kosovës pajtohemi që ky ligj të jetë në kuadër të Kryeministrisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete. Çështja e ushqimit, mendoj se është në rend të parë çështje e bujqësisë, pastaj edhe e shëndetësisë. Sigurisht se Qeveria do t'i ketë parasysh këto vërejtjet që po jepen. Në emër të LDK-së, fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Projektligji për ushqimin mundëson krijimin e infrastrukturës ligjore për ruajtjen e shëndetit publik në Kosovë. Projektligji është i përafërt me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare për ushqimin.

Qëllimi i Projektligji paraqet parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me higjienën, sigurinë e ushqimit, shëndetin e popullatës dhe ushqimin e sigurt për kafshët që do të mundësojë arritjen e objektivave të përgjithshme për një siguri më të madhe të qytetarëve të Kosovës, që si konsumatorë të jenë plotësisht të sigurt sa i përket sigurisë së ushqimit duke filluar prej fazës së prodhimit, përpunimit, importimit, tregtimit dhe konsumimit.

Projektligji bazohet në pronën private dhe ekonominë e tregut të lirë e në këtë kontekst parasheh mundësinë e themelimit të Agjencionit për Ushqim, ku do të hynë inspektorët sanitarë të Kosovës, inspektorët fito-sanitarë, veterinarë, sanitarët kufitarë si dhe inspektorët komunal.

Projektligji për ushqimin është i strukturuar mirë dhe është përmbajtjesor, në 13 kapituj dhe 51 nene, rregullon dispozitat e përgjithshme në lidhje me ushqimin, përcakton parimet e përgjithshme të analizës së rrezikut, duke u bazuar në parimet shkencore, rregullon kushtet e përgjithshme dhe specifike të higjienës së ushqimit, përgjegjësinë e subjekteve, kërkesat dhe hulumtimin e ushqimit, e po ashtu rregullon mënyrën dhe metodat e punës për secilën analizë që bëhet për kontrollin zyrtar të ushqimit të sigurt,

veçanërisht cilësisë së ushqimit në laboratorët e autorizuar për testim dhe laboratorët referentë.

Agjencioni i ushqimit me këtë ligj do të rregullojë organet drejtuese, këshillëdhënëse dhe mbikëqyrëse të agjencionit.

Zbatimi i këtij projektligji nuk paraqet implikime financiare, pasi që organet e parapara të themelohen, tashmë ekzistojnë.

Agjencioni për ushqimin krijon të hyra vetjake që derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Meqenëse me këtë projektligj do të rregullohet themelimi i Agjencionit të ushqimit, konsideroj se ky agjencion duhet të jetë nën mbikëqyrjen qeveritare për shkak të rëndësisë që ka ushqimi për shëndetin publik të qytetarëve të Kosovës, si dhe praktikat e drejta tregtare të ushqimit.

E shoh të arsyeshme të theksoj se në procedurat e mëtutjeshme të përpunimit të këtij projektligji duhet harmonizuar amendamentet e dy komisioneve për të cilat është punuar shumë në këtë drejtim dhe kontributin maksimal profesional e ka dhënë Komisioni për Shëndetësi në mandatin e kaluar. Do të thotë, Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të japë kontributin e tij dhe të bashkëpunohet me qëllim të kompletimit të këtij ligji, sepse amendamentet janë të gatshme dhe të përfitojmë një ligj të mirë për qytetarët dhe në interes të të gjithëve në Kosovë.

Ne do ta japim kontributin tonë edhe më tej për ta përfunduar dhe definuar mirë këtë ligj, prandaj Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Arsim Rexhepi.

ARSIM REXHEPI: I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar ministra, kolegë dhe kolege deputetë,

Fillimisht do të duhej ta analizojmë pak periudhën e pasluftës ku shoqëria e Kosovës i është nënshtruar një invazioni të mallrave nga të gjitha anët e botës, për të cilat ne nuk kemi as idenë se kah vijnë, si vijnë, çfarë cilësie kanë dhe si shërbehen e ruhen ato. Jemi dëshmitarë se tash, pas luftës, numri dhe cilësia e sëmundjeve me të cilat ballafaqohet populli i Kosovës ndryshon dukshëm nga numri dhe cilësia e atyre sëmundjeve që ky popull i ka takuar para luftës. Kjo edhe për faktin se këtij populli, në mënyrën më të paskrupultë nga afaristë të papërgjegjshëm i është ofruar dhe servuar ushqim i çfarëdollojshëm.

Një ndër defektet e politikave të derisotme, padyshim është edhe mos aprovimi, mos hartimi i një ligj që do të duhej dhe do të kishte për bazë organizimin e kësaj fushe.

Nuk do të ishte skandaloze t'i kujtoja kolegët deputetë këtu për pulat që kanë ardhur prej Belgjike dhe janë shitur shumë lirë, për bananet që kanë ardhur të modifikuara gjenetikisht dhe iu kanë servuar këtij populli, për mishrat antike që janë servuar tani dhe sinqerisht 20 a 30 vjet të vjetër mishi i servohet këtij populli. Ky është një terror, kjo

është një masakër që bëhet me një popull të pambrojtur. Kryetari po qeshë, por është shumë e vërtetë.

KRYETARI: Jo, ju lutem! Jemi duke debatuar për ligjin, në parim.

ARSIM REXHEPI: Po, po – pikërisht për ligjin po flasim. Po flasim në parim për politikat joparimore që janë bërë deri sot. Ju lutem!

KRYETARI: Ne po flasim për ligjin dhe për të ardhmen. Çfarë ka ndodhur, ne e dimë, edhe unë e di. Ju lutem, t'i përmbahemi debatit për ligjin.

ARSIM REXHEPI: Po, zoti Kryetar! Po, por baza për të folur për të ardhmen është e kaluara shumë destruktive që e ka lënë këtë popull në harresë dhe fëmijët tuaj dhe të mijë kanë hëngër ushqime për origjinën, përbërjen dhe cilësinë e të cilave nuk e dimë as unë as ti dhe kjo nuk është për t'u nënçmuar. Këtu është muhabeti.

Për interesa shumë mesquine, ne të gjithë që kemi qenë jashtë këtij Parlamenti, për interesa shumë mesquine të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Bujqësisë ka mbetur ky ligj pa u bërë para dy vitesh. Dhe, pse? Sepse, ka njerëz këtu që nuk e kanë hedhur vështrimin përtej regjionit për të parë se në botën e civilizuar ekziston ministria për mbrojtjen e konsumatorit. Dhe sikur të kishte ekzistuar kjo ministri, të cilën ne, në emër të Grupit tonë Parlamentar ia propozojmë këtij Kuvendi dhe Qeverisë që ta shqyrtojë, ta ketë në mendje themelimin e saj e që është po aq e rëndësishme sa edhe shumë ministri tjera, në mos më e rëndësishmja, sikur të ekzistonte një ministri e tillë, atëherë kishte për të pasur zonën e ... Do ta kryej, Kryetar, s'do ta zgjas shumë.

Dhe, e fundit çka desha të them, është se kjo është një kopje, një përkthim i dobët i një ligji nga shtetet që prodhojnë ushqim. Kosova është shtet importues, Kosova s'prodhon send dhe pikërisht te importet, aty ku ne do të duhej ta kemi një filtër shumë rigoroz se çka hyn në Kosovë, ky ligj nuk parasheh dhe nuk sanksionon si duhet kontrollet që duhet të jenë të shtuara dhe të forta të atyre mallrave që vijnë në Kosovë.

Andaj, ne, si Grup Parlamentar, po e përkrahim në parim. Vërejtjet tona do t'i kanalizojmë përmes aktiviteteve të Komisionit dhe do t'i propozojmë Qeverisë disa amendamente që do t'i bëjmë së shpejti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! E kam një lutje për deputetët. Debatin në parim për ligjet po e shndërrojnë në debat politik. Nëse vërtet janë të gatshëm të bëjnë debat politik, le të bëjnë kërkesa dhe ne do të organizojmë seanca për debate të tilla. Prandaj, kisha lutur që debatet të bëhet në parim për ligjin që e keni përpara dhe që e keni lexuar.

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti Kryetar,

Zotëri ministra,

Deputetë të nderuar,

Projektligj për ushqimin në mandatin e kaluar të këtij Kuvendi ka kaluar dëgjimin e parë, por edhe është amenduar nga Komisioni për Bujqësi dhe ekspertë ndërkombëtarë kanë marrë pjesë në amendimin e këtij ligji.

Për hir të rëndësisë dhe të ndikimit që ka ushqimi në shëndetin e njeriut dhe në paraqitjen e sëmundjeve që kanë lidhje me stilin e jetës, Komisioni për Shëndetësi ka vendosur që të marrë pjesë në amendimin e këtij projektligji gjë që e ka bërë, mirëpo kemi hasur në mosmarrëveshje me Komisionin për Bujqësi për çështjen se kujt do t'i takojë Agjencioni për ushqim. Kjo është arsye e vetme pse ky projektligj nuk ka kaluar në leximin e dytë. Përndryshe, amendamentet janë gati. Komisioni i këtij mandati i ka amendamentet e gatshme, do t'i mbetet vetëm Qeverisë ndoshta që ta bëjë një planifikim në të ardhmen dhe ta krijojë një ministri për ushqim dhe agrobiznes dhe që ta ketë nën ombrellën e vet kontrollin e tërë tregut të Kosovës, sa i përket ushqimit.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, mu për shkak të rëndësisë që ka ky projektligj dhe të një rëndësie që është e domosdoshme, në realitet kontrolli i ushqimit në tregun Kosovar, e përkrah këtë projektligj jo vetëm në parim, por edhe ato amendamente që kanë kaluar sepse ato janë amendamente shumë të mira dhe se ekspertët ndërkombëtarë janë paguar në një shumë të konsiderueshme të parave për të ndihmuar amendimin e këtij ligji. Prandaj, ne e përkrahim në parim dhe do të japim kontributin tonë nëpërmjet anëtarëve tanë që janë në Komisionin për bujqësi dhe Shëndetësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete. Në emër të Grupit të LDD-së, Lulzimi e tha fjalën e vet. Tani është në radhë Grupi Parlamentar "7+", deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala Predsedniče! Ovo što su govorili prethodni poslanici, kolege koji su bili u prethodnom mandatu u komisijama za zdravstvo i za poljoprivredu, zaista je tako. Ovaj zakon je prošao prvo čitanje i bio je pripremljen i za drugo čitanje jer su radjeni i amandmani. Zastoj je bio jedino kod poglavlja XI, gde se formira Kosovska agencija za hranu i veterinu i ova agencija je bilo predviđeno da bude kao Agencija za hranu i veterinu, kao izvršna agencija u okviru Ministarstva poljoprivrede. Komisija za zdravstvo je imala svoje primedbe jer je insistirala da ta komisija bude u okviru Ministarstva zdravlja. Bilo je više debata. Bilo je više javnih debata i na kraju je i Vlada donela svoje mišljenje pa je predložila da ova agencija bude u okviru Vlade, odnosno u okviru Kancelarije premijera. Da ne bude znači ni tamo – ni tamo, nego da bude u okviru Kancelarije premijera da bi se izbeglo neslaganje. Medjutim, bio je kraj mandata i nije se završilo sa ovim.

Ovde je pitanje da oba ministarstva, ponovo Ministarstvo zdravlja i Ministarstvo poljoprivrede nadju jedan zajednički jezik i da predlože da se izbegnu ovi konflikti. Oni koji pripadaju zdravstvu, treba sanitarni inspektorat da pripadne ministarstvu odnosno ovoj agenciji koja je pod kontrolom Ministarstva poljoprivrede, a sanitarni inspektorat zaista se bavi isključivo nadgledanjem hrane koja se skoristi, i koja je već gotovi proizvod. Znači, postoji razlika hrane koja je na njivama i hrane koja se servira i koja je više deo zaštite zdravlja čoveka. Znači, tu je taj problem koji je nastao. Komisija, na čijem sam čelu, a i Parlamenarna grupa, tada „6+“, a sada „7+“ je podržala ovaj nacrt zakona još u prošlom mandatu, podržaće ga i sada, ali želimo tu jasnoću oko agencije koja je bila prepreka na putu da se ovaj zakon usvoji.

Ukoliko ta prepreka bude prevaziđjena, amandmani su gotovi, i mi nećemo imati problema da ovaj zakon stigne pred Parlamentom. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka ministri i Shëndetësisë, zoti Alush Gashi.

ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Për ne të gjithë ky është një prej ligjeve shumë të rëndësishëm për vendin tonë dhe për të cilin ligj ky Kuvend ka punuar me shumë përkushtim për një kohë të gjatë. Ka shpreh gatishmëri dhe ka demonstruar një nivel të lartë të profesionalizmit në Komisionin funksional të Bujqësisë dhe po ashtu edhe në atë të Shëndetësisë. E kemi miratuar në parim. Ka filluar debati. Janë përgatitur amendamentet dhe këtu, në këtë Kuvend, është zhvilluar një debat shumë përmbajtjesor lidhur me atë se sa e pavarur duhet të jetë agjencia e cila merret me këtë çështje dhe nga të gjitha grupet ka qenë një demonstrim i vullnetit shumë të mirë që të kalohet në një nivel më të lartë të organizimit të pavarësisë së agjencioneve të vendit tonë. Dhe, debati është intensifikuar kur dëshira që ky ligj të zbatohet nën kontrollin e njëjës apo tjetrës ministri, ka ardhur në atë nivel, sa këtu nuk ka pasur vota të mjaftueshme. Pas riorganizimit të debateve, në grupe parlamentare, në Komision funksional për Bujqësi dhe të Shëndetësisë në debate publike, është rritur presioni nga seanca plenare që ky ligj të vjen për votim në leximin e dytë dhe para ardhjes në leximin e dytë Qeveria e ka parë të rrugës, në atë kohë, që ta bëjë një zgjidhje ligjore që ky agjencion t'i përgjigjet Zyrës së Kryeministrit.

Këto ditë, në bashkëpunim shumë intensiv me ministrin e Bujqësisë, ne jemi të vetëdijshëm se Kuvendi do ta gjejë mënyrën e pavarësisë të agjencioneve të vendit tonë dhe agjencionet e vendit tonë të mos jenë dorë e shtrirë e ministrit. Për shembull, Agjencioni Kosovar i Produkteve Meidicinale i përgjigjet ministrit të Shëndetësisë. Kjo është një ndërhyrje shumë e madhe që mund ta bëjë ministri në këtë veprimtari. Të njëjtën gjë do ta bënte edhe në ushqim, prandaj unë angazhohem para këtij Kuvendi që, në këtë fazë, ta pranojë rekomandimin që ne ta kalojmë ligjin dhe të jetë i lidhur me Kryeministri deri sa ky Kuvend të bëjë zgjidhje parimore për pavarësinë e agjencioneve.

Unë, si deputet, jam i bindur që agjencionet duhet t'i përgjigjen në mënyrë periodike Kuvendit, jo ministrit apo ministrit, sepse nuk është e garantuar ajo pavarësi.

Andaj, shpresoj se ky ligj, i cili është i përgatitur, sot do të kalojë në parim dhe lus Kryetarin e Kuvendit që t'i japë prioritet për leximin e dytë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Unë kam një kërkesë. Do t'ua jap fjalën të gjithëve, por kisha lutur që debatet dhe diskutimet të jenë në përputhje me rendin e ditës. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit zoti Kryetar!

Do të mundohem të jem sa më i shkurtër, sepse po shihet që gjërat ndoshta po përsëriten.

Së pari, unë jam deputet i ri, por është për të ardhur keq se si ky ligj është përcjellë prej një ministrie në një ministri dhe nuk ka gjetur përkrahjen e duhur, duke marrë parasysh se çfarë rëndësie të veçantë ka pasur për qytetarët e Kosovës. Këtë e them, sepse ndoshta është pak i vonuar. Nga ajo që ne kemi mund ta vërejmë edhe në përditshmëri, qytetarët e Kosovës kanë konsumuar produkte të servuara, të cilat kanë qenë të pakontrolluara, me përmbajtje ndoshta të tepëra të aditiveve, toksinave dhe disa substancave kancerogjene. Mua më vjen shumë keq kur dëgjoj nga ata ish qeveritarë se si e kanë përcjellë kush ku ta kontrollojë e kush ku ta ketë kompetencën, ndërsa vetë janë ushqyer me atë ushqim të pakontrolluar, apo kanë ngrënë ndoshta në ndonjë vend jashtë Kosovës.

Unë, të nderuar deputetë, kam edhe këtu disa vërejtje në përkufizimin e ushqimeve, e cila jepet edhe tash në këtë ligj, nuk është i ndarë ushqim dhe pijet. Ato janë të dyja të bashkëngjitura. Mesa dihet, pijet janë lëndë e parë ushqimore, nuk janë ushqim dhe kjo le të jetë vërejtje për komisionin funksional dhe nenet janë me fjali shumë të përsëritura. Po të lexohet me vëmendje, prej nenit në nen do të gjejmë shumë fjali të përsëritura. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Respekt, zotëri Kryetar!

Kabinet dhe deputetë të nderuar,

Ky ligj, s'ka dyshim se është një ndër ligjet më të rëndësishme për jetën e qytetarit të Kosovës, siç tha zotëri Rexhepi – totalisht deri më tani të pambrojtur, të nëpërkëmbur e të rrezikuar. Përpos atyre se ka me të vërtetë defekte gjuhësore e tjera, e tjera, unë do të isha ndalur së pari te neni 45. Ju lutem, thuhet “Këshilli shkencor”. Ne e dimë fare mirë se e kemi Universitetin publik që, gati po i bën pesë dekada dhe ka defekte sa i përket këshillit shkencor të fakultetit të caktuar, domethënë ka kërkesa rigorozë për të pasur këshill shkencor të mirëfilltë. Pikëpyetje e madhe do të ishte që të ketë këshill shkencor, po e zëmë, në kuadrin e cilësdo ministri. Do të kisha propozuar që të quhet institut. Ju lutem! Sepse, zakonisht, aty do të punonin specialistët. Diçka më pak se sa shkencëtarë, por diçka më shumë se profesionalistë. Kjo është një, por nuk përjashtohet mundësia që të kërkohen mendime, po e zëmë, nga fakultetet, sepse edhe kushton ekstra.

Kisha propozuar që nenin 47 ta riformulojmë, jo “dispozita ndëshkimore” sepse tingëllon disi apriori “ndëshkimore”, po “dispozita kundërvajtëse”. Dhe, ju lutem, këtu thuhet “gjykata”, nuk precizohet e cila gjykatë. Në praktikë mund të na paraqiten dilema: a kjo gjykatë, a ajo gjykatë. Pritet se gjykatat kundërvajtëse do të suprimohen, po flas sipas gjuhës së terminologjisë së Bashkimit Evropian, se nuk ekzistojnë këto gjykata, ato do të inkorporoheshin në gjykata themelore. Gjykatat kanë shumë lëndë dhe janë krejtësisht inefikase. Nuk mund të presim për një kohë të gjatë që këto do të bëhen eficiente. Prandaj, këtë çështje e kisha adresuar në procedurën administrative. Inspektori, ju lutem, i ministrisë, ai apo ajo, duhet ta konstatonte, po e zëmë, kundërvajtjen dhe do ta caktonte masën kundërvajtëse. Natyrisht, pala e pakënaqur do të kishte të drejtë ankese në ministri, po e zëmë, në shkallën e dytë, nga aty në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ky është institut juridik që quhet procedurë adminisitrative gjyqësore. Aplikohet në shtetet moderne në Gjermani, në Austri e kështu me radhë. Do të ishte shumë më efikas.

Dhe, e treta, ju lutem, kudo që thuhet “duhet”, “duhet” duhet të sanksionohet, sepse nuk ka dispozitë juridike pa dispozicion dhe pa sanksion. Dispozicioni është kur thuhet duhet, këtë, këtë, këtë. Nëse nuk ka sanksion, nuk është dispozitë juridike. Ka shumë dispozita në këtë ligj që nuk janë sanksionuar. Nëse nuk i sanksionojmë, ne ligjin e miratojmë, por nuk do të aplikohet, kurse jemi të interesuar që të aplikohet. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka anëtari i Kryesisë, Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I gjithë debati sot ishte në kuadër të debatit për shqyrtimin në parim të këtij projektligji. Esenca ka qenë dhe mbetet këtu: kush ta kontrollojë Agjencionin Kosovar të Ushqimit dhe të Veterinarisë? Ky ka qenë problemi. Ky ka qenë problemi që e ka mbajtur këtë ligj peng të mos kalojë në leximin e dytë në mandatin e kaluar.

Më lejoni të përshëndes fjalën e ministrit Alush Gashi, që në emër të Ministrisë së Shëndetësisë heq dorë nga pretendimi që kjo Ministri ta mbikëqyrë, ta themelojë Agjencionin Kosovar të Ushqimit dhe të Veterinarisë. Por, në fjalën e tij ai kërkoi që edhe Ministria e Bujqësisë ta bëjë të njëjtin veprim.

Ky ligj, i nderuar zoti Kryetar, mund të miratohet që në seancën e ardhshme. Vetëm neni 36 i këtij ligji duhet të ndryshojë me amendim dhe të miratohet në Kuvend. Pra, ligji është i gatshëm. Problemi dhe esenca, të nderuar deputetë, kanë qenë kush t'i kontrollojë paratë. Ky ka qenë problemi, sepse janë qindra milionë euro mallra që vijnë nga importi dhe normalisht në atë agjencion ka mundësi edhe për ryshfete, edhe për para të mëdha, edhe për t'iu lejuar dikujt importi i mishit nga Brazili, përkundër vlerës së ryshfetit e tjera, e tjera. Pra, esenca ka qenë kush t'i kontrollojë paratë.

E përshëndes edhe një herë fjalën e ministrit dhe, ju lutem, të kalojë ky agjencion për momentin në kuadër të Qeverisë dhe problemi të zgjidhet dhe në seancën e ardhshme ky ligj të kalojë. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Është e vërtetë që është debatuar shumë se nën kompetenca të kujt duhet të jetë Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit i Kosovës dhe ka pasur polemika gati deri në skandale në mes dy ministrive të mandatit të kaluar. Dhe, më së shumti është dëmtuar qytetari i Kosovës, konsumatori i rëndomtë.

Zotëri ministër i Shëndetësisë, unë pajtohem me propozimin tuaj që agjencionet e tilla, me një rëndësi të veçantë dhe që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin e qytetarit të Republikës së Kosovës, duhet t'i japin llogari Kuvendit të Kosovës. Unë nuk kam dëgjuar asnjëherë nga asnjë vend në regjion që jemi në ecje të përbashkët edhe të përmbushjes së kriterëve dhe të përafrimit të ligjeve të Kosovës me legjislacionin evropian, që Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit i përgjigjet Zyrës së Kryeministrit. Dhe, kërkoj një qasje serioze institucionale nga ekzekutivi i vendit.

Ju lutem, Agjencioni i Veterinës dhe i Ushqimit i Kosovës, në kushte normale duhet të jetë nën kontrollin dhe t'i japë llogari Ministrisë së Bujqësisë. Në disa vende kjo quhet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit. Në Slloveni, për shembull, i jep llogari Ministrisë së Shëndetësisë.

Që të hiqen të gjitha konfuzionet, unë në parim do ta përkrah këtë ligj shumë të rëndësishëm dhe ne duhet, si deputetë, por edhe si qytetarë, edhe si njerëz të segmenteve të caktuara profesionale – t'i japim mbështetje këtij ligji, në mënyrë që të përmbushet vakumi ligjor që e ka karakterizuar këtë sektor tejte të rëndësishëm për Kosovën.

Edhe një gjë. Laboratorët e biosigurisë, që e kontrollojnë cilësinë e ushqimit, janë nën kompetencat e Agjencionit të Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës dhe, normalisht, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, do të thotë, që ndërlidhet korrelacioni tani me Ministrinë e Shëndetësisë.

Unë kërkoj që, në procedimin e mëtutjeshëm të këtij ligji, të jemi shumë serioz, edhe ekspertët të cilët kanë marrë pjesë në hartimin e këtij ligji, që të caktohet një korrelacion, një hierarki shtetërore në mes të Agjencionit të Veterinës dhe Ushqimit, Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, doganave dhe inspeksioneve gjegjëse në nivelin komunal. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Këtu qenkan edhe dy deputetë, të cilët kanë folë më parë, si për shembull Lulzim Zeneli dhe Sadik Idriz. Urdhëroni zoti Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar! Do të jam shumë i shkurtër, dhe me vetëm një ndërhyrje në aspektin e asaj që ndjejmë si përgjegjësi edhe në emër të Komisionit, por edhe përgjegjësi politike, si deputetë.

Përsëritës dhe janë në përkrahje të plotë të të gjitha diskutimeve, sidomos të deputetëve, të cilët japin kontributin në këtë plan. Mirëpo, një gjë duhet sqaruar. Unë, në fjalën e parë, Qeveria e Kosovës duhet ta ketë konceptin e qartë. Si pretendon ta rregullojë këtë sferë? Nuk ka mundësi që kjo sferë të rregullohet në mënyrë spontane, pa e pasur një vizion të qartë për këtë segment shumë të rëndësishëm.

Nëse koncepti i Qeverisë së Kosovës është i tillë, që kjo sferë të rregullohet në kuadër të një agjencioni të pavarur, i cili do të kontrollohej prej Kuvendit të Kosovës, këtë duhet thënë. Mirëpo, ajo çka është, për mua, tendencioze është se, në qoftë se një draftprojekt vjen prej Qeverisë së Kosovës me nënshkrimin e Kryeministrit të Kosovës dhe në këtë draftprojektligj figuron që Agjencioni i Veterinës dhe i Ushqimit do të veprojë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë dhe, në anën tjetër, nuk e kemi këtë koncept të qartësuar brenda vetë Qeverisë, atëherë është diçka që ka luhatje, nuk është kah peshon.

Ne si deputetë, e ndjejmë për obligim të themi që, së pari Qeveria e Kosovës ta qartësojë konceptin e vet për rregullimin e kësaj sfere. Kjo do ta lehtësojë punën edhe të komisionit funksional, do t'i largojë të gjitha dilemat të cilat mund të rrjedhin në proces, sidomos gjatë procedurës së amendimit.

Zoti Maloku, preku një çështje shumë të ndjeshme. Për neve, është jorelevante...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, le t'i vazhdohet koha edhe pak!

LULZIM ZENELI: Faleminderit zoti Kryetar! Për komisionin funksional është jorelevante se në kuadër të kujt do të funksionojë. Për ne është relevante që të jetë funksionale kjo sferë, të funksionojë me përgjegjshmëri të plotë. Mirëpo, kjo çështje së pari duhet të qartësohet në kuadër të Kabinetit qeveritar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Deputet. Sadik Idriz e ka fjalën.

SADIK IDRIZ: Predsedniče, ja ću kratko. Samo da kažem da je Ministarstvo zdravlja i u prethodnom mandatu imalo isti stav koji je danas... Gospodine Maloku, Ministarstvo zdravlja je i u prethodnom mandatu imalo isti stav koji danas izneo ministar Alush Gashi, aktuelno. Jer, znači, ni mi nismo insistirali da agencija bude u okviru Ministarstva zdravlja, ali smo imali otpor od strane Sanitarnog inspektorata koji nije hteo da se uključi i da bude u sastavu Ministarstva poljoprivrede. Jer i Institut za nacionalno zdravstvo je

takodje insistiralo da ova agencija bude barem nezavisna, da ne potpadne pod Ministarstvo za poljoprivredu. Imali smo, sa druge strane, moram da priznam, fanatičnu borbu da se ova agencija zadrži u okviru Ministarstva poljoprivrede i ruralnog razvoja. I tu je nastao problem i svima je jasno. Znači, u ovom trenutku je pitanje kako će se opredeliti Vlada i kakav će stav zauzeti, to će olakšatai dalji rad u Parlamentu i u komisijama. Hvala!

KRYETARI: Mendoj që nuk është mirë që deputetët nga dy herë ta marrin fjalën. Do të kujdesemi që tjetër herë të mos e marrin fjalën nga dy herë. Fjalën tash do ta kenë deputetët që janë lajmëruar për herë të parë. Fjalën e ka deputeti Gani Koci dhe le të bëhet gati deputetja Gjylnaze Syla.

GANI KOCI: Faleminderit zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë do të përpiqem të vë në pah një përvojë jo fort të këndshme me këto agjencione rregullative, sepse edhe ky do të jetë një agjencion rregullativ i një fushe të caktuar, që ka një laramani nga njëri e tjetri dhe një kërkesë të tillë ia kam bërë edhe herën e kaluar Qeverisë, por edhe në autoritetin fiskal atje që vërtetë Qeveria do të duhej të kishte kujdes e të mos shndërrohej e tëra në agjencione rregullative dhe agjencione të ashtuquajtura të pavarura dhe ne këtu të shtrojmë dilemën se kujt duhet t'i përgjigjen.

Unë mendoj se varësia ose pavarësia e një mekanizmi nuk nënkupton se pse ti i përgjigjesh një instance të caktuar. Varësia dhe pavarësia krijohet me dispozitë dhe krijohet me rregull dhe në qoftë se në realizimin e dispozitave dhe të normave është krejtësisht i pavarur, shumë pak është e rëndësishme se a e themelon atë agjencion ose atë organ rregullativ Kuvendi, a e themelon Qeveria apo një mekanizëm tjetër. Në këtë drejtim, ne duhet të jemi të qartë. Ne kemi shumë autoritete të tilla që kanë edhe në fushën e tyre të veprimit fusha të caktuara dhe te njëri është tjetër çështje, për shembull në aspektin e financimit dhe të përgjegjësisë, te tjetri është krejt ndryshe dhe në këtë drejtim Qeveria do të duhej të kishte shumë kujdes, përndryshe nuk di pse duhet të ekzistojë Ministria e Shëndetësisë, kur e tërë shëndetësia rregullohet atje me organe rregullative, institute e tjera, e tjera, ose pse duhet të ekzistojë Ministria e Bujqësisë kur i ka të gjithë këta mekanizma rregullativ.

Prandaj, të kemi kujdes në ushtrimin e detyrës dhe të funksionit që iu jepen këtyre organeve dhe të jenë plotësisht të pavarur në implementimin e ligjeve dhe të rregullave të cilat i nxjerr ky Kuvend. Këtu unë e shoh pavarësinë e veprimit të tyre. Është shumë pak e rëndësishme a do të jetë në kuadër të Minsitrisë së Shëndetësisë apo të Bujqësisë një institut që do të merrej me kualitetin e produkteve ushqimore dhe do të na serojë vërtet ushqime të shëndetshme.

Herën e kaluar, ose në mandatin e kaluar, e tërë zënka ka qenë rreth kësaj. Po këto më tepër kanë qenë interesa të grupeve, interesa të caktuara të grupeve që secili ta ketë mbikëqyrjen në mekanizëm të tillë që, natyrisht, duke menduar se mund të sjellin edhe përfitime të interesave të tyre apo përmbushje të interesave të tyre.

Ne nuk duhet të ndalemi në atë se ku do të qëndrojë ky si mekanizëm, a do të jetë në kuadër të Qeverisë, të Zyrës së Kryeministrit, në kuadër të Kuvendit apo në kuadër të secilës ministri. Ne duhet t'i përcaktojmë normat e veprimit të këtyre mekanizmave dhe vetëm atëherë mund të dimë se a do të jenë të pavarur ose jo në respektimin e atyre rregullave që ne i nxjerrim këtu.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

I nderuari zotëri zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra, deputetë të nderuar,

Është evidente se ky ligj është shumë i rëndësishëm dhe jam e bindur se të gjithë deputetët pajtohen se duhet të kalojë, në parim.

Megjithatë, më lejoni t'i shtroj argumentet pse çështja e agjencionit duhet të jetë një çështje e një amendamenti të veçantë në këtë ligj, i cili specifikon se agjencioni është i pavarur. Këtë do ta mbështes me argumente të mëposhtme.

Shpenzimet për zbatimin e këtij ligji për një vit planifikohet të jenë 1.146.600 euro, por me zbatimin e këtij ligji, Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë, pa i llogaritur mjetet të cilat do t'i marrë nga gjrobat, në emër të taksave për licencim dhe të kompensimeve të tjera, planifikon të gjenerojë një shumë në vit prej 4.000.000 eurove, të cilat do të derdhen në buxhetin e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj që të mendoni për të mirën e qytetarëve të Kosovës, prandaj për këtë arsye mendoj se duhet të ekzistojë një nen i posaçëm i cili specifikon se agjencioni është i pavarur dhe i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi, në parim, i Projektligjit për provimin përfundimtar të maturës

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij, në parim.

Ftoj ministrin Enver Hoxhaj, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë Projektligjin.

ENVER HOXHAJ: I nderuari zoti Kryetar!

Shumë të nderuar dhe të respektuar deputetë, zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Meqë ky ligj veç e ka pasur leximin e parë në ish-qeverinë dhe merita për draftimin e këtij ligji i takon ish ministrit Agim Veliu, unë do të synoj që të jem i shkurtër për ata që s'e kanë lexuar në prezantimin e këtij ligji me elementet kyçe dhe të njëjtën kohë do t'i jap disa argumente kryesore rreth asaj se pse Ministria e Arsimit, pse Qeveria e Kosovës, e ka parë të udhës që në formën se si është dorëzuar deri më tash edhe të vazhdohet më tutje.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni fillimisht t'ju informoj se është një kornizë ligjore të cilën Kosova s'e ka pasur deri më tash për rregullimin e provimit përfundimtar dhe të atij të maturës.

Projektligji përmban këto elemente kryesore të cilat i rregullojnë të dy llojet e provimeve. Së pari, e rregullon mënyrën e organizimit të dy provimeve, përmbajtjen, kushtet, kriteret dhe procedurat për provimin përfundimtar dhe të atij të maturës.

Së pari, i definon se çfarë është provimi përfundimtar dhe provimi i maturës. Për një definicion të tillë, definitivisht, Kosova ka pasur nevojë. E definon se çfarë është matura shtetërore, çfarë nënkupton aftësi për punë dhe mundësinë për vazhdimin e studimeve. Ju e dini që për vende, dhe Kosova, pas 17 shkurtit, është e barabartë në hartën politike botërore – provimi i maturës, marrja e maturës dhe provimi përfundimtar paraqesin një nder jashtëzakonisht të veçantë, kështu që Projektligji definon shumë qartë rolin e maturës shtetërore.

Së dyti, e definon rolin e Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës, përbërjen e tij.

Së treti, rolin e Qendrës për Vlerësime.

Së katërti, rolin e drejtorive komunale në pushtetin lokal, në fushën e arsimit, rolin që e kanë.

Së pesti, komisionet dhe qendrat e testimit dhe elementet e tjera që kanë të bëjnë me Komisionin Vlerësues ose edhe me afate se kur duhet të ndodhë organizimi i të dy llojeve të provimeve.

Arsyeja pse Ministria e Arsimit, e cila ka disa vërejtje në këtë projektligj dhe unë kisha përmendur vetëm nenet, të nderuar deputetë, pa ju marrë shumë kohë meqë një pjesë e madhe jona ka qenë në ish legjislaturë dhe është kyçur në debat, do të thotë ne kemi sugjerime konkrete sa i përket nenit 3, nenit 18, 19, 20, 21, 27 dhe nenit 33.

Por, arsyeja kryesore pse ne s'e kemi tërhequr këtë ligj, ka të bëjë me javën e parë të qershorit, në të cilën javë të parë të qershorit duhet të mbahet provimi i maturës dhe ne jemi shumë të interesuar që kësaj here provimi i maturës të mbahet me ligj dhe matura të definohet si maturë shtetërore. Do të thotë, do të merrte shumë kohë nëse ne do ta tërhiqim ligjin në Ministri, do të kemi vërejtjet tona, do ta sjellim ligjin edhe një herë këtu. Prandaj, Ministria e Arsimit, me komisionin funksional, do të thotë me të gjithë deputetët, është e interesuar që me një bashkëpunim sa më të ngushtë ta shoh mundësinë që të gjitha vërejtjet që ne i kemi, të gjitha vërejtjet që do të dalin nga kjo seancë ta mundësojnë që të kemi një ligj sa më të mirë.

Arsyeja e dytë, është e kësaj natyre. Ne jemi në një proces të rishikimit të të dy llojeve të provimeve dhe kemi një debat shumë intensiv në Ministrinë e Arsimit, me qendër vlerësuese, i cili debat e reflekton përvojën që kemi pasur deri më tash. Prandaj, jemi të interesuar që ky evoluimi i brendshëm, rishikimi i brendshëm të jetë pastaj edhe një mundësi e mirë që gjatë punës me komisionin funksional dhe në leximin e dytë, të gjitha ato vërejtje që ne i kemi, thjeshtë t'i inkorporojmë në ligj.

Meqë është një ligj, për të cilin ka pasur nevojë Kosova, është një ligj i cili është hartuar në ish mandatin e Qeverisë, është një ligj i cili ka nevojë të përmirësohet, ju ftoj që ta votoni, por të njëjtën kohë e njoh shumë të udhës që secili prej jush të na ndihmoni që ky ligj ta marrë formën sa më të përkryer meqë e rregullon realisht fatin e mbi 20.000 deri 30.000 të rinjve që ne prej viti në vit i kemi në rritje e sipër dhe të cilët do t'i nënshtrohen provimit përfundimtar dhe provimit të maturës.

Kuptohet që rol vendimtar edhe gjatë debatit të ardhshëm, duhet të ketë edhe vetë Universiteti i Prishtinës ose bartësit e arsimit të lartë në Kosovë, meqë një pjesë e punës duhet të harmonizohet edhe se si e shohin ata mbajtjen e këtyre dy llojeve të provimeve dhe po ashtu ky ligj do të jetë edhe në harmoni me Ligjin për kornizën kombëtare të kualifikimeve, të cilin ligj, ne së shpejti, do ta sjellim në Kuvend të Kosovës dhe ju do ta shihni se qëndrimi i Ministrisë së Arsimit do të jetë që të dy ligjet të jenë në harmoni të plotë.

Jemi shumë të interesuar që të kemi komente të cilat vërtet këtë ligj do ta bënin sa më të plotë meqë interesi është që Ligji të jetë sa më i mirë dhe në të njëjtën kohë ftesa ime është që Kuvendi i Kosovës me procedurë sa më të shkurtër, për çka edhe ne jemi në dispozicion të Kuvendit dhe Komisionit, që leximin e dytë të këtij ligji ta përfundojë sa më shpejt dhe që së bashku thjeshtë ta implementojmë ligjin, të paktën për këtë gjysmën e vitit shkollor që ka mbetur dhe për vitin e ardhshëm që do të fillojë.
Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit për prezantimin! Shpresojmë se për ligje të tjera nuk do të ketë nevojë për vërejtje në prezantim. Sipas radhës, fjalën duhet ta kishte kryetari i Komisionit për arsim, shkencë dhe teknologji, Agim Veliu.

AGIM VELIU: Faleminderit i nderuar Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Unë do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Sikurse e tha edhe ministri i Arsimit, zoti Enver Hoxhaj, ky ligj është proceduar në Kuvend nga qeveria e kaluar më 10 shtator 2007. Në shqyrtimin e parë është aprovuar nga Kuvendi, mirëpo për shkak të ndërrimit të legjislacioneve ky projektligj nuk i ka kaluar të gjitha procedurat dhe tani është riproceduar.

Ky projektligj është i rëndësishëm sepse kjo materie deri më tani është rregulluar vetëm me udhëzime administrative, domethënë nuk ka pasur ligj dhe matura është organizuar në këto dy vite të kaluara, kështu që nevoja e rregullimit të kësaj materie me ligj është e domosdoshme.

Projektligji, mendoj se është i hartuar mirë, por ka nevojë edhe për disa plotësime, sepse gjatë përvojës sonë dyvjeçare me organizimin e provimit të maturës po edhe të provimeve përfundimtare kemi parë se ka nevojë që ky ligj të plotësohet dhe të sillet në Kuvend me ndryshime dhe plotësime.

Synimi i Projektligjit, u tha këtu, është që kjo materie të rregullohet me ligj si dhe të hiqen provimet pranuese nga institucionet e arsimit të lartë dhe me këtë ne besojmë se do të hiqen edhe dyshimet që tani ekzistojnë rreth padrejtësive që bëhen në provimet pranuese në institucionet e arsimit të lartë.

Komisioni parlamentar i ka bërë një shqyrtim paraprak këtij projektligji dhe mendon se ky projektligj duhet të aprovohet në Kuvend, në parim, dhe po ashtu të njëjtin qëndrim e ka edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, që do të thotë se Grupi Parlamentar e përkrah në parim Projektligjin, kurse kontributin në bërjen gati për

aprovim në Kuvendin e Kosovës, do ta japë edhe në komisione dhe gjatë procedurave të mëtejme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe për kursimin e kohës! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka Vlora Çitaku.

VLORA ÇITAKU: I nderuari zoti Kryetar,

Zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për provimin përfundimtar dhe atë të maturës dhe ne si Grup Parlamentar e konsiderojmë si nevojë të ngutshme procedimin e mëtutjeshëm dhe miratimin e ligjit në fjalë, sepse rregullon një materie e cila deri më tani është rregulluar me rregullore, ndërkohë që, siç e tha edhe ministri, provimi i maturës në qershor, ne besojmë, do të duhej të na gjente me ligj të miratuar.

Ne kemi një numër vërejtjesh, si teknike, ashtu edhe përmbajtjesore, duke filluar nga mungesa e harmonisë gjuhësore në ligj e deri te përkufizimet ku nuk janë përfshirë të gjitha termat që janë në projektligj dhe ata që janë përfshirë, nuk janë shumë të qartë. Kemi vërejtjet tona në nenin 18, 19, por besojmë që kontributin tonë do ta japim në komisionin përkatës.

Po ashtu, ftojme Ministrinë që të jetë pjesë e punimeve tona në kuadër të Komisionit, në mënyrë që sa më shpejt Kuvendit t'i paraqesim propozimet tona dhe ligji të kalojë edhe në leximin e dytë. Ne, në parim, do ta miratojmë këtë ligj. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit. Për Grupin e LDK-së, foli Agim Veliu. E ka fjalën, në emër të Grupit parlamentar të AKR-së, Arsim Rexhepi.

ARSIM REXHEPI: I nderuar zoti Kryetar,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re përkrah, në parim, këtë projektligj. Kemi një varg vërejtjesh tona, të cilat për kursim të kohës do t'i kanalizojmë përmes Komisionit përkatës dhe ato pastaj do t'i adresohen edhe zotit ministër dhe Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës, duke qenë një nga projektligjet më të rëndësishme të përgatitura nga Ministria e Arsimit, domosdo se paraqet një hap përpara në rrugën e reformave në arsimin fillor dhe atë të mesëm. Deri më sot, siç u tha edhe më herët nga ish ministri, provimi përfundimtar dhe i maturës rregullohej vetëm me një udhëzim administrativ.

Ky projektligj sot, përveç që mbulon tërësisht këtë fushë, krijon kushte dhe kompetenca shtesë për institucionet arsimore dhe qeveritare në Republikën e Kosovës.

Duke u pajtuar në parim, dua të theksoj se provimi përfundimtar dhe i maturës, si projektligj mund të rishikohet dhe të analizohet më mirë nga njerëz të thirrur të kësaj fushe.

Unë do të ndalem te neni 19 pika 5. Citoj:

“Rezultatit përfundimtar të arritshmërisë së nxënësve e përbëjnë:

- a) 40% rezultatet e arritura gjatë viteve të shkollës së mesme, si vlerësim i brendshëm; dhe
- b) 60% rezultatet e arritura nga provimi i maturës, si vlerësim i jashtëm.”.

Kujtoj se ka metoda më të avancuara të vlerësimit të nxënësve. Nuk është metodë e mirë që rezultati i kalueshmërisë të jetë peng vetëm i provimit përfundimtar dhe i maturës. Kjo do të thotë se duhet të kishim jo 40% me 60%, por mendoj të kundërtën.

Në projektligj nuk është bërë hulumtimi dhe vlerësimi i dukurive negative, siç janë: jotransparenca gjatë vlerësimit të maturanëve për regjistrim në fakultetet publike. Pastaj, intervenimet në rastet individuale, e ngjashëm.

Duke mos e cekur në Projektligj pagesën e komisioneve, konsideroj se krijohet mundësia për “alternativa të reja të vetëfinancimit”, apo thënë më thjeshtë, hapet rruga për korrupsion.

Grupi Parlamentar i AAK, e përkrah në parim këtë projektligj.

Dhe, krejt në fund, do të thoja diçka për ministrin, i cili e prezantoi ligjin.

Zoti ministër, do të ishte mirë që këto vërejtje, në nenet që i parashtrove, do të ishte mirë të intervenohet në to, e jo të silltet kështu projektligji. Megjithatë, po më pëlqen qasja për ndryshime. Ju jeni vetë sponsor i këtij projektligji, është dashur para se të vijë në Kuvend, të bëhen disa ndryshime dhe plotësime. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet! Në emër të LDD-së, Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit! Përshëndetje!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Ne konsiderojmë se në shqyrtimin e parë projektligjin e përkrahim në parim dhe duke ditur rëndësinë e këtij projektligji për reformën e mëtutjeshme të arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, si Grup Parlamentar do të japim vërejtjet dhe sugjerimet tona gjatë procedurave të amendimit të Projektligjit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Mufera Shinik.

MÜFERA ŞİNİK:

Sayın Başkan, Başbakan yardımcısı, Bakanlar, Milletvekilleri
Olgunluk sınavının hazırlanmasında yetkili organ Kosova Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanlığıdır. Bu sınavın örgütlenmesinde Eğitim Bakanlığı, Devletin Merkezi Mezuniyet

Komisionuyla, Ölçme ve Değerlendirme Merkeziyle, Belediye Eğitim Komisyonuyla, Merkezi Test Düzenleme Komisyonuyla, Okullarda Ölçme ve Değerlendirme Komisyonuyla ve Okullarda Sınav Düzenleme Komisyonuyla işbirliğinde bulunmalıdır. Öğrencilerimize, gençlerimize çok büyük önem taşıyan Olgunluk Sınavı Yasa Tasarısının birinci okunuşunu 7+ Parlemlenter grubu olarak kabul ediyoruz, gerekli tamamlamaları Eğitim Komisyonuna sunacağımızda diktate alınmasını arz ediyoruz. Teşekkür ederim. Ju faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar SLS, mungon. Tani fjalën e ka kërkuar anëtar i Kryesisë, Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje Kabinet qeveritar,

Përsëritje kolegë deputetë,

Unë, në radhë të parë jam këtu për ta përsëritur kurajën e ministrit aktual që të procedojë me një ligj, duke vlerësuar punën që ka bërë ministri pararendës dhe, natyrisht, përsërites sidomos ekspeditivitetin e tij që ta procedojë më shpejt një ligj që është tepër i nevojshëm për arsimin në Kosovë.

Unë, që vij nga Universiteti i Prishtinës, mund të shpreh këtu vështirësitë që i ka Universiteti i Prishtinës për mungesën e këtij ligji që, këtu e disa vite, me rastin e organizimit të provimeve pranuese për pranimin e maturantëve nga shkollimi i mesëm në shkollimin e lartë. Dhe ky ligj, hiq për tjerat, vetëm për efikasitetin që sjell, është shumë nevojshëm.

Natyrisht, edhe Partia jonë e përkrah, në parim, dhe ne do të kontribuojmë në faza të amendimit për ta përsëritur aprovimin e këtij ligji.

Unë do të them diç vetëm lidhur me nenin 7 - te kompetencat, që i kam disa paqartësi dhe ka nga pak kolizione së paku në formulimin e fjalive. Për shembull, neni 9.3 “Qendra e vlerësimit organizon, realizon dhe bën vlerësimin e testeve” dhe në të njëjtën kohë ka një komision vlerësues që e bën po atë punë, neni 15.2. Pastaj “Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës, i publikon rezultatet që i merr nga Qendra e Vlerësimit”. Po për të njëjtën gjë, thuhet edhe në një dispozitë – paragraf që e bën edhe Qendra e Vlerësimit dhe thotë “shpall rezultatet”. Shpall ose publikon - është fjalë e njëjtë, dhe duhet evituar këto kolizione që krijohen, sepse janë finesa gjuhësore që duhet të rregullohen.

Përndryshe, edhe një herë e përsërites dhe kërkoj në fakt që ky ligj, ndoshta pak me më shumë prioritet, të procedohet sa më shpejtë nga ky Parlament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. Sipas radhës, fjalën e ka deputetja Drita Kadriu.

DRITA KADRIU: I nderuari zoti Kryetar!

Të nderuar zotërinj të Kabinetit qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Shqyrtimi i parë i këtij ligji vjen në kohën e domosdoshme për zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë së mësimin, si dhe zhvillimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri të dijes. Ligji mbulon mirë shumë çështje teknike, por sipas vështrimit tim, ka ngecje të mëdha në cilësi.

Më lejoni të marr një shembull, derisa në ligj parashihet pragu i kalueshmërisë në 40% dhe është planifikuar që rezultatet e provimit të maturës deri në vitin 2010 – 2011 të merren për bazë 100% në regjistrimin në nivelin e lartë, aktualisht ky prag i kalueshmërisë, sipas përvojave të ndërtuara dy vitet e kaluara, nuk ka arritur 40% por është nën këtë prag. Prandaj, këtu duhet të ketë një qasje dhe analizë të mirë në bazë të përvojave që janë ndërtuar deri më tani në këto dy vitet e kaluara dhe ato informacione të futen si informata hyrëse në shqyrtimin e ligjit më tutje.

Gjithashtu, sa i përket cilësisë, shtrohet çështja e kapaciteteve të Qendrës së Vlerësimit, të cilat merren njëkohësisht edhe me hartimin e testeve e po ashtu merren edhe me organizimin teknik të testeve. Kishte qenë mirë që të mendohet për një vlerësim të jashtëm të sistemit të arsimit në përgjithësi të kësaj reforme se deri ku ka arritur dhe në këtë mënyrë do të amendohet dhe do të planifikohet shumë më mirë në kuadër të këtij ligji.

Unë e mbështes dhe do të kontribuojmë në punën e komisionit funksional gjatë punës për këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, i nderuar Kryetar!

Sigurisht, ministri i Arsimit ka përvojë në këtë drejtim dhe edhe vetë e tha se ka disa vërejtje. Me këtë ligj maturantët nuk do të bien pre e abuzimeve të konkurseve, siç është bërë në të kaluarën dhe do të marrin atë çfarë iu takon në bazë të njohurive që kanë marrë përgjatë katër viteve që kanë mësuar në shkollë të mesme. Sa e kam kuptuar, ky është edhe qëllimi kryesor i këtij projektligji, i cili çon deri te heqja graduale e organizimit të provimeve pranuese në institucionet e arsimit të lartë.

Zotëri ministër,

Edhe komisioni duhet ta ketë parasysh të sistemi i njohurive, sepse edhe në nenin 19, të kriteret e provimit të maturës, ndoshta këtu duhet të ndryshojmë – të rezultati përfundimtar, sepse një kandidat i caktuar mund të aplikojë në një drejtim shkencor, ndërsa shkollën e mesme e ka kryer në shkollën e mesme shoqërore, kurse prirjet e tij kanë qenë për atë lëmi. Nuk bën që pikët e marra, mund ta gjejmë një sistem ndryshe të pikëve, mund të marrim një model më të kapshëm, sepse ky, siç po shihet, është një model perëndimor, i cili e vlerëson dhe nxjerrë një kandidat më të suksesshëm. Mund të jetë që dikujt nuk i shkon historia, por i shkon matematika dhe të mos vlerësohet ai në bazë të atij rezultati të cilin e ka marrë përfundimtar, por në bazë të rezultatit të lëndës së caktuar dhe në drejtimin të cilin ai tani aplikon dhe t'i nënshtrohet atij testi. Kjo është një vërejtje e imja që besoj se do ta keni parasysh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Zoti zëvendëskryeministër, ministra dhe ju deputetë,

Unë desha t'i vë në dukje këtu një dy-tri fjalë përkitazi me këtë ligj. Të them se këtë, siç e tha edhe kryetari Komisionit, e kemi shqyrtuar dhe e kemi pranuar në parim. Natyrisht se do të bëjmë vërejtje të mëtejme në leximin e dytë në mënyrë që ky ligj të jetë sa më i përsosur.

Do të flas për dy çështje, për mendimin tim, individual, dhe këtë e them nga përvoja më shumë se 35 vjeçare në arsimin fillor, në atë të mesëm dhe në universitet. E them këtë sepse ato pjesët ku bëhet fjalë për provimet përfundimtare dhe të maturës më duket se nuk duhet të jenë në të njëjtën formë të provimit. Provimi përfundimtar mund të shkojë ashtu, por provimi i maturës duhet paksa të ndryshojë, të mos jetë ajo formë e testimit sepse aty bëhen malverzime të shumta. Ju thatë që në universitet t'u ikni malverziimeve, po aty bëhen dhe mund të dalë më i mirë nxënësi në maturë që nuk ka qenë i mirë në provime dhe nuk ka punuar, sepse mund të ketë forma të ndryshme. Por, unë propozoj, e këtë do ta shohim edhe më vonë, që provimi të jetë me gojë para komisionit, jo në formë klasike, dhe aty të shihet mirë se në çfarë forme po e përfundon nxënësi shkollën e mesme, maturën.

E dyta, edhe forma që u imponohet institucioneve të larta nuk është në rregull. Nuk është në rregull ajo që imponohet që të mos kenë provim. Duhet një formë provimi për t'i zgjedhur kuadrat sipas profesioneve, sepse njeriu i cili nuk ka prirje për art, nuk mund të shkojë në art edhe nëse e ka atë, në shkollimin e maturës i ka të gjitha notat të mira.

Dhe, në fund, për gjuhën, më falni se do ta jap një vërejtje të përgjithshme. E kanë thënë edhe shokët në terminologji, por aq më bëjnë nervoz disa gabime edhe të deputetëve, edhe të ministrave, edhe të ligjeve që i keni pru këtu. Shikoni, nuk ka zot, zoti kryetar, as nuk është zot kryetar, as ministri, as deputeti, por zotëri. Unë mendoj që duhet të hiqet, shikoni gjuhën frenge, mesie, gjuhët edhe sllave edhe këto të Ballkanit nuk e kanë atë zot, dhe të hiqet, unë mendoj.

Mandej, gabimet e shumta që i dëgjoj, për shembull, do të vjen radha, në vend do të vie radha, do ta lehtëson, do ta lehtësojë. Kemi kujdes, edhe si deputetë, edhe funksionarët që mos ta nënçmohim gjuhën standarde, se gjuha standarde është e rëndësishme. Tash, për ligjin, për shembull, është marrë aty në faqen 3, kështu thotë: “kandidat janë të gjithë nxënësit”, “kandidat” është në njëjës, “janë” është në shumës, “të gjith” është po ashtu pa “ë” në fund. Krejt këtu ka disa gabime të cilat e “përfundojnë” me sukses, e përfundojnë pa “ë”. Gabime të shumta, që nuk duhet të jenë. Dhe, po ta krahasojmë këtë me serbishte, fjalë për fjalë është në gjuhën serbe. Nuk është rendi i njëjtë i gjymtyrëve të gjuhës shqipe me gjuhët e tjera, as në anglishten, e përkthehet në mënyrë bukvalë. Në dashit po ua lexoj edhe shqip, edhe serbisht dhe do të shihni se është krejtësisht ..., po të mos e ngarkoj Kuvendin. Prandaj, kërkojmë që ato edhe gjuhësisht, e keni shërbimin, dhe të mos vijnë të njëjtat gjëra. Unë e kam këtu të nënshkruar në fund nga Kolë Berisha, si kryetar, tash është Jakup Krasniqi, i njëjti ka ardhur, do me thënë, që e kanë vënë re edhe të tjerët.

Edhe në fund, vetëm po them, e kam një libër në gjuhën gjermane: “Gjuha e Parlamentit”, 400 faqe i ka. Duhet t'i përmbahemi gjuhës së Parlamentit, e jo të flasim gjithçka. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju e dini që kontributi për ndryshimin e Ligjit bëhet në komisione.
Tani diskutuesja e radhës është deputetja Luljeta Shehu.

LULJETA SHEHU: I nderuari Kryetar,
I nderuari zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra dhe deputetë,

Parimisht e përkrah këtë Projektligj për provimin përfundimtar dhe të maturës, por kam një vërejtje në të hyrat që i realizojnë nga ky ligj, që janë para publike dhe që ky Projektligj parasheh pagesën prej 10 euro për hyrje në secilin nga këto dy provime. Provimit përfundimtar 10 euro, dhe i maturës 10 euro. Në këto të hyra është dashur të bëhet dallimi ndërmjet nxënësve familjet e cilëve jetojnë nga ndihma sociale, nga pensionet e dëshmorëve dhe pensionet për persona të zhdukur gjatë luftës, sepse kjo shumë për këto nxënës është një shumë mjaft e lartë. Prandaj, kisha dashur që kjo vërejtje të merret parasysh dhe të shqyrtohet në komisionin funksional. Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Sipas radhës, deputeti Adem Salihaj.

ADEM SASLIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Ne të gjithë po shohim që kemi të bëjmë me një ligj të rëndësishëm, edhe vetë diskutimet e tregojnë këtë. Unë dëshiroj ta çmoj korrektësinë e ministrit, i cili dha këtu shumë vërejtje dhe ndoshta nuk ka arritur ta lexojë para se ta sjellë këtu, ose i kanë shpëtuar, ose ka pasur disa arsye. Unë mendoj që do të duhej të ishte punë e Qeverisë, para së gjithash, që t'i bëjë këto korrigjime dhe plotësime dhe propozoj që t'ia mundësojmë Ministrisë ta marrë ligjin prapa dhe ta korrigjojë ashtu siç mendon e të na sjellë në Parlament. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti vijues është Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Kolegë deputetë,

Mendoj se Projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës është ndër ligjet më të rëndësishme që mund t'i sjellë Ministria e Arsimit dhe është një nevojë emergjente për miratimin sa më të shpejtë të tij, duke pasur parasysh se që në muajin qershor duhet ta kemi provimin e ardhshëm të maturës, por edhe për shkak, ndoshta, të nenit 20, i cili po ashtu e shpreh një nevojë emergjente që ka të bëjë me heqjen e provimeve pranuese nga institucionet e arsimit të lartë. Deri më tash, në vitet e kaluara maturanët e Kosovës padrejtësisht janë munduar me dy provime për një periudhë shumë të shkurtër, është dashur të përgatiten dhe të hyjnë në provimet përfundimtare, në provimin e maturës dhe menjëherë pastaj të përgatiten edhe për një provim tjetër. Mendoj se neni 20 do ta rregullojë këtë çështje shumë mirë, me qenë se në traditat evropërisht tashmë në institucionet e arsimit të lartë nuk ka provime pranuese, por pranimi në institucionet e arsimit të lartë në universitetet dhe të tjera bëhet përmes kritereve të paracaktuara që kryesisht janë rezultatet e provimit të maturës apo rezultatet në testet e standardizuara të mëhershme.

Megjithatë, unë personalisht i kam disa vërejtje tek paqartësitë që i ka përbrenda vetes ky Ligj dhe që u cekën edhe nga parafolësit. Janë disa gjëra, si për shembull, te neni 13, administrues dhe vëzhgues të teksteve nuk dihet se kush janë ata, përveç që dikush i përcakton për çfarë profili duhet të jenë. Besoj se është me rëndësi që këtë ta saktësojmë, sepse në vende të ndryshme ka tradita të ndryshme, mund të jenë profesorë të profilit akademik, por mund të jenë, sikur në disa vende, edhe të punësuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ose t'i biem më shkurt, policë, të cilët e administrojnë edhe e

vëzhgojnë dhe në fund e ruajnë deri tek Qendra e Vlerësimit. Është mirë të saktësohet kjo, sepse përndryshe lihet hapësirë për interpretime të ndryshme.

Pastaj, edhe te neni 19, që u përmend edhe nga parafolësit, duhet ta rimendojmë mirë punën e ndarjes 60% për provimin përfundimtar, dhe 40% të 4 viteve shkollim. Edhe te dispozitat kalimtare në fund ka paqartësi, edhe përkthimi në shumë raste është jokonsistent. Por, besoj që me punën tonë edhe në komisionin funksional dhe në bashkëpunim me Ministrinë do të kemi mundësi që, shpresoj, sa më shpejtë t'i tejkalojmë këto paqartësi, ta harmonizojmë këtë ligj në mënyrë që të miratohet sa më shpejt, që të jemi të gatshëm për vitin e ardhshëm shkollor, i cili fillon për pak muaj. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, deputeti më i vjetër, zoti Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: I nderuari zoti Kryetar i Parlamentit,
Të nderuar ministra dhe deputetë,

Grupi Parlamentar i Koalicionit LDD-PSHDK e përkrah në parim Projektligjin për Provimin e përgjithshëm dhe provimin e maturës siç u tha.
Me këtë Ligj bëhet një risi në judikaturën e Republikës së Kosovës dhe plotësohet një boshllëk dhe një nevojë për një segment të fushës së gjerë të arsimit kosovar.

Me këtë Ligj bëhet i mundshëm vërtetimi më objektiv i aftësisë dhe zotësisë së nxënësve për të vazhduar studimet e larta universitare dhe pastaj për të kryer me sukses detyrat e caktuara në vende të tyre të punës.

Me këtë Ligj, (sipas komentit të tij paraprak) mund të evitohet mosobjektiviteti, familjarizimi, korrupsioni e tjera me rastin e provimeve pranuese për regjistrimin në fakultet, gjë që, siç dihet, çdo vit ka shkaktuar reagime të ashpra të studentëve dhe të opinionit kundër padrejtësive me këtë rast. Ka ngjarë që djemtë e vajzat e profesorëve, të mjekëve, të anëtarëve të komisioneve provuese, e të lidhjeve të tjera të ngjashme, për shembull – korrupsionit e të tjera, këta kandidatë, në sajë të lidhjeve dhe mundësive të tilla, të kalojnë në provim, pa marrë parasysh suksesin dhe aftësitë e tyre, kurse të tjerët, të mbesin në rrugë, nëse nuk kanë mundësi materiale për t'u regjistruar në ndonjë universitet privat.

Me këtë ligj gjithashtu u jepet një kontribut reformave të nevojshme të arsimit tonë konform kërkesave ndërkombëtare, por gjithashtu edhe proceseve integruese evropiane, të cilat janë synimet dhe përpjekjet e Republikës së Kosovës për anëtarësimin e saj sa më të shpejtë në organizmat dhe institucionet përkatëse të Botës Perëndimore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Sipas radhës, fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, Kryetar!

Unë do të jem shumë konkrete. Në parim jam që ky Projektligj të miratohet, por mendoj se neni 20 i këtij Projektligji duhet të ketë një plotësim. Konkretisht, neni 20 ka të bëjë me obligimet e arsimit të lartë.

Në pikën 2 të këtij neni thuhet se: “Pranimi i studentëve do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura në provimin e maturës”. Sipas mendimit tim do të duhej të ishte në vazhdim të këtij neni, do të thotë të ceket se ish nxënësit që kanë marrë provimin e maturës në një drejtim duhet të precizohet që me drejtimin e kryer në cilat drejtime të institucioneve të larta ata mund të aplikojnë për regjistrim.

Mendoj se nuk është në rregull nëse provimi i maturës është në lëmin e shkencave shoqërore, ndërsa studenti të aplikojë për shkenca natyrore. Prandaj, këtu duhet të ketë një sqarim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete.
Diskutuesi i fundit, deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Shpresoj se ky Ligj do të aplikohet me konsekuencë dhe do të prodhojë efekte juridike tepër të dobishme edhe për këtë uroj personalisht ministrin, zotëri profesorin Hoxhaj, shpresoj se do të bëhet kjo punë në mënyrë konsekuente edhe do të evitohen shumë anomali. Unë di shumë, po flas me qenë se jam jurist. Jurist, që thotë: Nuk kam talent, unë më tepër merrem me elektricitet, po e zëmë, e tjera, e tjera. Do me thënë, shpresoj që do të evitohen dukuritë e këtilla, se kjo është shumë relevante, se në qoftë se ai apo ajo që ka talentin natyror, studion fushën që i përket, do të bëhet ekspert i mirë, profesionalist i mirë, ndoshta specialist, mund të bëhet edhe ekspert, apo jo. Kjo është një.

Dy, ju lutem, angazhohem që dispozitat të cilat u referohen taksave për aplikacion, ato të fshihen menjëherë, ato t’i lehen ministrit, dhe jo vetëm në këtë ligj, po secilit ministër t’i lehet që me akt nënligjor t’i përcaktojë. Kjo duhet të jetë jurisdikcion, autoriteti i ministrit, ju lutem. I cakton mandej edhe ato lehtësirat që një kolege i përmendi. Nuk është kjo tematikë e ligjit, ligji nuk i rregullon ato. Kjo është çështje e ministrit që me akt juridik nënligjor që mund të jetë rregullore, urdhëresë, mund të jetë instruksion administrativ, i cakton edhe favorët e caktuara, beneficionet e caktuara për ata, ato që janë të pastrehë, që janë fëmijët e dëshmorëve, të invalidëve, e tjera. Ju faleminderit!

KRYETARIA: Faleminderit, zoti deputet!
Pasi që nuk ka të paraqitur të tjerë për diskutim,

Vazhdojmë me:

- Shqyrtimin e parë të Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,
Ministra të nderuar,

Sot para nesh gjendet Projektligji për aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, sponzorizues i të cilit është Ministria e Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

Fjala ime e shkurtër ka për qëllim dhe objektiv të ofrojë disa shpjegime të nevojshme lidhur me Projektligjin e përmendur.

Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë integrale dhe e natyrshme e shoqërisë në tërësi. Për këtë shkak, atyre duhet t'ju ofrohet mundësia që përmes formave të ndryshme të kontribuojnë në zhvillimin e vendit dhe në të njëjtin kohë të integrohen në proceset e ndryshme shoqërore.

Ligj të aplikueshëm të veçantë i cili rregullon rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nuk ka, nuk ekziston. Çështja e punësimit të kësaj kategorie, pra të personave me aftësi të kufizuara ka qenë e rregulluar me Rregulloren 2001/27 për Ligjin themelor të punës e që rregullohet vetëm në një paragraf të vetëm, pra në dispozitën e nenit 2 të kësaj rregulloreje, në të cilën flitet për nocionin e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Siç shihet, kjo rregullore është e mangët në rregullimin e shumë çështjeve nga e drejta e punës së këtyre personave dhe kjo krijon probleme praktike në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Deputetë të nderuar,

E drejtë për të punuar dhe për t'u aftësuar pa diskriminim është e drejtë e njohur në botë dhe e mbrojtur me konventat ndërkombëtare të punës si dhe me konventat që u atribuohen personave me aftësi të kufizuara, nga njëra anë, dhe po ashtu nga të drejtat kryesore të punëtorëve.

Respektimi i parimeve themelore të të drejtave të njeriut është parakusht për funksionimin e duhur të sistemit të marrëdhënieve të punës. Aftësimi profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara është fakt që adreson një mori çështjesh të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave, të kushteve, të kritereve, mënyrën e aftësimit profesional dhe punësimin e këtyre personave, mandej integrimin e tyre në tregun e punës sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta dhe shumë çështje tjera nga sfera e aftësimit dhe punësimit të këtyre personave me aftësi të kufizuara.

Deputetë të nderuar,

Projektligji për aftësim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara, i cili është para jush për shqyrtim vërejte dhe plotësim eventuale, është në harmoni me zgjidhjet më të reja konceptuale dhe aktualisht të zbatueshme në vendet në tranzicion, si dhe në përputhje me nivelin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe social të vendit tonë.

Duke miratuar Projektligjin për aftësim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara do të krijojmë një bazë solide ligjore edhe për shumë aspekte të tjera të nevojshme të kësaj lëmie, e cila me rregullore dhe udhëzime administrative që do të hartohen më pas, do të bëhet plotësisht e zbatueshme.

Qëllimi themelor i nxjerrjes së këtij Projektligji është përkrahja ligjore dhe institucionale për rehabilitim profesional, zgjidhjen e punësimit të përshtatshëm për persona me aftësi të kufizuara në përputhje me aftësitë e tyre të mbetura të punës.

Po ashtu, Projektligji i përmendur është një akt ligjor i rëndësisë së veçantë, i cili rregullon dhe përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë me rastin e rehabilitimit dhe punësimit të personave me aftësi të kufizuara, me qëllim të integritetit të tyre në tregun e punës në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm vendor dhe ndërkombëtar.

Prandaj, të nderuar deputetë, duke pasur parasysh materien që trajtohet në këtë Projektligji, si dhe implikimet buxhetore nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, e të cilat nuk janë shumë të larta krahasuar me ligje të tjera të kësaj fushe, ju lus që Projektligjin e përmendur ta përkrahni, në parim, por natyrisht edhe ta plotësoni me kontributet e juaja me qëllim të ngritjes së cilësisë së tij.

KRYETARI: Faleminderit!

Pas prezantimit, fillojnë diskutimet.

Sipas radhës, kryetari i Komisionit nuk është lajmëruar.

Vazhdojnë kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Projektligji për rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara është një ndër projektligjet që vendit tonë i japin epitete të një shoqërie humane, sepse ka të bëjë me aftësimin e personave të cilët duhet të shfrytëzojnë të drejtën për punë, të inkuadrohen në shoqëri dhe të japin kontributin e tyre për ndërtimin e shoqërisë sonë dhe, sigurisht, edhe përmirësimin e standardit të familjeve të tyre.

Ndërsa, shoqëria me këtë ligj merr obligimin jo vetëm të aftësojë, të rehabilitojë, por edhe të punësojë, duke dhënë dispozita ligjore për punëdhënësit që janë obligative dhe kjo është në favor të kësaj kategorie shumë të ndjeshme të shoqërisë sonë.

Ky Projektligj pati kaluar në mandatin e kaluar, në seancën e parë, do me thënë, në shqyrtim të parë, edhe me pëlqimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Gjithashtu, anëtarët e Komisionit të këtij Grupi Parlamentar patën biseduar, patën kontakte, tubime dhe patën mbledhur sugjerime nga ata që janë të interesuar për ligjin, patën biseduar me shoqërinë civile, Edhe Komisioni për Çështje Sociale pati organizuar debat publik dhe pati marrë sugjerimet e ekspertëve në lidhje me këtë Ligj. Ne dhamë kontributin tonë edhe në amendimin e ligjit dhe besoj që të gjitha këto do të merren parasysh edhe në Komisionin e këtij mandati që e shqyrton këtë çështje, që është Komisioni për Çështje Sociale dhe Shëndetësi.

Edhe në të ardhmen do të kontribuojmë në Komision, duke i dhënë sugjerimet tona. Sigurisht, një vërejtje e kemi, pasi që dje e shqyrtuam skemën sociale, e fjala është për asistentët e domosdoshëm të një kategorie të personave me aftësi të kufizuara. Mbetet pikëpyetje kush do t'i paguaj dhe a do të paguhen asistentët për këta persona, kur ata aftësohen për punë dhe kur marrin punë. Vërejtja është dhënë nga të gjithë këta që i

përmenda nga takimet e shumta, që asistentët të paktën të marrin pensionet që më parë i merrnin personat me aftësi të kufizuara, sipas kategorisë që kanë.

Besoj që Qeveria do ta marrë parasysh këtë dhe në Komision kështu do të aprovohet. Në të kundërtën, jemi shumë të interesuar të japim kontributin tonë që procesi të shkojë sa më parë në Komision dhe në shqyrtim të dytë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i LDK-së, deputetja Sanije Alijaj.

SANIJE ALIJAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kryetar i Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër, zoti Manaj,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

E përshëndes Qeverinë e Republikës së Kosovës që në këtë seancë plenare ka rënditur një varg projektligjesh për shqyrtim, në parim, që rregullojnë statusin e personave me aftësi të kufizuara, por edhe që garantojnë përkujdesje institucionale.

Shqyrtimi në parim i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, paraqet një hap të rëndësishëm të Qeverisë drejt kompletimit të infrastrukturës ligjore për përkrahje ligjore dhe institucionale për rehabilitim, aftësim profesional dhe nxitjen e punësimit të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara si dhe integrimin e tyre në tregun e punës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës përkrah në parim këtë Projektligj dhe e konsideron si shumë të domosdoshëm për këto arsye:

Në radhë të parë, rregullon statusin e personave me aftësi të kufizuara. Projektligji është në harmoni me ligjet e Bashkimit Evropian i cili mundëson që edhe ne, si shteti më i ri në botë, të jetësojmë praktikën për trajtim të nevojshëm të personave me aftësi të kufizuara.

Me dispozitat e këtij Projektligji mundësohet hartimi i politikave e programeve për rehabilitim, për aftësim profesional, kualifikim plotësues si dhe angazhimet individuale personale për ngritjen profesionale, me qëllim të integritetit të tyre në shoqëri, duke krijuar mjedis të përshtatshëm dhe kushte për punësim, për qasje pa vështirësi.

Projektligji ka 9 kapituj dhe 34 nene, ku ndër të tjera do të theksoja se çdo punëdhënës çka ka mbi 24 punëtorë, është i detyruar ta punësojë një person me aftësi të kufizuara ose të paguaj 1% të të ardhurave minimale të tij.

Mendoj se Qendra për Rehabilitim e Punësim qysh në start duhet të ndërtojë strategjinë afatshkurtër dhe afatgjatë për rehabilitim e punësim.

Propozoj me këtë rast që Qeveria e Kosovës dhe Qendra për Rehabilitim Profesional dhe Punësim, për të jetësuar këto programe në praktikë, të formojë Fondin për Rehabilitim dhe Punësim, apo të ndahet buxhet i veçantë për start në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të mos diskriminohen, por të krijohen kushte dhe rrethana që ata të punësohen, pra të jenë vetë kreativë dhe pjesë ndërtuese e shoqërisë së Kosovës. Me këtë rast konsideroj se do të kursehet edhe buxheti i Kosovës.

Beneficionet e ofruara me këtë Projektligj për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara tregojnë seriozitetin e institucioneve të Republikës së Kosovës për përkujdesje institucionale, duke i ndihmuar punëdhënësit për adoptim të vendit të punës dhe krijimit të kushteve të punës duke ofruar lehtësime tatimore, lehtësime doganore, si dhe stimulim me mjete financiare dhe lehtësime të tjera.

Dispozitat ndëshkimore në gjobë prej 200 deri në 2.000 euro për ta dënuar punëdhënësin që diskriminon personin me aftësi të kufizuara konsideroj se duhet të jenë edhe më të larta për shkak se një punëdhënës, i cili ka arritur të ndërtojë një sasi të madhe të parave, ndoshta në këtë drejtim edhe nuk do të brengoset fare.

Deputetët e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës gjatë procedimit të mëtutjeshëm të këtij Projektligji do të japin kontributin e tyre duke propozuar amendimin e këtij Projektligji në komisionet funksionale dhe komisionet kryesore.

Në fund, e kam edhe një vërejtje. Projektligjit t'i bëhet një lekturë gjuhësore, e në disa raste edhe përmbajtësore. Me këtë rast, një vërejtje tjetër e veçantë për ata të cilët e bëjnë renditjen e këtij Projektligji, të kenë kujdes e mos të fusin vendime të cilat nuk kanë të bëjnë asgjë me këtë projektligj. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i AKR-së, Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Ne, si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Deri tani ka qenë i nevojshëm ky Ligj. Siç dihet, personat me aftësi të kufizuar kanë qenë në gjendje jo të mirë. Gjatë shqyrtimit kemi vërejtur edhe disa gabime në terminologji, e cila nuk është përdorur në mënyrë adekuate. Gjatë shqyrtimit që kemi bërë, te neni 3 janë përdorur disa terma: personat me aftësi të kufizuar, me të meta fizike, mendore, intelektuale. Në bazë të kontributit dhe të propozimeve tona, do t'i shqyrtojmë këto në Komisionin përkatës që është dhe në parim pajtohem me këtë Projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi.

SYLFIJE HUNDOZI: Zoti Kryetar,

Zotëri ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale, i mandatit të kaluar, e ka përpunuar dhe e ka amenduar këtë Projektligj, ja ku i kam 32 amendamente, dhe me atë rast nga ana e ekspertëve iu ka ndërruar titulli këtij Projektligji. Ky është Projektligji për aftësimin profesional dhe punësimin e personave me nevoja të veçanta. Ky është ligj shumë i mirë më se i nevojshëm për Kosovën.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah, jo vetëm në parim, por edhe këto amendamente që janë bërë edhe shpresoj që sa më shpejtë të kalojë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Amendamentet, kur të vijë koha.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë pas shqyrtimit të Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara përkrah, në parim, këtë Projektligj, duke pasur parasysh rregullimin me ligj dhe përkujdesjen institucionale të kësaj kategorie tejet të veçantë të shoqërisë sonë.

Ky projektligj rregullon të drejtat, kushtet, mënyrën e rehabilitimit profesional si dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe integrimin e mundshëm të tyre në tregun e hapur të punës. Pas skadimit të leximit të parë, ne si Grup Parlamentar do t'i japim sugjerimet eventuale gjatë procedimit të amendimit të këtij Projektligji.

E kam një sugjerim të deklaratave financiare, janë dy variante dhe i propozoj komisionit funksional që të orientohet për cilindo variant, në mënyrë që ky ligj, thjeshtë, të jetë një nga ligjet më të mira që Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës ia servon kësaj kategorie të veçantë shoqërisë tonë.

Ne e përkrahim, në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniče.

I Parlamentarna grupa „7+“ se pridružuje i podržaje ovaj Nacrtzakona zato što je on već bio u prethodnom mandatu, prošao je prvo čitanje i bio je pripremljen i za drugo čitanje, bili su urađeni amandmani i mi smo imali svog člana u funkcionalnoj komisiji koja je radila na Nacrtu ovog zakona.

Mislim da ono što je kolegnica Zylfije Hundozi rekla da u nazivu Zakona stoji da je to Zakon za osobe sa ograničenim sposobnostima, mislim da je mnogo prikladnije koristiti termin „osobe sa posebnim potrebama“, to je himanije, čak mislim da je potpuno izbačen termin „hendikepirane osobe“, to već možda više ima i drugačije značenje danas. I ovaj termin „sa ograničenim sposobnostima“ na prvi pogled pokazuje osobe koje nisu sposobne, a mi želimo da te osobe budu uključene u društvu.

Ovo što je govoreno o finansijskoj deklaraciji, date su dve variante. Jedna varijanta govori od prilike o 3 miliona evra budžetske implikacije, druga oko 16 - 17 miliona. To neće biti pitanje za funkcionalnu komisiju, to će više biti pitanje za Komisiju za budžet i za Vladu, da li će ona moći da podrži. Znači, to se za 3 godine predviđaju te dve variante, koliko su mogućnosti ove Vlade i uopšte da budžetski pokrije. Verovatno da je ova varijanta povoljnija od 3 miliona za 3 godine zato što u fazi kojoj se nalazimo postoje ograničenja u ovu pogledu budžeta.

Znaçi, naša grupa će podržati ovaj Zakon, a u komisiji na čijem sam čelu, već smo planirali da u narednom mesecu, ne u martu, nego u aprilu, Zakon bude na dnevnom redu, i svakako korišćemo amandmane koje je pripremila Komisija u prethodnom mandatu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Deputetët e Grupit Kuvendor të SLS-së mungojnë.

Tani vjen radha e deputetëve të paraqitur.

Për diskutim është paraqitur deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Deklaroj fillimisht se këtë Ligj e përkrah. Atë që e pashë dje gjatë analizimit të këtij Ligji, vërejtja se është marrë si mostër Ligji amerikan, i ashtuquajtur American with Disability Acts, ai kanadez është shumë i përafërt me atë të Britanisë me Disability Discrimination Acts të vitit 95 dhe të atij Australian. Do me thanë në tërësi është përdorë judikatura anglosaksone.

Për ndryshim nga disa ligje të tjera, ky Ligj edhe pse jo aq në mënyrë strikte si këto ligje e perëndimit, por megjithatë i ka sanksionet dhe shpërblimet për ata të cilët nuk e respektojnë këtë ligj. Do me thënë, ndërmarrjet i obligojnë që çdo të 25-tin punëtorë ta kenë të këtij grupi të qytetarëve dhe pasojnë pastaj shpërblimet financiare në kuptimin e lehtësirave tatimore.

Madje është, për çudi, edhe konform ligjit për ndihma shtetërore, të cilin nuk e kemi shqyrtuar, por megjithatë është këtu. Edhe atje shihen disa shpërblime financiare, fiskale për të gjithë ata ndërmarrës të cilët e kanë parasysh këtë grup të shoqërisë tonë. Po, ajo që e thashë dje, e sot u prek, terminologjia ligjore ngatërrohet me atë të korrektësisë politike. Nuk është keq të përdoren në ligj fjalët: “personat me paaftësi”, “disaftësi”, “joaftësi” të cilat në mënyrë origjinale e shpjegojnë këtë grup të njerëzve, por nëse dëshirojmë të jemi politikisht korrekt, ju lutem, këtë fjalën diskriminuese: “personat me aftësi të kufizuara” mos ta përdorim. Të përdorim terma të tjerë, janë “persona të sfiduar”, janë “persona me kërkesë” apo “me kërkesa të veçanta”, është fjala “persona të aftësuar ndryshe” e tjera, e tjera, e t’i ikim kësaj fjale diskriminuese, pasi që edhe ashtu Kapitulli 2, neni 5 flet për diskriminimin, e në të njëjtën kohë e diskriminojmë, e kufizojmë këtë grup të qytetarëve tanë.

Pastaj, janë edhe disa mungesa të vogla terminologjike, p.sh. unë nuk e kuptova nenin 20, te Kapitulli 6, ku thuhet: “stimulimi material në të holla” e të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Diskutuesi i fundit, deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Fillimisht, ju përsëndes dhe ju mbështes në përdorimin e termit “grup kuvendor”. Është i qëlluar dhe mendoj se do të duhej të gjithë ne ta përdorim. Pastaj, jo “president” sepse nuk është sistem presidencial Kosova, edhe juridikisht nuk është në rregull, po “kryetar”. E shfrytëzoj rastin edhe për termin që përdoret shumë herë: “amendament” jo, por “amendment”. Është fjalë neolatine, gjithë popujt e përparuar e përdorin “amendment” e tjera, e tjera, si dhe atë që profesori Hajdaraj e tha, jo “zoti” po “zotëri”, sepse nëse do ta

përdorim “zoti” për mashkullin, femrës do të duhej t’i thoshim “zotesha”, po e zëmë, po pse atëherë “zonjë”, e kështu. Kjo është, një.

Dy, ju lutem, e kemi një problem teknik që shpresoj që zotëri sekretari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me një urdhër do ta tejkalojë. Po e zëmë, shtypen gabimisht, që bie fjala faqja kështu, në vend që të jetë në vazhdim, duhet të kthehet kështu, të gjitha materialet. Kjo nuk është në rregull teknikisht.

Edhe në nenin 4, thuhet “statut”. “Statuti i punës” është do me thënë gabim i rend, se Statuti është praktikisht mini-kushtetuta e një institucioni një organizate. Status.

Do të isha ndalur parimisht te neni 12, që është relevant për mua, ju lutem. Sikur të mbetej ky nen kësi soji, ky ligj nuk do të aplikohet dot. Do të ishte vetëm dekor, e ne jemi të interesuar që ky Ligj të aplikohet, se Kosova do të jetë ndër të tjera, përpos shtet demokratik, po edhe humanist. Ju lutem. Të paaftin për ta aftësuar, për ta integruar në shoqëri është punë e madhe, edhe nevojë dhe ka dimensionin e tij, e ka edhe dimensionin ekonomik. E lexoj, ju lutem, neni 12, faqja 19, thuhet: “Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik, si dhe organizatat joqeveritare obligohen që në kushte të përshtatshme”. Tash, ky termi “kushte të përshtatshme” është slogan juridik i ngjashëm me shoferin që kurdoherë, edhe kur 100% nuk është fajtor, gjykata e shpall fajtor, se thotë: “nuk e ka përshtatur shpejtësinë me kushtet e komunikacionit”. Mund t’i ketë grahur 5 kilometra në orë e ta ketë lënduar, po e zëmë, këmbësorin edhe shpallet i përgjegjshëm. Do me thënë, është term tepër problematik. Sikur të mbetej kështu, cilido punëdhënës do të mund t’i shmangej obligimit ligjor për ta punësuar invalidin. Nuk është term i keq, si të themi, të quhet “invalid” se është fjala për të paaftë, ju lutem. Ka pasur Kosova kësi ligji edhe përpara, ka qenë ligj mjaft i mirë. Natyrisht, ky ka synime të jetë edhe më i mirë. Kjo është një, do me thënë, kjo shprehje duhet të riformulohet. Tash të mos ndalem për hir të respektit, për kohën, por në etapën e mëtejme... Pikërisht ky ligj nuk është sanksionuar, nuk ekziston sanksioni për këtë nen që do ta apsolvonte cilindo punëdhënës, do të nxirrej ... sepse nuk është përcaktuar sanksioni, masa si të themi ndëshkimore apo kundërvajtëse. Prandaj, angazhohem që të riformulohet ashtu që të krijohet obligim i precizuar i punëdhënësit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Para se ta bëjmë pauzën, dua edhe një sqarim.

Të gjitha ligjet, pas miratimit në parim bëhen pjesë e përgjegjësie së Kuvendit, të komisioneve dhe të Administratës së Kuvendit, por kjo pjesë deri këtu, ka qenë dhe vazhdon të mbetet përgjegjësi e Qeverisë. Prandaj, ne mendojmë që Qeveria në çdo ministri duhet t’i ketë lektorët në mënyrë që vërtet ligjet të mos na vinë me këto vërejtje që janë duke ardhur.

Tani, deri në orën 12,30 do të kemi një pauzë.

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Të nderuar deputetë, me shpresë që edhe kolegët të tjerë që ende nuk janë kthyer, na bashkohen shpejtë, vazhdojmë me seancën. Fillimisht po ju njoftoj për një ndryshim të vogël që është bërë në agjendën e shqyrtimit të projektligjeve. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që ishte në radhë për shqyrtim, zëvendësohet me

marrëveshjen e ministrave përkatës me Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit, meqë ministri përkatës, zoti Yagcilar javën tjetër nuk do të jetë këtu.

Prandaj me lejen tuaj procedojmë me Ligjin:

- Shqyrtimi i parë të Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin, në parim.

Ftoj ministrin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju falënderoj për mirëkuptimin, sepse vërtet javën tjetër, të hënën, nuk do të jem në Kosovë. Për këtë aspekt Ligji është shumë i rëndësishëm, dy ligjet i kemi kaluar nga fusha e mjedisit, kështu që është e nevojshme të bëhet shqyrtimi i ligjeve edhe në komisione përkatës në pako, mund të them. Edhe njëherë ju falënderoj për mirëkuptim!

I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Problemet e mjedisit kanë qenë gjithmonë pjesë përbërëse e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili mundëson depërtime të reja në planifikim, duke siguruar një shqyrtim gjithëpërfshirës të të gjithë faktorëve që e karakterizojnë zhvillimin e një civilizimi modern.

Në vitin 2003 është miratuar Ligji për mbrojtjen e mjedisit, çka ka rezultuar deri diku me një sukses në lidhje me promovimin e menaxhimit të mjedisit në Kosovës. Gjatë kohës së implementimit të tij dhe vlerësimit me acquisin e BE-së, janë vërejtur mangësi në ligjin aktual, kështu që u muar vendimi për ndryshimin e tij për të prurë kërkesat mjedisore në përputhshmëri me standardet evropiane.

Të nderuar deputetë,

Ligji për mbrojtjen e mjedisit rregullon sistemin integral të mbrojtjes së mjedisit, i cili përmban masat, kushtet dhe masat për menaxhim të qëndrueshëm me vlerat natyrore, parandalimin e ndotjes, kontrollin e zvogëlimit të ndotjes, masat e sanimit të të gjitha formave të ndotjes së mjedisit dhe ekzekutimin e masave që i kryen Inspekcioni i mjedisit.

Për të arritur një balancim të dëshiruar mes aktivitetit njerëzor dhe zhvillimit të mbrojtjes së mjedisit, kërkohet ndarje e përgjegjësisë dhe përmbushje e obligimeve, e cila është e drejtë dhe në mënyrë të qartë e definuar nga referenca konsumuese dhe sjellja e drejtë me mjedisin dhe resurset natyrore. Kjo përfshinë integrimin e rrethanave mjedisore në formulimin dhe implementimin e politikave ekonomike dhe sektoriale. Në vendimet e autoriteteve publike në drejtimin dhe zhvillimin e procesit të prodhimit dhe sjelljes individuale. Kjo na tregon edhe nevojën për këtë Ligj, i i cili do të kontribuojë në ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe për një përdorim të kujdesshëm dhe racional të burimeve natyrore.

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i këtij ligji është që të rregullohet korniza ligjore për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me kushtet dhe direktivat e Bashkimit Evropian si dhe të definohen standardet përkatëse të mbrojtjes së mjedisit, të cilat sigurojnë një mjedis të shëndoshë në Kosovë.

Sa u përket prioriteteve për nxjerrjen e Ligjit për mbrojtjen e mjedisit bazë është marrë strategjia legislative e Ministrisë dhe Qeverisë, në të cilën bazë do të krijohet mundësia për: shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e emisioneve në mjedis, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar, përmirësimin e kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore të përtëritshme dhe të papërtëritshme si dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre, bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. bashkëveprimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit, nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit, realizimin e parimeve që ndotësi paguan dhe shfrytëzuesi paguan.

Ky draftligj është në përputhje me direktivat kornizë të Bashkimit Evropian nga lëmi i mbrojtjes së mjedisit, si dhe me aktet nënligjore që do të nxirren në bazë të këtij ligji, me çka sigurohet baza për zbatimin e plotë të ligjit.

Të nderuar deputetë,

Projektligji ka për qëllim të adresojë çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture komplete gjithëpërfshirëse dhe përmbajtësore të shtjelluar në 12 kapituj sipas teknikës juridike bashkëkohore dhe në harmoni me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e juaja besoj se do të ndikojnë që ky Ligj të jetë sa më i mirë, me çka ju falënderoj më parë për angazhimin e juaj lidhur me ligjin në fjalë. Edhe njëherë ju falënderoj, vërtet ky Ligj do të jetë një prej ligjeve bazike nga aspekti i mbrojtjes dhe mjedisit. Faleminderit!

KRYESUESI: Falënderojmë, ministrin!

Pas prezantimit të Projektligjit, hapim diskutimet.

Sipas radhës fjalën duhet ta ketë kryetari i Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinorë, zoti Zeneli, nuk është këtu dhe nuk është paraqitur për fjalë dikush në emër të tij.

Kalojmë me kryetarët e grupeve kuvendore nga radhët e partive. Për diskutim është paraqitur Selvije Halimi, nga radhët e PDK-së.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për mbrojtjen e Mjedisit është ligji i ri dhe gjatë ekzistimit të Parlamentit të Kosovës, do me thënë, për 4 vite ne po e shqyrtojmë ligjin e dytë duke e shfuqizuar pas aprovimit Ligjin e parë për mbrojtjen e mjedisit.

Një fakt mendoj se duhet të cekët, asnjëherë për 4 vite më parë nuk është kërkuar që të bëhet plotësim apo ndryshim i këtij ligji me qëllim që të krijohet mundësia e zbatimit të këtij ligji në mënyrë më complete dhe më funksionale, mirëpo, sido që të jetë, duke pas parasysh një gjuhë shumë të avancuar në kuptimin e profesionalizmit lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe duke pas parasysh faktin tjetër që në të ardhmen, si vend do të ballafaqohemi me problemin e ndotjes së mjedisit dhe plotësimin e kritereve për të vazhduar më tutje, ne mendojmë se ky ligj duhet të aprovohet në parim, duke i pasur parasysh disa çështje.

Në rend të parë, ky Projektligj duhet të lirohet nga disa çështje teknike të cilat e përcjellin këtë ligj, do me thënë, në tekst si i shkruar, më pastaj duhet të kemi parasysh edhe vërejtjen që është dhënë nga *acquis* komunitaire lidhur me parimet e përgjithshme, do të thotë nenin 6 të këtij ligji, pika 12, që do të thotë se këta na japin edhe alternativën se si ky parim duhet të plotësohet konform parimeve të BE-së.

Vërejtje tjera që kanë qenë më mirë të rregulluara dhe që tash në këtë ligj duhet të harmonizohen janë ato që kanë të bëjnë me nenin 32, që duhet të bëhet qartësimi dhe plotësimi lidhur me lejet mjedisore komunale, që deri më tash s'kanë qenë, mirëpo duhet të bëhet një qartësim dhe plotësim me qëllim që të mos lejohet zbrastira ligjore dhe neglizhimi në kompetencë.

Pastaj, kemi te neni 59, që duhet të rishikohet në detaje lidhur me Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit.

Neni 82 dhe 83, që kanë të bëjmë me mbikëqyrjen inspektuese, krejt kjo me qëllim që të kemi një mbikëqyrje inspektuese shumë funksionale që nuk ka qenë në rregull deri më tash.

Duke pasur parasysh këto vërejtje dhe vërejtjet e tjera të cilat do të jepen nga deputetët këtu dhe në bashkëpunimin që do ta kemi me Ministrinë gjatë draftimit të këtij Projektligji, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet në parim këtë Projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falënderojmë deputeten Halimi!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ftojme deputeten Myrvete Pantina.

MYRFETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky projektligj, së bashku me dy projektligjet që u miratuan në parim më herët, ditët e mëparshme, që ishte Projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor dhe Projektligji për vlerësimin e ndikimit mjedisor, krijojnë një bazë të mirë legislative për mbrojtjen e mjedisit. Mbetet të shohim se sa do të implementohen këto ligje dhe sa në realitet do të luajnë rolin për të cilin janë hartuar.

Për ne është me rëndësi që të sigurohet harmonizimi në mes të zhvillimit ekonomik, gjë që presim të ndodhë në të ardhmen, dhe të parimeve themelore për mbrojtjen e mjedisit.

Kosova si shet i ri, me siguri në të ardhmen do të jetë nënshkruese e marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit. Prandaj, edhe duhet të arrihet ky kriter.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas shqyrtimit të këtij Projektligji, ka vërejtur disa mangësi.

Me këtë Projektligj parashihet realizimi i të hyrave të cilat do të grumbullohen nga kompensimet nga shfrytëzimi i resurseve natyrore, nga kompensimet, nga ndotësitë e ambientit, lejet e mjedisit, kundërvajtjet dhe të hyrat e tjera të parapara me ligj, ndërsa mjetet e grumbulluara do të shkojnë në Fondin për Mbrojtjen e Mjedisit. Në këtë ligj ekziston një paqartësi lidhur me këtë fond. Thuhet se kompetencat, administrimi, burimet e financimit dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve nga Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit, do të rregullohen me ligj, por nuk ceket se me cilin ligj. Prandaj, mendojmë se do të ishte mirë që kjo të precizohet.

Vërejtja tjetër është se në nenin 4, pika 25 përdoren shprehjet, mirëpo unë tash gjatë prezantimit të ministrit, vërejtja se ministri i kishte përmirësuar ato gabime, mirëpo në material apo në Projektligj qëndrojnë shprehjet, “resurset natyrore të papërsëritshme dhe të përsëritshme”. Mendojmë se më e drejtë është që të përdoren shprehjet: “resurset natyrore të papërtritshme dhe resurset natyrore të përtëritshme”. Një pikëpyetje e madhe për implementimin e këtij ligji është se sa kemi kuadro të përgatitura profesionalisht për këtë lëmi, por edhe institucione përkatëse, kur dihet se me një aktivitet të tillë, pra, duhet të merren institutet shkencore hulumtuese të fushave përkatëse.

Zoti kryesues, më falni, unë harrova ta përfundoj. Grupi Parlamentar, megjithatë, edhe pas këtyre vërejtjeve është që ky projektligj të miratohet në parim.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, është paraqitur, zoti Haset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, e ka shqyrtuar me një kujdes të veçantë. Edhe pse kemi disa vërejtje të përgjithshme dhe konkrete, grupi ynë parlamentar, në parim, pajtohet që ky projektligj të shkojë në procedim të mëtutjeshëm.

Ne, gjatë kësaj seance plenare i kemi shqyrtuar, gjithashtu, edhe dy projektligje të rëndësishme për vlerësimin strategjik mjedisor dhe për vlerësimin e ndikimit në mjedis, të cilat, mendoj se e kompletojnë mjaft mirë edhe Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit, që rregullon një fushë shumë interesante për rrethanat në të cilin gjendet sot shteti i ri i Kosovës.

Projektligji për mbrojtjen e mjedisit ka gjithsej 102 nene, në të cilat janë dhënë disa çështje, që sipas mendimit tonë, po përsëriten dhe ka mundësi, ndoshta, të reduktohen tekstet, sepse janë mjaft të gjata dhe gjatë implementimit të këtij projektligji, në praktikë

mund të ketë vështirësi apo interpretime të ndryshme. Mirëpo, besoj, ne si grup parlamentar do të angazhohemi që ta japim kontributin tonë në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Cakolli!

Në emër të Grupit të AAK-së, është paraqitur për diskutim Donika Kada.

DONIKA KADA: I nderuari kryesues,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës edhe më herët ka pasur informata për ligjin në fjalë, përndryshe, është rishikuar edhe një herë. Dispozitat e përgjithshme të këtij ligji flasin për zhvillimin ekonomik të vendit në parim me mbrojtjen dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit.

Në parim do ta përkrahim, mirëpo duke marrë parasysh që ky ligj në vete ngërthen edhe implikime buxhetore, domethënë, rritjen e inspektorëve dhe stafit tjetër përkatës, Kuvendi i Kosovës duhet ta mbikëqyrë për se afërmi implementimin e këtij ligji, pasi që është shumë i rëndësishëm në përgjithësi për zhvillimin e vendit, por edhe për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës. Pra, do të fokusohemi në zonat që shfrytëzohen me këtë ligj, pra, duhet të bëhet rehabilitimi i tyre. Ky do të jetë një ndër prioritetet tona.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete Kada!

Në vazhdim, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së është paraqitur për diskutim, zoti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Edhe ne si grup parlamentar e mbështesim në parim ligjin, në fakt ky është prej ligjeve bazike për mbrojtjen e mjedisit apo mbrojtjen e ambientit.

Mirëpo, parafolësit e mi, sigurisht, i thanë ato implikacionet buxhetore, kurse unë do t'i them disa elemente që kur vjen momenti i zbatimit të këtij ligji, sigurisht, do të kenë konsekuenca në komunitetin e biznesit. Në qoftë se e kemi pranuar atë parimin se kryesisht potencialet e zhvillimit apo vizionit për këtë periudhën afatmesme janë të natyrës energjetike, domethënë, potencialeve energjetike, sigurisht, zbatimi i këtij ligji do të krijojë obligime të posaçme plotësuese për investitorët potencial në sektorin e energjetikës. Mirëpo, duke marrë parasysh se Kosova deri me tani nuk ka pasur të rregulluar elementin e mbrojtjes së ambientit, unë mendoj se miratimi dhe zbatimi me korrektësi i këtij ligji, sigurisht, do të krijojë përgjegjësi apo obligime plotësuese për të gjithë investitorët potencial, qoftë në lëmin e industrisë nxjerrëse, qoftë në lëmin e industrisë, respektivisht energjetikës. Prandaj, duke marrë parasysh implikacionet e ndryshme dhe zhvillimin e bizneseve në këtë fushë, unë besoj se do të ketë konsekuenca, mirëpo duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e mbrojtjes së ambientit në Kosovë, ku po shihet se jemi dëshmitarë të vërtetë të degradimit ekologjik të Kosovës, atëherë, ne, në parim, si grup parlamentar e përkrahim këtë ligj, por do të japim, sigurisht, kontributin tonë në Komisionin funksional.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falënderojmë deputetin Ramosaj dhe në Emër të Grupit Parlamentar “7+,” është paraqitur për diskutim Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, zoti Kryesues,

Değerli bakanlar,

Saygıdeğer Milletvekiller,

Çevrenin Korunmasıyla ilgili Yasa Tasarısında vermiş olduğu açıklama yüzünden Bakanımıza teşekkürlerimizi sunarız. 7+ Parlementer grubu olarak Yasa Tasarısını görüştüğten sonra birinci okunuşunu benimsediğimizi belirtmek istiyoruz. Ancak bazı önerilerde bulunmamız gerekmektedir. Önerimizden biri yapılan çalışmalarla kazılan yerler doğadan alınan maddeler kullanıldıktan sonra, çevrenin düzenli kalabilmesi için boşlukların doldurulması, biriken gereksiz maddelerin, yığınların ortadan kaldırılması gerekmektedir. Yani çevrenin eski haline dönüştürülmesi kaçınılmaz olmalıdır. Aynı zamanda kullanılan maddelerin karşılığında gerekli organlara belli bir maddi desteğin sunulması gereklidir. Bunun devamında 96. maddede de uyarılarımız olacaktır, çünkü 96. maddede öngörülen ceza miktarı Yasa Taslağının 27. ve diğer maddeleriyle uyuşmamaktadır. Yasaya ve Bakanlığın çalışmalarına karşı çıkan kamu çalışanları sadece 500 ve 1000 auro arasında bir cezayla cezalandırılacaktır, oysa yasa dışı işlere giren kamu yetkililerinin daha fazla bir cezayla cezalandırılması gerekir, ki bu suçlar engellenilebilir. Teşekkürler. Faliminderit.

KRYESUESI: Falënderojmë deputetin Kervan.

Meqenëse, askush nuk është paraqitur për diskutim e konsiderojmë të shteruar debatin për shqyrtim në parim të Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe rikthehemi te Projektligji i radhës që ishte- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe konsiderojmë janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të tij.

Ftoj ministrin për Tregti dhe Industri, zoti Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta propozojë Projektligjin.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ligji për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 23 mars 2005 dhe është shpallur më 8 shtator 2005 nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, përmes Rregullores 2005/44, mirëpo ky ligj nuk ka qenë në zbatueshmëri të plotë, prandaj edhe është paraqitur domosdoshmëria për ndryshimin e Ligjit ekzistues.

Arsyeshmëria e ndryshimeve të propozuara, është vendosja e një kornize ligjore e cila specifikon riklasifikimin e ndërmarrjeve në mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, përmes të cilave mund të zhvillohen aktivitetet afariste në Kosovë. Ndryshimet e propozuara përcaktojnë në mënyrë më të plotë objektin e veprimtarisë së Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme, e cila vepron në kuadër të MTI-së. Këto ndryshime, gjithashtu, harmonizojnë procedurat e emërimit të zyrtarit kryesor ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme me ato të agjencive të tjera në Kosovë.

Projektligji ka për qëllim që të definojë ndryshimet të cilat konsistojnë në eliminimin e paqartësive në rolin e ushtrimit të kompetencave dhe krijimin e kushteve për zbatimin e Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ndryshimet e propozuara janë në harmoni me ligjet e tjera në fuqi dhe u janë përshtatur rrethanave në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në lëmin e ekonomisë në përgjithësi, dhe në lëmin e NMV-ve, në veçanti, ju propozoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe ta miratoni në këtë seancë parlamentare.

Ju faleminderit !

KRYESUESI: E falënderojmë ministrin Zharku për prezantimin e Projektligjit. Sipas radhës, ftojme përfaqësuesin e Komisionit, kryetaren e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, zonjën Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet ministrit dhe deputetët.

Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në cilësinë e Komisionit funksional, në mbledhjen e datës 25.2. ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Në këtë takim Komisioni konstatoi se çështja esenciale e këtij projektligji është fushëveprimtaria e Agjencisë të themeluar me nenin 8 të Ligjit në fuqi dhe themelimi i Këshillit të Agjencisë me nenin 5 dhe 6 të Projektligjit.

Komisioni konsideron se vëmendja kryesore lidhur me këtë projektligj, në këtë seancë, duhet përqendruar dhe vlerësuar në qëndrueshmërinë apo arsyeshmërinë e themelimit të Këshillit të Agjencisë, i cili në fakt mund të ketë edhe implikime buxhetore. Komisioni këtë çështje e ka lënë të hapur dhe do të dakordohet me qëndrimet e përgjithshme këtu në Kuvend. Nëse miratohet në parim themelimi i këtij këshilli, atëherë duhet të përcaktohem edhe për përfaqësimin dhe statusin e Këshillit se a do të ketë përfaqësim ekspertësh apo përfaqësim politik?

Në fund Komisioni ka nxjerrë rekomandimin me të cilin e mbështet në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në këtë aspekt edhe nga Grupi Parlamentar i AKR-së, jap përkrahjen në parim për këtë projektligj.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: E falënderojmë udhëheqësen e Komisionit përkatës dhe vazhdojmë me diskutimet sipas grupeve parlamentare.

Kemi nga PDK-ja të paraqitur dy për diskutim dhe unë s'e kam shumë të qartë. Mirë, tash e kam të qartë që në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së do të diskutojë deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues dhe kolegë,

Ne, në Grupin Parlamentar të PDK-së, kemi vlerësuar se me këto ndryshime dhe plotësime të Ligjit do të mundësohen dhe zhvillohen aktivitete afariste, sidomos me konkretizimin e obligimeve të Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Këto ndryshime ofrojnë bazën për funksionimin e Agjencisë dhe Projektligji i propozuar do të ndihmojë në klasifikimin e ndërmarrjeve. Në arsyetimin e dhënë thuhet se zbatimi i Projektligjit nuk ka implikime buxhetore, përkundër faktit se është paraparë edhe formimi i Këshillit të Agjencisë, mirëpo shpenzimet e tij nuk do të jenë të mëdha dhe nuk do të kenë problem për buxhet. Prandaj, duhet të shikohet kjo.

Ne, Grupi Parlamentar, është i pajtimit që ky projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të miratohet në parim, ndërsa, më tutje, përmes Komisionit funksional, me siguri, do të punojmë në përmirësimin e këtij propozimit.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falënderojmë deputeten Kaqusha Jasharin!

Në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, është paraqitur Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Të nderuar të pranishëm,

Roli dhe rëndësia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për zhvillimin ekonomik, është i pamohueshëm dhe i padiskutueshëm. Në ekonominë e tregut, sektori privat i cili mund të karakterizohet si sektor i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, meqenëse ato e përbëjnë numrin më të madh të ndërmarrjeve, paraqet forcë motorike të rritjes dhe të transformimeve.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme promovojnë zhvillimin ekonomik dhe kjo mund të vërehet përmes ndikimit dhe kontributit të tyre në punësim dhe në rritjen e bruto produktit vendor të vendeve të ndryshme.

Kosova, aktualisht, po kalon nëpër periudhën e tranzicionit, ku zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, mund të luajë një rol vendimtar në rimëkëmbjen dhe zhvillimin e ekonomisë së saj. Kjo mund të ilustruhet me faktin se shumica e iniciativave private, si ato të bizneseve familjare, përjetuan një ekspansion të shpejtë në këto vitet e tranzicionit, posaçërisht, në sektorin e tregtisë. Kjo nuk ishte rezultat i kushteve të favorshme dhe mjedisit të përshtatshëm, por më tepër si veprim i ndërmarrësve kosovarë në sektorin, në të cilin, me investime më të vogla mund të arrihen fitime dhe natyrisht edhe si rezultat i qarkullimit më të shpejtë të kapitalit.

Mirëpo, një zhvillim i tillë nuk ndodhi në të gjithë sektorët e ekonomisë në Kosovë për shkak të kushteve të pafavorshme për zhvillimin e tyre. Për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit privat duhet të krijohen kushtet për funksionimin e duhur të sistemit ligjor dhe strukturave institucionale. Ky projektligj paraqet një kontribut në këtë drejtim. Esenca e këtij projektligji qëndron në vendosjen dhe përmirësimin e kornizës themelore legjislativë në të cilën bëhet fjalë për klasifikimin e ndërmarrjeve, në radhë të parë, pastaj për funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, si dhe formimin e Këshillit të Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Kosto shtesë e këtij projektligji, do të jetë kostoja e paraparë për Këshillin e Agjencisë, si organ drejtues, i cili do të përbëhet nga shtatë anëtarë që do të jenë përfaqësues nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare. Mirëpo, në këtë projektligj nuk janë cekur të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Agjencisë, por parashihet që ato të rregullohen me akt nënligjor nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, e cila edhe është inicuese e ndryshimit dhe e plotësimit të Ligjit për mbështetjen e NMV-ve. Megjithatë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mendon se me miratimin e këtij projektligji do të kontribuojmë në drejtim të plotësimit të një vakumi ligjor në këtë lëmi, si dhe në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Prandaj, jemi për miratim në parim, ndërsa kontributin tonë do ta japim në kuadër të Komisionit funksional.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në vazhdim, në emër të Grupit të AKR-së, si duket diskutimin e shfrytëzoi zonja Selmanaj.

Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, është paraqitur zoti Et'hem Çeku.

ET'HEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues,
Kolegë deputetë,
Ministra të nderuar,

Në parim, Aleanca i mbështet këto ndryshime që janë paraparë në këtë projektligj. Unë mendoj, që ministri, Ministria e Industrisë dhe Tregtisë, duhet ta ketë edhe për bazë, në aspektin e zhvillimeve të ardhshme strategjinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës, njërin nga dokumentet më të rëndësishme që është punuar për shumë kohë dhe nga një numër i madh i ekspertëve.

Ne, po them edhe një herë, e mbështesim në parim këtë projektligj. Do të japim edhe kontributin tonë në Komisionin Parlamentar, por edhe një herë i bëj ftesë ministrit, që gjithë spektrin e zhvillimit, brenda kompetencave të Ministrisë ta ketë për bazë strategjinë- një dokument tepër të rëndësishëm, i cili është miratuar edhe ka qenë i punuar nga një numër i madh i ekspertëve në ish- Qeverinë e kaluar.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Çeku!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, për fjalë është paraqitur deputeti, Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së në parim e përkrah. Të jemi të qartë, si Grup Parlamentar, ne mendojmë se me këtë ligj tentohet të rregullohet çështja e Agjencisë e nuk është fjala për rëndësinë apo të madhe apo të vogël të NMV-ve. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme edhe në strategjinë e zhvillimit edhe ndërmarrjeve kështu në përgjithësi edhe të vendeve tjera të regjionit, në fakt duhet të jenë baza kryesore e zhvillimit. Ne mendojmë se edhe Kosova përmes zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sigurisht, do të krijojë kushte edhe për rritjen e nivelit të punësimit, respektivisht zvogëlimit të papunësisë e padyshim duke marrë parasysh rolin e deritashëm të agjencisë, i cili, vërtet, ka pasur probleme në nivel të Ministrisë. Unë shpresoj dhe Grupi Parlamentar i LDD-së mendon se me këtë ligj një herë e përgjithmonë do të rregullohet çështja e Agjencisë ku nuk duhet të jetë çështje politike dhe ajo agjenci të krijojë bazat, respektivisht ky këshill t'i krijojë bazat e një agjencie

më tepër të natyrës profesionale, të natyrës së zhvillimit ekonomik, sepse shpresoj se shtylla kryesore, në të cilën do të mbështetet zhvillimi ekonomik i ardhshëm i Kosovës, është në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla se të mesme. Po e ceku vetëm një shembull të thjeshtë, por të mos ju lodh 95% të punësuarve në Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sot realizohen përmes ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Duke u mbështetur në të gjitha këto përvoja edhe të vendeve të mëdha edhe të vende në rajon , unë shpresoj që, definitivisht, me rregullimin e kësaj agjencie, me miratimin e këtij ligji, zbatimin e tij Agjencia do të kryejë punën e vet dhe do të jetë mbështetëse e madhe e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Ne si grup parlamentar e përkrahim, fuqimisht, këtë ligj dhe të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me avancimin, respektivisht, mbështetjen e zhvillimit të biznesit. Njëkohësisht, vërejtjet tona eventuale që janë të natyrës, qoftë juridike, qoftë të natyrës krejt teknike, do t'i implikojmë përmes Komisionit Parlamentar.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në vazhdim, në emër të Grupit” 7+,” është paraqitur për diskutim deputeti, Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Ju përshëndes juve edhe ministrat që ndodhen momentalisht në Parlament.

Po ashtu , kolegët e mi deputetë, zonjat dhe zotërinjtë,

Në parim Ligjin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ne e mbështesim sikur të gjithë të tjerët, sepse ky ligj do të ndihmojë shumë për zvogëlimin e shkallës së papunësinë që e kemi në Kosovë. Sigurisht, në këto ndërmarrje të vogla dhe të mesme do të punësohen të varfëritë , se të pasurit kërkojnë të punësohen në ndërmarrjet e mëdha.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Grupi Parlamentar SLS, mungon.

Tash i kemi në radhë diskutuesit. Për diskutim është paraqitur Sala Berisha- Shala.

SALA BERISHA- SHALA: Ju faleminderit!

I nderuari, zoti kryesues i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar ,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të filloj me Projektligjin do të doja të potencoja një sugjerim në formë të vërejtjeje për administratën e Qeverisë e që dëshiroj që kjo vërejtje të ketë kuptimin e një lëshimi teknik. Në fund të faqes së parë të këtij dokumenti, siç e do rregulli, është nënshkrimi i Kryeministrit të Republikës të Kosovës, zotit Thaçi.

Duke shfletuar më tutje gjejmë nënshkrimin e ish- kryeministrit, kjo dukuri na përcjell edhe në fund të këtij dokumenti. Le të jetë një vërejtje mirëdashëse për stafin teknik administrativ, që është përgjegjës për këtë çështje. Uroj që të mos përsëriten lëshime të tilla.

Domosdoshmëria për të nxitur e sidomos për t'i përforcuar bizneset e vogla dhe të mesme në Kosovë, është më se esenciale, prandaj zhvillimi i këtij sektori është vendimtar në ndërtimin e një qëndrueshmërie ekonomike dhe sociale.

Ligji për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, është shqyrtuar për herë të parë në Kuvend më 27 janar 2005, për t'u nënshtruar nga PSSP-ja në shtator po të këtij viti. Edhe në atë kohë ka pasur vërejtje të shumta që nuk janë marrë parasysh për t'u inkorporuar në ligj. Ajo që bie në sy dhe është interesant se gati të gjitha ato ligje që nuk kanë gjetur mbështetje nga opozita në legjislacionin e kaluar, kanë pasur vështirësi në implementim, si të tilla janë iniciuar procedurat për ndryshime nga vetë Qeveria e mëparshme. Dëshiroj t'i përmend disa prej tyre, siç është Ligji për eficiencën e energjisë, Ligji për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe shumë ligje në strategjinë legjislative për vitin 2008, që e kemi si dokumente pranë.

Duke analizuar dhe krahasuar ndryshimet e këtij draft ligji me Ligjin për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, shihet se disa nene kanë ndryshuar dhe disa prej tyre janë plotësuar. Ndryshimet kanë filluar nga neni 4 i ligjit paraprak, përkatësisht neni 1 i këtij drafti me të cilin rirregullohet klasifikimi i ndërmarrjeve në mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme, klasifikim i bazuar në kritere siç janë; numri i punëtorëve dhe qarkullimi vjetor i ndërmarrjeve. Mirëpo, përbrenda këtij kriteri të klasifikimit i kemi nën kritere për të cilat mendoj se janë ashpërsuar për ndërmarrjen në kuptimin e përfitimeve nga ky ligj, përderisa neni 2 i ligjit të mëparshëm nuk ndryshohet. Ky nen përcakton qëllimet e ligjit, i cili thotë-citoj: "Qëllimi i këtij ligji është të mbështetë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, me çka nënkuptohet se ky projektligj nuk mbështet mikrondërmarrjet sipas ndryshimit të bërë. Domethënë përjashton ose nuk i përfshinë mikrondërmarrjet në programet për nxitje dhe zhvillim. Kjo tendencë përforcohet edhe me plotësimin e nenit 5 të Ligjit, përkatësisht nenin 2 të këtij drafti që e kemi në shqyrtim.

Mendoj se Kosova ende nuk e ka kaluar një stad fillestar për nxitje të bizneseve e që të shkohet në një fillim apo shkallëzim të tillë, që do të ishte dekurajues për ndërmarrës ose mikrondërmarrjet sipas ligjit. Mendoj se do të ishte mirë që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, së bashku me ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj t'i ofrojë Kuvendit ose së paku Komisionit funksional në Parlament, një raport, një analizë të tillë për të ditur, ose për të kuptuar më mirë se cilat kanë qenë efektet, ose çfarë efektesh ka prodhuar zbatimi i këtij ligji nga viti 2005 e deri sot, qofshin ato pozitive apo negative.

Bazuar në aktivitetet e Qeverisë, përkatësisht, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në nenin 2 të projektligjit, përkatësisht nenin 5 të ligjit, mendoj se si mbështetje të mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme mund t'u shtohen edhe këto aktivitete, krijimi i benifiteve të ndryshme, lehtësira administrative gjatë regjistrimit, lehtësira fiskale, doganore, krijimi i fondeve qeveritare për biznese fillestare etj.

Më tutje, ndryshimet bëjnë një kapërcim nëpër nene, se a ka nevojë të ndryshohen dhe plotësohen edhe nenet tjera në këtë draft, mendoj se po. Plotësime duhet të ketë edhe tek përkufizimet në Ligjin e mëparshëm, mendoj se ndryshimet duhet bërë edhe në nenin 7 të ligjit, i cili nuk është përfshirë për ndryshime dhe plotësime. Është shumë e qëlluar që në këtë nen është paraparë përparësia e mbështetjes për zonat e varfra, po e përsërisë edhe tani, atë që e kam menduar dhe thënë me 2005, gjatë shqyrtimit të këtij ligji. Mendoj që shprehja: "zonat e varfra" të zëvendësohet me shprehjen: "komunat e varfra apo komunat e pazhvilluara". Ky ndryshim duhet të bëhet për arsye se do të ndikonte në

zhvillimin e komunave më pak të zhvilluara dhe jo të veprohet si në praktikën e mëhershme, ku përparësitë i kanë shfrytëzuar pjesët apo komunat e zhvilluara dhe është rritë në mënyrë drastike diferenca në zhvillim.

Është hera e parë që në Kosovë, komunave më pak të zhvilluara mund t'u japim një përparësi të mbështetur në ligj.

Bazuar në përvojën e vendeve që kanë kaluar fazën e tranzicionit, na jep të kuptojmë se ndërtimi i një politike ekonomike me ndërmarrjet e tilla, si njëfishë komplekse është e domosdoshme dhe esenciale. Mirëpo, ajo që i mungon infrastrukturës ligjore në Kosovë, është Ligji për ndërtimin për ndërmarrjet publike me të cilët do të rregullohet një sferë shumë e rëndësishme siç janë ndërmarrjet publike të ne e që në të shumtën e rasteve paraqiten si gëlltitësh të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, siç është rasti me KEK-un.

Në fund e mbështes këtë draft, duke shpresuar se gjatë amendimit do të plotësohet.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falënderojmë deputeten Berisha- Shala për kontributin, për diskutim është paraqitur deputeti Naser Osmani, gjegjësisht zëvendësministër.

NASER OSMANI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Ligji në fjalë edhe që është në zbatim që një kohë të gjatë, 2 vjet e 3-4 muaj, domethënë, nga nëntori i vitit 2005, në praktikë ka treguar që duhet të ndryshohet dhe të plotësohet. Kjo vjen në kohën më të mirë, domethënë në një gjendje të re politike, në kohën pas statusore kur perspektiva e zhvillimit të ekonomisë së Kosovës, në përgjithësi, duhet të mbështetet në ekonominë e vogël dhe në ekonominë mesme. Konsideroj që do të rregullohen disa raporte të Qeverisë me biznesin, por jo një kuptimin e asaj të një ngufatje të biznesit, por raportet që kanë të bëjnë më tepër në atë që quhet, një edukim apo një ngritje e nivelit të kulturës së biznesit në përgjithësi.

Krejt kjo që është paraqitur para nesh sot përmbledhet sidomos në nenin 4, që tregon këto raporte të Qeverisë me biznesin, veçanërisht në mbështetje të cilat i ofron Qeveria biznesit të vogël, zhvillimin e kornizës së politikave afariste, grumbullimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre, sidomos dhe vlerësimin e kredive lehtësuese, të cilat duhen t'i ketë biznesi në këtë kohë. Prandaj, konsideroj që kjo pjesë mbulohet mirë dhe do të krijohen disa relacione të reja, të mira, të bashkëpunimit në mes institucioneve të Qeverisë dhe biznesit në përgjithësi, duke përfshirë edhe mikro-biznesin, ekonominë e vogël dhe ekonominë e mesme.

Ajo që kisha dashur të them edhe lidhur me këtë ligj ka të bëjë me Këshillin e Agjencisë. Kjo duhet të rishqyrtohet edhe një herë nga Komisioni përkatës, për arsye se konsideroj që këtu duhet të krijohet një relacion më i ngushtë mes ministrisë përkatëse dhe asociacioneve të biznesit, duke mos marrë atë shabllonin e përfaqësimit të gjitha qeverive, ministrive në Këshill. Domethënë, duhet të bëhet vetëm një korrigjim të një përgjegjësie apo të një koordinimi më të mirë të funksionimit dhe krijimit të raporteve të reja në mes Qeverisë dhe biznesit. Konsideroj se kjo duhet të kalojë pasi që të bëhen edhe disa shqyrtime apo përmirësimet të tjera teknike, të cilat janë paraqitur, sidomos kur është hartuar ky propozim në kohën e kompetencave të UNMIK-ut.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për diskutim është paraqitur deputeti Zef Morina, në vazhdim.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti Kryesues,
Të nderuar ministra,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Sigurisht që të gjitha vendet të cilat kanë kaluar tranzicionin, siç është edhe Kosova, rëndësi të veçantë i kanë kushtuar zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke pasur parasysh se ato mund të jenë të shpërndara në të gjitha pjesët ku ka qytetarë, jo vetëm në qendrat e mëdha, por edhe nëpër fshatra dhe në komunat tjera. Andaj, ky ligj, mendoj se ka një rëndësi të veçantë dhe ne si institucione duhet të kemi parasysh që ligji, të cilin tani do ta miratojmë, të krijojë lehtësira të nevojshme, sidomos në një fazë të caktuar, për ndërmarrjet të cilat kanë kapacitete dhe të cilat, ndoshta, për shkak të ndryshme nuk kanë mundësi t'i realizojnë ato.

Ne jemi dëshmitarë, që edhe gjatë viteve të '90-ta, kur Kosova ishte e okupuar ka pasur ndërmarrje të vogla dhe të mesme, të cilat nuk kanë gëzuar të drejtën ligjërisht sikur të gjitha ndërmarrjet e tjera për shkak të ligjeve diskriminuese nga regjimi. Shpresoj se ky ligj, i cili, vërtet, duhet ta ketë parasysh, sepse Kosova nuk ka kapacitete të mëdha të ketë ndërmarrje të mëdha që dëshironim edhe ne tani për tani, por ndërmarrje të vogla dhe të mesme ka mjaft në Kosovë. Fatkeqësisht këto nuk janë duke u trajtuar ashtu si duhet, pasi që ligji, të cilin më herët e kemi pasur, vërtet, ka pasur shumë mangësi, dhe pikërisht ndryshimi dhe plotësimi tash i këtij ligji, shpresoj se do të ndikojë dukshëm në punën profitabile të këtyre ndërmarrjeve, duke u krijuar kushte më të mira.

Çka nënkuptojmë me kushte më të mira? Natyrisht se ne do të krijojmë lehtësira në sistemin e taksave, sistemin e tatimeve të përgjithshme, duke u dhënë mundësi apo lehtësira në prodhimet gjysmë produkteve apo të tjera, si dhe në kreditim. Tani Kosova është shtet. Ka mundësi që përmes sistemit bankar të krijojë një formë të kreditimit, duke u dhënë mundësi që ato mjete të cilat do të merren nga bankat, të kenë një kamatë apo shkallë të interesit shumë më të vogël për një periudhë shumë më të gjatë.

Unë dëshiroj këtu të theksoj edhe një vërejtjen që shpresoj se do të analizohet edhe nga kolegët deputetë, sidomos gjatë amendamentit. Agjencia e cila do të krijohet të mos jetë i politizuar për arsye se do të krijonte një konfuzitet të ndërmarrjet, duke pasur parasysh natyrisht që sistemet politike apo qeveritë ndërrohen, ndërsa ndërmarrjet dëshirojnë të kenë punën e tyre në mënyrë permanente, por këto agjenci të formohen, vërtet, nga njerëzit profesionistë, të cilët e dinë rëndësinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. E dinë se, vërtet, këto janë tani për tani faktori kryesor i zhvillimit ekonomik të vendit. Shpresoj që këtu edhe ne do të japim kontributin tonë, qoftë si deputet, qoftë edhe si përfaqësues të partive politike, në mënyrë që, vërtet, ne ta kemi një zhvillim, ashtu siç e kanë pasur të gjitha shtetet, të cilat tani kanë një zhvillim shumë më të hovshëm ekonomik, pikërisht duke u nisur nga zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Vazhdojmë me diskutuesit. Diskutuesi i radhës është deputeti, Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar ministra

Deputetë të respektuar,

Kur në një vend ekzistojnë dy ligje që e rregullojnë një materie, ose përafërsisht të njëjtën materie, zakonisht paraqiten, ato quhen kolizione, përplasje.

Në Kosovë ekziston një dokument ligjor, i cili quhet Ligji për organizatat biznesore. Është ligj mjaft i mirë, ligj konform me standardet bashkëkohore. Sipas atij ligji, për çudi, unë mendoj të mirë, sepse në literaturën europereëndimore dhe amerikane, po thuaj se nuk njihet termi ndërmarrje. Në këtë ligj quhen organizata biznesore dhe ato klasifikohen në katër tipa. Quhet ndërmarrje vetëm ndërmarrja personale biznesore, ndërsa partnershipi, ose ortakëria si bashkim me kontratë i këtyre, i ndërmarrjeve biznesore personale. Ndërsa, organizatat biznesore kategorizohen në shoqëri aksionare, që mund të jenë - me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare me përgjegjësi të pakufizuar edhe shoqëri aksionare homanditore. Tani paraqitet dokumenti që i trajton ndërmarrjet - të mëdha, të vogla, e të tjera.

Prandaj, ju lutem, në procedurën e mëtejme duhet medoemos të paralelizohen këto edhe termat të harmonizohen. Pastaj do të isha angazhuar, sepse në aktet ligjore nuk ekziston as termi ndërmarrje e vogël, e mesme, e madhe, varet prej vendit. Po e zëmë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndërmarrja e madhe e ka një nocion krejt tjetër, ka dimensione, ka kriteret tjetër fare, por jo veç në SHBA, por edhe po e zëmë në shtetet me JDP-i shumë të lartë, e tjera. Prandaj, këtë do t'ia kishim lënë ministrit, ju lutem, që me akt nënligjor, në konformitet me rrethanat, të japë udhëzime, se në qoftë se kërkojmë prej ministrit, po e zëmë, përgjegjësi, ne duhet t'i japim autorizime, që në përshtatje me rrethanat, ta bëjë përcaktimin e kriterëve për definimin e këtyre organizatave biznesore.

Edhe në këtë tekst, po jo vetëm në këtë tekst, ju lutem, përdoret gjithmonë shumësi, e është gabim. Në ligj duhet vetëm njëjësi. Nëse thuhet, bie fjala, qytetarët kanë të drejtë, del se unë, ani pse jam qytetar, nuk kam kurrfarë të drejte, duhet ta kem së paku edhe një të tjetër, që të kërkojmë ne të drejtë. Prandaj, është rregull elementare e onomoteknikës që një njëjës, gjithmonë në njëjës. Kush mundet më pak, ajo është, bile ka për këtë, si të them, libra.

Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Smaka.

Diskutuesi i fundit është deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë jam deputet i ri. Deri tash u përmend pothuaj për çdo ligj se është i rëndësishëm, por kam frikë ta përmend se janë shumë të rëndësishme këto ndryshime. Për të mos shkuar edhe më larg, po e përmend që zoti Kryeziu e pat shpikur edhe një fjalë “ligj fisnik”. Realisht, në ligjin e miratuar në vitin 2005, ndryshimet e paraqitura, janë bërë në rrethana politike krejtësisht të tjera dhe ne sot ndryshimet po i diskutojmë në rrethana tjera politike. Unë konsideroj se ndryshimet e propozuara për këtë projektligj duhet të jenë konform rrjedhave politike që kanë ndodhur para disa ditëve. Pra, mendoj se është një moment, që edhe përmes këtyre propozim-ndryshimeve të kihet parasysht ajo që e

theksoi zoti Morina, në njëfarë forme lehtësira, domethënë, në biznes. Ne e dimë në cilat rrethana ekonomike po kalojmë, kështu që nga përvoja që jemi duke kaluar, si qytetarë, e veçanërisht, biznesi pas luftës, realisht, deri tash asnjëherë nuk është menduar në këtë drejtim.

Ajo që mua më ra në sy dhe që është e paqartë, ka të bëjë me klasifikimin e ndërmarrjeve. Realisht, këtu po propozohet edhe mikrondërmarrje, që aludohet, se duhet t'i ketë 9 punëtorë, ndërsa ndërmarrjet e vogla të kenë prej 50 deri në 249 punëtorë. Tash shtrohet pyetja si do të quhen ndërmarrjet që kanë prej 9 deri në 49 punëtorë? Mendoj se po lihen disa zbrazëtira, me të cilat, sigurisht, gjatë zbatimit të ligjit do të kenë probleme jo Ministria, por ata që do të merren me biznes. Prandaj, unë mendoj se gjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm nëpër komisione, duhet të kihet parasysh edhe disa masa, të cilat, realisht, vendet që kanë kaluar tranzicionin si Kosova, i kanë krijuar dhe, sigurisht, ne e presim edhe intervenime të biznesit nga jashtë, kështu që ne, me ligje, mendoj që është koha të krijojmë komoditet, që, sigurisht, kjo sferë të ndikojë edhe në zvogëlimin e papunësisë së madhe në Kosovë.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Berisha!

Pra, diskutimet lidhur me këtë projektligj u shteruan, por ne jemi para një dileme. Sipas marrëveshjes, termini i paraparë për shqyrtimin e Projektligjit mbaron në orën 14,00, kemi pak kohë për të filluar një projektligj tjetër të radhës dhe unë kërkoj mendimin tuaj, domethënë, ta përfundojmë apo të vazhdojmë edhe një projektligj, por nga ora 16,00, dihet se e kemi terminin për votim të projektligjeve të shqyrtuara, por ministri i ligjit vijues nuk është këtu. Vetëm kemi një frikë që për ditën e hënë, kur parashihet seanca e radhës, nuk do të na mjaftojë koha për t'i shqyrtuar pakon, ta quaj ashtu të ligjeve që i kemi ndarë për shqyrtim dhe që i kemi marrë materialet. Ndërkaq, të martën na pret një seancë për shqyrtimin e dytë të projektligjeve nga pakoja e Ahtisarit, kështu që do të ishte mirë të procedojmë edhe me një projektligj, nëse ju jeni të gatshëm sot, në mënyrë që të hënë ta kemi të sigurt se do t'i shterojmë ligjet që i kemi në agjendë. Si duket, shumica janë për të vazhduar edhe me një projektligj dhe vazhdojmë me projektligjin e pestë të paraparë për sot:

- Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij, në parim. Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve ta paraqesë këtë projektligj.

IDRIZ VEHAPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe tregtimi i produkteve të cilat përmbajnë këtë material.

Fushëveprimi i këtij projektligji është krijimi i një infrastrukture efikase ligjore për trajtimin e organizmave të modifikuar gjenetikisht, duke u bazuar në legjislacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Arsyeja e propozimit të këtij projektligji është eliminimi i vakumit ligjor, që ka të bëjë me këta organizma, të cilët tashmë janë bërë realitet i ri në shoqërinë bashkëkohore. Prandaj, vendosja e bazës ligjore është nevojë e

kohës, në të cilën po jetojmë dhe janë krijuar standardet të cilat duhet të respektohen në punën me organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Projektligji ka një strukturë komplete e gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore të shtjelluar në 7 kapituj, me gjithsej 39 nene dhe 7 anekse, të hartuara sipas teknikës juridike bashkëkohore, në harmoni me standardet dhe Direktivën 2001/18 të Parlamentit Evropian.

Projektligji është hartuar në përputhje me nenin 36 të Rregullores së punës së Qeverisë së Kosovës, nr. 1/2007. Gjatë hartimit të këtij projektligji, si model bazë janë marrë: ligji slloven, austriak dhe ai gjerman. Projektligji është në harmoni të plotë me parimet kryesore të Acquis Communautaire të BE-së. Shpenzimet për hartimin e këtij projektligji nuk ka pasur, pasi që në hartimin e tij janë angazhuar ekspertët vendorë nga Ministria e Bujqësisë.

Zbatimi i këtij projektligji, në pjesën më të madhe të tij nuk ka implikime financiare në buxhetin e konsoliduar të Republikës së Kosovës. Shpenzimet mund të dalin nga zbatimi i këtij projektligji, rreth formimit të komisioneve të Këshillit Shkencor dhe Këshillit Etik, që do të themelohen me akte të veçanta nënligjore. Sido që të jetë, konsiderojmë se me zbatimin e këtij projektligji pritet që të hyrat të jenë më të mëdha se sa shpenzimet e tij.

Duke parë rëndësinë e këtij projektligji me të cilin do të përmbushet një vakum ligjor lidhur me organizmat e modifikuar gjenetikisht për të cilët edhe debatohet edhe në vendet e Bashkësisë Evropiane, ju kisha lutur që ta votoni në parim, ndërkaq komisionet funksionale këtë ligj mund ta plotësojnë dhe ta ndryshojnë.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Ministër!

Pas prezantimit të ministrit, hapim diskutimin për këtë projektligj.

Kryetari i Komisionit përkatës parlamentar për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor nuk është këtu, kalojmë te grupet parlamentare. Është paraqitur për diskutim, deputeti Berat Luzha, nga radhët e PDK-së.

BERAT LUZHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Me Ligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht, mëtohet të krijohet mbrojtje ligjore nga organizmat e modifikuar, në mënyrë që të sigurohet ushqim i shëndosh dhe mbrojtja e shëndetit të njeriut, si dhe mbrojtja e mjedisit.

Është karakteristikë se për zbatimin e ligjit do të obligohen tri ministri: e Bujqësisë, e Mjedisit dhe e Shëndetësisë. Duket se në këtë projektligj, në tekstin e tij, kemi persona juridikë që janë të pa emërtuar, si Komisioni, autoritetet kompetente etj.

Ministria me këtë ligj formon Këshill Shkencor që është e arsyeshme, por nuk ka pse të formojë edhe një këshill etik për dhënien e këshillave etike, domethënë është diçka krejt e paarsyeshme. Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht është vlerësuar nga Agjencia për Integritet Evropian se nuk është në përputhje të plotë me Acquis Communautaire të Bashkësisë Evropiane, prandaj i mbetet edhe shumë punë për të bërë Komisionit funksional.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike vlerëson se ky ligj duhet të miratohet në parim, kurse vërejtjet do t'ia paraqesim Komisionit përkatës.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, nuk është paraqitur askush. Tash u paraqit kryetari i Grupit, më fal .

EQREM KRYEZIU: Duket se sikur ka ndodhur një ndryshim gjenetik edhe në grupin tim, se deri pardje nuk ka folur askush e tash të gjithë po flasin. Unë nuk guxova të paraqitem fare për fjalë, por meqë erdhi puna, natyrisht ne e mbështesim në parim këtë projektligj, por megjithatë duke theksuar se ai Komision etik është shumë i rëndësishëm, sepse është e vërtetë se shkenca ka një përparim shumë të madh në botën moderne, që në shumicën e rasteve ka natyrën e vet, përparimet edhe i shikon ato vlerat etike.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti kryesues i Grupit Parlamentar dhe anëtar i Kryesisë. Kalojmë te Grupi Parlamentar i AKR-së, është paraqitur Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, ju që jeni këtu,

Të nderuar deputetë,

Për të mos e zgjatur shumë, pas shqyrtimit të këtij projektligji, Grupi Parlamentar i AKR-së, ka vendosur që ta përkrahë në parim, përkundër disa vërejtjeve, të cilat do t'i artikulojë në etapën vijuese dhe këto vërejtje gjithsesi se do të shkojnë në komisionet funksionale të cilat do të japin edhe vlerësimet e tyre.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete Hajzeraj. Për fjalë është paraqitur, në emër të Grupit të AAK-së, Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti Mministër,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikusht është specifik dhe është një lëmi e re në shoqërinë kosovare. Ashtu siç e tha edhe ministri, ky projektligj mbulon zbrazëtimin ligjorë në fushën e mbrojtjes nga organizmat e modifikuar gjenetikusht. Qëllimi i këtij projektligji është për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisit nga lirimi i qëllimshëm, që mund të bëhet në mjedis i organizmave të modifikuar gjenetikusht, por edhe gjatë shitjes në treg të prodhimeve që përmbajnë apo përbëhen nga organizmat e modifikuar gjenetikusht. Pra, me këtë projektligj kryhet korniza ligjore me parimet e përgjithshme për përmirësimin e cilësisë, rritjes së karakteristikave ushqyese, rritjes së tolerancës së stresit në kulturat bujqësore, promovimit të rezistencës ndaj sëmundjeve, pesticideve, hibrideve, ndikimit potencial në shëndetin e njeriut dhe mjedisit.

Qasja lidhur me këtë çështje në botë sot është e ndryshme, sidomos në shoqëritë demokratike të avancuara. Aty ekziston një dallim në mes të qeverive dhe të publikut dhe zhvillohet një debat i gjerë. Derisa qeveritë në vendet industrializuara e shohin ushqimin gjenetik si mundësi për rritjen e industrisë ushqimore të kësaj kategorie në të

ardhmen, në anën tjetër konsumatorët hezitojnë ta pranojnë. Për të tjerët kjo është edhe çështje etike, ofendim për parimet lidhur me raportet në mes njerëzimit dhe natyrës. Kurse, në Kosovë nuk vërehet se ka ndonjë prodhues të ndonjë organizmi të modifikuar gjenetikisht dhe nuk ka informata të mjaftueshme lidhur me këtë. Përndryshe, projektligji është i përpiluar mirë, janë të përcaktuara kushtet për lirim e organizmave gjenetikisht të modifikuara, procedurat, informimi i publikut dhe shkëmbimi i informatave në mes mekanizmave përgjegjës.

Është paraparë, gjithashtu, mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nga inspektorët e autorizuar nga ministritë përkatëse. Janë paraparë dënimet me gjobë, të cilat sillen prej 1000 euro gjer në 20.000 euro, varësisht nga shkalla e shkeljes së ligjit.

Projektligji është në pajtim me disa konventa apo vendime të Bashkësisë Evropiane, por parimet e obligueshme ligjore të legjislaturës evropiane nuk janë të përfshira plotësisht. Prandaj, këtu kemi një vërejtje të përgjithshme që ka të bëjë me Ministrinë që duhet të përfshijë së paku tri rregullore, që janë të legjislaturës evropiane, por edhe vendime të tjera, të cilat janë të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, sidomos ato të cilat kanë të bëjnë me formimin e autoritetit evropian për sigurinë e ushqimit dhe të cilat përcaktojnë procedurat për sigurinë e ushqimit.

Sa i përket vërejtjes tjetër, e kemi një vërejtje të veçantë e cila lidhet me nenin 32 dhe që ka të bëjë me zbatimin e Protokollit të Kartagjenës për biosigurinë nga autoriteti kompetent. Propozojmë që të plotësohet, ashtu që këto masa të jenë në pajtim me vendimin 2002/628 EC.

Sa i përket kostos buxhetore, nuk parashihet të ketë ndonjë kosto të lartë buxhetore, gjegjësisht vlerësohet që ajo kosto të jetë 15 mijë e 540 euro, mund të ketë edhe shpenzime shtesë vjetore 7.500 euro. Gjithashtu, pritën të hyra në buxhetin e Kosovës nga pagesat e zbatimit të ligjit. Meqenëse projektligji i plotëson kërkesat e nevojshme, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah, në parim, por kërkojmë që projektligji të përpunohet më tej dhe, sidomos, propozojmë që gjatë përpunimit të tij, të bëhen dëgjime publike, sepse është i nevojshëm grumbullimi i informatave nga ata që kanë më shumë njohuri lidhur me këtë çështje.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: E falënderojmë deputeten Gjylnaze Syla për vërejtjet dhe sugjerimet koncize. Në vazhdim, në emër të Grupit të LDD-së është paraqitur deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së e përkrah në parim ligjin edhe pse Kosova nuk është në këtë periudhë të zhvillimit, nuk është shumë e tanguar nga këto fenomene të ndryshimeve gjenetike, mirëpo duke e llogaritur mundësinë e zhvillimit të shkencës dhe të teknologjisë, që ka sot zhvillim eksponencial, atëherë, padyshim që aplikimi i këtij ligji do të ketë edhe ndikimet pozitive. Veçanërisht në këtë ligj do të japim kontributin tonë kur është fjala për raportin e harmonizimit të tij me konventat ndërkombëtare, respektivisht ato evropiane. Mendojmë se në parim ligji i plotëson të gjitha kushtet për procedim të mëtejshëm.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Ramosaj!

Në emër të Grupit "7+", është paraqitur për diskutim Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsedavajući!

Važnost donošenja ovog Nacrta zakona odnosi se na obezbedjenja stvaranja zakonskog okvira za zaštitu ljudskog zdravlja i životne sredine, u slučajevima kada se vrši namerno ispuštanje genetički modifikovanih organizama u okolini, i stavlja ju se na tržište proizvodi koji sadrže genetički modifikovane organizme.

Parlamentarna grupa „7+“, smatra da je ovaj Nacrt zakona sveobuhvatan, da detaljno reguliše pitanje iz ove oblasti i da ispunjava uslove za jedan zakon ovakve prirode i u načelu ga podržava. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pra, nuk kemi diskutues të tjerë, u shterua debati lidhur me këtë projektligj. Unë ju falënderoj për mirëkuptimin që patët për ta shtruar edhe këtë projektligj për shqyrtim, në këtë fazë. Ju ftoj që në orën... Edhe tre janë, nuk janë edhe dy dhe kemi mungesë të ministrave përkatës që ta bëjnë prezantimin. Jo, në katër është vendimi vetëm për t'i votuar ligjet që i kemi shqyrtuar sot, për t'i miratuar në parim.

Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës së pasdites, në orën 16,00

KRYETARI: Të nderuar deputetë dhe ju dy ministra, Vazhdojmë seancën e pasdites lidhur me votimin në parim të projektligjeve të shqyrtuara në pjesën e paradites. Mirëpo, para se të fillojmë me votim, neve na kanë mbetur prej të gjitha këtyre ligjeve edhe 3 ligje. A jeni dakord që të hënën ta kryejmë edhe debatin, edhe votimin në pjesën e paradites.

Mirë, edhe të hënën vendosim, nëse dikush s'është dakord për shkak të vendimit që e kemi marrë.

Konstatohet se në sallë janë të pranishëm 69 deputetë, edhe pse kartela janë 82. Prandaj, fillojmë me projektligjin e parë. Në sallë janë tani 74 deputetë.

- Miratimi në parim i Projektligjit për ushqimin

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ushqimin.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe referues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Edhe pse nuk është përcaktuar këtu, pasi në debat kanë kërkuar dhe Komisioni për Shëndetësi dhe Çështje Sociale, le të jetë edhe ai i angazhuar për leximin e dytë.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime, sipas Rregullës 35.1.

Ju e dini, tash jemi në votim, nuk ka debat edhe pse është paraqitur për diskutim Gani Buçinca.

Vazhdojmë me ligjin e dytë të sotshëm:

- Miratimi në parim i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës

Kërkojmë nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, si komision funksional dhe referues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime, sipas Rregullës 35.6.

Në radhë është:

- Miratimi në parim i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 73 vota “për”, asnjë votë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Ju njoftoj se në sallë janë 75 deputetë.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe referues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime, sipas Rregullës 35.6.

Vazhdojmë miratimin në parim të

- Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.
Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe referues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime, sipas Rregullës 35.6.

Tani është në radhë miratimi në parim i

- Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.
Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport, si komisionin funksional dhe referues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime, sipas Rregullës 35.6

I fundit për sot është

- **Miratimi në parim i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht**

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 70 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe referues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime, Rregulla 35.6.

Të nderuar deputetë, ky ishte ligji i fundit për votim për sot. Shihemi të hënën, në orën 10,00.

Më 3 mars 2008

Vazhdimi i Seancës plenare

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën e sotme, më 3 mars 2008.

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Zoti zëvendëskryeministër,

Vazhdojmë punën e seancës së filluar më 26 shkurt 2008.

Në sallë janë 67 deputetë dhe janë krijuar kushtet që të fillojmë punën.

Pikë e parë e rendit të ditës në vijim është:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për taksën e vendosjes.**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin për Tregti dhe Industri, zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin.

LUTFI ZHARKU: I nderuar Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Ligji për taksën e vendosjes luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm të turizmit dhe politikave zhvillimore në Kosovë. Në të njëjtën kohë, ky ligj paraqet një premisë të qëndrueshme juridike për sigurimin dhe mbrojtjen e shërbimeve të ofruara në objekte turistike dhe hoteliere, në përputhshmëri me direktivat e konventave ndërkombëtare, me legjislacionet dhe praktikatat e Unionit Evropian dhe vendeve anëtare të tij, si dhe kontribuon në përfshirjen e Kosovës në rrjedhat ndërkombëtare ekonomike.

Me këtë ligj do të rregullohet taksa e vendosjes për shërbime të ofruara nga ana e objekteve turistike dhe hoteliere, të cilën e paguan personi që shfrytëzon shërbime të vendosjes. Taksa e vendosjes propozohet të jetë në lartësi prej 0.50 euro deri në 1.50 euro për person, varësisht nga çmimi i fjetjes. Ligji përcakton edhe kategoritë, të cilat janë të lira nga pagesa e kësaj takse, siç janë: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat në rehabilitim mjekësor, invalidët e luftës, si dhe kushtet për shfrytëzimin e këtij lirim.

Projektligji parasheh që shfrytëzimi i mjeteve të grumbulluara nga taksa e vendosjes të përcaktohet me akte nënligjore. Natyrisht që ligji parasheh edhe dispozita ndëshkimore lidhur me zbatimin e tij.

Të nderuar deputetë,
Duke marrë parasysh rëndësinë dhe domosdoshmërinë e ndërtimit të një baze të qëndrueshme juridike për taksën e vendosjes, ju propozoj që, pas procedurave të shqyrtimit, ky projektligj të miratohet në Kuvend.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit për prezantimin!
Hap debatin.
Shkojmë sipas radhës së grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, fjalën e ka Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: **Përshëndetje**, zoti Kryetar!
Përshëndetje zëvendëskryeministër,
Përshëndetje ministra,
Përshëndetje të nderuar kolegë,

Projektligji për taksën e vendosjes, është një projektligj i cili **synon** të mbulojë vakumin që ka ekzistuar deri më tash në legjislacionin tonë. Rregullorja e UNMIK-ut, që ka ekzistuar deri më tash, nuk i ka mbuluar në mënyrë të duhur dhe nuk i ka specifikuar ato çfarë i specifikon ky ligj.

Në të vërtetë, përmes këtij ligji, bëhet e mundur që Qeveria e Kosovës të vendosë kontrollin mbi objektet e vendosjes dhe në këtë mënyrë të ndikojë edhe në përmirësimin e buxhetit të Kosovës, si dhe të ketë mundësi t'i evidentojë dhe kontrollojë në mënyrë më të rregullt të gjitha veprimtaritë që kanë të bëjnë me vendosjen, respektivisht akomodimin.

Nga ky ligj do të ketë rrjedhoja pozitive, sepse implikimet buxhetore do të jenë pozitive për buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Gjithashtu, Grupi Parlamentar i PDK- së ka konstatuar se, vërtet, ky ligj është në pajtueshmëri me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe është në përputhshmëri me te, prandaj nuk ka ndonjë arsye pse ky ligj të mos shkojë në procedim të mëtutjeshëm.

Duke pasur parasysh këto, Grupi Parlamentar i PDK- së do ta përkrahë në parim këtë ligj.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, Kolë Berisha.

KOLË BERISHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër dhe Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për taksën e vendosjes është lexuar me kujdes dhe është mirë që më në fund edhe ky segment i jetës ekonomike të Kosovës, i cili, megjithatë, paraqet një burim të mirë për buxhetin e konsoliduar të Kosovës, po vihet brenda një kornize ligjore dhe rregullohet dhe sanksionohet me ligj.

Duhet thënë se Projektligji në fjalë, nga aspekti gjuhësor, teknik dhe as ai përmbajtësor nuk dallon shumë nga tekstet e tjera që i kemi pasur deri më tash në shqyrtim.

Projektligji ka një gjuhë juridike, do të thotë, jo të nivelit të kënaqshëm, nuk ka një strukturë të shthurjes së lëndës. Për shembull, në vend se pas dispozitave të përgjithshme dhe të atyre që shpjegojnë terminologjinë të përdorura në këtë projektligj, fillohet me “personat të cilët lirohen nga pagesa e taksës së vendosjes”, duhet të jetë e kundërta. Madje, edhe provat që kërkohen për të dëshmuar këtë lehtësi ose mos pagesë të taksës së vendosjes, janë joadekuate me kriteret që kërkohen për personat që lirohen nga pagesa. Mendoj, po ashtu, se ndëshkimet janë të vogla kur dihet se në shtetet e tjera, ikja nga pagesa e taksës së vendosjes, dënohet shumë më rëndë, ndoshta, se sa ndonjë vepër tjetër penale.

Megjithatë, duke pasur parasysh se Kosova ka nevojë për një projektligj të tillë dhe anën pozitive të ligjit që rregullon këtë materie, Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet këtë ligj në parim.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Përsëritje për zëvendëskryeministrin, për Kabinetin qeveritar,

Unë do të flas, njëkohësisht, edhe në emër të Komisionit. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, në mbledhjen e datës 25. 2. 2008 e shqyrtoi Projektligjin për taksën e vendosjes, duke paragjykuar se ky komision edhe do të jetë edhe komision raportues. Sipas komisionit, materia të cilën e rregullon ky projektligj, është e rëndësishme, ngase, përveç faktit që rregullon dhe krijon të drejta, obligime e përgjegjësi në fushën përkatëse, ky projektligj krijon edhe parakushtet për të hyrat e kësaj veprimtarie që në Kosovë është njëra nga veprimtaritë më të hershme, më të shtrira dhe më rentabile.

Komisioni ka evidentuar disa vërejtje parimore, që kanë të bëjnë me shumë me standardet tekniko-juridike. Disa dispozita nuk janë radhitur sipas rëndësisë, disa janë deklarative dhe nuk krijojnë obligime. Disa janë të karakterit mohues, në vend të dispozitave pohuese dhe disa norma krijojnë të drejta apo obligime për ndonjë subjekt, pa e përcaktuar në mënyrë të saktë autoritetin, për shembull: organin e turizmit, organin kompetent, e të tjera. Këto shprehje krijojnë dilema dhe mundësi për keqinterpretime.

Komisioni, gjatë shqyrtimit, do të angazhohet për përmirësimin e tyre.

Nga mbledhja e mbajtur, Komisioni nxjerr rekomandimin se: Projektligji për vendosjen e taksës, pranohet në parim.

Dëshiroj ta shtroj edhe një kërkesë të Komisionit, zoti Kryetar.

Meqenëse projektligjet në përgjithësi përmbajnë lëshime që kanë të bëjnë me kërkesat e standardizimit tekniko-juridik dhe gjuhësor, si dhe nga fakti se tani në kuadër të Administratës së Kuvendit të Kosovës është themeluar Shërbimi për Standardizim dhe Përafrim me Legjislacion me ekspertë përkatës, Komisioni kërkon që para dhe gjatë shqyrtimit të projektligjeve nëpër komisione, Shërbimi për Standardizim dhe Përafrim t'i ofrojë me shkrim: këshilla, sugjerime dhe propozime përkatëse, me qëllim që projektligjet, në aspektin tekniko-juridik, të jenë sa më në nivel.

Kjo kërkesë bëhet për shkak të ekonomizimit sa më të mirë të kohës gjatë shqyrtimit të projektligjeve, ashtu që komisionet të merren me punë përmbajtësore.

Në këtë aspekt edhe Grupi Parlamentar i AKR-së Projektligjin për taksën e vendosjes, e përkrah në parim.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!
I nderuar zoti zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar
Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe e mbështet projektligjin. Ky projektligj do të plotësojë një vakum në legjislacionin ekonomik, sidomos, gëzon fakti se me anë të këtij ligji do të ketë rritje edhe të hyrave buxhetore.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, përveç se e përkrah, do të japë edhe kontributin e vet në Komisionin funksional dhe në komisionet kryesore nëpër të cilat do të kalojë projektligji.

KRYETARI: Faleminderit , zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, zoti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti Kryetar! Përshëndetje për ekipin qeveritar dhe për kolegët e nderuar deputetë,

Sa i përket Ligjit për taksën e vendosjes, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji dhe arsyeshmërinë, që e tha shumë bukur ministri për Ekonomi, Tregti e Industri, mirëpo, duke marrë parasysh legjislacionin ekzistues në Kosovë dhe mundësitë e vjeljes së taksave, unë kam shpresë se do t'i shtyjme edhe ligjet tjera të cilat do të mundësojnë, sepse ka mundësi që ky ligj të mbetet si i vetmuar në kuptimin e rregullimit të çështjes së bizneseve të turizmit. Mirëpo, duke marrë parasysh harmonizimin e mundshëm të tij, respektivisht, harmonizimin me normat juridike në fuqi të shumicës së vendeve evropiane, shpresoj se edhe ky ligj, në kuptimin e zhvillimit të biznesit të kësaj fushe, respektivisht, të konsekuencave që dalin , qoftë në rregullimin, standardizimin dhe vendosjen e akomoduar të turistëve apo të të gjithë mysafirëve të mundshëm – do të japë mundësi që këto mjete të kthehen në formë të investimeve në këto biznese apo në infrastrukturën në përgjithësi.

Andaj, unë shpresoj se ky ligj do të mbulojë një pjesë të hapësirës që ka mbetur si vakum nga periudha e kaluar që faktikisht shihej në zhvillimin e këtij biznesi.

Grupi Parlamentar i LDD- së në parim, e përkrah këtë ligj. Pra, shpresojmë se do të japim kontributin tonë në definimin e saktë të normave të taksave dhe në aspektin e rikthimit të këtyre mjeteve në bizneset ekzistuese, në infrastrukturë të ndërmarrjeve hoteliere apo të ndërmarrjeve të tjera që janë mbështetëse. Ne do ta japim kontributin tonë në komisionet gjegjëse dhe në parim e përkrahim.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+” deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, i nderuari Kryetar i Parlamentit të Kosovës!

Ju përshëndes juve dhe stafin tuaj, zëvendëskryeministrin dhe të gjithë ministrat që sot janë më shumë këtu. Po ashtu, i përshëndes mysafirët e pranishëm!

Zonja e zotërinj deputetë,

Sot kemi para nesh një ligj, të cilin duhet ta miratojmë, sepse pa këtë ligj shumë gjëra s'mund t'i rregullojmë pastaj, sikur ato që na vijnë prej jashtë. Grupi “7+” e mbështet këtë ligj, sigurisht, edhe në komisione do ta japim kontributin tonë.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të SLS-së, mungon.

Tani është radha e deputetëve. Në sallë janë 75 deputetë.

Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje, zoti zëvendëskryeministër,
Përshëndetje ministra,

Do të isha ndalur vetëm në dy pikat e ligjit, më saktë të them – në nenin 3 pika 1, që përcakton taksën e vendosjes, të cilën nuk do ta paguajnë, domethënë janë fëmijët deri në moshën 12 vjeçare, personat me aftësi të kufizuara, personat të cilët komisionet kompetente mjekësore i dërgojnë për kurim klimatik e tjerë. Pastaj, personat të cilët bëjnë punë stinore, ekskursionet, shtetasit e huaj si dhe invalidët e luftës.

Vërejtja ime konsiston me nenin 3 pika 2. Për të gjithë këta persona, të cilët janë cekur në nenin 3 pika 1 dhe që vërtetohet gjendja e tyre, domethënë, përmenden: certifikata e lindjes, librezë e anëtarësisë, vërtetimi i shkollës. Mendoj se do të kishte vlerë sikur që të shtohet edhe pika d), më saktësisht, vërtetimi nga komisioni mjekësor, sepse jo të gjithë personat e cekur në nenin 3 pika 1 mund të vërtetohen me certifikatë të lindjes, librezë të anëtarësisë apo vërtetim të shkollës. Domethënë, mendoj se është e udhës të shtohet edhe vërtetimi nga komisioni mjekësor apo vërtetimi nga mjeku.

Gjithashtu, kam edhe një vërejtje tjetër lidhur me nenin 7 pika 1, në të cilin lartësia e taksës së vendosjes përcaktohet, varësisht nga çmimi i fjetjes për person. Mendoj se më e udhës do të ishte sikur taksa e tillë të vendosej pasi të bëhet kategorizimi i objekteve hoteliere turistike, sepse varësisht nga kategoria, niveli i të cilit i takon një objekti hotelier turistik do të mund të vendosej edhe taksa. Pra, një taksë e tillë mendoj se është shumë e ulët, duke marrë parasysh nivelet, gradimin apo kategorizimin e objekteve të caktuara hoteliere turistike.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar të pranishëm,

Fillimisht më lejoni të them se në parim e mbështes këtë projektligj, por i kam disa vërejtje. Këtu parashihen që të jenë të punësuar 21 punëtorë, apo punonjës. Mendoj se për 21 punonjës shpenzimet në mallra dhe shërbime janë paksa të larta, rreth 35.000 euro, saktësisht 34.746 euro dhe pagat e mëditjet mendoj se janë OK – 63.000 euro.

Pastaj, zoti Kryetar, duhet bërë përmirësime në pikën 7 dhe 8. Te taksa e vendosjes, mendoj se 50 centë dhe 1.50 është tatim i ulët, duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me persona të cilët nuk janë sensitivë në çmime. Edhe ashtu personat të cilët janë sensitivë në çmime, janë të liruar nga kjo taksë, por nëse dëshirojmë që ta mbajmë karshi ambientit afarist në Kosovë, atëherë mund t'i kategorizojmë bujtinat apo hotelet, e tjera, e tjera, ashtu siç bëhen në vende të ndryshme, domethënë vihet një limit atje, si në SHBA – është 20 dollarë, pra, hotelet që kushtojnë më lirë se 20 dollarë nuk paguajnë tatim të akomodimit apo të vendosjes.

Pastaj, te çështja e sanksionimeve, mendoj se është dashur, po ashtu, të afatizohet koha. Domethënë, nëse entiteti afarist nuk i përgjigjet këtij ligji me kohë, dënimi, ndonëse është i vogël këtu, po megjithatë të themi se është 500 euro, atëherë për çdo vonesë të themi

brenda një muaji, nëse kalohet ai muaj, çdo javë të jetë dënimi, t'i shtohet në interes qoftë 3% të asaj shume apo 5%. Kjo edhe do t'i disiplinonte më shumë personat juridikë, mendoj entitetet afariste që t'i mbajnë me rregulla librat e tyre të kontabilitetit.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zoti, deputet! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar Kryetar,
Anëtarë të Qeverisë dhe deputetë,

Kam disa vërejtje parimore. Në qoftë se nuk do të riformulohej, po e zëmë, kur thuhet taksa e vendosjes, po në diksionin për vendosje do të ishte e pakuptimtë. Ju lutem, te paragrafi 1.2. Meqenëse dy ministri do ta bënin mbikëqyrjen e taksës për vendosje, atëherë do të duhej ta kishin një bazë juridike dhe atë do të duhej ta krijonte Qeveria me një udhëzim. Kjo është praktikë e ligjeve, kur janë dy ministri a më shumë, atëherë Qeveria i përcakton rregullat se si bëhet mbikëqyrja, ndryshe, paraqiten kolizione.

Te shpjegimi – taksa e vendosjes, po e zëmë aty, ndër të tjera, po e lexoj vetëm këtë: “jashtë vendbanimit”. Kjo do të ishte bazë për manipulime dhe spekulime të llojllojshme. Po e marr Pejën, që e ka, po e zëmë, ndër të tjera, Rugovën. Mund të jetë qytetar i Pejës, mirëpo mund të vendoset në ndonjë objekt hotelier, bie fjala, pikërisht në komunën e Pejës dhe do të lirohej në bazë të kësaj. Prandaj, do të duhej të hiqet kjo “jashtë vendbanimit”.

Kudo në këtë ligj, po edhe në të gjitha ligjet duhet të përdoret njëjësi, sepse ndryshe do të ishte formulim problematik. Në qoftë se thuhet, po e zëmë, “personat të cilët bëjnë punë stinore”, atëherë personi nuk do të kishte të drejtë në lehtësira. Ose, kur thuhet “shtetasit e huaj”, një shtetas nuk do të kishte të drejtë sipas tij, do të duhej të jenë së paku dy shtetas. Kudo duhet njëjësi të përdoret, medoemos.

Edhe paragrafi 3 alineja 2, është materie e Rregullores. Kur thuhet, cilat dokumente duhet, e tjera – kjo është materie e udhëzimit ose administrativ ose e Rregullores, që ministri e përcakton dhe ia përshtat rrethanave, sepse, Ministria është e përgjegjshme për zbatimin konsekuent të ligjit dhe i cakton rregullat që janë në frymë me ligjin, nuk është pra materie ligjore.

Po e zëmë, te neni 7. Nuk është konsekuent. Paragrafi i parë, e rregullon një materie me ligj, materien e ngjashme ia jep, ia konsedon Ministrisë, prandaj do të duhej që kjo çështje të jetë prapëseprapë komplet në ingerencën e Ministrisë.

Në qoftë se do të thuhej “me gjobë prej 100 deri 300 euro do të gjobiten”, kjo e krijon njëfarë imperativi. Kudo, në këto raste, duhet të përdoret kushtimorja – “do të gjobitej”, do të thotë po që se do të bëhej kjo – “do të gjobitej”.

Edhe neni 11 duhet krejtësisht të riformulohet, sepse është skaduar me pavarësinë e Kosovës. Ky material fare nuk është lexuar, së paku telegrafisht edhe të përshtatet - ku thuhet se ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes së tij nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Këto janë vërejtje parimore.
Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: I nderuari, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra dhe ju deputetë,
Për ligjin, të cilin po e shqyrtojmë sot, do të kisha dhënë vetëm një vërejtje parimore. Ky ligj është më se i domosdoshëm dhe ka të bëjë me çështje të sigurisë në Kosovë. Ministria e Tregtisë dhe ajo e Financave, ma merr mendja, se nuk duhet të kontrollojnë pagesën e taksës për vendosje, por kjo kompetencë do të duhej t'i jepet Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pikërisht nga ky ligj nuk duhet synuar që të fitojë më shumë para buxheti i Kosovës, por që të rritet siguria në Kosovë për të pasur një kontroll të lëvizjeve të njerëzve për t'iu ofruar siguri të gjithë atyre, qoftë shtetas të huaj, qoftë vendorë, të cilët vendosen në objekte jo private. Besoj se, gjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm, duhet riformuluar disa nene të këtij ligji dhe duhet që ky ligj të ketë qëllim, domethënë garantimin e sigurisë së personave të cilët e vizitojnë Kosovën ose të personave të cilët vendosen diku jashtë banimit të vet dhe të ketë një kontroll në lidhje me lëvizjen e personave Ministria e Punëve të Brendshme. Pra, çdo objekt hotelier, qoftë privat ose shtetëror, do të duhej që të informojë Ministrinë e Punëve të Brendshme, përkatësisht Stacionin e policisë pranë të cilit vepron, për të pasur një kontroll dhe për t'u rritur siguria e vizitorëve edhe e qytetarëve të Kosovës.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ky ishte diskutuesi i fundit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë Projektligjin.

HAJREDIN KUÇI: I nderuari Kryetar i Kuvendit! Të nderuar deputetë, të nderuar ministra, zonja e zotërinj,

Jam i nderuar që në emër të Qeverisë së Kosovës, të paraqes para jush Projektligjin për tokën ndërtimore, të privatizimit dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore.

Ky ligj cakton normat për rregullimin e tokës ndërtimore, për kushtet, mënyrën dhe procedurën e privatizimit, si dhe rregullat për dhënie me qira të tokës ndërtimore në pronësi të Kosovës, në bazë të të cilave titullarët i realizojnë këto të drejta dhe detyrime pronësore-juridike përmes institucioneve kompetente të Kosovës.

Nevoja për këtë projektligj është e pakontestueshme. Ju e dini se ka qenë një ligj paraprak për tokën ndërtimore në vitin 1980 dhe i plotësuar në vitin 1986, por ai ka qenë në disproporcion me ndryshimet juridike dhe ekonomike që i ka Kosova sot, duke përfshirë atë që ne kemi kaluar në një ekonomi të lirë të tregut dhe në një fazë të re të sistemit demokratik. Këto rregulla juridike bëjnë edhe zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore-juridike për regjimin e tokës ndërtimore, të cilat u përshtaten këtyre rrethanave.

Ky ligj krijon infrastrukturë ligjore të harmonizuar me standarde ndërkombëtare për rregullimin e tokës ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore. Veçanërisht, ka ndikim në sigurinë dhe përshtatjen e investimeve të huaja në sfera të ndryshme ekonomike, siç janë: në fushën e ndërtimit urban, mbrojtjen e ambientit dhe planifikimit hapësinor.

Të nderuar deputetë,

Shpenzimet për zbatimin e këtij ligji mund të mbulohen dhe të tejkalohen me të hyrat që krijohen nga procesi i privatizimit dhe i dhënies me qira, pra me zbatimin e këtij ligji.

Ligji është i ndarë në 11 kapituj, 12 nënkapituj dhe përfshin gjithsej 102 nene.

Ju ftoj, të nderuar deputetë, që t'i jepni sugjerimet tuaja dhe ta miratoni në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit për prezantimin. Hap debatin në parim. Sipas radhës Grupi Parlamentar i PDK, deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti Kryetar! Të nderuar deputetë,

Projektligji për tokën ndërtimore, për privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore, Ligji për të drejtat sendore, Ligji për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme, Ligji për detyrimet dhe Ligji për koncesionet – janë ligje kryesore që paraqesin bazamentin e ekonomisë së lirë të tregut.

Duke u mbështetur në parimin kryesor të formimit të infrastrukturës ligjore për rregullimin e fushës juridike për tokën ndërtimore, Projektligji i propozuar rregullon detajisht tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve lidhur me rregullimin juridik të tokës ndërtimore, procedurën e privatizimit të tokës ndërtimore dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore në pronësi të Kosovës.

Toka ndërtimore është e mirë dhe me interes të përgjithshëm të Kosovës dhe gëzon mbrojtje të veçantë juridike. Si e tillë, toka ndërtimore, në procedurë të caktuar, mund të privatizohet, të jepet me qira dhe me koncesion.

Ligji është mjaft voluminoz dhe i ka gjithsej 102 nene. Është kompleks, në shumë kapituj mjaft i ndërlikuar. Ligji mund të sjellë probleme në praktikë, sidomos tek implementuesit e ligjit të propozuar.

Sipas nenit 10 të këtij ligji, tokën ndërtimore, në pronësi të Kosovës, e administron Qeveria e Kosovës. Me këtë rast duhet të saktësohet se cili është organi kompetent që duhet të bëjë administrimin, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore në pronësi të Kosovës.

Bartja e pronësisë dhe dhënia me qira e tokës ndërtimore, bëhen me ankand publik dhe me marrëveshje të drejtpërdrejtë.

Toka ndërtimore e Kosovës mund të jepet me koncesion, konform Ligjit të koncesioneve. Tokën ndërtimore në pronësi të Kosovës, Qeveria e Kosovës mund t'ia japë me koncesion personit fizik dhe juridik, të brendshëm ose të jashtëm, nëse destinimi i saj është në interes të përgjithshëm të Kosovës.

E drejta e qirasë afatgjate, është një çështje tjetër me rëndësi kapitale që e rregullon ky ligj. Në tokën ndërtimore mund të konstituohet e drejta e qirasë afatgjate në favor të personit fizik dhe juridik, të brendshëm, në procedurën ligjore.

Qiradhënia afatgjate është e drejtë sendore dhe regjistrohet në librat publikë për regjistrimin dhe evidencimin e të drejtave për paluajtshmëri. Ligji parasheh decidivisht se qiradhënia mund të jetë më së shumti për 99 vjet. Bartësi i së drejtës së qirasë afatgjate, është personi në emër dhe në favor të cilit kjo e drejtë është themeluar ose ka kaluar tek ai.

Sipas ligjit, e drejta e qirasë afatgjate, detyrimisht regjistrohet në librat publikë për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmëri, në pajtueshmëri me nenin 34 të Ligjit që ka të bëjë me shuarjen e të drejtës së qirasë afatgjate për shkak të shuarjes së të drejtës së pronës, ku duhet harmonizuar me Ligjin për të drejtat sendore, ndërsa për shuarjen e të drejtës për qira afatgjate heqje dorë me zgjedhjen e kontratës duhet të harmonizohen dhe zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit për detyrimet.

Një çështje tjetër – objekt i rregullimit të këtij ligji, është edhe privatizimi i tokës ndërtimore. Toka ndërtimore në pronësi të Kosovës mund të privatizohet me të drejtë pronësie të personave fizikë dhe juridikë, të brendshëm vendorë – shfrytëzues të tokës ndërtimore. Ky privatizim mund të jetë në tërësi ose në pjesë, pra pjesërisht.

Ligji parasheh, në nenin 55, afatin prej 2 vjetësh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji për urdhëresën për privatizim, që mendoj se është afat shumë i gjatë.

Në nenin 70 të ligjit, është përcaktuar se lartësinë e qirasë për tokën ndërtimore, që është objekt i qirasë afatgjate, mënyrën dhe procedurën e pagimit të saj – e cakton Qeveria e Kosovës, ia propozon ministrit kompetent.

Vërejtja e parë është: Cili është ai ministër që e bën një gjë të tillë, siç theksohet në ligj?

Në të njëjtin nen, paragrafi 2, theksohet se “Qeveria e Kosovës cakton me akt të veçantë organin kompetent që përcakton zonat e tokës ndërtimore dhe lartësinë e qirasë që duhet të paguhet”, por nuk e propozon dhe nuk e precizon aktin juridik të veçantë të domosdoshëm.

Vërejtja e tretë, konsiston në nenin 7, ku duhet të precizohen dispozitat konkrete për privatizimin e tokës ndërtimore në të cilin është e njohur e drejta e qirasë afatgjate që mund të privatizohet me shpërblim.

Vërejtja e katërt, Kontrata për qiranë afatgjate të tokës ndërtimore rregullohet në nenin 79. Ky nen duhet të harmonizohet në pjesën e veçantë të Ligjit për detyrimet, me qëllim të përcaktimit të mënyrës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore në të cilin njihet e drejta e qirasë afatgjate, detyrimi për bartjen e së drejtës së qirasë afatgjate, pronarit të objektit, në rast të shitjes së objektit të ndërtuar në tokën në të cilën është fituar e drejta e qirasë afatgjate.

Vërejtja e pestë, ka të bëjë me nenin 82, ku theksohet se “aktvendimi për qiranë afatgjate i dërgohet bartësit të së drejtës dhe organit kompetent”, por nuk precizohet se cili është ai organ konkret kompetent.

Vërejtja e gjashtë, lidhet me nenin 84, ku duhet të precizohet- cili është organi kompetent i Kosovës që paraqet padi për mos përmbushjen e plotë të kontratës së qirasë afatgjate të tokës ndërtimore?

Vërejtja e shtatë, paraqitet në nenin 85, paragrafi 2, ku ,patjetër, duhet të precizohet ministri kompetent që administron tokën ndërtimore apo Ministrinë që parasheh formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës kur kërkesat e paraqitura për aktvendimet e miratuara dhe të anuluar për kontratat për qiranë afatgjate, si dhe për paraqitjen e padive për përmbushjen e detyrimeve për qiranë afatgjate.

Vërejtja e tetë, duhet të precizohet, saktësisht, se cila është procedura e veçantë për lirim dhe ndërprerjen e pagimit të shpërblimit. Sipas rregullës, procedura për lirim dhe përkohshëm nga pagesa e shpërblimit për privatizim, për marrjen e qirasë afatgjate – fillon me kërkesën e personit fizik, si bartës i të drejtave të caktuar anë tokës ndërtimore dhe kërkesës i bashkëngjitet aktvendimi i organit shtetëror të administratës kompetente për çështje sociale, me të cilin vërtetohet statusin e shfrytëzuesit të ndihmës sociale, përkatësisht të mbrojtjes sociale.

Vërejtja e nëntë, ka të bëjë me nenin 91, ku duhet të precizohet, konkretisht, se cili është organi shtetëror kompetent i administrimit për çështje pronësore-juridike?

Ligji në nenin 94 parasheh marrjen e së drejtës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore me interes publik, me propozim të organit që kujdeset për mbrojtjen e pronësisë së Kosovës, por nuk precizohet se në cilin ligj konkret të veçantë dhe me cilën procedurë do të merret e drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore që është me interes vital publik.

Ky ligj është i lidhur ngushtë edhe me ligje të tjera, në veçanti me Ligjin për të drejtat sendore, që rregullon çështjet më vitale të shoqërisë sonë, siç janë: pronësia, posedimi, servitutet, hipoteka, uzufrukti dhe të tjera.

Ky ligj është i miratuar në Kuvendin e Kosovës, në vitin 2004, por nuk është nënshkruar ende.

Në Kosovë, zoti zëvendëskryeministër, ende zbatohet ligji i aplikueshëm i përmendur. Moszbatimi i ligjit të ri për të drejtat sendore, është duke paraqitur probleme të mëdha në praktikën gjyqësore, që në kohën e fundit ka raste edhe më të rënda të vrasjeve, siç ishte rasti i javës së kaluar në Besianë, ku si shkak kryesor janë konflikte të rënda të pazgjidhura pronësore.

Kërkoj nga Qeveria e Kosovës të marrë masa adekuate, urgjente për përshpejtimin e nënshkrimit të këtij ligji.

Sa i përket Projektligjit të propozuar, më gjithë vërejtjet e shumta të paraqitura në emrin tim dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrah parimisht ligjin në shqyrtimin e parë, ndërsa kontributin tim profesional lidhur me amendamentet përkatëse të ligjit do t'i parashtoj në Komisionin funksional.
Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zonja deputete! Është paraqitur për një sqarim apo ndërhyrje zëvendëskryeministri zoti Hajredin Kuçi. Urdhëroni, e keni fjalën, zoti Kuçi.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryesues! Faleminderit zonja deputete, profesoreshe për vërejtjet që keni dhënë. Po besoj dhe të gjithë e dimë se po ashtu edhe ligji është mjaft voluminoz, i ka 102 nene dhe nëse do ta rregullonin në detaje këtë lëmi me siguri se do të kishim edhe telashe me 500 nene. Po krejt atë që e thatë, në një mënyrë mund ta themi se është menduar në ligj, në nenin 10 pika 2: “Qeveria e Kosovës e përcakton me akte të veçanta”, jo me një akt, por me akte të veçanta “organin kompetent i cili do të bëjë administrimin, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore në pronësi të Kosovës”. Unë mendoj se këtu, me një lloj akti jo, por me disa akte do të bëjmë administrimin, pronësinë dhe të gjitha të tjerat. Përndryshe, ligji ka rregulluar parimet e përgjithshme.

Si do që të jetë, besoj se vërejtjet do t’i bëni edhe me shkrim dhe unë premtoj se Komisioni parlamentar dhe Qeveria do t’i marrin ato parasysht.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e ka fjalën deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Projektligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore është i një rëndësie të veçantë, sepse shfrytëzimi i tokës ndërtimore do të bëhet në mënyrë më racionale dhe të planifikuar sipas standardeve bashkëkohore, duke përcaktuar kushtet për privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore në Republikën e Kosovës.

Ligji i vjetër për tokën ndërtimore, nuk mund të jetë i zbatueshëm pasi nuk i përballon dot trendet e zhvillimit dhe rregullimit të planeve hapësinore, rregullative dhe urbanistike që përcaktojnë kriteret për tokën ndërtimore. Ky projektligj bazohet në kriteret sipas standardeve më të larta ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë do të ketë ndikim në tërheqjen e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës për ndërtimet si në zonat urbane po ashtu edhe në ato rurale.

Projektligji mbi tokën ndërtimore do të rregullojë në mënyrë të drejtë shfrytëzimin e tokës ndërtimore. Fatkeqësisht, kemi shumë raste të shndërrimit pa kriter të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, duke shkaktuar humbje të mëdha në sektorin e bujqësisë.

Meqë projektligji në fjalë është i përgatitur kohë më parë, në të gjitha nenet duhet të bëhen ndryshime dhe në vend të fjalive “tokë ndërtimore në pronësi të Kosovës” duhet të jetë “tokë ndërtimore në pronësi të Republikës së Kosovës”.

Në projektligj, qartë janë dhënë përkufizimet që kanë të bëjnë me mënyrën e privatizimit të tokës ndërtimore, formën e shfrytëzimit të tokës ndërtimore, llojet e dhënieve me qira, llojin dhe përbërjen e tokës ndërtimore e tjera.

Ky projektligj, përveç që përcakton zonat e tokës ndërtimore, do të bëjë edhe përcaktimin e trojeve sipas planeve urbanistike dhe hapësinore, kështu që do të kemi një rregullim të vendbanimeve jo vetëm në zonat urbane, por edhe në ato jo urbane, gjë që do të ndikojë në një lloj rregullimi të vendbanimeve sipas standardeve evropiane.

Në parim, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah këtë projektligj, duke dëshiruar që gjatë punës në komisione, pasi qe, siç e ceku edhe deputetja më herët, ka mjaft lëshime dhe shpresojmë se ne, me kontributin tonë, do të bëjmë atë që ky ligj të jetë më funksional dhe i zbatueshëm në praktikë.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë dhe deputetë të respektuar,
Sa i përket titullit, ku thuhet: “Projektligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore”, do të isha përcaktuar që ta zëvendësojmë, ku thuhet “privatizimin dhe dhënien me qira” me shprehjen “për disponimin”, sepse, ju lutem, ky e përfshin, e nënkupton dhe i jep mundësi edhe Qeverisë e Ministrisë për të qenë edhe më aktive, fleksibile dhe më adaptabile me rrethanat. Do ta përfshinte arendën, emfiteuzën, pastaj koncesionet dhe privatizimin. Kjo do të ishte në faqen 9.

Paragrafi I i nenit 5, “Toka ndërtimore mund të jetë në pronësi të Kosovës, ose në pronësi private”. Kjo, në pronësi të Kosovës, nuk është shprehje e përshtatshme, por do të duhej të jetë “në pronësi shtetërore”. Kosova është shtet, ju lutem, do të duhej “pronësi shtetërore”. Toka ndërtimore mund të jetë në pronësi shtetërore, por duhet të shtohet se mund të jetë edhe në pronësinë private, do të thotë mund të jetë natyrisht në pronësinë publike. Kjo duhet të thuhet dhe të shtohet, sepse është e mundur. Toka – pronë, bie fjala, që është me tapi e këtej, por në interesin e përgjithshëm mund të përcaktohet me planin urbanistik “tokë ndërtimore” dhe ajo është në pronë private.

Duhet të inkorporohet procedura administrative, sepse kjo është shumë më efikase se sa procedura gjyqësore. Në zgjidhjen e kontesteve “procedura administrative dhe gjyqësore” vetëm kaq të thuhet. Përndryshe, ne e kemi edhe Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative dhe e kemi edhe Ligjin për konfliktet administrative.

Duhet domosdo të inkorporohet edhe një kaptinë, që do t’u referohej ndërtimeve në tokat jondërtimore, të krijohet bazë juridike për të ndërhyrë në mënyrë urgjente organet e pushtetit, sepse kjo ka ndodhur, ndodh dhe pa fije të dyshimit – do të ndodhë. Dhe, kudo që është, duhet të zëvendësohet termi “organet kompetente”, sepse në praktikë do të rezultojë paqartësi – për cilat organe kompetente? Ne duhet të përmendim vetëm ministrinë e caktuar, e më pastaj kur thuhet asisoj, autoriteti publik, dihet se ministria i ka strukturat e veta.

Parimisht, nga Grupi Parlamentar i partisë politike Aleanca Kosova e Re, ky projektligj mbështetet dhe kemi dëshirë që sa më parë të miratohet dhe të hyjë në aplikim.
Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini. Urdhëroni!

ARDIAN GJINI: Faleminderit zoti kryesues!
Zëvendëskryeministër, ministër,

Po duket, në bazë të leximit, qëllimi politik i sjelljes së këtij ligji ka mbetur ai i njëjti që ka qenë më parë. Do të tentoj të mos i përsëris kolegët që të gjithë i patën në rregull diskutimet. Një prej elementeve për të cilat është synuar që të rregullohen me këtë ligj, është edhe çështja e shndërrimit të shfrytëzuesve të ligjshëm të trojeve në pronarë të trojeve. Ky ka qenë, do të thotë një prej synimeve, që është krejt në rregull.

Është e vërtetë ajo që tha zëvendëskryeministri se ligji ka elemente të cilat do ta ndihmojnë edhe zhvillimin ekonomik në Kosovë dhe të gjitha këto elemente janë paraparë, por, me qenë se seanca plenare nuk është një komision i madh kur ligjet shqyrtohen nën për nën, mirëpo shqyrtohen në aspektin tipik politik, unë do të them se nëse dikush e ka lexuar agjendën legjislativë mund të shihet se nuk përcillet, saktësisht, si strategji se çka duhet të pasohet me këtë ligj. Ky ligj është një tullë e madhe që vendoset në sistemin legjislativ të Kosovës edhe në sistemin politik, mirëpo nuk mund të vendoset një tullë në të majtë e një tullë të djathtë, duhet të ketë një strategji e cila do ta përcjellë miratimin e secilit ligj. Ta marrim vetëm një shembull të thjeshtë- cilat do të jenë elementet të cilat do të përcillen me restituim, për shkak se në momentin kur ne i shndërrojmë njerëzit në pronarë trojeve kemi edhe shumë qytetarë të tjerë të Kosovës, të cilët do të kenë problem me ish- pronat. Unë sot nuk po propozoj se si t'i qasen Qeveria dhe Kuvendi këtij ligji, mirëpo vetëm po them se nëse e shihni strategjinë legjislativë e merrni këtë ligj që është një ligj i mirë, atëherë nuk gjeni harmoni. Nuk i ngjanë një strategjie, por një liste.

Sidoqoftë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah këtë ligj në parim do t'i japim kontributet tona veç e veç nëpër komisione të cilat do të jemi, mendojmë se është një Ligj i mirë dhe duhet të kalojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryesues!
Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë i jep mbështetje parimore këtij projektligji, duke konsideruar si të nevojshëm, duke iu përshtatur realitetit kohor në të cilën jemi duke rrugëtuar si shoqëri dhe si shtet i Kosovës. Ajo çka është e rëndësishme për ne se ky projektligj i përshtatet konceptit të ekonomisë së tregut, ashtu siç u tha edhe nga parafolësit.

Një element tjetër me rëndësi është që duhet të ketë për bazë që ndërlihet edhe me vetë mbështetjen që ne si Grup Parlamentar i japim. Është në harmoni të plotë me standardet e nevojshme që lidhen me sigurinë e investimeve, qoftë në fushën e ndërtimeve urbane, të mbrojtjes së mjedisit, por edhe të planifikimit hapësinor.

Prandaj, pa hyrë në detaje, duke ditur dhe duke pas konsideratë se jemi në fazën e leximeve në parim, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë i jep mbështetje këtij projektligji.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Në emër të Grupit Parlamentar “7+” fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsedavajući. Dozvolite da pozdravim i vas, i zamenika premijera. Prilika je da kažem da je usvajanje Nacrta zakona o građevinskom zemljištu, privatizaciji, davanju građevinskog zemljišta pod zakup neophodnost u ovoj fazi razvoja našeg društva.

Tu pre svega mislim na regulisanje zakonskih odredbi za korišćenje građevinskog zemljišta, jer se nalazimo u nasleđenom haosu i ekspanziji bespravnog zauzeća i gradnje, kako bi smo prešli na urbanu i neurbanu gradnju i zaštitu sredine i prostornog planiranja.

Koa što je već rečeno od nekoliko mojih kolega, on je dosta obiman, nezgrapan i zbog toga će procedura njegovog regulisanja zahtevati i dosta vremena i stručnog brusanja pojedinih poglavlja i podpoglavlja i pravnog pojednostavljenja, kako je već rečeno.

Ja ću takođe navesti da je radna grupa koja je radila na njemu, bar prema onome kako stoji u dokumentu koji je pred nama, dosta je brojna i za njih stoje stručne kvalifikacije, a pominje se u istom tom poglavlju da je radna grupa ostvarila i standarde, kako se kaže, ali ja bih rekao s obzirom da u njoj nema nijednog člana iz nevećinske zajednica, da taj deo standarda nije ispunjen.

Međutim, mi ćemo biti aktivni deo dalje njegove procedure i daćemo sigurno u nastavku njegovog procesuiranja određene primedbe u vidu amandmana, tako da ga mi u načelu prihvatamo. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në mungesë të përfaqësuesve parlamentar të SLS-së, kalojmë në debat sipas radhës së paraqitjes së deputetëve.

Për fjalë është paraqitur Sanije Aliaj. Të përgatitet deputeti Berat Luzha.

Sanije Aliaj e ka fjalën.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti Kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, zoti Kuçi,

Të nderuar deputetë.

Shteti i ri i Kosovës po kalon në një ekonomi të lirë dhe treg të hapur ku rregullat juridike për zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore juridike në rregullimin e tokës ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të kësaj toke duhet t'u përshtaten rrethanave të reja dhe standardeve evropiane.

Procedimi i këtij projektligji bën specifikimin e tokave ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tyre.

Projektligji duhet të pasojë edhe me një varg projektligjesh të tjera, në mënyrë që të kompletohet infrastruktura ligjore për investimet e huaja, sepse nuk mund të realizohet: ndërtimi urban, zhvillimi ekonomik, mbrojtja e ambientit dhe as planifikimi hapësinor pa infrastrukturë adekuate.

Pas një vlerësimi të bërë mendoj se vështirë mund të rregullohen këto tri çështje me një ligj, sepse shumë çështje kanë mbetur të padefinuara, siç janë:

Dhënia e tokës me qira për 99 vjet edhe pse është standard i kërkuar sot është e padrejtë në rrethanat tona nga fakti se nuk janë bërë decentralizimi dhe dekonfiskimi i pronave që u është marrë me dhunë dhe në mënyrë kundërligjore qytetarëve të Kosovës.

Mendoj se nuk mund t'i njihet e drejta e shfrytëzimit të tokës shfrytëzuesit që ka ndërtuar objektin në kundërshtim me ligjin, pa leje ndërtimi në tokën ndërtimore të qytetit ose në tokën urbane.

Projektligji i mungojnë dispozitat ndëshkuese lidhur me uzurpimin e pronave apo me ndërtimet pa leje, pa respektuar kriteret për infrastrukturën rrugore.

Projektligji në nenin 94 parasheh marrjen e së drejtës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore me interes publik, por nuk precizon se me cilin ligj apo akt nënligjor edhe me cilën procedurë do të merret në shfrytëzim toka me interes publik.

E drejta e qirasë dhe çështjet e tjera me rëndësi duhet të rregullohen në harmoni me ligjet e tjera për të drejtat sendore dhe me dispozitat e Ligjit për detyrimet.

Ky projektligj do të ketë vështirësi të zbatohet në praktikë, nëse nga Serbia nuk merret lënda e kadastrave, por , duke e ditur rëndësinë e këtij ligji dhe rregullimin e kësaj çështjeje shumë të domosdoshme për ne, është për t'u përshëndetur edhe unë e përkrah në parim në mënyrë që vërejtjet e mia dhe të të tjerëve gjatë këtij debati të begatojnë në procedimin e më tutjeshëm këtë projektligj që është shumë në interes për ne.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Berat Luzha. Të përgatitet deputeti Shkumbin Demaliaj.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti Kryesues!

Projektligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore ishte i paraparë të miratohej sipas planit legjislativ të vitit 2005, do të thotë ishte prioritet nga planet për standardet për Kosovën.

Mirëpo, shqyrtimi i tij i parë është bërë në maj të vitit 2006 dhe prej atëherë dhe deri tash nuk kemi ditur se çka është bërë me këtë ligj.

Materia që rregullon projektligji është mjaftë e ndërlikuar, por edhe e ndërlidhur me shumë ligje të tjera bazike si me Ligjin për pronën, me Ligjin për tokën bujqësore, me Ligjin për koncesione dhe me një varg ligjesh të tjera, shumica prej të cilave ende nuk janë miratuar.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

I fundit, deputeti Shkumbin Demaliaj, e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë.

Në paraqitjen time nuk do të lëshohem në vërejtje , sepse neve në parim si grup parlamentar jemi dakorduar se e pranojmë këtë ligj që të shkojë më tutje. Mirëpo, rreth procedurave dhe diskutimeve që u paraqitën këtu është në levërdi të përgjithshme rreth

diskutimit të zëvendëskryeministrit në rast kur e paraqet se me nenin 10 është rregulluar që në mënyrë atributive rregullohet se të gjitha udhëzimet e tjera burojnë me aktet nënligjore që është në të mirën e të gjitha ligjeve që i nxjerr Kuvendi. Pra, ky Kuvend duhet t'ju bëjë thirrje hartuesve të drafteve që këtu vinë si projektligje që me një dispozitë të veçantë të lënë, kushtimisht, hapësirë që gjithçka çka mungon brenda hapësirës dhe dispozitave ligjore në përgjithësi le të lehet kjo mundësi, që gjithçka çka mungon në mënyrë atributive le të rregullohet që nxjerrët me akte tjera nënligjore, duke përfshirë rregullore të ndryshme, aktet e tjera normative.

Kështu që në përgjithësi kërkesë ime imediate, është që komisionet profesionale përfundimisht të përcaktojnë te zgjidhjet procedurale te zgjidhjet e kontesteve, në këtë rast, të mos mbetet që organi apo gjykata kompetente ta zgjidhë këtë problem, por edhe aty, në mënyrë atributive, me emër të përcaktohet se kush është organ i cili duhet t'i ekzekutojë këto lëndë, sepse duke shëtitur lëndët nëpër gjykata të ndryshme e kemi edhe këtë problem te gjyqësia, sepse vetëm i lejohet- i jepet mundësia organit kompetent, gjykata kompetente edhe po krijohet kolizion. Pra, me akte nënligjore besoj se ato mund të ndryshojnë hapësira kohore të ndryshme edhe vetë ndryshimi i aktit prej aktit, atëherë shumë lëndë mbeten pa zgjedhura edhe qytetarët mbesin me probleme të vazhdueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Me këtë paraqitje mbyllet debati për pikën e dytë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës për sot.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Bujqësisë

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin Arsim Bajrami që në emër të Qeverisë të prezantojë Kuvendit Projektligjin. Zoti ministër e kenë fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari Kryesues!

Të nderuar deputetë,

Jam i thirrur që të zëvendësoj ministrin e Bujqësisë, i cili për shkaqe objektive nuk mund ta paraqesë ekspozenë e këtij projektligjin.

I nderuari Kryesues,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që këtu para jush në pika të shkurta të prezantojë Projektligjin për Inspektoratin Bujqësor të hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Projektligji është i një rëndësie të madhe, sepse një ligj i tillë i duhet Kosovës për ta ruajtur jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe përgjithësisht, shëndetin publik.

Inspektimi është nevojë për ta kontrolluar zbatimin e ligjit nga subjektet afariste dhe individët në aspektin profesional dhe praktikë, konform standardeve evropiane.

Projektligji ka për qëllim krijimin e kornizës të domosdoshme ligjore për inspektimin e fushave me sa vijon: bujqësisë, pylltarisë dhe gjuetisë, mbrojtjes së bimëve, blegtorisë,

peshkatarisë dhe të veterinarisë dhe ky Projektligj ka një strukturë komplekse dhe përmbajtësore . të përbërë prej 7 kapitujve dhe është hartuar sipas teknikës juridike bashkëkohore në harmoni me standardet e Bashkimit Evropian

Me këtë projektligj rregullohet organizimi i Inspeksionit bujqësor, i cili është organ ekzekutiv në kuadër të Ministrisë dhe kompetent për realizimin e inspektimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Të drejtat, detyrimet dhe autorizimet e Inspeksionit janë përcaktuara qartë. Po ashtu ky projektligj rregullon bashkëpunimin e Inspeksionit bujqësor qendror me Inspeksionin lokal.

Jam i bindur se ky projektligj i plotëson standardet evropiane dhe ju lus që pas shqyrtimit në parim dhe diskutimit në komisionet adekuate parlamentare ta bëni miratimin e këtij projektligji.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Unë e shfrytëzoj rastin që në emër të Kryesuesit të kësaj seance t'i sugjeroj Qeverisë që në seancat e tjera, kur bëhet zëvendësimi i ministrave që prezantojnë, të bëhet me shkrim dhe jo gjatë seancës, po të kem paraprakisht nga Qeveria, pra, zëvendësimin me shkrim. Ju mund të thoni tani që më luti ministri për Bujqësi që unë ta zëvendësoj[, pra, në prezantim të ligjit. Faleminderit!

Kalojmë në debat, në parim.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së ,deputeti Berat Luzha e ka fjalën.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti Kryesues!

Qëllimi i Ligjit për Inspektoratin e Bujqësisë është krijimi i normave ligjore për mbikëqyrjen inspektuese në bujqësi, në pylltari, në gjueti, në blegtori, në peshkim, në veterinarin dhe në mbrojtjen e bimëve si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin komunal apo lokal. Sipas kësaj nuk kemi të bëjmë thjeshtë

me një Inspektorat qendror dhe me një Inspektorat komunal, por faktikisht do t'i kemi 5 inspektorate qendrore dhe 5 inspektorate komunale për secilin komunë të Kosovës. Raportet në mes inspektoratit qendror dhe atyre komunale, nuk kanë të përcaktuara drejtë me dispozitat e këtij ligji, që krijon paqartësi dhe dilema në zbatimin Ligjit. Edhe për shpenzime buxhetore për funksionimin e inspektoratit ka paqartësi dhe llogaritje të pasakta.

Rëndësia e politikës ndëshkimore është mjeti i fundit, por i domosdoshëm, detyrimet që dalin nga shfrytëzimi i kundërligjshëm i tokës bujqësore, por edhe i resurseve tjera natyrore. Në këtë drejtim roli i gjykatave ka rëndësi të posaçme për funksionimin e inspektorateve, por me këtë dinamikë të punës që kanë gjykatat, nuk mund të presim shumë prej tyre.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Haki Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet në parim Projektligjin për Inspektoratin e Bujqësisë. Kemi ngjashëm të njëjtat dilema me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike. Këto dilema janë **shtruar** edhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në kohën kur është hartuar Projektligji dhe lidhen me relacionin në mes inspektoratit, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë dhe inspektorateve komunale, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me implikimet buxhetore në ndryshimet e mundshme gjatë zbatimit të këtij ligji. Besoj që komisionet përkatëse, pas miratimit në parim do ta kryejnë punën si duhet dhe këto dilema do të sqarohen.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, ftoj deputetin Heset Cakolli ta marrë fjalën.

HESET CAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Përhëndetje, të respektuar deputetë,

Projektligji për Inspektoratin e Bujqësisë ka për qëllim të krijojë bazën ligjore për inspektimin në sektorët e bujqësisë, mbrojtjes së bimëve, pylltarisë, gjuetisë, blegtorisë, peshkatarisë dhe veterinarisë.

Projektligji për Inspeksionin Bujqësor, është hartuar sipas standardeve të Unionit Evropian. Ky projektligj, sipas Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re, është mjaft përmbajtësor dhe është hartuar edhe sipas teknikës juridike bashkëkohore. Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re në parim pajtohet që ky projektligj të procedohet në komisionet funksionale për shqyrtim të mëtutjeshëm. Besojmë se ne, si Grup Parlamentar, do të kemi mundësi që të japim kontributin edhe në ato komisione ku do të shqyrtohet ky projektligj.

Ju faleminderit !

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ibrahim Selmanaj e ka fjalën.

IBRAHIM SELMANAJ: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në parim mbështet Projektligjin për Inspektoratin e Bujqësisë. Duke pasur parasysh se ky ligj është mjaft kompleks, ne do të japim kontributin tonë të pakontestueshëm në komisionet përkatëse, por njëkohësisht konsiderojmë se është shumë me rëndësi që ky inspektorat të funksionojë, është ende më i rëndësishëm se sa ligji. Njëkohësisht propozojmë që të kihet parasysh që në zhvillimet e mëtutjeshme, inspektoratet të kenë një ligj të veçantë e jo të bëjmë ashtu duplikim të ligjeve, që në fakt, në momentet e caktuara nuk funksionojnë, posaçërisht, në nivelin lokal.

Në këtë mes edhe një herë e përsërisë se Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në parim mbështet Projektligjin për Inspektoratin e Bujqësisë.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Unë nuk kam të paraqitur për fjalë, po deputeti Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet në parim Projektligjin për Inspektoratin e Bujqësisë. Konsiderojmë se struktura në cilën ngërthen ky projektligj është e tillë që krijon kompetenca për çka është edhe i thirrur dhe përgjegjësitë, adreson mjaftë qartë përgjegjësitë e Inspektoratit Sanitar, si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal.

Kolegët e cekën një element, i cili duhet të kihet në konsideratë nga Komisioni funksional. Bashkëpunimin në mes nivelit qendror dhe nivelit lokal, duhet të detajohet dhe duhet të precizohet më qartë, prandaj mbi këtë bazë ne e mbështesim dhe vërejtjet tona eventuale do t'i paraqesim në Komisionin funksional.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Shpresa Murati e ka fjalën

ŠPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Pozdrav svima prisutnima u sali,

Ovim Zakonom utvrđuje se rad, nadležnosti i obaveze i odgovornosti Inspektora. Nacrt zakona ima za cilj da stvori neophodni zakonski okvir inspektovanja u oblastima poljoprivrede, šumarstva, lovstva, zaštite bilja, stročarstva, ribarstva i veterinarstva.

Moram o istaći da nisu navedeni članovi Radne grupe koji su učestvovali u izradi ovog Predloga zakona. Važno je znati ko je učestvovao u izradi Predloga zakona kojima bi se funkcionalna komisija mogla obratiti za eventualno objašnjenje u toku njegovog razmatranja u Komisiji.

Verujemo da će funkcionalna komisija učiniti sve da dobijemo zakon sprovedljiv u praksi savremenog Kosova. S toga, Parlamentarna grupa „7+“ podržava ovaj Nacrt zakona u načelu i daće svoj doprinos u funkcionalnoj komisiji. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Kalojmë në debat, deputetët sipas radhës. Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaj, përgatitet deputeti Riza Smaka.

NURISHAHE HULAJ: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Me Projektligjin për Inspektoratin Bujqësor rregullohen puna, kompetenca, detyrimet dhe përgjegjësitë e inspeksionit. Është e rëndësishme në të ardhmen për të qenë i implementuar ky projektligj, se a do të interferohet me Ligjin për ushqimin. Konsideroj se në këtë çështje duhet të harmonizohet me një amendament që do ta rregullojë këtë çështje në kuadër të Agjencionit të Ushqimit, i cili do të themelohet në të ardhmen.

U cekën shumë çështje nga kolegët e mi, që nuk dua t'i përsëris, por do të konsideroj se ligji është i përpunuar nga profesionistë të ndryshëm dhe është shumë i harmonizuar dhe ka 7 kapituj, në të cilët organizimi parashihet në dy nivele, niveli qendror dhe niveli lokal. Kostoja financiare e këtij projektligji lidhet kryesisht me koston e organit të

ri dhe organizimit të inspeksionit dhe kjo kosto nuk paraqet shumë implikime buxhetore me qenë se ka mekanizmat e saj dhe ka buxhetin e saj brenda Ministrisë përkatëse të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në parim e përkrahim këtë ligj dhe konsideroj se një amendament i veçantë, të cilin Komisioni funksional duhet ta përpunojë se si do të dukej në të ardhmen me Ligjin për Ushqim, që të jetë Ligji i ushqimit, respektivisht, Agjencioni i Ushqimit i implementueshëm.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete.

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, lë të përgatitet deputetja Sanije Aliaj

RIZA SMAKA: Ju faleminderit zotëri Kryesues!

Të nderuar të gjithë të pranishëm,

Ju lutem, një sugjerim parimor, por shumë i rëndësishëm. Faqet po dalin krejtësisht gabimisht, po duhet të rrotullohen në anën e kundërt. Unë nuk e di kjo teknikë qysh bëhet, që nuk është fare në rregull, se e vështirëson punën praktike. Disa vërejtje parimore me qëllimin më të mirë, që me shpresë se këto do të rishikoheshin, në mënyrë që në etapën e mëpasatajme të diskutojmë për çështje më substanciale.

Po e zëmë, te neni 3, medoemos do të duhej të integrohej edhe uji, do të thotë inspektimi. Inspektori kryen punë inspektuese në fushat e bujqësisë, pylltarisë, gjuetisë, mbrojtjes së bimëve, blegtorisë, peshkatarisë, veterinarisë dhe ujit. Natyrisht, se ne do të kemi Ligj për ujin, mirëpo këtu ujë në kontestin e bujqësisë. Ne e dimë fare mirë se burimet tona në masë të madhe kanë filluar të shteren, pikërisht për shkak të abuzimeve me ujë e rreth ujit. Uji është vital. E marrim një shembull, po e zëmë, Sahara, që i ka 2 milion kilometra katrorë shkretëtirë, paska qenë dikur sikur në Amazonë, por qytetarët e asaj kohe e kanë abuzuar ujin edhe, ndër tjera, si... Ne e dimë fare mirë se ka gurra që janë shterë ose janë në shterje e sipër.

Më pastaj, ju lutem, te neni 4, paragrafi 3. Paragrafi 3, kjo materie është tipike e aktit nënligjor, prandaj do të duhej të hiqej. Neni 9, paragrafi 1. “Për masat nga neni 8 i këtij Ligji, Inspektori merr vendim”. Inspektori nuk mund të miratojë vendim, po aktvendim. Kjo është rregull me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative. Vendimin e miraton organi kolegjial, vendimi nuk ka hyrje, vendimi nuk ka arsyetim, kurse aktvendimi duhet t’i ketë elementet, duhet ta ketë preambulën, diapozitivin, arsyetimin, udhëzimin juridik, prandaj aktvendim. Kjo është me gjuhën e ligjit, ju lutem.

Te paragrafi 13 i nenit 10, thotë, këtu thuhet kësi soji: “Inicon procedurën kundërvajtëse dhe ushtron fletëparaqitje penale”. Duhet të riformulohet: “Inicon procedurë ligjore” se akti mund të jetë i karakterit kundërvajtës, mund të jetë i karakterit penal, prandaj “ligjore”.

Te neni 14, kjo dispozitë: Kur inspektori gjatë inspektimit nuk e takon personin përgjegjës të subjektit ndaj të cilit bëhet mbikëqyrja inspektuese, inspektimi bëhet në prezencën e personit”. Kjo materie është e rregulluar jashtëzakonisht mirë dhe detalisht me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, prandaj do të thuhej, do të thotë: “vepron sipas ligjit” me “I” të vogël, se këtu është rregulluar, por shumë cekët, atje është detalisht dhe mjaftë mirë, prandaj i referohet atij ligji që ai do ta aplikojë në këtë rast.

Te neni 20: "Inspektori përcjell ekzekutimin". Nuk mjafton përcjellja. Fjalës: "përcjell" do duhej t'i shtohet: "dhe ndërmerr masa ligjore", se nuk do të ishte asgjë prej gjëje roli apo funksioni i inspektorit në qoftë se vetëm do ta kishte përcjellë. Edhe unë, si qytetar pa kurrfarë autorizimi, shoh shumë dukuri negative, nuk kam ç'të bëjë, i përcjell, i komentoj me dikë dhe përfundon. Ky do të jetë organ i shtetit, duhet të ketë, pa dyshim, autorizime dhe duhet të veprojë e të ndërmerr masa sipas ligjit.

Neni 21, propozoj që, ku thuhet: "ekzekutimi i dhunshëm", të hiqet "i dhunshëm". Ekzekutimi është shprehje e mjaftueshme, kjo i "dhunshëm" është njëfarë pleonazmi që e ngarkon panevojshëm, se ndryshe e kemi edhe Ligjin për përmbarimin.

Dhe, përfundimisht, ju lutem, neni 25, paragrafi 1, thotë: "Rezultatet e analizës" nuk thuhet çfarë analiza, a kush, "kontestohen me rezultatet e super analizës". Sipas këtij diksioni do të dilte se ato do të duhej gjithmonë të kontestohen, por duhet të shtohet: "mund të" dhe kjo ndryshon krejt atë filozofinë e kësaj.

Ju lutem, edhe përfundimisht te nenit 30: "Ministria, në afat prej një vitit nga dita e miratimit nxjerr akte nënligjore për zbatimin e tij". Kjo nuk ka kuptim, nuk është fare në rregull. Sa më parë që është e mundur, po afatin bile te caktojnë 3 muaj. Ne e dimë se shumë ministri apo ministra nuk do ta përfillojnë, por së paku ne me Ligj mos të japim aso hapësirë "brenda një viti". Ne jemi të interesuar që Ligji të aplikohet dhe nuk ka kurrfarë pengese që brenda 3 muaj ditëve të miratohen aktet nënligjore në implementim, në funksion të zbatimit të këtij Ligji dhe, ngjashëm te 32-shi, paragrafi 2, duhet të riformulohet, sepse i referohet procedurës së miratimit, që ia adreson Përfaqësuesit Special të Sekretarit Gjeneral të OKB-së. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Dhe, në fund, deputetja Sanije Alijaj e ka fjalën.

SANIJE ALIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!
I nderuari zoti kryesues,
I nderuar zëvendëskryeministër, ministër dhe ju të respektuar deputetë,

Bujqësia tradicionalisht ka qenë një ndër sektorët më të rëndësishëm në Republikën e Kosovës. Edhe sot e kësaj dite bujqësia është e lënë pas dore dhe shumica e prodhimeve bujqësore importohen nga jashtë, edhe pse kushtet për zhvillimin e bujqësisë janë shumë të favorshme në Republikën e Kosovës. Prandaj, ardhja e Projektligjit për Inspektionin e Bujqësisë, është shumë e nevojshme sepse bën rregullimin e kësaj fushe dhe mundëson rritje ekonomike, gjenerim të të ardhurave dhe punësim.

Mbrojtja e tokës bujqësore nëpërmjet të krijimit të legjislacionit dhe mekanizmave të tjerë, duhet të rregullohet përmes një koordinimi të përgjegjshëm institucional në kohën kur tokës bujqësore në Kosovë i ndërrohet destinimi pa kurrfarë kriteri. Gjatë zbatimit të këtij Projektligji do të paraqiten vështirësitë nga inspektorët e bujqësisë, sepse ngatërrohen kompetencat me ministritë e tjera, ngatërrohet dhe paraqiten vështirësi nga neglizhenca e kuvendeve komunale dhe vetëdija e ulët për mosdisiplinën e qytetarëve në dëm të tokës bujqësore. Masat ndëshkimore në këtë Projektligj duhet të jenë të larta për ata të cilët ndërrojnë destinimin e tokës bujqësore pa kurrfarë kriteri.

Projektligjin e përkrah në parim nga se është hartuar në pajtim edhe me ligjet e BE-së, njëherësh për shkak se ky Projektligj rregullon një fushë shumë të rëndësishme dhe me interes vital për ne. Unë kërkoj që procedura për miratimin e Projektligjit të jetë e përshpejtuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për fund, është paraqitur zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi. E keni fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, zoti kryeses!

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj shumë për vërejtjet dhe sugjerimet që i dhatë edhe për përmbajtjen edhe për anën teknike dhe formale të ligjeve dhe besoj që duhet ta bëni një gjë të tillë edhe në të ardhmen. Ju premtoj se do t'i marrim parasysht vazhdimisht dhe disa lëshime të bëra deri me tani, me siguri se do t'i përmirësojmë.

Ajo çka desha të theksoj, janë dy çështje që u vërejtën, dy shqetësime. Shqetësimi i parë ka të bëjë me agjendën, që po e quan ministri Gjini, apo strategjinë legjislative dhe, e dyta, me implementimin e ligjeve.

Sa i përket agjendës legjislative, e dini se e kemi ofruar një agjendë, e cila besoj që është e përballueshme për Kuvendin e Kosovës, por me siguri shumë më e ngarkuar se sa në vitet paraprake. Në agjendën tonë kemi paraparë rreth 175 ligje, të cilat do të përfshijnë ligjet që dalin apo janë procedura më herët nga Qeveria dhe kemi menduar t'i sjellim prapë, ligjet që dalin nga Pakoja e Presidentit Ahtisari, ligjet që dalin nga ndërtimi i infrastrukturës shtetërore të Kosovës, ligjet që dalin nga prioritetet e Qeverisë dhe një pjesë e ligjeve që do të jenë si rezultat i transformimit të kompetencave nga UNMIK-u në institucionet e Kosovës. Por, e tërë kjo strategji është evolutive. Në këtë strategji keni të drejtë të merrni pjesë edhe ju, të nderuar deputetë. Shumë shpejt, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, edhe qytetarët e Kosovës me një numër të caktuar të nënshkrimeve, dhe besojmë që këtë vit rreth 200 ligje do t'i miratojmë në Kuvendin e Kosovës, në mënyrë që ta ndërtojmë infrastrukturën legale të Kosovës, e cila është në tërësi në përputhje me synimet dhe vetë ekzistimin si shtet, pra duke hequr bazën legale që ka qenë para 23 marsit të vitit '89, duke hequr në një mënyrë rregulloret e UNMIK-ut dhe duke ndërtuar infrastrukturë legale që përputhet me shtetin e Kosovës, por edhe me integritet evropiane.

Një shqetësim tjetër, nga disa deputetë u përmend, do të thosha tejkalim i diskutimeve, jo me atë që ka të bëjë me ligjin, por me implementimin e tij. Janë të natyrshme këto. Edhe ne si Qeveri e kemi vërejtur dhe i kemi krijuar dy komisione: një komision që ka të bëjë kolizionin e ligjeve, ku kemi paraparë që përfaqësues të jetë edhe dikush nga Kuvendi i Kosovës, nga pushteti lokal dhe nga gjykatat, dhe një komision që ka të bëjë me monitorimin e zbatimit të ligjeve. Edhe në atë komision ka përfaqësues nga Kuvendi, nga gjykata, pushteti lokal dhe Qeveria. Por, unë ju ftoj ju, që edhe përmes komisioneve adekuate që i keni, të monitoroni zbatimin e ligjeve, nxjerrjen e akteve juridike që e plotësojnë ligjin dhe ju ftojme në bashkëpunim të plotë me Qeverinë. Ne jemi në dispozicion, që kërkesat tuaja në monitorim, kolizionin e ligjeve dhe bashkërisht ta bëjmë një sistem juridik adekuat, por edhe të ekzekutueshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatohet se debati për tri pikat e rendit mëdites për sot ka marrë fund dhe shihemi në orën 16,00, kur është votimi.

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja Urdhëro, nëse keni tjetër propozim.

RAMË BUJA: Unë besoj, jeni edhe ju në rrjedhë, që të premten jemi marrë vesh që tri ligjet e mbetura, menjëherë pas përfundimit të debatit do t'i votojmë. Kështu që, kjo besoj se do të jetë...

KRYESUESI: Unë propozoj që ta qesim në votim, që pas gjysmë ore të jetë votimi. Nëse keni propozim tjetër. Gjysmë ore pauzë dhe pastaj votimi. Kush është “për”?

Gjysmë ore pauzë, e pastaj në orën 12.00, ju lus që të vini në sallë, në mënyrë që ta kalojmë votimin.

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KRYETARI: TË nderuar deputetë,

Vazhdojmë seancën me votim në parim të projektligjeve të shqyrtuara në pjesën para pauzës.

Konstatohet se në sallë janë të pranishëm 71 deputetë, andaj fillojmë me projektligjin e parë:

- Miratimi në parim i Projektligjit për taksën e vendosjes

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij Projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për taksat e vendosjes.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisioni:

1. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisioni për Buxhet e Financa, dhe
4. Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhen që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime, Rregulla 35.6.

Vazhdojmë me miratimin, në parim, të

- Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij Projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 75 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinorë si komision funksional dhe referues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Ju njoftoj se në sallë janë 76 deputetë.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime, sipas Rregullës 35.6.

Dhe, pika e fundit e rendit të ditës për miratim është:

- **Miratimi në parim i Projektligjit për Inspektoratin e bujqësisë**

Kërkoj nga deputetët që pas zhvillimit të debatit të paradites të deklarojnë për miratimin, në parim, të këtij Projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Inspektoratin e bujqësisë.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime, sipas Rregullës 35.6.

Të nderuar deputetë,

Me këtë votim e mbyllem këtë seancë njëjavore. Mirupafshim në seancën e ardhshme.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës